

Dituri natyre

Libër për mësuesin

Terry Hudson
Alan Haigh
Debbie Roberts
Geraldine Shaw

1

BOTIME

pegi

1 Përmbajtje

Hyrje	iv	4 Shtytja dhe tërheqja	52
Mbështetja gjuhësore	xiv	Si lëvizin gjërat	54
Si të bëhesh shkencëtar?	2	Më shpejt ose më ngadalë	58
Si të bëhesh shkencëtar: Hetimi shkencor	2	Vëzhgo gjërat në lëvizje	62
How to be a Scientist: Fletët e hetimit shkencor	4	Çfarë mësuam për shtytjen dhe tërheqjen	66
1 Vetja ime	6	5 Tingujt	68
Jemi njësoj, por të ndryshëm	8	Të flasësh dhe të dëgjosh	70
Trupi ynë	10	Tingujt dhe lëvizja	76
Pesë shqisat	12	Krahasimi i tingujve	80
Çfarë mësuam për veten	16	Çfarë mësuam për tingujt	82
2 Materialet	18	6 Rritja e bimëve	84
Materiale të ndryshme	20	Pjesët e një bime	86
Vetitë e materialeve	22	Rritja e bimëve	88
Metalet dhe jometalet	24	Për çfarë kanë nevojë bimët që të rriten	96
Grupimi i objekteve	30	Çfarë mësuam për rritjen e bimëve	100
Çfarë mësuam për materialet	36	Fjalorth	102
3 Gjallesat dhe rritja e tyre	38		
Gjallesë apo jogjallesë?	40		
Ku jetojnë kafshët dhe bimët?	42		
Të ngrënë dhe të pirët	44		
Familjet	46		
Çfarë mësuam për gjallesat dhe rritjen e tyre	50		

Hyrje në fushën e shkencave të natyrës

Paketa e librave të fushës së shkencave të natyrës për klasën e parë përputhet me kurrikulën bërthamë të fushës së shkencave të natyrës për shkallët 1 dhe 2 dhe në programin e lëndës *Dituri natyre* për klasën e parë. Kjo hyrje tregon se si librat mund të ndihmojnë në zhvillimin e njohurive dhe të aftësive shkencore, si dhe të qëndrimeve dhe të vlerave të nxënësve tuaj.

Paketa përmban *Librin e nxënësit* dhe *Librin e mësuesit*. Mënyra e konceptimit dhe e hartimit të tyre përforcon bindjen se shkenca nuk është vetëm njohuri, por edhe një mënyrë të menduari e të punuari. Ajo na ndihmon të kuptojmë botën ku jetojmë dhe na jep aftësitë intelektuale që na ndihmojnë në të gjitha fushat e jetës.

Paketa ka katër qëllime kryesore:

- të japë njohuri dhe fakte shkencore;
- të mundësojë të kuptuarin shkencor;
- të mësojë metodat shkencore të kërkimit;
- të mësojë të mësuarit dhe të arsyetuarit shkencor.

Njohuritë dhe faktet shkencore

Njohuritë ose përmbajtja në paketën e klasës së parë bazohen në strukturën e programit *Dituri natyre* për klasën e parë. Librat e paketës kanë gjashtë kapituj:

Klasa 1
Kapitulli 1 Vetja ime
Kapitull 2 Materialet
Kapitull 3 Gjallesat dhe rritja e tyre
Kapitull 4 Shtytja dhe tërheqja
Kapitull 5 Tingujt
Kapitull 6 Rritja e bimëve

Libri i nxënësit i paraqet konceptet me radhë logjike dhe idetë e reja të prezantohen me masë. Në të shpjegohen konceptet shkencore kyçe dhe u kërkohet nxënësve të diskutojnë dhe të zbatojnë njohuritë e reja.

Të kuptuarit shkencor

Njohuritë pa të kuptuarin janë shterpe dhe hyjnë në punë vetëm sa për t'i kujtuar. Të kuptuarit është një nivel më i lartë intelektual që u mundëson nxënësve të mendojnë dhe të zbatojnë njohuritë. Të nxënit efektiv kërkon zhvillimin e aftësive, të sjelljeve dhe të motivimit. Kjo mund të arrihet nëpërmjet mësimdhënies efektive dhe përdorimit të burimeve të përshtatshme. Me zhvillimin e të nxënit efektiv, nxënësit përftojnë të kuptuarin e parimeve dhe të praktikës së shkencës.

Megjithëse *Libri i mësuesit* nuk është një libër teorik, është e rëndësishme të theksohen idetë që çojnë në praktika të mira në klasë. Këto praktika mbështeten në:

- strategjitë e mësimdhënies
- stilet e të nxënit
- të nxënit aktiv

Mësimdhënia

Mësimdhënia ka një rol kyç në procesin e formimit shkencor të nxënësve. Transmetimi i informacionit gjatë mësimdhënies është i rëndësishëm, por dhënia vetëm e tij vetëm sa përmirëson kujtesën afatshkurtër të nxënësve mbi faktet shkencore, por nuk i përfshin intelektualisht ata në procesin e të nxënësve. Ky lloj të nxënës quhet pasiv. Stereotipi i krijuar nga një pjesë e mësuesve është që mësuesi qëndron para nxënësve dhe u flet, duke u dhënë atyre informacionin e ri që duhet të nxënë. Supozohet që, meqenëse mësimi po përçohet, atëherë po përçohet edhe të nxënësve. Kjo didaktikë lidhet me nocionin që mësimdhënia e drejtpërdrejtë është strategjia e duhur për t'u përdorur. Në ndryshim me filozofinë e këtij stereotipi, strategjitë heuristike të mësimdhënies i nxitin nxënës të t'zbulojnë gjërat vetë nëpërmjet zbulimit dhe e vënë mësuesin në rolin e udhëzuesit dhe të lehtësuesit. Është e qartë që më shumë se sa dy pole, këto filozofi zënë dy skajet e një spektri. Nuk ka gjasa që përvoja e të nxënësve të jetë vetëm didaktike ose vetëm udhëzuese dhe është e vështirë të imagjinosh që cilido mësues, pavarësisht filozofisë së tij personale, do të mbështetet plotësisht vetëm te njëra ose vetëm te tjetra. Secila ka epërsitë dhe të metat e veta.

Stilet e të nxënësve

Stili i të nxënësve është një metodë personale dhe e parapëlqyer e individit, për ta organizuar e për ta pasqyruar informacionin. Mënyra e të nxënësve ose mënyra e të menduarit ndikon në mënyrën se si e shohin dhe e kuptojnë botën nxënësve tanë.

Stilet e të nxënësve zakonisht klasifikohen sipas dy përmasave. Përmasa analitiko-holistike. Një njeri e organizon informacionin si një të tërë apo në pjesë?

1 Përmasa verbalo-pamore. Një njeri e pasqyron informacionin me fjalë apo me pamje?

Këto mund të tregohen si vijon:

Holistik ← → Analitik
Verbal ← → Pamor

Kjo na ndihmon të kuptojmë se disa nxënës kur studiojnë një kapitull ose një temë priren të shohin tërësinë, kurse disa të tjerë ndihen më të qetë nëse studiojnë vetë një ose dy pikëpamje të tij. Verbalizuesit mendojnë nëpërmjet fjalëve ose shprehjeve verbale. Imagjinuesit përfytyrojnë pamje mendore kur u paraqitet informacioni. Këto mënyra të nxënësve kanë një ndikim madhor në përpunimin e informacionit.

Epërsitë		Epërsitë
- Objektiva të qarta të të nxënësve. - Mësuesi demonstroi një trajtim profesional, p.sh. prezantime. - Mësuesi shihet si "ekspert". - Më pak probleme me menaxhimin e klasës dhe të sjelljes.		- Mund të jetë motivues dhe i fuqishëm. Zhvillon një gamë aftësish. - Të nxënësve është i përshtatshëm. - Nxit krijimtarinë dhe zgjidhjen e problemeve. - Nxënës ka pjesën e vet në procesin e të nxënësve.
Didaktik	← →	Udhëzues
Të metat		Të metat
- Mund të ndërtojë njohuri të pasakta. - Mund të mos jetë motivues. - Nuk zhvillon aftësi. - Nuk i jep përgjegjësi nxënësve. - Kufizohet nga mësuesi.		- Mund të mos merret me parime themelore: tepër pragmatist. - Nëse zhvillon vetëm aftësitë që nxënësve i ka, mund të mos nxitet zhvillimi i aftësive të reja të tij. - Mungesa e strukturës mund t'i hutojë nxënësve. - Menaxhimi i klasës mund të jetë problematik.

(Cotton, J., 1995, The Theory, Learning, An and Introduction, Kogan Page, London)

Siç duket, është thelbësore që të jemi të ndërgjegjshëm mbi mënyrat e mundshme të të nxënës dhe të sigurohemi se qëndrimi ynë nuk ka tepri të njërit stil dhe dëmtim të tjetrit. Për shembull, verbalizuesit përdorin marrëdhëniet dhe grupimet shoqërore për të diskutuar idetë e tyre, për të ndihmuar të nxënës, ndaj ata do të përfitonin më shumë nga diskutimi i punës në grup. Imagjinuesit janë më pak të pavarur ndaj të folurit, kur përpiqen të kuptojnë diçka.

Kjo lidhet me teorinë e Inteligjencave të shumëfishta të Hauard Gardner (*Howard Gardner*), e cila ngjason me më të thjeshtin, por dhe më të cituarin model të mënyrës së të mësuarit: Pamor, Dëgjimor, Kinestetik (lëvizor) (PDK¹), i zhvilluar në vitet '20. Gardner identifikoi disa lloje të ndryshme inteligjence dhe përdorimi këtij modeli pati një ndikim kyç mbi mësimdhënien. Shtatë inteligjencat janë:

- gjuhësore - fjalët dhe gjuha
- logjiko-matematikore - logjika dhe numrat
- muzikore - muzika, tingulli, ritmi
- trupore-kinestetike - kontrolli i lëvizjes së trupit
- hapësinore-pamore - pamja dhe hapësira
- ndërpersonale - ndjenjat e të tjerëve
- intrapersonale - vetëndërgjegjësimi

Gardner argumentonte se lloji i inteligjencës ndikon mbi mënyrën e parapëlqyer të të nxënës. Për shembull, një njeri që është shumë logjik dhe matematik, por i dobët në aftësitë gjuhësore, mund t'i zhvillojë këto të fundit, duke u nxitur të flasë dhe të shkruajë për matematikën dhe numrat. Modeli PDK pranon që njerëzit nxënë në mënyra të ndryshme. Sipas këtij modeli, shumica e njerëzve zotërojnë një model dominues të të nxënës, por disa mund të jenë edhe një përzierje e dy ose tre prej tyre. Modelet janë:

- pamore - të shikuarit dhe të dëgjuarit
- dëgjimore - të dëgjuarit dhe të folurit
- kinestetike - të prekurit dhe të bërit

Është e qartë se nëse e pranojmë këtë model, atëherë puna jonë me nxënësit duhet të përfshijë pikëpamje të ndryshme të secilit model të parapëlqyer. Një nxënësi që parapëlqen modelin pamor të të nxënës, do të mbetej pas ose mbase do të humbte edhe motivimin, nëse do t'i duhej të dëgjonte për periudha të gjata kohore. Po ashtu, një nxënësi që nxë sipas modelit kinestetik do të

parapëlqente të bënte gjëra, në vend që të shikonte dhe të dëgjonte.

Lev Vigovski (Lev Vygotsky) nxjerr në pah rolin jetik të gjuhës në zhvillimin e fëmijëve dhe nevojën për t'i marrë parasysh faktorët shoqërorë e kulturorë. Ai thekson se më thelbësorja, është rëndësia e marrëdhënieve shoqërore mes mësuesve dhe atyre që nxënë, e atyre që nxënë dhe të tjerëve që nxënë.

Gjuha dhe diskutimi funksionojnë aty ku janë kyçe për zhvillimin. Në vitet '70 Benxhamin Blum (*Benjamin Bloom*) propozoi një "taksonomi arsimore", duke identifikuar fushat e ndryshme të të nxënës:

- konjitive/njohëse (njohuritë)
- afektive/emocionale (qëndrimet dhe sjelljet)
- psikomotore (aftësitë)

Ideja e Blumit mbi fushën njohëse ka ndikuar shumë mbi mësuesit dhe mësimdhënien. Fusha mund të shihet si shkallë që fillon me memorizimin dhe vazhdon me detyra më komplekse, si analiza. Kjo na jep çelësin përparimit në veprimtaritë tona komplekse. Gjashtë nivelet e taksonomisë së Blumit janë:

- Njohja
- Të kuptuarit
- Zbatimi (përdorimi)
- Analiza
- Sintezë
- Vlerësimi

Taksonomia e Blumit i ka ndihmuar mësuesit të hartojnë detyra, të sigurojnë vazhdimësinë e tyre dhe të bëjnë pyetje të përshtatshme për nivelin e të menduarit të nxënësve. Kjo është thelbësore kur synoni të zhvilloni aftësitë e nxënësve tuaj në të menduar e në të arsyetuar.

Të nxënës aktiv

Qasjet e të nxënës aktiv janë hartuar që t'i nxitin nxënësit të merren me detyrat dhe të zhvillojnë aftësi, që zor se mund të zhvillohen gjatë mësimëve didaktike të udhëhequra nga mësuesi. Në këtë kuptim, të nxënës aktiv është një term i përgjithshëm, që bën bashkë një sërë modelesh të mësimdhënies, të cilat rrjedhin nga idetë e "të nxënës nëpërmjet zbulimit".

¹ Në original: *Visual, Auditory, Kinaesthetic (VAK)*

Të nxënit me mësuesin në qendër	Të nxënit me nxënësin në qendër
Mësuesi shpjegon.	Punohet në grup.
Theksi vihet te konkurrenca.	Theksi vihet te bashkëpunimi.
Mësimdhënia nuk bazohet në grupe të vogla, por në gjithë klasën.	Të nxënit bazohet në burime.
Mësuesi është përgjegjës për të nxënit.	Nxënësi është më i përgjegjshëm për të nxënit.
Mësuesi siguron dijet.	Mësuesi shihet si udhëzues, lehtësues.
Nxënësi shihet si enë e zbrazët që duhet mbushur.	Nxënësi ka pronësi mbi idetë dhe punën.
Vlerësohet njohuria mbi lëndën.	Vlerësohen aftësitë në proces.
Disiplina imponohet nga mësuesi.	Vetëdisiplinim.
Theksohet roli i mësuesit dhe i nxënësit.	Nxënësi shihet si burim dijeshe dhe idesh.
Mësuesi përcakton programin mësimor.	Nxënësi përfshihet në planifikimin e programit mësimor.
Nxënësit ka rol pasiv.	Nxënësi përfshihet aktivisht në procesin e të nxënit.
Stilet e të nxënit dhe veprimtaritë e të nxënit merren pak parasysh.	Merret parasysh një gamë e gjerë stilesh të të nxënit.

Është e rëndësishme të vërejmë se tabela e mësipërme nuk tregon mësimdhënie të keqe në të majtë (të nxënit me mësuesin në qendër) dhe mësimdhënie të mirë në të djathtë (të nxënit me nxënësin në qendër). Ka disa të dhëna që sugjerojnë se mësimdhënia ndaj të gjithë klasës, mund të jetë po aq efektive sa edhe mësimdhënia individuale, sidomos në kushtet e kohës që nxënësi shpenzon me detyrën. Çelësi i mësimdhënies efektive është përzgjedhja e përshtatshme në çdo kohë, me çdo grup të caktuar. Faza më e përshtatshme do të ishte: “Përshtatshmëri për të arritur qëllimin”.

Strategji të të nxënit aktiv

- Diskutime në grup (të folurit dhe të dëgjuarit)
- Të lexuarit aktiv
- Të shkruarit aktiv
- Prezantime
- Luajtje rolesh ose teatër
- Teknologji e informacionit
- Vizita, vizitor dhe punë në terren
- Trajtim i të dhënave
- Zgjidhje e problemit
- Regjistrime video dhe audio
- Lojëra dhe stimulime

Në vijim të ideve dhe të filozofive të paraqitura më sipër, *Libri i nxënësit* i prezanton idetë në shumë mënyra: me shkrim, me diagrame, me grafikë, me tabela dhe me fotografi. Mësimi përmban një larmi të pasur mënyrash të të nxënit dhe të mësimdhënies, si lexime dhe shkrime individuale, diskutim pune në grupe dhe çifte, veprimtari dhe

diskutime të të gjithë klasës, zgjidhje të problemeve, hetime, veprimtari kërkimore, prezantime, analiza, përmbledhje dhe pasqyrime. Për më tepër, në *Librin e Mësuesit* përfshihen sugjerime për veprimtari të tjera, si ekskursione dhe vizita arsimore.

Kërkimi shkencor – të nxënit e proceseve shkencore

Kjo paketë mbështet dhe zhvillon hetimin shkencor. Nxënësit nxiten të mendojnë dhe të pasqyrojnë mënyrat e ndryshme të punës dhe të të menduarit të shkencëtarëve. Ajo bazohet tek *empirizmi*: të mbërrish te dija dhe të kuptosh, nëpërmjet vëzhgimit dhe eksperimentimit.

Shkencëtarët bëjnë përparime nëpërmjet vëzhgimit dhe ngritjes së pyetjeve mbi atë që shohin dhe që dinë. Në këtë mënyrë, ata zhvillojnë hipoteza, që i testojnë nëpërmjet eksperimenteve, për të zbuluar të vërtetën dhe për të zhvilluar dije të reja. Kjo thellohet më tej në temën “Si të bëhesh shkencëtar”, në *Librin e nxënësit* dhe në shënimet e mësimdhënies.

Shkenca u mëson nxënësve të mendojnë në mënyrë të strukturuar, gjë që është e mirë për të analizuar dhe zgjidhur probleme. Megjithatë, shkenca është edhe një aventurë krijuese njerëzore dhe është e rëndësishme që nxënësit ta kuptojnë këtë. Imagjinata është thelbësore për përparimin shkencor, ashtu siç është edhe për letërsinë dhe artet e tjera.

Librat e kësaj pakete u lejojnë nxënësve të zhvillojnë aftësitë e hetimit shkencor, duke u marrë me çdo

proces të përshtatshëm të hetimit shkencor, në çdo fazë. Për më shumë, nxënësit nxiten të planifikojnë dhe të kryejnë hetime në shkallë të gjerë në klasat e mëvonshme, si zbatim i aftësive të nxëna më herët.

Të menduarit dhe të arsyetuarit shkencor

Është thelbësore që ashtu siç marrin njohuri shkencore, nxënësit të nxiten dhe të mësojnë të mendojnë e të arsyetojnë me kokën e tyre. Përveçse janë aftësi të rëndësishme në jetë, kompetencat e të menduarit, të arsyetuarit dhe kërkimit i bëjnë nxënësit të mësojnë të pavarur dhe të lirë, madje janë në gjendje t'i interpretojnë e t'i kuptojnë më shpejt idetë e reja. Në këtë paketë, kompetenca e të menduarit dhe e të arsyetuarit nxitet, ushqehet, praktikohet dhe vlerësohet në çdo nivel. Shkencëtarët përdorin të menduarin logjik deduktiv për të arritur në konkluzione të bazuara mirë, duke

u nisur nga e njohura, për të zbuluar të panjohurën. Ata përdorin arsyen dhe argumentin e bazuar mbi fakte e prova, për të vërtetuar çështjen e tyre. Duke u lejuar nxënësve të përjetojnë këto procese, kurioziteti dhe entuziazmi i tyre do të ngrihet në atë pikë që kërkesa për të nxënë një dorë faktesh, nuk e arrin dot. Të gjitha premiset e "të nxënësve nëpërmjet zbulimit" është se kështu u lejojmë nxënësve të përjetojnë emocionin e zbulimit.

Mësuesit duhet t'i bëjnë ballë tundimit, për t'ua treguar përgjigjet, për t'u dhënë zgjidhje dhe për t'u ofruar më shumë mbështetje nga ç'duhet nxënësve të tyre. Veprimtaritë e të nxënësve në libra dhe mbështetja e ofruar në *Librin e mësuesit*, ndihmon për krijimin e një ambienti të të nxënësve, ku edhe nxënësit mund të planifikojnë, të zbulojnë e të mësojnë vetë ide të reja – me ju si udhëzues e lehtësues. Jepuni kohë t'i mendojnë e t'i diskutojnë idetë, para se t'i drejtoni me dashamirësi ata që kanë nevojë për mbështetje.

Teknika të mësimdhënies

Kjo është një hyrje e shkurtër për disa teknika të mësimdhënies, që do t'ju ndihmojnë në procesin e mësimdhënies dhe të të nxënësve. Mund të provohet se shkenca përbëhet nga tri pjesë:

- fakte shkencore
- njohuri shkencore
- të kuptuarit shkencor

Faktet dhe njohuritë shkencore hyjnë shumë në punë, por për fat të keq, ato jo gjithmonë çojnë në të kuptuarin shkencor. Të jesh në gjendje të mbash mend fakte dhe njohuri shkencore është e nevojshme, vetëm kur të kërkohet të kujtosh një fakt të caktuar. Për shembull:

Pyetje: Cili ishte shkencëtari që zbuloi forcën e gravitetit?

Përgjigje: Isak Njutoni

Të dish përgjigjen e kësaj pyetjeje nuk e çon të nxënësit më tej. Nuk kërkon aftësi më të larta të menduarit, as të ndihmon për zgjidhjen e problemeve të tjera. Por, nëse një nxënëse kupton teorinë e gravitetit të Njutonit dhe lëvizjen, ai mund të fillojë të shpjegojë e të parashikojë se si do të lëvizin, do të notojnë e do të fluturojnë gjërat. Të kuptuarit u jep mundësinë nxënësve t'i zbatojnë dijet, të zgjidhin problemet dhe ta çojnë më tej nxënësin e tyre.

Kjo seri synon të japë jo vetëm fakte e njohuri shkencore, por edhe të kuptuar shkencor. Disa strategji janë më të mira në të mësuarin e të kuptuarit, sesa të tjerat.

Pyetjet efektive janë çelësi

Njerëzit mund të mësojnë të kuptojnë duke dëgjuar dhe duke lexuar, por kjo është e mundur vetëm nëse kanë arritur teknika të sofistikuar të të nxënësve dhe kanë formim të mjaftueshëm njohurish dhe të kuptuarit, që mund të përkojë me çdo ide të re. Prandaj mund ta çoni më tej të kuptuarin, për shembull për mësimdhënien tuaj, nëpërmjet këtyre përjasjeve, por kjo nuk funksionon për nxënësit e vegjël. Për nxënësit pa përvojë dhe me shumë pak aftësi, është mësuesi ai që iu mundëson përparimin nga *cekëtinat e thirrjes në kujtesë tek thellësitë e të kuptuarit*. Qasjet ndaj të nxënësve dhe mësimdhënies në këtë paketë përqendrohen te mësimdhënien e të kuptuarit. Natyrisht që mbulohen edhe faktet e dijet shkencore, ndryshe do të kishte mangësi konteksti dhe përmbajtjeje, por veprimtaritë janë hartuar në mënyrë të tillë që të zhvillojnë të menduarin dhe aftësitë e të nxënësve. Kërkimet na tregojnë se mësuesit ngrenë deri 400 pyetje në ditë. Kjo mund të jetë 30% e kohës së mësimdhënies. Është e qartë se kjo kohë e shpenzuar për të përmirësuar teknikat

tona të ngritjes së pyetjeve, do të kenë një ndikim të rëndësishëm mbi të nxënësit. Po ju japim disa ide të pyetjeve të ndërlikuara, që mund t'i përdorni gjatë procesit mësimor:

- Pse po e bën pyetjen?
- Ç'lloj pyetje do të bësh?
- Kur do t'i bësh pyetjet?
- Si do t'i bësh pyetjet?
- Cilëve prej tyre do t'ua bësh pyetjet?
- Si pret të të përgjigjen?
- Si do të përgjigjesh, nëse personi s'e kupton pyetjen?
- Si do të reagosh ndaj një përgjigjeje të papërshtatshme ose të gabuar?
- Si do të reagosh ndaj një përgjigjeje të përshtatshme?
- Sa do të presësh për një përgjigje? Si mësues, ne bëjmë pyetje për një sërë arsyes:
- për të tërhequr vëmendjen;
- për të kontrolluar nëse nxënësit e kanë mendjen;
- për të kontrolluar të kuptuarit;
- për të përforcuar ose për të ndrequr një temë;
- për të rritur të kuptuarit;
- për të nxitur të menduarit;
- për të zhvilluar një diskutim.

Për t'u përqendruar te të menduarit e të kuptuarit, na duhet t'i rikthehemi *Blumit*. Ashtu siç thamë, *Blum* përshkruan gjashtë nivele të procesit të të menduarit:

- njohja
- të kuptuarit
- zbatimi
- analiza
- sintetizimi
- vlerësimi.

Kjo thekson nevojën për të ngritur pyetje të përpiluara në mënyrë të tillë që të nxitin mendim më të thellë. Nëse bëjmë vetëm pyetje në nivelin e njohjes, nuk do t'i nxitim nxënësit të analizojnë ose të sintetizojnë ide të reja. Duhet të mendojmë edhe për natyrën dhe stilin e pyetjeve tona. Dy kategoritë kryesore të pyetjeve janë: pyetje të mbyllura dhe pyetje të hapura.

Pyetje të mbyllura

Këto pyetje kanë prirjen të kenë vetëm një ose sasi të kufizuara përgjigjesh të sakta. Ato kërkojnë thirrjen në kujtesë të fakteve. Janë të nevojshme për seancat e pyetjeve dhe të përgjigjeve në grup, për t'i kontrolluar nxënësit shpejt, për t'ua rifreskuar kujtesën ose dhe si lidhje për një veprimtari të re. P.sh.:

Pyetje: Cila është temperatura e zierjes së ujit në nivelin e detit?

Përgjigje: 100°C.

Pyetje: Cilat janë tri fazat e ciklit të ujit?

Përgjigje: Ujë, re, shi.

Pyetjet e mbyllura janë shumë të mira për të thirrur njohuritë në kujtesë, por përgjithësisht nuk të bëjnë produktivë në lidhje me diçka tjetër.

Pyetje të hapura

Këto lloj pyetjesh mund të kenë disa përgjigje të ndryshme dhe mund të jetë e vështirë të vendosësh se cila është e sakta. Përdoren për të zhvilluar të kuptuarin dhe për të nxitur njerëzit të mendojnë për problemet dhe idetë. Këto i nxitin njerëzit të mendojnë, ta tjetërsojnë informacionin dhe janë shumë më të ndërlikuara. Prej tyre nuk kërkohet një përgjigje e vetme e saktë, po kërkohet që nxënësi të mendojë se cila mund të jetë e sakta. Kur mësuesi i ka vënë nxënësit të mendojnë, atëherë ai mund ta përdorë këtë informacion për t'i çuar të gjithë nxënësit drejt përgjigjes së saktë, ndërsa, në të njëjtën kohë, nxit të kuptuarit. Prandaj këto pyetje janë produktive në termat arsimorë. P.sh.:

Pyetje: Nga mendoni se vjen uji që gjendet në retë e shiut?

Përgjigje: Çdo përgjigje do ketë nga pak "të drejtë" brenda saj, që mësuesi mund ta përdorë. Nxënësit mund të përgjigjen "Nga deti".

Pastaj mësuesi mund të ndjekë linja të mëtejshme të hetimit për të shtrirë të nxënësit. Për shembull, mësuesi mund të pyesë: "A dini vende të tjera prej nga mund të vijë uji?" ose "Si mendoni se hyri uji te retë?". Këto pyetje ndjekëse me "si" dhe "pse" i nxitin nxënësit të mendojnë më thellë për shkencën dhe të kuptuarit e tyre mbi idetë kyçe dhe parimet. Pyetjet e hapura kërkojnë që nxënësit të bëjnë lidhjet mes ideve dhe të zbatojnë njohuritë. Ato shpesh kërkojnë që nxënësit të shfrytëzojnë logjikën dhe imagjinatën. Pyetjet e hapura kërkojnë një kohë më të gjatë të të menduarit dhe të të përgjigjurit, sesa

pyetjet e mbyllura dhe mund të çojnë në diskutime ose debate më të gjera.

Vargjet e pyetjeve

Pyetjet e hapura dhe të mbyllura mund të lidhen së bashku për të krijuar një varg. Një varg i planifikuar mirë, mund të çojë në të kuptuar shumë më të përmirësuar. Filloni me disa pyetje të mbyllura, të ngritura mbi fakte relativisht të thjeshta dhe shkoni drejt pyetjeve më të hapura. Kjo njihet si “ndërtimi i agjendës”. Në të njëjtën kohë, ju mund të kaloni nga individ i tek çifti dhe pastaj në diskutime me grupe të vogla, ndërsa pyetja sa vjen e hapet dhe kërkon të menduar të nivelit më të lartë. Me këtë varg ne nxitim një “klasë hetuese”, ku përdoren pyetjet e mbyllura, por edhe pyetjet e hapura, për të ngacmuar mendjet hetuese.

Teknika pyetjesh e përgjigjesh – disa këshilla

1 Teknika “mos i drejto nxënësit drejt tunelesh të errëta”

Nxënësit duhet ta dinë se ku po shkojnë para se të fillojnë rrugëtimin e tyre të të nxënës, prandaj tregojani këtë. Për shembull:

“Sot do të mësojmë se si magnetet reagojnë ndaj njëri-tjetrit.”

Kjo u jep nxënësve idenë e madhe mbi të cilën mund të varin informacionin që do të pasojë dhe ta kuptojnë atë.

2 Teknika “pyeti nxënësit se çfarë mendojnë”

Nxënësve zakonisht u mungon besimi t’u përgjigjen pyetjeve si:

“Si hyri uji i detit në re?”

Veç në mos qofshin të sigurt për përgjigjen e saktë, me gjasë do të ngurrojnë të përgjigjen, sepse druajnë se mos nuk ia dalin dot mbanë. Gjithsesi, ju mund ta riformuloni pyetjen dhe të thoni:

“Si mendoni, si mund të jetë ngjitur uji nga deti drejt reve?”

Kështu u jepni leje ta provojnë, edhe pse nuk janë të sigurt se do të jenë të saktë. Në këtë mënyrë nuk do të keni gjithmonë të njëjtët nxënës të gatshëm për t’u përgjigjur dhe mund t’u krijoni besim edhe nxënësve të tjerë, duke u rritur vetëvlerësimin.

3. Teknika “lëvdoji të gjitha përgjigjet”

Nëse nxënësit tanë do të kenë besimin ta ndajnë me të tjerët atë që mendojnë dhe të sugjerojnë, atëherë na duhet t’i vlerësojmë dhe t’i falënderojmë për përpjekjet e tyre, pavarësisht se sa mund të kenë gabuar; edhe në qoftë: “goxha tentativë, por nuk është ende përgjigja e duhur. Prit se mos të ndihmoj - mendon se mos ka ndonjë lidhje me nxehtësinë e Diellit?”

Zakonisht ka një gjurmë saktësie në përpjekjet e shumicës së nxënësve, që ne mund ta lëvdojmë.

4. Teknika “shpjego nëpërmjet përgjigjeve të nxënësve”

Një mësues mund të bëjë një pyetje të tillë:

“Pse ka 600 fara një shalqi?”

Si nxënës, unë nuk e di përgjigjen dhe kam frikë mos dështoj.

Nëse mësuesi përdor teknikat 2 dhe 3, pra i pyet nxënësit se çfarë mendojnë dhe ua vlerëson përgjigjet, atëherë kjo linjë produktive hetimi do t’i japë mësuesit mundësinë ta çojë një nxënës dhe gjithë klasën, jo vetëm drejt përgjigjes së duhur, por edhe drejt të kuptuarit.

Arti i këtyre teknikave është të përzgjedhësh elementet e saktësisë nga nxënësit dhe pastaj ta zgjerosh e të shpjegosh, duke i ndihmuar të gjithë nxënësit të kuptojnë. Për shembull:

Nxënësi: Mendoj sepse duan të rrisin shumë shalqinj të rinj!

Mësuesi: Përgjigje e mirë. Çështja është rritja dhe jeta e re. Gjithsesi, mendon se kur një shalqi zhvesh farat, do të mbijojnë edhe 600 shalqinj të rinj krah tij?

Nxënësi: Jo, jo që të 600 farat!

Mësuesi: Mirë, kjo është e rëndësishme. Sapo më the se jo të gjitha mbijetojnë. Sa mendon se mbijetojnë?

Kështu mësuesi drejton dhe u shton informacion përgjigjeve të nxënësit për të arritur tek të kuptuarit e “të prodhuarit shumë, që të mund të mbijetojnë pak për të përçar specien”. Këtë mund t’ua tregoni nxënësve që në fillim sipas mënyrës së mësimdhënies me mësuesin në qendër ose sipas modelit didaktik, por gjithsesi do të zbuloni se, për shkak se nxënësit janë përfshirë në mënyrë aktive në këtë rrugëtim, ata jo vetëm do kujtojnë, por edhe do të kuptojnë.

5. Teknika “mos i lër nxënësit të përpëlitën”

Nëse zbuloni se po bëni pyetje dhe përgjigjet nuk

po i afrohen fare asaj që kërkoni, atëherë thojni nxënësve përgjigjen ose sugjeroni të zgjedhin nga një mori përgjigjesh. Pa këtë, progresi i mësimit ndalet, dhe si nxënësit, ashtu edhe mësuesi irritohen. Çoje mësimin përpara. Thojeni përgjigjen, zgjeroheni dhe shpjegojeni.

6 Teknika “e përgjigjes së duhur”

Nëse merrni përgjigjen e duhur, atëherë është shumë mirë, apo jo? Vetëm personi që ka dhënë përgjigjen e kupton pse është e saktë, ndaj duhet ta zgjeroni e ta shpjegoni, që edhe pjesa tjetër e klasës të mund të kuptojë si nxënësi.

Mësuesi: Përgjigje e mirë. Ç’të bëri ta mendoje?

Mësuesi: E kuptoj se ç’deshe të thuash; bëre lidhjen mes ibrikut që zien dhe avullit dhe mendove se nxehtësia e Diellit i bën të njëjtën gjë detit, vetëm se është e padukshme. Shumë mirë!

Teknika të mësimitdhënies me bazë hetimin shkencor

Teknikat e mësimitpërme të pyetjeve janë të njëjtat strategji të përdorura në *Librin e nxënësve*, në hetimin shkencor. Gjithsesi, në hetimin shkencor duhet shtuar një shtresë metodologjie, pasi aty duhet të mësohen këto aftësi shkencore: vëzhgimi, krahasimi, parashikimi, identifikimi i faktorëve, kontrolli i ndryshoreve, testimi me një ndryshore, regjistrimi dhe interpretimi. Teknika juaj duhet të zgjerohet si në pyetje mbi proceset, ashtu edhe në pyetje mbi përmbajtjen. Për shembull:

- Çfarë mendoni se do të ndodhë?
- Pse ju kërkohet të shtoni ujë? Çfarë arrini të shihni? A keni parë herë tjetër diçka të ngjashme?
- Si do ta provoje për të parë se cili është më i thatë?

- Pse nuk ishte testim me një ndryshore më parë?

Libri i nxënësit përfshin një sërë shembujsh me pyetje të tilla, por ju do të mund t’i ndiqni dhe t’i shndërroni në një mënyrë të thjeshtë për t’i nxitur nxënësit të mendojnë për shkencën. Kur tregoni një fenomen ose diskutoni një ide, bëjuni nxënësve pyetjeve të bazuara mbi hetimin. Përfshini edhe pyetje për sigurinë dhe për përdorime të shkencës në jetën e përditshme. Një qasje që bazohet në hetim, i nxit nxënësit të mendojnë “pse” dhe “si”, jo vetëm “çfarë”.

E gjithë klasa ose puna në grup

Metoda e pyetjeve dhe e përgjigjeve ndaj gjithë klasës funksionon shumë mirë dhe veprimtaritë e strukturuar mirë për të gjithë klasën mund t’i ndihmojnë nxënësit të plotësojnë detyrën. Gjithsesi, kontributet dhe përfshirja zakonisht arrihen me grupe të vogla.

Puna në grup mund t’i ndihmojë nxënësit të nxënë në mënyrë më efikase. Ata mund ta mësojnë më mirë shkencën dhe të nxënit bashkëveprues, çka mund të ndihmojë në kohezionin shoqëror, motivimin dhe përmirësimin e vetëvlerësimit. Nxënësit që janë të ndrojtur kanë më shumë gjasa të kontribuojnë në një diskutim me një tjetër person, ose me një a dy të tjerë që dalin vullnetarë të japin ide para gjithë klasës. Për më tepër, duke ndarë punën, nxënësit mund të mbulojnë më shpejt dhe më shumë terren. Grupi i vogël është gjithashtu një forum i mirë për të prodhuar krijimtari.

Një përparësi tjerë që nuk duhet nënvleftësuar është se puna në grupe të vogla e çliron mësuesin nga të ndenjurit para klasës dhe nga të drejtuarit e saj si një e tërë. Mësuesi mund të lëvizë nëpër klasë dhe ta drejtojë vëmendjen, kur dhe ku ka më shumë nevojë. Nevojat individuale marrin përgjigje më të mirë kështu.

Si t’i përdorim këta libra

Libri i nxënësit

Faqet hapëse

Secila temë fillon me faqe plot ngjyra vërtet mbresëlënëse. Qëllimi i këtyre faqeve është të fillojë temën e kapitullit me një gamë pamjesh dhe veprimtarish ngacmuese, për t’i përfshirë nxënësit menjëherë në idetë kryesore pas kapitullit. I nxit edhe të mendojnë për dijet dhe të kuptuarin që kanë. Këto faqe mbresëlënëse janë më së shumti

me pamje, por kanë edhe pyetje të shkurtra dhe veprimtari për të prezantuar një skicë të shpejtë të asaj që mbulohet dhe për të nxitur diskutimin.

Kjo mund t’i ndihmojë nxënësit të shohin pamjen e plotë të kapitullit dhe përmbajtjen e tij. Nxitni sa më shumë biseda që të jetë e mundur kur të përdorni faqet mbresëlënëse. Ato ju japin një mundësi të shkëlqyer që të theksoni hetimin shkencor dhe aftësitë e vëzhgimit.

Faqet e temës

Shumica e faqeve të temës në çdo temë lidhet me përmbajtjen ose hetimin shkencor të kapitullit. Secili lidhet drejtpërsëdrejti me rezultatin e të nxënësit për atë temë.

Faqet kanë shumë figura, me pamje tërheqëse dhe domethënëse, diagrame dhe veprimtari. Ka pesë lloj veprimtarish:



Veprimtari me shkrim. Ka hapësira ku nxënësit regjistrojnë përgjigje të shkurtra për pyetjet kyçe, duke përdorur informacionin në faqe.



Veprimtari diskutimi. Nxënësit nxiten të diskutojnë ide e qasje shkencore dhe pritjet të punojnë në çifte dhe në grupe të vogla tre-katër veta, për këto lloj veprimtarish.



Zbulo. Nxënësit prezantohen me çdo zbulim në *Librin e nxënësit* dhe nxiten të përdorin *Blokun e shënimeve* si shtesë ndaj *Librit të Nxënësit* për të regjistruar planet, shënimet shkencore dhe rezultatet për secilin zbulim. Zbulimet mbështeten me udhëzime hap pas hapi në *Librin e mësuesit*.



Veprimtari matëse



Pyetjet “Si mendon?”

Libri i mësuesit

Ky libër përmban përgjigje për pyetjet me shkrim dhe sugjerime përgjigjesh që mund të merren nga nxënësit, kur përfshihen në veprimtari diskutimesh. Për më tepër, sigurohet mbështetje duke sugjeruar veprimtaritë e zgjeruara dhe pyetjet në vijimësi, që mund të doni t'i përdorni.

Zbulo

Një përbërës kritik dhe i përbashkët i faqeve të *Librit të nxënësit* janë veprimtaritë e hartuara për t'i ndihmuar njerëzit të zhvillojnë aftësitë e tyre të hetimit shkencor. Nxënësit nxiten të bëjnë parashikime, të hartojnë e të planifikojnë hetime, të zbatojnë hetimet e përzgjedhura, të analizojnë, të mbledhin, të interpretojnë dhe të analizojnë rezultate. Ndonjëherë aftësitë e hetimit shkencor trajtohen më vete dhe herë të tjera, sidomos në fazat e mëvonshme, pritjet që nxënësit t'i organizojnë vetë dhe të bëjnë hetime relativisht të ndërlikuara.

Për të mbështetur zhvillimin e kësaj aftësie, veprimtaritë e hetimit kanë udhëzime të qarta ose, nëse janë bërë enkas, që rezultatet të jenë të hapura, mbështeten nga një sërë pyetjesh ndihmëse ose

udhëzime. Shënimet e mësimdhënies mbështesin organizimin e klasës, procesin e hetimit, rezultatet e pritshme dhe burimet e nevojshme.

Blloku i Zbulimit

Përgjigje të shkurtra ndaj pyetjeve zbuluese mund të shkruhen në hapësirën e duhur në *Librin e nxënësit*, por kur kërkohet planifikimi dhe hartimi i hetimeve më të detajuara, nxënësit këshillohen të përdorin një Bllok Zbulimi shtesë. Sugjerojmë t'u jepni nxënësve nga një bllok shënimesh me faqe të bardha A4 në fillim të çdo faze, që të mund ta përdorin për hetime gjatë gjithë vitit. Kjo u mëson modelin se si punojnë shkencëtarët dhe mund të siguroheni se nxënësit mbajnë plane të detajuara, shënime, regjistrime të dhënash, ide dhe përmbledhje në këtë bllok shënimesh. Kjo bën që *Libri i nxënësit* të mbetet për përgjigje më të shkurtra dhe më të përqendruara.

Pyetjet “Si mendon?”

“Secila temë përmban nëpër të edhe pyetje të shpejta “Si mendon...? këto kanë si synim t'i nxitin nxënësit të mendojnë më thellë mbi një koncept ose të përpiqen ta zbatojnë një ide në një kontekst të ri. Këto janë shumë të nevojshme në zhvillimin e aftësive të të menduarit dhe mund të përdoren edhe për të bërë dallime.

Vlerësim formues

Çdo temë në një kapitull ka një mundësi vlerësimi të përfundimit të temës. Këtu përfshihen pyetje në një mori formatesh: lojëra të vogla, lojëra me enigma, diagrame për t'u etiketuar, që i nxitin nxënësit të provojnë të kuptuarit e tyre mbi objektivin që sapo është mbuluar nga tema. Në shënimet e mësimdhënies gjenden këshilla se si mund të përdoren dhe të përfshihen në mësim.

Për më tepër, çdo kapitull në *Librin e nxënësit* përfundon me një pjesë “Çfarë mësuam për...”. Paçka se janë vendosur në fund të modulit, këto faqe janë hartuar të përdoren gjatë tij. Pas përfundimit të çdo teme dhe kryerjes së vlerësimit formues, nxënësit mund të ndalojnë tek veprimtaritë përkatëse në faqet “Çfarë mësuam për...”. Këto do të jenë një testim i shkurtër i të kuptuarit dhe një mundësi për të vetëkontrolluar përparimin dhe besimin. Duke iu kthyer faqeve “Çfarë kemi mësuar për...” nëpër gjithë kapitullin, ndërsa mbulohet secila temë, nxënësit përfshihen në mënyrë të vazhduar me procesin e shqyrtimit dhe të pasqyrit.

Vlerësim përmbledhës

Në fund të kapitullit, mund t'u kërkonti nxënësve të shohin faqet shqyrtues dhe të marrin në konsideratë progresin që kanë bërë. Ata mund të shohin sërish përgjigjet e hershme dhe të monitorojnë progresin e tyre. Shprehja e nivelit të sigurisë lihet në zgjedhjen tuaj. Nxënësve u tregohet një rreth i zbrazët, të cilin mund të kërkonti ta plotësojnë në disa mënyra, në varësi të moshës së tyre dhe parapëlqimeve që kanë. Për shembull, mund të bëjnë një fytyrë të qeshur, pa emocione, ose të ngrysur, për të treguar siguri të lartë, mesatare ose të ulët. Në një mënyrë të ngjashme, mund t'u kërkonti ta ngjyrosin rrethin me të gjelbër për shumë siguri, me të verdhë për siguri dhe me të kuqe për pasiguri. Po ashtu, mund të zhvilloni edhe një sistem më të sofistikuar, duke u kërkuar nxënësve të shkruajnë një numër nga 1-5 në rreth, ku 1 mund të thotë pa besim dhe 5 me shumë besim. Sistemi i fundit ju ndihmon t'i nxitni nxënësit të shtojnë pikë për një kapitull ose grupe kapitujsh, për të mbledhur disa të dhëna përparimi.

Fjalori i termave kyçe

Çdo *Libër i nxënësit* përmban edhe një fjalor për t'u plotësuar nga nxënësi në fund të librit, fjalor i cili mbulon të gjithë kapitujt. Ndërsa nxënësve u prezantohet një fjalë e re kyçe – qoftë përmbajtje, qoftë hetim shkencor – kërkojuni të bëjnë fjalorin e tyre, duke e kthyer te fjala në fund të librit dhe duke shkruar, me mbështetjen tuaj, një përkufizim të thjeshtë në gjuhën e tyre. Do të gjejnë boll mbështetje edhe në *Librin e nxënësit*, pasi fjalët kyçe nuk prezantohen pa shpjegime. Qëllimi i bërjes së fjalorit nga vetë nxënësit është që të promovojnë një proces më ndërveprues dhe të ndihmojnë të nxënit.

Ky mbështetet nga fjalori i plotë i termave kyçe në *Librin e mësuesit*.

gjuhësore në klasë

Studimi i shkencës përfshin familjarizimin me një fjalor të gjerë e specifik. Këtë ndonjëherë e përcaktojmë si gjuha e shkencës. *Libri i nxënësit* e mbështet zhvillimin e gjuhës, duke identifikuar qartë fjalët kyçe në *Renë e fjalëve* në faqet mbresëlënëse dhe duke e qartësuar mirë përmbajtjen kyçe, si edhe fjalët e kërkimit shkencor për çdo mësim. Fjalori ndërveprues ka gjithashtu rëndësi themelore në ndihmën që u jep nxënësve për të kuptuar gjuhën. Faqet e temës në *Librin e nxënësit* gjithashtu ndërthurin fjalët me pamjet, pasi kjo është më efikase për nxënësit për të kuptuar thelbin e fjalëve. Lidhja e pamjes me fjalën është një faktor thelbësor në zhvillimin gjuhësor.

Përsëritja është gjithashtu shumë e rëndësishme edhe te *Libri i nxënësit*, pasi nëpërmjet saj prezantohen dhe përforcohen fjalët, duke i treguar ato dhe duke u kërkuar nxënësve t'i përdorin në diskutime e në përgjigje.

Secila pjesë e shënimeve të mësimdhënies që lidhet me një veprimtari ose mësim të caktuar, mundëson gjithashtu mbështetje specifike gjuhësore. Këshilla të detajuara dhe specifike gjenden për çdo fjalë kyçe, bashkë me fjalë të tjera thelbësore për gjuhën dhe të shkruarit shkencor. Sugjerohen një sërë strategjish, përfshirë ndarjen e skedave didaktike; lojërat me karta, muret e fjalëve, lojëra në skuadër, për të përcaktuar ose shpjeguar fjalë; përdorimin e fjalëve të ngjashme, për të shpjeguar kuptimin dhe

zbulimin e origjinës së fjalëve.

Parimet kryesore për mbështetjen gjuhësore janë:

- fjalët duhet të prezantohen dhe të shpjegohen me kujdes; fjalët duhet të shpjegohen në kontekst; përsëritja është thelbësore; fjalët duhet të lidhen me pamje ose veprime; nxënësit duhet të zhvillojnë fjalorin e tyre; të nxënit e fjalorit duhet të jetë argëtues; gjuha nuk duhet të jetë pengesë për të nxënit.

Jo të gjithë nxënësit do t'i kuptojnë idetë dhe konceptet në të njëjtën masë dhe me siguri që ka nxënës me aftësi të ndryshme gjuhësore. Faqet e *Librit të Nxënësit* janë krijuar që të ndiqen e të përdoren lehtësisht. Ato kanë edhe sugjerime për punë dhe veprimtari të mëtejshme në çdo kapitull të këtij libri. Kjo do t'ju ndihmojë të bëni dallimet mes të nxënit dhe të krijoni mundësi alternative të të nxënit. Këshillat për çiftet dhe grupet do t'ju hyjnë veçanërisht në punë, duke ju ndihmuar të plotësoni nevojat e individëve.

Për më tepër, *Libri i nxënësit* përmban një gamë të gjerë fletësh pune e veprimtarish mbështetëse dhe sugjerimesh për punë të zgjeruar dhe të nxënit në shtëpi. *Blloku i shënimeve* gjithashtu i strukturon veprimtaritë me më shumë detaje, veçanërisht punën hetimore, prandaj sidomos për nxënësit me arritje të ulëta ai do të jetë vërtet i vlefshëm.

1 Mbështetja gjuhësore

Krijimi i një mjedisi të pasur gjuhësor

Mësuesit e klasave fillore shpesh ia dalin mbanë më së miri të krijojnë një mjedis fizik plot ngjyra dhe gjithëpërfshirës për nxënësit. Posterat, "Muri e fjalëve", listat e strukturave bazë, punët e nxënësve dhe tabelat e komunikimit në gjuhën shqipe, që të gjitha shndërrohen në një sfond që jep mundësinë e ekspozimit dhe të përvetësimit të gjuhës.

Planifikimi

Kur bën planifikimin, mësuesi duhet të shikojë me kujdes çdo fazë të kapitullit dhe të identifikojë se cilat janë kërkesat gjuhësore. Kjo do të thotë të mendosh rreth asaj gjuhe që do t'i duhet nxënësit për të kuptuar ose për të krijuar dhe të vendosësh se cila do të jetë mënyra më e mirë për të strukturuar të nxënit, që gjuha të mos bëhet pengesë e të kuptuarit të konceptit. Kjo përfshin përfitim të mbështetjes gjuhësore dhe shkon përtej strategjisë së njohur të identifikimit të fjalorit kyç.

Mbështetje për të dëgjuarit dhe të lexuarit

Të dëgjuarit dhe të lexuarit janë *aftësi perceptuese*, që kërkojnë të kuptuar më shumë se prodhim të gjuhës.

Ja disa sugjerime për t'iu qasur këtyre detyrave:

Nëse u kërkon nxënësve të dëgjojnë ose të lexojnë tekste, bëjini vetes këto pyetje kur të planifikoni kapitullin:

- 1 Mos duhet t'ua shpjegoj ndonjë fjalor përpara se të dëgjojnë a lexojnë?
- 2 Si t'i përgatis për përmbajtjen e tekstit, që të mos humbasin interesin gjatë dëgjimit?
- 3 A mund t'ua siguroj mbështetje pamore, që t'i ndihmoj të kuptojnë thelbin e përmbajtjes?
- 4 Sa herë duhet t'ua kërkoj të dëgjojnë a të lexojnë?
- 5 Ç'pyetje të thjeshta mund të bëj para se të dëgjojnë a lexojnë për herë të parë, që t'ua përqendroj vëmendjen?
- 6 Si ta kontrolloj më në thellësi të kuptuarin e tekstit? A mund të përdor organizues grafik (p.sh. tabela, grafikë ose diagrame) ose detyra me plotësim të hapësirave boshe, për t'ua zvogëluar kërkesat gjuhësore?
- 7 Mos duhet të bëj ndryshime në detyrë për ata nxënës që kanë vështirësi me leximin a dëgjimin?
- 8 A mund ta bëj detyrën ndërvepruese (p.sh.

lexime me pjesëza për t'ua formuar, fjala bie, kur nxënësit përballen me informacione të ndryshme, para se ta mbledhin bashkë apo ta ndajnë informacionin)?

- 9 Si t'i kontrolloj përgjigjet e tyre dhe të bëj raportime?

Mbështetje për të folurit dhe të shkruarit

Të folurit dhe të shkruarit janë *aftësi prodhuese* dhe si të tilla, mund të duan më shumë informacion gjuhësor nga mësuesi, i cili duhet të vendosë se cila është detyra gjuhësore që duhet të kryejë nxënësi dhe si ta bëjë këtë sa më mirë.

Kur planifikoni një detyrë, e cila kërkon që nxënësi të flasë ose të shkruajë gjuhë shqipe, ju duhet të mendoni se si mund t'i ndihmoni ta bëjnë këtë.

Kjo do të thotë se duhet të mendoni në detaje se çfarë gjuhe i nevojitet detyrës (*Kërkesat gjuhësore* – KGJ) dhe se cilat strategji do të përdorni për t'i ndihmuar të përdorin shqipen për të kryer detyrën (*Mbështetja gjuhësore* – MGJ).

Duhet t'i bëni vetes pyetjet e mëposhtme:

- 1 Ç'lloj fjalori kërkon detyra? (KGJ)
- 2 Mos duhet t'ua shpjegoj këtë para se të fillojnë? Si? (MGJ)
- 3 Cila frazë a fjali do t'iu duhet?
- 4 Mendoni për gjuhën e të nxënit në shkencë a matematikë: p.sh. parashikimet dhe krahasimet. Ç'struktura u nevojiten për këto funksione gjuhësore? (KGJ)
- 5 Do të jenë në gjendje t'i prodhojnë vetë fjalitë apo duhet t'ua mundësoj unë një strukturë [p.sh. fillues fjalie; strukturë fjalie; fjali me boshllëqe a tabela zëvendësuese (shiko më poshtë)]? (MGJ)

A	katror			brinjë
	trekëndor		3	
	drejtkëndësh	ka	4	
	katërkëndësh		5	
	pesëkëndësh			

- 6 Ndërsa po monitoroj këtë detyrë, a ka ndonjë mundësi të krijoj mbështetje të mëtejshme për përdorimin e gjuhës së tyre (veçanërisht për nxënësit më të dobët)? (MGJ)

- 7 Cila gjuhë u nevojitet nxënësve për t'u përdorur në fazën e raportimit (p.sh. kur prezantojnë detyrën)? Mos duhet ta strukturuj këtë? (KGJ, MGJ)

Fjalori dhe strukturat e mësimdhënies

Fjalori

Të nxënit e fjalorit kyç të matematikës dhe të shkencës është në qendër të “të nxënit” dhe do të thotë më shumë se thjesht të nxjerrësh kuptimin. Të diturit e një fjale përfshin gjithashtu edhe të qenit në gjendje ta shqiptosh atë saktë dhe ta përdorësh në vendin e duhur. Poshtë gjendet një listë strategjish që mund të jenë të nevojshme:

- Shmangni të shkruarin e listës së fjalorit në dërrasë në fillim të kapitullit dhe *shpjegimin e tij*. Fjalori duhet të futet kur të mbërrijë çasti i tij në kapitull. Kjo i ndihmon nxënësit të lidhin fjalën ose frazën me konceptin dhe kontekstin.
- Regjistrojeni fjalorin qartë në dërrasë dhe kontrolloni që jeni të sigurt me shqiptimin dhe germëzimin.
- Jepuni nxënësve një mundësi që ta thonë fjalën pasi ta kenë kuptuar atë. Mënyra efikase për ta bërë këtë është nëpërmjet manovrave të përsëritjes.
- Përdorni pamje sa herë të mundni, për të përforcuar të kuptuarin e fjalës nga nxënësit.
- Sigurohuni që nxënësit ta regjistrojnë fjalorin sistematikisht në fjalorët e tyre dhe, nëse është e mundur, përdorni një “Mur fjalësh”, ku është listuar fjalori nën titujt e kapitullit ose të temës.
- Kujtohuni të ricikloni dhe të rishikoni fjalorin.

Strukturat

Në mënyrë që nxënësit të flasin ose të shkruajnë për shkencën a matematikën e tyre, duhet të shkojnë përtej fjalorit: do t'u duhet të përdorin ato struktura të frazave e fjalive që detyra i kërkon specifikisht. Për shembull, mund t'u duhen shprehjet vijuese në matematikë e shkencë:

X është njësoj me Y.

Anët kanë të njëjtën gjatësi.

Numri vijues në radhë.

Parashikoj se do të ndodhë X.

Nëse ndodh X, atëherë do të ndodh Y.

Hapi i radhës është...


Mësuesi duhet të ndërtojë kësi frazash të zakonshme shkencë a matematike dhe duhet t'i nxitë nxënësit t'i regjistrojnë. Kjo është një pjesë e rëndësishme e identifikimit të *Kërkesave gjuhësore* dhe që siguron mbështetjen e nevojshme. Mësuesi këtu nuk ka në fokus gramatikën, pasi këtu gjuha mund të mësohet më shumë me “copëza” sesa me struktura të përcaktuara gramatikore.

1 Si të bëhesh shkencëtar: Kërkimi shkencor

Këto faqe ju ndihmojnë t'u mësoni nxënësve se si të hetojnë gjatë orëve të lëndës Dituri natyre. Struktura e faqeve ndjek atë të Librit të Nxënësit në mënyrë që t'i udhëhiqni nxënësit hap pas hapi.

Diagrami tregon idetë e rëndësishme të kërimit shkencor. Në *Librin e nxënësit* jepet shembulli i një hetimi:

Cili material është më i mirë për ta mbajtur pambukun të thatë?



Pak njohuri

Ka vite që nxënësit bëjnë punë praktike në orët e diturisë së natyrës. Shpeshherë ata ose shohin një demonstrim ose e kryejnë eksperimentin vetë në bazë të udhëzimeve të detajuara që u jepen gojarisht ose me shkrim. Megjithatë kjo mund të jetë një qasje e dobishme, ajo nuk i lejon nxënësit të zhvillojnë aftësi të tjera të kërimit shkencor.

Qasja ndaj kërimit shkencor, e zbatuar në këtë skemë, i shtyn nxënësit të jenë më të përgjegjshëm në identifikimin e asaj që duhet të hetojnë dhe për mënyrën se si duhet ta hetojnë. Nxënësit nxiten të reflektojnë mbi rezultatet dhe të shpjegojnë domethënien e këtyre rezultateve. Kjo mund të përmbledhet si vijon:

ÇFARË do të hetoj?

Si do ta hetoj këtë?

ÇFARË më tregojnë rezultatet e mia?

Nxënësit nuk janë të detyruar të kryejnë hetime të plota gjatë gjithë kohës. Ju mund të përqendroheshi në një ose dy faza të procesit të kërimit shkencor. Për shembull, paraqituni nxënësve rezultate nga burime dytësore dhe kërkojuni t'i shpjegojnë ato. Ose, planifikoni një hetim dhe pa e kryer atë, diskutoni me nxënësit. Kjo ndihmon për t'u zhvilluar nxënësve aftësitë e duhura për kërkimin shkencor. Është e rëndësishme që nxënësit ta kryejnë vetë të gjithë procesin e hetimeve. Kështu ata bëhen shkencëtarë.

Hetimet është më mirë të kryhen brenda kontekstit të ideve shkencore që nxënësit mësojnë. Ato nuk duhet të konsiderohen vetëm veprimtari plotësuese. Nxënësit duhet të kenë njohuri bazë që të kuptojnë hetimin. Idetë për kërkimin shkencor zakonisht fillojnë me një stimulim. Nxënësve u duhet informacion për të kuptuar idetë shkencore bazë dhe për të formuluar pyetje, por jo aq shumë sa të humbasin kureshtjen.

Pas këtyre hapave, çdo nxënës është në gjendje të vazhdojë fazat e tjera të kërimit shkencor.

Përmbledhtazi:

Konteksti → njohuritë bazë → stimuli
→ kërrimi shkencor

Unë bëj pyetje

Nxitja e nxënësve për të bërë pyetje është çelësi për një kërkim shkencor të efektshëm. Nxënësve u kërkohet të fillojnë pyetjet me fjalë të tilla, si: cili, çfarë, a, pse. Atyre u jepen disa pyetje që përkohet me hetimin e dhënë si shembull:

- Cili material është më pak i përshkueshëm nga uji?
- Çfarë do të ndodhë me materialin nëse e fusim brenda në ujë?
- A e mban materiali të thatë pambukun?

Ndihmohini nxënësit që të bëjnë pyetje që në fillim. Kjo është pjesa eksploruese e hetimit shkencor.

Ju u zhvillon nxënësve aftësitë e të pyeturit edhe kur nuk jeni duke bërë hetim. Çfarëdo punë shkencore që ndërmerrni, gjithherë bëjuni nxënësve pyetje të tipit: Çfarë do të ndodhte sikur... ose Pse

ndodh kjo...

Unë mendoj se...

Kjo fazë e procesit të hetimit shkencor në fazat e mëvonshme, quhet parashikimi. Në këtë fazë, nxitni nxënësit tuaj të diskutojnë idetë rreth asaj që ata mendojnë se mund të ndodhë. Nxënësve u jepet një shembull parashikimi bashkë me një pyetje:

Pyetja

Cili nga materialet do ta mbajë më gjatë pambukun të thatë?

Parashikimi

Qesja plastike.

Ndihmohini nxënësit ta kuptojnë këtë fazë duke krijuar situata në të cilat atyre u duhet të parashikojnë. Mbajeni pambukun mbi ujë dhe pyesni: "Çfarë do t'i ndodhë pambukut nëse e hedh në ujë?" Klasa mund të diskutojë rreth mundësive të ndryshme. Përgjigjet e vlefshme janë "Do të bjerë" nëse ata po mendojnë për ndikimin e forcave ose "Do të laget" nëse po mendojnë për hetimin në fjalë. Kështu, ata kanë përshkruar se çfarë mendojnë se do të ndodhë. Përdorni parashikimin që në fillim të çdo veprimtarie praktike në shkencë.

Unë do të...

Më vonë, kjo fazë do të njihet si "planifikimi i një hetimi". Nxënësit mund të planifikojnë vetë hetime të thjeshta. Këto plane janë të lidhura me hetimin e marrë si shembull, por pyetjet kyçe janë:

Çfarë do të mbash njësoj?

Çfarë do të ndryshosh?

Flisni me nxënësit për pajisjet që do t'u duhen. Është mirë që planet të diskutohen para se të fillojë hetimi. Kjo u jep mundësi nxënësve të shohin shembuj të mirë hetimesh dhe ju të kontrolloni nëse planet e nxënësve janë të realizueshme. Ju mund edhe t'i rigruponi nxënësit sipas planeve që kanë bërë.

Pyesni nxënësit nëse eksperimenti që kanë planifikuar është i drejtë apo jo.

Unë po kërkoj...

Kjo fazë bazohet në aftësitë vëzhguese dhe në përdorimin e saktë të mjeteve matëse. Gjatë hetimit nxënësit:

- masin kohën;
- përcaktojnë cilët objekte janë të lagura apo të thata.

Në hetime të tjera, për të marrë rezultatet e nevojshme, duhet t'u tregoni nxënësve si të përdorin vizoret apo termometrat. Tregojuni nxënësve për rëndësinë e saktësisë në matje. Pyetini nëse do t'u pëlqente që një doktor që po u mat temperaturën të tregohej i pakujdesshëm.

Për t'i ndihmuar nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre vëzhguese, mund të luani një lojë që lidhet me vëzhgimin. Vendosni 10 objekte në një tabaka dhe lëri nxënësit ta shikojnë atë për 30 sekonda. Më pas, ata duhet të mbyllin sytë sërish dhe ju ndërkohë, të hiqni nga tabakaja një objekt. Pasi ta shohin sërish tabakanë me objekte, ata duhet të shkruajnë emrin e objektit që mungon.

Unë kam gjetur...

Sigurohuni që nxënësit e dinë se ka shumë mënyra për të mbajtur shënim rezultatet e tyre. Mënyra më e zakonshme, në këtë fazë, është plotësimi i një tabele rezultatesh. Nxënësit duhet të mësojnë si t'i ndërtojnë tabelat. Nxitini që të raportojnë gjetjet e tyre në mënyra të ndryshme. Kjo mund të bëhet me anë të vizatimeve, të fjalëve të shkruara ose duke folur.

Kjo do të thotë që...

Nxitini nxënësit që t'i shohin rezultatet e tyre me kujdes. Në hetimin e marrë si shembull, ata po krahasojnë materialet.

A vërejnë ndonjë prirje në rezultate?

A mund ta zgjedhin materialin që është më pak i përshkueshëm nga uji?

A ishte i saktë parashikimi i tyre?

Pyetini nxënësit si mund ta përmirësojnë hetimin. Kjo është një anë tjetër e rëndësishme e kërkimit shkencor.

1 Si të bëhesh shkencëtar: Kërkimi shkencor

Rrjeti planifikues i hetimit shkencor

Unë bëj pyetje

Çfarë do përpiqem të hetoj? Cila është pyetja ime?

Unë mendoj se...

Arsyeja pse mendoj kështu është...

Unë do të...

Do të më duhet...

Çfarë do të ndryshoj?

Çfarë do të mbaj të pandryshuar?

Do të mas...

Do të bëj...

Do bëj kujdes...

Vizatimi i aparatit që do të ndërtoj.

Unë po kërkoj...

Si mund t'i bëj vëzhgimet më të sakta?

Ç'mjete matëse mund të përdor?

Unë kam gjetur...

Si mund t'i shënoj rezultatet në mënyrë të rregullt?

A do të përdor tabelë?

Ç'lloj grafiku do të përdor?

Tabela do të jetë kështu.

Kjo do të thotë që...

A vërej ndonjë vijueshmëri?

A ka ndonjë rezultat të pazakonshëm?

A e mbështesin rezultatet parashikimin?

Si mund ta bëj hetimin më të saktë?

1 Vetja ime

Në këtë kapitull, nxënësit:

- njohin ngjashmëritë dhe dallimet mes njëri-tjetrit;
- njohin dhe emërtojnë pjesët e jashtme kryesore të trupit;
- zbulojnë se si njerëzit dhe kafshët e tjera i përdorin shqisat për të njohur botën rreth tyre.

1. Vetja ime

Në këtë kapitull, ti:

- zbulon se jemi të gjithë njësoj, të gjithë të ndryshëm;
- emërton pjesët e trupit;
- mëson rreth shqisave të tua.

njeri
kafshë
krahason
shqisë
rritem
shikoj
Reja e
fjalëve



Shiko figurat.

Çfarë kanë njësoj njerëzit në figurë? Çfarë kanë të ndryshme?

Shkruaj një gjë që është njësoj për të gjithë këta njerëz. Të gjithë këta njerëz kanë _____.



Fakt i çuditshëm

A e di që macja shqisën e nuhatjes e ka puthuajse 14 herë më të fortë se të njeriut?

Si të fillojmë

Në këtë kapitull, nxënësit mësojnë se njerëzit dhe kafshët e tjera lëvizin dhe rriten. Ata mësojnë gjithashtu për shqisat dhe për mënyrën si mund t'i përdorin ato për të eksploruar botën.

Aftësi të nevojshme shkencore

Duke mbledhur të dhëna përmes vëzhgimit, nxënësit mund t'u përgjigjen pyetjeve. Ata marrin pjesë në diskutime dhe bëjnë parashikime lidhur me dukuri shkencore. Ata mësojnë si të sugjerojnë ide, si të ndjekin udhëzimet dhe si të mbajnë shënime. Ata krahasojnë të dhënat si dhe shohin nëse parashikimet e tyre përkojnë me rezultatet. Ata modelojnë dhe komunikojnë idetë e tyre në mënyrë që të mund t'i ndajnë me të tjerët, t'i shpjegojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e të menduarit shkencor.

Fjalë kyçe

dëgjim	gisht	gojë	gju	hundë
kafshë	këmbë	kokë	krah	ndijim
nuhatje	njeri	rritem	sy	shijim
shikim	shpatull	shputë	shqisë	trup
vesh				

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

krahason parashikoj shoh

Vështtrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të kuptojnë se të gjithë jemi njësoj, por të ndryshëm;
- të emërtojnë pjesët e trupit;
- të shpjegojnë rolin e shqisave.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë më shumë për pjesët e trupit.

Kërkojuni nxënësve të vështrojnë fotografitë në faqet hyrëse.



Çfarë kanë njësoj njerëzit në figurë? Çfarë kanë të ndryshme? Kërkojuni nxënësve t'i vështrojnë fotografitë sërish dhe të diskutojnë për dallimet dhe ngjashmëritë mes njerëzve. Kjo veprimtari zhvillon aftësinë e krahasimit të objekteve.



Udhëhiqni nxënësit duke iu bërë pyetje të thjeshta. Për shembull, tregoni me gisht një krah në një nga fotografitë dhe pyesni: Sa krahë ka ky njeri? Bëjini të mendojnë më tej, duke i nxitur të shohin të gjithë njerëzit në fotografi dhe pyetini: A kanë të gjithë dy krahë? Shpjegoni që kështu janë të gjithë njerëzit. Veproni njësoj për numrin e syve, të këmbëve etj. Përsëriteni këtë proces për të treguar dallimet. Për shembull, tregoni një njeri me flokë të shkurtër dhe pyesni: A kanë të gjithë njerëzit në fotografi flokë të shkurtër? Shpjegoni që të gjithë njerëzit në fotografi kanë flokë, por ata janë të ndryshëm, sepse disa njerëz kanë flokë më të gjatë. Veproni njësoj për karakteristikat e tjera, p. sh.: për ngjyrën e lëkurës, për gjatësinë e trupit dhe për ngjyrën e syve.

Përgjigje e mundshme: Disa njerëz kanë flokë të shkurtër dhe disa njerëz kanë flokë më të gjatë.



Shkruani një gjë që është njësoj për të gjithë këta njerëz.

Rekomandohet që nxënësit të stërviten gojarisht, para se ata të shohin përgjigjen e shkruar në dërrasën e zezë. Për shembull, pyesni: *A mund të gjeni një gjë që është njësoj te këta njerëz?*

Shkruani, në dërrasën e zezë, një tipar që është i njëjtë te të gjithë njerëzit në fotografi dhe kërkojuni nxënësve që ta kopjojnë në *Librin e nxënësit*.

Përgjigje e mundshme: Të gjithë këta njerëz kanë flokë.

A e dini se...

Referojuni faktit të çuditshëm. Shpjegoni me terma të thjeshtë që macja ka nuhatje shumë të fortë. Bëjini nxënësit të mendojnë për këtë. Pyesni:

- Pse duhet një mace të ketë nuhatje shumë të fortë?

Përgjigje të mundshme: Që të gjuajë për ushqim, që të nuhasë sendet, që të nuhasë ushqimin.

Udhëhiqini nxënësit drejt këtyre përgjigjeve, duke i pyetur ata se çfarë mendojnë se ha macja dhe si e gjen ajo ushqimin. Për shembull, thoni: *Çfarë mendoni se i pëlqen maces të hajë?*

Mbështetje gjuhësore

Një pikënisje e mirë e mësimin janë fjalët e reja. Diskutoni dhe përkufizoni disa nga fjalët që janë të panjohura. Krijoni për çdo kapitull një "Mur fjalësh" në mënyrë që nxënësit t'i shohin fjalët dhe të familjarizohen me to. *Libri i Nxënësit* ka një fjalor ku nxënësit mund të shkuajnë rregullisht përkufizimet e fjalëve, ndërkohë që përparojnë me kapitullin. Është mirë që të fillohet me ndërtimin e fjalorit që prej mësimin të parë.

Për të përforcuar familjaritetin me fjalët e reja kërkonin nga nxënësit t'i dëgjojnë, t'i thonë, t'i lexojnë dhe t'i shkruajnë ato.

Veprimtari më të zgjeruara

Kërkojuni nxënësve të krahasojnë ato që kanë njësoj dhe ndryshe mes vetes së tyre dhe nxënësve të tjerë, si p. sh., gjatësinë e flokëve apo gjatësinë e trupit.



Nxitini nxënësit të bëjnë krahasime gojarisht, për të mësuar përmendsh strukturat e nevojshme të fjalive. Për shembull, *Flokët e mi janë më të gjatë se flokët e tu.*

Jemi njësoj, por të ndryshëm

Nxënësit zbulojnë çfarë kemi njësoj dhe çfarë kemi ndryshe.

Jemi njësoj, por të ndryshëm

Ti zbulon çfarë kemi njësoj dhe çfarë kemi ndryshe.

Ideja kryesore

Ne nuk jemi të gjithë njësoj.

☐ A janë njësoj këta njerëz?

Cdo njeri është i ndryshëm. Ne të gjithë jemi **njerëz**, por dukemi ndryshe nga njëri-tjetri. Ndërsa **ritemi**, ne zgjatemi. Fytyra dhe trupi na ndryshojnë.



Ne të gjithë kemi një hundë, dy sy, dy veshë, një gojë dhe flokë. Por fytyra e secilit prej nesh është e ndryshme. Këtë mund ta dallojmë duke krahasuar fytyrën tonë me fytyrat e njerëzve të tjerë.

Si mendon?
Nga se ndryshon fytyra jote nga ajo e dikujt tjetër?

Vizato fytyrën tënde.

Flokët **Syri**
Koka **Hunda**
Veshi **Goja**

Përfundo etiketat duke bashkuar pikat e fjalëve.

☐ A pëlqejnë shokët e shoqet e tua të njëjtat gjëra?

Të gjithë ne pëlqejmë gjëra të ndryshme. Kjo është një gjë tjetër që na dallon.

☐ Cilat ngjyrë të pëlqen më shumë?

☐ Cilat kafshë të pëlqen më shumë?

Plotëso me fjalët që mungojnë. Ndaj shembullin.

Ne të gjithë jemi _____
Ne kemi disa _____
që janë _____

Kutia e fjalëve
të ndryshëm, njësoj, gjëra

Varfëria ime

Tani shiko në faqen 34 për të kontrolluar se çfarë di.

Si të fillojmë

Ky mësim paraqet idenë se ne jemi njësoj, por kemi ndryshime dhe se këto ndryshime na bëjnë të veçantë dhe të dallueshëm nga njëri-tjetri. Nxënësit vizatojnë fytyrat e tyre dhe mendojnë për ngjashmëritë dhe dallimet mes njëri-tjetrit. Ideja e dallimeve zgjerohet me parapëlqimet personale si një mënyrë tjetër për të vëzhguar dallimet mes njëri-tjetrit.

Burime

Materiale krijuese për të vizatuar fytyrën.

Fjalë kyçe

goja hunda njeriu koka syri veshi

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

krahasoj shoh

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të dinë se njerëzit janë njësoj, por kanë dhe dallime;
- të dinë se ne jemi njerëz;
- të vizatojnë një fytyrë dhe të etiketojnë hundën, veshët, sytë, gojën, flokët dhe kokën
- të mendojnë për gjërat që janë të ndryshme te njerëzit, p. sh., parapëlqimet personale dhe tiparet fizike.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë më shumë për emrat e pjesëve të jashtme të trupit.

Veprimtaria fillestare ndërtohet mbi punën që nxënësit kanë bërë gjatë kohës që shihnin dhe diskutonin për fotografitë në faqet hyrëse. Kërkojuni nxënësve të shohin fotografitë në *Librin e nxënësit* dhe të diskutojnë rreth tyre.

A janë njësoj këta njerëz?

Kërkojuni nxënësve të flasin për çfarë shohin te fotografitë. Përforconi idenë se ka dallime mes nesh. Shpjegoni se disa dallime ndodhin ndërkohë që rritemi, p. sh., ne rritemi dhe zgjatemi. Diskutoni me nxënësit se kur ishin foshnja, ata ishin shumë më të vegjël.



Paraqisni fjalën “njeri”, duke shpjeguar që të gjithë ne jemi njerëz.

Shpjegoni se ne jemi të gjithë njerëz, por ndryshojmë nga njëri-tjetri dhe kjo është arsyeja pse e dallojmë një njeri nga një tjetër. Shpjegoni me terma të thjeshtë se ne jemi të gjithë të veçantë.

Përgjigje e mundshme: Jo.



Vizatoni fytyrën tuaj. Përfundoni etiketat duke bashkuar pikat e fjalëve.

Tregoni me gisht hundën tuaj dhe kërkojuni nxënësve të bëjnë si ju duke thënë: *Kjo është hunda ime*. Kërkojuni që ta përsërisin. Veproni njëllë për sytë, veshët, gojën, flokët dhe kokën.

Kërkojuni nxënësve të vizatojnë dhe të etiketojnë fytyrën duke përdorur vijat e vagëta që ndodhen në *Librin e nxënësit*. Pastaj, ata ngjyrosin flokët dhe tiparet e fytyrës.

Përgjigje: sytë, hunda, veshët, goja, koka, flokët.

Pasi nxënësit vizatojnë fytyrën e tyre, filloni një diskutim me pyetjen:

- Shikoni fytyrën që keni vizatuar. Nga dallon ajo nga fytyra e të tjerëve?

Përdorni diskutimin për të përforcuar idenë se ne jemi njësoj, por të ndryshëm. Bëjini nxënësit të identifikojnë dallimet e vogla në fytyrat e tyre, p. sh., flokët më të gjatë. Përdorni fytyrën tuaj për krahasim.

Kërkojuni nxënësve t'ju thonë se sa nga secili tipar i fytyrës kanë, p. sh.: Sa sy keni? etj.

Duhet të tregoheni të kujdesshëm dhe të ndjeshëm kur përdorni këto lloj krahasimesh sidomos nëse keni ndonjë nxënës me tipare të shfytyruara.

Theksoni se të gjithë kemi tipare të fytyrës, por ato janë paksa të ndryshme në njerëz të ndryshëm, prandaj ne mund të dallojmë njëri-tjetrin.

A pëlqejnë të njëjtat gjëra shokët tuaj?

Ndajini nxënësit në grupe të vogla ose në dyshe dhe kërkojuni të gjejnë gjërat e parapëlqyera të secilit, p. sh.: ushqimi apo loja e parapëlqyer. Kjo do të sjellë shumëllojshmëri përgjigjesh dhe do të përforcojë idenë se ne na pëlqejnë gjëra të ndryshme, që është diçka tjetër që na dallon.

Cila ngjyrë të pëlqen më shumë?

Kërkojuni nxënësve t'ju japin përgjigjet e tyre dhe shkruajini ato në dërrasë. Përdorni ngjyrën përkatëse të shkurtesit apo të shënuesit, që nxënësit të njohin dhe të emërtojnë ngjyrat.

Kërkojuni nxënësve të shkruajnë ngjyrën e tyre të parapëlqyer në *Librin e nxënësit*.

Përgjigje e mundshme: E kuqja.

Cila kafshë të pëlqen më shumë?

Sërish, shkruajini përgjigjet e nxënësve në tabelë dhe thoni emrin e secilës kafshë ndërkohë që e shkruani.

Kërkojuni nxënësve të shkruajnë emrin e kafshës së tyre të parapëlqyer në *Librin e nxënësit*. Filloni një diskutim duke i pyetur nëse të gjithë nxënësit pëlqejnë të njëjtat gjëra.

Përgjigje e mundshme: Qeni.

Vlerësim formues



Plotësoni fjalët që mungojnë. Ndiqni shembullin.

Kërkojuni nxënësve të vendosin fjalët që mungojnë në *Librin e nxënësit*.

Përgjigje: Ne të gjithë jemi të ndryshëm.

Disa **gjëra** i kemi njësoj.

Përsëritje dhe reflektim

Mbylleni temën duke u kërkuar nxënësve të përfundojnë veprimtarinë e përsëritjes dhe të reflektimit në faqen 14 të Librit të Nxënësit.

Mbështetje gjuhësore

Veprimtaritë që kanë të bëjnë me gjuhën janë të ndërthurura me hapat e mësimdhënies. Për ta mbështetur më tej zhvillimin e gjuhës, mund të përdorni një palë letra që pasqyrojnë tiparet e fytyrës dhe një palë letra të tjera me emrat e tyre. Pastaj, kërkojuni nxënësve të përputhin imazhet me emrat.

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Kërkojuni nxënësve të bëjnë një poster me fytyrat e tyre. Jepuni një skicë të zmadhuar të një fytyre si model për të vizatuar fytyrën e tyre. Pastaj pritini fytyrat sipas formës dhe bëni një kolazh në mur.
- 2 Bëni një veprimtari ndërkurrikulare ku t'i kërkon nxënësve të numërojnë sa hundë ndodhen në klasë, sa sy, sa veshë etj.
- 3 Nxënësit përfundojnë fjalorin e fjalëve të përdorura në mësim. Ata mund të shtojnë fjalët për pjesët e fytyrës në "Murin e fjalëve": Vendosini fjalët në thonjëza: "koka", "sytë", "veshët", "hunda" dhe "goja".



Si mendon?... Kjo pyetje bëhet që nxënësit ta zgjerojnë më tej të menduarit për dallimet mes nesh. Prisni përgjigje që shpjegojnë se: edhe pse ne kemi të njëjtat tipare si: sytë, hundën, gojën etj. ne jemi shumë të ndryshëm.

Trupi ynë

Nxënësit njohin dhe emërtojnë pjesët e jashtme kryesore të trupit

Trupi ynë
Ti emërtosh pjesët e trupit.

Ideja kryesore
Çdo pjesë e trupit tonë ka një emër.

Bashko pikat e fjalëve për pjesët e trupit.
Sa krahë ke?
Sa gishta këmbë ke?
Lidh secilën pjesë të trupit me fjalën e saktë.

Koka
Shpatulla
Dora
Bërryli
Krahu
Gjuri
Gishtat
Këmba
Shputa
Gishtat e këmbës

a. sytë
b. hunda
c. veshët
d. goja
e. flokët

Gjej dhe rretho fjalët.

ç	k	r	a	h	b	q	sh	t	z	x
o	i	p	t	e	a	b	k	n	s	
k	n	y	a	r	r	p	d	o	r	e
e	k	g	s	y	m	v	e	sh	d	
a	e	i	f	l	o	k	e	p	e	
v	m	sh	p	a	t	u	ll	u	a	
e	b	t	f	g	j	m	f	u	t	v
t	e	a	h	u	n	d	e	e	x	

Kurta e fjalëve
krah këmbë kokë vesh sy hundë gishta
shputë gjuri bërryl flokë dorë shpatull

Tani shiko në faqen 14 për të kontrolluar se çfarë di.

Si të fillojmë

Në këtë mësim nxënësit njihen me trupin e tyre. Në fund të mësimin, ata duhet të jenë në gjendje të njohin dhe të emërtojnë pjesët kryesore të jashtme të trupit. Duhet të jeni të kujdesshëm e të ndjeshëm në mënyrën si i qaseni kësaj teme, sidomos nëse keni nxënës me tipare të shfytyruara apo me aftësi të kufizuara. Nxënësit në këtë mësim praktikojnë edhe aftësinë e të numëruarit.

Burime

Vizore dhe lapsa.

Fjalë kyçe

gishti i këmbës	gjuri	këmba
krahu	rriem	shpatulla
shputa e këmbës	trupi	

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

marr me mend parashikoj

Vështrimi i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të emërtojnë tiparet e fytyrës;
- të njohin dhe të emërtojnë pjesët e jashtme të trupit;
- të lidhin pjesët e trupit me emrin përkatës të tij.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë më shumë për shqisat.



Bashko pikat e fjalëve për pjesët e trupit.

Kjo temë lidhet me emërtimin e pjesëve të jashtme të trupit. Kërkojuni nxënësve të shohin fotografitë në *Librin e nxënësit*. Fotografia tregon skicën e trupit me pjesët e etiketuara me shkrim të vagët.

Shpjegojuni nxënësve se do të mësojnë pjesët e trupit. Tregoni me gisht kokën tuaj dhe thoni: kjo është koka ime. U thoni nxënësve të bëjnë si ju dhe të përsërisin fjalinë. Veproni njëlojtë për secilën pjesë të trupit të etiketuar në fotografi. Më pas, kërkojuni nxënësve të shkruajnë emrat e pjesëve të trupit në *Librin e nxënësit*, duke i mëshuar sipër vijave të vagëta.

Përgjigje: koka, shpatulla, krahu, bërryli, dora, gishtat, këmba, gjuri, shputa e këmbës, gishtat e këmbëve.



Sa krahë keni?



Këto veprimtari me shkrim mund të përdoren bashkë me lojën "Andi thotë", ku nxënësit mësojnë emrat e pjesëve të trupit.

U thoni nxënësve t'i shkruajnë përgjigjet në *Librin e nxënësit*.

Përgjigjja: Dy krahë.



Sa gishta këmbë keni?

Përgjigjja: Dhjetë gishta.

Si veprimtari përforcuese, kërkojuni nxënësve të ulen duke formuar një rreth me këmbët e tyre të shtrira përpara. Kërkojuni nxënësve të tregojnë me gisht pjesët e trupit.

Tregoni me gisht secilën prej pjesëve të trupit, ndërkohë që e përmendni: koka, shpatullat, gjunjët, gishtat e këmbëve, sytë, veshë, goja, hunda.

Lidhni secilën pjesë të trupit me fjalën e saktë.

Veprimtaria pasuese është veprimtari përforcuese. Tregojuni nxënësve si të lidhin emrat me pjesët përkatëse të trupit. Për shembull, vizatoni një krah në dërrasë, shkruani fjalën "krah" dhe përdorni një vizore për të lidhur fjalën me vizatimin.

Përgjigjet: a) koka, b) krah, c) bërryli, d) dora, e) këmba, f) gjuri, g) shputa.

Ku janë sytë, veshët, hunda dhe goja? Lidh me vizë fjalën me pjesën e saktë në fytyrë.

Kërkojuni nxënësve të plotësojnë ilustrimin e fytyrës, duke vizatuar vija që lidhin etiketat me pjesën përkatëse të fytyrës.

Veprimtaria përforcon përvetësimin e saktë të fjalorit për pjesët e fytyrës.

Përgjigjet: Vija të vizatuara për të lidhur etiketat me pjesët përkatëse të fytyrës:
a) sytë, b) hunda, c) veshët, d) goja, e) flokët.

Vlerësimi formues

Gjeni dhe rrethoni fjalët.

Përdorni kërkimin e fjalëve si veprimtari përforcuese. Kërkojuni nxënësve të përdorin lapsa dhe vizore për të gjetur pjesët e trupit (fig. në faqen 11).

Përgjigjet:

k	r	a	h	b	q	sh	t	z	x
o	l	p	t	ë	a	b	k	n	s
k	n	y	a	rr	p	d	o	r	ë
ë	k	g	s	y	m	v	e	sh	d
a	ë	i	f	l	o	k	ë	p	e
v	m	sh	p	a	t	u	ll	u	a
e	b	t	f	gj	m	f	u	t	v
t	ë	a	h	u	n	d	ë	ë	x

Përsëritje dhe reflektim

Përfundojeni mësimin duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë veprimtarinë e përsëritjes dhe të reflektimit në faqen 14 "Çfarë mësuam për veten tonë" të Librit të Nxënësit.

Mbështetje gjuhësore

Sugjerime për mbështetjen gjuhësore janë dhënë edhe gjatë mësimdhënies. Për zhvillimin e mëtejshëm të bazave gjuhësore përdorni letra me fjalë dhe fotografi të pjesëve të trupit. Kërkojuni nxënësve të tregojnë me gisht secilën pjesë të trupit të tyre ndërkohë që ju tregoni letrën përkatëse.

Veprimtari më të zgjeruara

- Luani lojën "Driloni thotë" me nxënësit si një mënyrë argëtuese për të përforcuar pjesët e trupit. U thoni nxënësve të ulen në formë rrethi. Njëri lojtar është "Driloni" (ose zgjidhni një emër tjetër) dhe lojtarët e tjerë duhet të bëjnë atë që thotë Driloni për sa kohë që fraza "Driloni thotë" thuhet para se të jepet urdhri (p. sh., Driloni thotë prekni hundën tuaj). Nëse Driloni nuk thotë "Driloni thotë" para urdhrin, lojtarët nuk duhet ta zbatojnë urdhrin. Nëse një lojtar zbaton urdhrin pa u thënë "Driloni thotë", ai lojtar largohet nga loja. Nxënësi i fundit që mbetet në lojë është fitimtari.
- Kërkojuni nxënësve të shtojnë fjalët e mësuara në këtë mësim në "Murin e fjalëve": "njeriu", "trupi", "krah", "shpatull", "këmba", "gjuri", "shputa", "gishti i këmbës", "syri", "veshi", "goja", "hunda".

Pesë shqisat

Nxënësit zbulojnë se si njerëzit dhe kafshët e tjera i përdorin shqisat për të njohur botën rreth tyre.

Pesë shqisat

Ti mëson rreth shqisave.

Ideja kryesore

Shqisat na ndihmojnë të zbulojmë botën rreth nesh.

Ku i ka veshët, sytë, hundën dhe gojën koteja?

Njerëzit dhe kafshët kanë shqisat. Shqisat na ndihmojnë të zbulojmë botën rreth nesh.

Për çfarë i përdorim sytë?

Shiko fotografinë.

Ditë Notë

Kafshë e shikim njeriu. Kafshë e shikim mace.

A mendon se macet shikojnë më mirë se ne?

a. veshët b. sytë c. hunda d. goja

Ne mund të shikojmë ngjyra të ndryshme.

Ngjyros ylberin.

Për çfarë i përdorim veshët?

Disa gjëra lëshojnë tinguj. Disa jo.

Shiko figurat. Rretho gjërat që lëshojnë tinguj.

dautllë libër gojë

tortë tavolinë radio

Si të fillojmë

Ky është i pari prej dy mësimëve që do të merren me zbulimin e shqisave të njerëzimit dhe të kafshëve të tjera. Mësimi i parë merret me shqisat e të parit dhe të të dëgjuarit; mësimi i dytë merret me të shijuarit, të prekurit dhe të nuhaturit. Ju mund t'i bëni mësimet më të frytshme, duke përdorur materiale ndijore si vegla muzikore, objekte me ngjyra, ushqim me shije të fortë etj. Në secilin prej mësimëve do të bëhen edhe sugjerime të tjera.

Burime

Materiale ndijore si: vegla muzikore, si: trekëndëshi, ksilofoni, daullja; objekte me ngjyra, si: lodra, fruta; ylber i madh e i ngjyrosur; materiale krijuese, si: lapsa me ngjyra për secilën ngjyrë të ylberit; vizore dhe lapsa.

Fjalë kyçe

dëgjim kafshë shikim shqisë

Vështrimi shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të mësojnë për shqisat e të parit dhe të të dëgjuarit;
- të dinë se cilat pjesë të trupit përdoren për të parë dhe për të dëgjuar;
- të krahasojnë shqisën e të parit të njeriut me atë të maces;

- të dinë se cilët artikuj të përditshëm lëshojnë tinguj e cilët jo.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë më shumë për të shijuarit, të prekurit, dhe të nuhaturit.



Ku i ka veshët, sytë, hundën dhe gojën koteja?

Veprimtaria e parë ka të bëjë me përsëritjen e tipareve të fytyrës, por këtë herë duke përdorur fotografinë e një koteleje. Kjo veprimtaria është ndërtuar e tillë që nxënësit të kuptojnë se kafshët kanë tipare të ngjashme me njerëzit.

Kërkojuni nxënësve që ta shohin me vëmendje fotografinë e fytyrës së koteles. Ata duhet të përdorin vizoret dhe lapsat për të lidhur etiketat me tiparet e fytyrës së koteles: veshët, sytë, gojën dhe hundën.

Përgjigjet: Vija të vizatuara që lidhin etiketat me pjesët përkatëse të fytyrës së maces:

a) Veshët, b) Sytë, c) Hunda, d) Goja.



Për çfarë i përdorim sytë?

Shpjegoni se njerëzit dhe kafshët përdorin shqisat për të eksploruar dhe mësuar për botën rreth tyre. Kërkojuni nxënësve të shikojnë fotografinë e syve.

Shkruani përgjigjen në dërrasë dhe kërkojuni nxënësve ta kopjojnë atë në *Librin e nxënësit*. Tregojuni se sa e rëndësishme është shqisa e të parit dhe sillni disa shembuj se për çfarë e përdorim të parit, p. sh., për të lëvizur në mënyrë të sigurt, për të lexuar etj.

Përgjigje e mundshme: Për të parë.



A mendoni se macet shikojnë më mirë se ne?

Kërkojuni nxënësve të shohin figurat në *Librin e nxënësit* nga këndvështrimi i një njeriu dhe i një maceje. Nisni një diskutim rreth gjërave që macet mund të shohin, me anë të pyetjes:

- A mendoni se macet shikojnë më mirë se ne?

Për t'i bërë nxënësit të mendojnë më tej, thojuni atyre se macet janë të afta t'i ndjekin shumë mirë lëvizjet. Macet mund të shohin nuanca të blusë dhe të jeshiles, por ato nuk mund ta shohin të

kuqen. Ato mund të shohin në dritë gjashtë herë më të dobët se njerëzit. Ato gjuajnë në muzg, sepse sytë e tyre janë ndërtuar për të gjuajtur më mirë gjatë kësaj pjese të ditës.

Shpjegoni se ne mund të shohim shumë ngjyra të ndryshme. Krahasoni këtë me numrin e ngjyrave që macja mund të shikojë me fjalë të thjeshta, p. sh., *Macja nuk mund të shohë të njëjtat ngjyra si ne.*

Përgjigje të mundshme: Ato mund të shohin më mirë se ne natën./Ato shohin qartë natën./Gjatë ditës ato shohin më pak ngjyra./Ngjyrat janë të ndryshme.

Ngjyrosni ylberin

Tregojuni nxënësve fotografitë e ylberit. Kërkojuni të ngjyrosin ylberin skicë në *Librin e nxënësit*, duke përdorur fotografinë si udhëzim.

 Nxënësit ndihmohen me ngjyrat e ylberit skicë.

Për çfarë i përdorim veshët?

Pasi nxënësit të mbarojnë së ngjyrosuri ylberet, kërkojuni të shohin fotografinë që vjen më pas në *Librin e nxënësit* dhe të mendojnë se për çfarë i përdorim veshët.

 Shkruani përgjigjen në dërrasë dhe kërkojuni nxënësve ta kopjojnë në *Librin e nxënësit*.

Përgjigje e mundshme: Për të dëgjuar.

Shikoni fotografitë. Rrethoni objektet që lëshojnë tingull.

Vizatoni në dërrasë një tabelë me tituj: "Këto gjëra lëshojnë tingull" dhe "Këto gjëra nuk lëshojnë tingull".

Kërkojuni nxënësve të shohin fotografitë në *Librin e nxënësit* dhe të qarkojnë gjërat që lëshojnë tingull dhe ato që nuk lëshojnë. Shkruajini përgjigjet në dërrasë.



Për t'u familjarizuar me fjalët e reja, kërkojuni nxënësve t'i dëgjojnë, t'i thonë, t'i lexojnë dhe pastaj t'i shkruajnë fjalët.

Pas plotësimit të listës së gjërave, kërkojuni nxënësve të rrethojnë gjërat që lëshojnë tingull.

Përgjigjet: Këto gjëra lëshojnë tingull: daullja, radioja, goja.

Këto gjëra nuk lëshojnë tingull: torta, tavolina, libri.

Mbështetje gjuhësore

Për të mbështetur zhvillimin e gjuhës, përdorni disa nga sugjerimet e dhëna gjatë hapave të mësimdhënies. Ju mund të përdorni gjithashtu, materiale ndijore për të përmirësuar gjuhën, p. sh.: merrni një nga objektet, emërtojeni atë dhe ngjyrën e tij. Më pas, merrni një objekt tjetër dhe pyesni: *Si quhet ky/kjo? Ç'ngjyrë ka?*

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Përdorni materiale ndijore për të përforcuar emrat e objekteve dhe të ngjyrave siç janë përshkruar në paragrafin "Mbështetje gjuhësore".
- 2 Përdorni veglat muzikore për të treguar dallimet mes tingujve të lartë dhe tingujve të ulët, si p. sh., duke i rënë daulles fort dhe butë për të krahasuar tingujt.
- 3 Kërkojuni nxënësve të bëjnë me objekte pamore dhe dëgjimore postera me tituj "Unë mund ta shoh këtë" dhe "Unë mund ta dëgjoj këtë".

Pesë shqisat

Nxënësit zbulojnë se si njerëzit dhe kafshët e tjera i përdorin shqisat për të njohur botën rreth tyre.

Pesë shqisat

Ti mëson rreth shqisave.

Ideja kryesore

Neve na pëlqen të hamë gjëra që kanë erë të mirë dhe që janë të shijshme.

Shija

Cili ushqim të pëlqen më shumë?

Disa ushqime kanë shije të kripur dhe disa të tjera kanë shije të ëmbël. Gjuha e njeriut ka sytha të shijes. Ata na ndihmojnë të bëjnë dallimin mes të kripurës dhe të ëmbël.

Cilat ushqime janë të ëmbla dhe cilat janë të kripura?

Nuhatja

Nuhatja përdoret për shumë gjëra.

Trego një gjë që për ty ka erë të mirë.

Disa kafshë përdorin shqisën e fortë të nuhatjes për të gjetur ushqim.

Disa gjëra nuk kanë erë të mirë. Trego ndonjë prej tyre.

Prekja

Shiko këto figura.

Cilat gjëra janë të sigurta për t'u prekur? Cilat gjëra janë të rrezikshme për t'u prekur?

Plotëso me fjalat që mungojnë. Ndëq shembullin.

Ne kemi **P E S Ë** shqisë. Këto janë të parit, të degjuarit, _____ të prekurit dhe _____.

Kutia e fjalëve

Kutia e fjalëve

Pesë **të shijuarit** **të nuhaturit**

Tani shiko në faqen 15 për të kontrolluar se çfarë di.

Si të fillojmë

Ky mësim përqendrohet në shqisën e të shijuarit, të të prekurit, dhe të të nuhaturit. Duke përdorur fjalë të thjeshta bëhet lidhja mes ushqimit që vjen erë të mirë e që gjithashtu ka shije të mirë. Përvetësimi i këtij mësimi e lehtëson eksplorimi i një numri të madh materialesh ndijore.

Fjalë kyçe

nuhatja/të nuhaturit prekja/të prekurit
shija/të shijuarit

Burime

Materiale ndijore të ndryshme: artikuj ushqimorë të ëmbël e të kripur; artikuj me aroma të ndryshme, si: lule, bukë e freskët, kokrra kafeje; pëlhura më thurje të ndryshme, si: kadife, atlas, mëndafsh, pambuk, gëzof i rremë; çanta që përmbajnë artikuj të ndryshëm që nxënësit mund t'i dallojnë duke i prekur.

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të mësojnë për të prekurit, të shijuarit dhe të nuhaturit;
- të përdorin materiale ndijore për të eksploruar

këto shqisa;

- të kuptojnë se ka disa gjëra që nuk duhen prekur dhe ngrënë.

Në mësimin tjetër, nxënësit do të përsërisin dhe do të reflektojnë rreth atyre që kanë mësuar.



Cili është ushqimi juaj i parapëlqyer?

Niseni mësimin duke u kërkuar nxënësve të shohin personin që po ha ushqim të shijshëm dhe pyetini se ç'ushqime u pëlqen të hanë. Shkruajini përgjigjet e nxënësve në dërrasë dhe pastaj u thoni t'i shkruajnë përgjigjet e tyre në *Librin e nxënësit*.

Përgjigje të mundshme: mollë, djathë, pica etj.



Cilat ushqime janë të ëmbla e cilat ushqime janë të kripura?

Shpjegoni që disa ushqime janë të kripura dhe disa janë të ëmbla. Shpjegoni me terma të thjeshtë që ne kemi sytha shijeje në gjithë gjuhën për të dalluar ndryshimin mes shijes së kripur dhe asaj të ëmbël.

Tregojuni nxënësve disa ushqime të ëmbla dhe disa të kripura dhe kërkojuni t'i provojnë ato. Pyetini se cilat nga ushqimet janë të kripura e cilat janë të ëmbla.



Mos përdorni fruta të thata të kripura, sepse ndonjë nxënës mund të jetë alergjik ndaj tyre.



Mësoni prej nxënësve ushqimet e ëmbla apo të kripura që u pëlqejnë. Pyetini se kur i hanë këto ushqime dhe kush ua përgatit apo blen. Kjo detyrë në grup ose në çift, ndihmon nxënësit të mësojnë se çfarë i pëlqen secilit. Ata mund edhe të vendosin se cili nga anëtarët e grupit ha më shumë ushqime të ëmbla a të kripura.

Nëse nuk doni të bëni një veprimtari për shijimin e ushqimit, mund t'u kërkonit nxënësve që të ndajnë artikujt ushqimorë në të ëmbël e të kripur.

Kërkojuni nxënësve të shikojnë fotografitë *Librin e nxënësit*. Vërin të punojnë në dyshe për të gjetur se cilat ushqime janë të ëmbla e cilat të kripura.

Kërkojuni nxënësve të shkruajnë "i/e ëmbël" ose "i/e kripur" në secilën kuti që ndodhet nën fotografi.

Përgjigjet: a) çokollata – e ëmbël, b) djathi – i kripur, c) pica – e kripur, d) torta – e ëmbël, e) buka – e kripur, f) ëmbëlsira me fruta – e ëmbël.



Thoni emrin e diçkaje, aroma e së cilës ju pëlqen.

Kërkojuni nxënësve të shikojnë fotografinë e vajzës që po u merr erë luleve dhe pastaj tregojni disa materiale ndijore. Kërkojuni t'i marrin erë artikujve dhe pyetini se cilat mbajnë erë të mirë e cilat jo. Mund të merrni përgjigje të ndryshme meqë njerëz të ndryshëm parapëlqejnë aroma të ndryshme.

Kërkojuni nxënësve të emërtojnë aromën e tyre të parapëlqyer. Shkruajini përgjigjet e tyre në dërrasë dhe pastaj u thoni që edhe ata t'i shkruajnë në *Librin e nxënësit*.

Shpjegoni rëndësinë e të nuhaturit dhe flisni për disa nga përdorimet e tij. Kthehuni pas e kujtoni të nuhaturit e maces që diskutohet në faqet hyrëse dhe shpjegoni se disa kafshë përdorin nuhatjen e tyre të mprehtë për të gjetur ushqim për të ngrënë.

Përgjigje të mundshme: Lulet, bukë e sapopjekur etj.



Disa gjëra nuk kanë erë të mirë. Tregoni ndonjë prej tyre.

Nisni një diskutim për gjëra që nuk mbajnë erë të mirë.

Përgjigje të mundshme: qelbësit, vezët e prishura etj.



Cilat gjëra janë të sigurta për t'u prekur? Cilat gjëra janë të rrezikshme për t'u prekur?

Shpjegoni se të prekurit është një shqisë shumë e rëndësishme dhe se ka objekte që mund t'i prekim dhe objekte që nuk duhet t'i prekim kurrë.

Tregojuni nxënësve çantat me artikuj të ndryshëm që keni përgatitur dhe pyetini se cila nga çantat u jep ndjesi të mirë e cila jo.

Përgjigje të mundshme: Jo të rrezikshme për t'u prekur: lepurushi lodër, topi i futbollit.

Të rrezikshme për t'u prekur: kaktusi, flaka e gazit.



Kërkojuni nxënësve të shikojnë fotografitë në *Librin e nxënësit*. Thoni emrat e artikujve për të mbështetur zhvillimin e gjuhës, pastaj pyesni se cilat gjëra mund të preken e cilat jo.

Vlerësim formues



Plotësoni fjalët që mungojnë. Ndiq shembullin.

Kërkojuni nxënësve të plotësojnë veprimtarinë me fjalët që mungojnë.

Përgjigje: Ne kemi **pesë shqisa**. Këto janë të parit, të dëgjuarit, **(të shijuarit)** të prekurit dhe të nuhaturit.

Përsëritje dhe reflektim

Në mbyllje të mësimit, kërkojuni nxënësve të përfundojnë përsëritjen dhe reflektimin në “Çfarë mësuam për veten” në faqen 15 të Librit të Nxënësit.

Mbështetje gjuhësore

Ju mund të përdorni një seri kartash që tregojnë fotografi të hundës, të gojës, të veshëve dhe të syve dhe kërkojuni nxënësve të lidhin secilën prej tyre me shqisën përkatëse. Bëjini nxënësit të mëndojnë më tej duke u kërkuar të sugjerojnë pjesët e trupit që lidhen me të prekurit. Krijoni një “Mur fjalësh” me fjalët e përdorura gjatë mësimit.

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Kërkojuni nxënësve të bëjnë një poster me emrat dhe ilustrime të të gjitha shqisave.
- 2 Kërkojuni nxënësve të bëjnë një vjershë ose një këngë për shqisat.

Çfarë mësuam për veten

Çfarë mësuam për veten

Jemi njësoj, por të ndryshëm

Rretho përgjigjen, që është e vërtetë për ty.

1. A ngjan me motrat ose me vëllezërit e tu? po jo

2. A ngjan me shokët ose shoqet e klasës? po jo

3. Kujt i ngjan më shumë?
shokut tim shoqes sime vëlloit tim motrës sime

Unë kujtoj se të gjithë jemi njësoj, por edhe të ndryshëm.

Trupi ynë

Plotëso me fjalët e duhura.

Gishtat e dorës sime janë të lidhur me q time.

Dora ime është e lidhur me k time.

Krahu im është e lidhur me s h time.

Gishtat e këmbës sime janë të lidhur me s h time.

Shputa e këmbës sime është e lidhur me k time.

Këmba ime është e lidhur me g time.

Kutia e fjalëve

dorën këmbën shputën krahun gjurin

Unë mund të emërtoj gjashtë pjesë të trupit.

Pesë shqisat

Përgjigju pyetjeve. Zgjidh fjalën në kutinë e fjalëve.

1. Cilat janë dy shqisat që përdor më shumë gjatë rrugës për në shkollë?
të q dhe _____

2. Cilat janë tri shqisat që të tregojnë se cili ushqim është i keq dhe jo i sigurt për t'u ngrënë?
_____ dhe _____

Kutia e fjalëve

të parit të degjuarit të prekurit të shjuarit të nuhaturit

Unë mund t'i emërtoj të pestë shqisat.

Të fillojmë

Qëllimi i kësaj pjese është të nxisë nxënësit të përsërisin ato që kanë mësuar pas çdo teme të kapitullit. Çdo temë ka disa pyetje përforcuese të cilave nxënësit duhet t'u përgjigjen. Ato do të shërbejnë për të vlerësuar njohuritë dhe përvetësimin e mësimin nga nxënësit.

Pas çdo serie pyetjesh, ndodhet një detyrë përsëritjeje dhe reflektimi së cilës nxënësit duhet t'i përgjigjen. Ju duhet ta lexoni detyrën dhe t'i ndihmoni ata ta plotësojnë qarkun vetëpërsëritës për të treguar sa të sigurt ndihen për secilin mësim. Në klasën e parë, nxënësit mund të ngjyrosin, të vizatojnë një fytyrë të buzëqeshur ose të vendosin një poster.

Është e rëndësishme të raportohen pjesët ku nxënësit nuk ndihen të sigurt. Ky informacion është thelbësor për mësuesin në ndihmën që duhet t'u japë nxënësve në fund të vlerësimit përmbljedhës.

Përsëritje dhe reflektim

Jemi njësoj, por të ndryshëm



Rrethoni përgjigjen që është e vërtetë për ju.

Disa nxënës mund të mos kenë motra apo vëllezër. Atyrë kërkojuni t'u përgjigjen pyetjeve numër 2 dhe 3 për një shok apo kushëri që ka motra ose vëllezër.

Merrni përgjigjet nga klasa: kërkojuni nxënësve të ngrënë dorën nëse kanë dhënë përgjigjen "shok" për pyetjen numër 3. Pastaj, veproni njëllor për "vëlla" dhe për "motër".

Përgjigje:

- 1 Po ose Jo.
- 2 Po ose Jo.
- 3 Vëllai im/motra ime.

Përdorni përgjigjet e nxënësve për të ngulitur, me terma të thjeshtë, idenë se ne ngajmë më shumë me njerëzit e familjes sonë dhe se ngjashmëritë bëhen më të mëdha sa më e afërt të jetë lidhja familjare me ta.

Pyetini nxënësit nëse ka binjakë në klasë apo në shkollë. Bëni pyetje që të dilni në përfundimin se edhe binjakët identikë janë paksa të ndryshëm.

Udhëhiqini nxënësit që të dalin në përfundimin: *Ne të gjithë kemi të njëjtat tipare, por asnjëri nuk është krejt njëllor me dikë tjetër.*

Trupi ynë



Plotësoni me fjalët e duhura.

Shkruani fjalët kyçe në dërrasë (gishtat, dora, krahu, shpatulla, gishtat e këmbës, shputa e këmbës, këmba, gjuri) dhe u thoni nxënësve t'i shkruajnë ato në vendin e duhur në fjali.

Lexoni fjalitë bashkë me nxënësit. Ndërkohë që lexoni, tregoni me gisht secilën fjalë kyçe dhe pjesën përkatëse në trupin tuaj. Kërkojuni nxënësve të shkruajnë përgjigjet në *Librin e nxënësit*.

Bashkë me nxënësit, këndojini fjalitë si vargje me një melodi të thjeshtë. Përsëriteni këtë disa herë. Bëjeni argëtuese.

Përgjigjet: Gishtat e mi janë të lidhur me dorën time.

Dora ime është e lidhur me **(krahun)** tim.

Krahu im është i lidhur me **(supin)** tim.

Gishtat e mi të këmbës janë të lidhur me **(shputën)** time.

Shputa ime është e lidhur me **(këmbën)** time.

Këmba ime është e lidhur me **(gjurin)** tim.

Pesë shqisat



Përgjigjuni pyetjeve. Zgjidhni fjalët në kutinë e fjalëve.

Kërkojuni nxënësve të përfytyrojnë sikur janë rrugës për në shkollë. Pyetini se cilat shqisa

i ndihmojnë ata të gjejnë rrugën. Nxitini të mendojnë për çfarë shohin dhe dëgjojnë rrugës për në shkollë.

Më pas, kërkojuni nxënësve të përfytyrojnë sikur kanë një pjatë me ushqim të shijshëm para tyre.

Pyetini:

- Si duket ushqimi? Ç'erë vjen? Ç'shije ka?

Pastaj, kërkojuni të imagjinojnë se ushqimi ka shije të keqe dhe bëjuni të njëjtat pyetje.

Bini dakord, si klasë, për përgjigjet e pyetjeve në *Librin e nxënësit* dhe kërkojuni nxënësve t'i shkruajnë ato.

Përgjigjet:

- 1 *Të parit* dhe *të dëgjuarit*.
- 2 *Të parit*, *të nuhaturit* and *të shijuarit*.

Thellojeni të mësuarit e nxënësve duke u thënë se, mijëra vite më parë, të mbijetoje ishte më e vështirë se në ditët e sotme. Pyetini nxënësit:

- Si i ndihmonin shqisat njerëzit e hershëm për të mbijetuar?

Përgjigje të mundshme: Të dëgjonin kafshët e rrezikshme. Të shihnin kafshët që duhet t'i gjuanin për ushqim. Të nuhasnin ushqimin e keq apo helmues etj.

Tregoni që shqisat nuk shërbenin vetëm për të eksploruar botën, por edhe për të mbijetuar.

Vlerësim përmbledhës

Detyra në "Çfarë mësuam për veten tonë" në *Librin e nxënësit* është një pikë fillestare e shkëlqyer për rastet kur duhet të diskutoni për përparimin e secilit nxënës në veçanti. Ky informacion mund të përdoret edhe për dëftesat në fund të tremujorit.

Mund të jetë e dobishme të mbani shënime sa të sigurt ndihen nxënësit, për të identifikuar ato pjesë që do të duhet të përsëriten më vonë (shikoni një shembull në tabelën e mëposhtme).

Detyra për "Çfarë mësuam për veten"	Shumë i sigurt	Jo shumë i sigurt	Jo i sigurt

Këto të dhëna mund të përdoren për të ndërtuar një program ndihmues për nxënësit që kanë nevojë. Të dhënat dhe analiza për çdo nxënës duhet të jenë në një formë të thjeshtë. Ju duhet vetëm një përshtypje e përgjithshme për vlerësimin e klasës dhe jo të dhëna personale të nxënësit, p. sh.: 50% e klasës nuk ishin të sigurt për...

2 Materialet

Në këtë kapitull, nxënësit:

- përdorin shqisat për të zbuluar dhe për të folur për materiale të ndryshme;
- identifikojnë karakteristikat e materialeve të ndryshme;
- njohin dhe emërtojnë materiale të zakonshme;
- klasifikojnë objektet në grupe sipas vetive të materialeve prej nga përbëhen.

2. Materialet

Në këtë kapitull, ti:

- përdor shqisat për të zbuluar materiale të ndryshme;
- zbulon si duken materialet dhe çfarë ndien kur i prek ato;
- zbulon çfarë bëjnë materialet kur vepron mbi to;
- emërtën disa materiale të zakonshme;
- ndan materialet në grupe.

material
plastikë
letër
dru
qelq
tregoj
metal

Reja e
fjalëve

16

- ☐ Përfytyro sikur po mban në dorë këtë lodër. Çfarë ndien kur e prek?
- ☐ Përkrahuj këtë lodër. Çfarë ndien kur e prek?



Objektet që i përdorim për të njëjtën gjë, mund të jenë të ndryshme edhe kur i shikojmë, edhe kur i prekim.

- ☐ Vështro filxhanët. A ka ndonjë ndryshim mes tyre?



Fakt i çuditshëm

Letra mund të mbajë një libër të rëndë! Provoje. Bëji si tub 12 fletë letre. Lidhi së bashku tubat e letrës në formën e një kulle. A e mban librin kulla jote?

Materialet

17

Si të fillojmë

Qëllimi i këtij kapitulli është t'u paraqesë nxënësve materialet, çfarë janë ato dhe si përdoren. Nxënësit mendojnë për materialet që përbëjnë objektet. Ata parashikojnë se ç'pamje kanë materialet dhe marrin parasysh se objektet e përdorura për të njëjtin qëllim mund të jenë të përbëra prej materialeve të ndryshme. Vetitë e materialeve tregohen duke përdorur fjalë, figura dhe hetime. Nxënësit mësojnë si t'i klasifikojnë materialet në grupe duke përdorur shqisat e të parit dhe të të prekurit. Ata shqyrtojnë arsyen se pse i grupuan ashtu objektet.

Nxënësit zbulojnë karakteristikat e materialeve të ndryshme duke përdorur shqisat e të prekurit dhe të të parit. Ata mësojnë për vetitë e materialeve si i fortë, i butë, me ose pa shkëlqim dhe identifikojnë vetitë e objekteve të ndryshme. Ata nisin të mendojnë se pse materiale me veti specifike përdoren për qëllime të ndryshme.

Nxënësit hetojnë materialet që kanë vetitë më të mira kundër ujit. Si fillim, ata parashikojnë se ç'u ndodhë materialeve kur futen në ujë. Çdo pesë minuta, ata bëjnë vëzhgime. Sqarohet gjithashtu ideja e gabuar se disa materiale nuk janë pëlhurë, ndonëse duken si të tilla.

Nxënësit nxiten të njohin dhe të emërtojnë materiale të zakonshme. Metali paraqitet si material shumë i rëndësishëm. Nxënësit bëjnë një listë me përdorime të metaleve dhe i lidhin këto përdorime me vetitë e tyre. Duke identifikuar të gjitha objektet

prej metali që ndodhen në klasë, ata tregojnë se sa kanë kuptuar si t'i dallojnë metalet. Ata nxiten gjithashtu që të gjejnë mënyrën se si këto objekte përdoren dhe emrin e secilit metal.

Jometalet paraqiten si çfarëdolloj materiali që nuk është metal. Nxënësit krahasojnë vetitë e metaleve me ato të jometaleve. Pastaj ata bëjnë një shqyrtim të objekteve në të gjithë shkollën dhe krahasojnë materialet e objekteve që gjetën me materialin që kanë marrë si shembull.

Në temën e fundit, nxënësit mësojnë si të grupojnë objekte të ndryshme sipas vetive të materialeve që i përbëjnë ato.

Aftësi të kërkimit shkencor

Gjatë këtij kapitulli, nxënësit kanë mundësi të kryejnë vëzhgime dhe hetime për të grupuar dhe për të testuar vetitë e materialeve. Nxënësit nxiten të bëjnë vëzhgime dhe t'i regjistrojnë të dhënat ndërkohë që studiojnë një shumëllojshmëri materialeve dhe bëjnë krahasime të metaleve me jometalet. Ata duhet gjithashtu ta përdorin aftësinë e krahasimit për të lidhur vetitë e metaleve me përdorimet e tyre. Kapitulli i nxit nxënësit të identifikojnë modele dhe shoqërizime të thjeshta.

Burime

Fletë letre A4, ngjitës, libra të rëndë.

Fjalë kyçe

dru	gomë	letër	material
metal	pëlhurë	plastik	qelq

(dhe çfarëdolloj materiali tjetër që mund të përdorni me nxënësit)

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

ndaj	them	zbuloj	zgjedh
------	------	--------	--------

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të përdorin shqisat për të zbuluar më shumë për materialet;
- të zbulojnë se si duken materialet kur i shoh dhe kur i prek;
- të jenë të aftë të emërtojnë disa materiale;
- të jenë të aftë të grupojnë materialet;
- të fillojnë të dallojnë fjalët kyçe.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë si të përdorin shqisat për të zbuluar materiale të ndryshme.

Kërkojuni nxënësve të shohin fotografinë e madhe të objekteve në faqet hyrëse dhe pyetini: *Sa objekte mund të shihni? A mund të thoni emrin e ndonjë materiali që shihni në fotografi?* Përdorini këto pyetje për të filluar një diskutim për materialet.

A e dini se...

Referojuni faktit të çuditshëm. U thoni nxënësve ta provojnë edhe ata. Kërkojuni nxënësve të punojnë në grupe dhe jepini secilit grup 12 fleta A4. Tregojuni si të mbështjellin një letër në formë tubi dhe si ta ngjisin. Tregojuni si të grupojnë tubat për të bërë një kullë. Ata mund ta provojnë kullën duke vendosur një libër të rëndë sipër saj.

Përfytyroni sikur po mbani në dorë këtë lodër. Çfarë ndieni kur e preknë?

Përdoreni këtë pyetje dhe tjetrën që vjen më pas për të zbuluar fjalët e ndryshme që përshkruajnë objektet. Shtojni fjalët e reja në "Murin e fjalëve" të klasës.

Përgjigje të mundshme: lodra të buta: e butë, e lëmuar, me gëzof, e qullët, e rrëshqitshme.

Përkrahuni këtë lodër. Çfarë ndieni kur e preknë?

Përgjigje të mundshme: Makina lodër: e fortë, e lëmuar, e rrumbullakosur.

Shikoni filxhanët. A dalloni ndonjë ndryshim ndërmjet tyre?

Kërkojuni nxënësve të shohin tre figurat e filxhanëve. Diskutoni faktin se objekte që kryejnë të njëjtin funksion mund të duken dhe të japin ndjesi të ndryshme.

Përgjigje të mundshme: Njëri është me shkëlqim dhe duket si metal. Tjetri është i vjetër dhe i treti duket si një filxhan i ri normal.

Mbështetje gjuhësore

Filloni me fjalët kyçe në faqen 16. Me qëllim që nxënësit t'i shohin shpesh fjalët kyçe dhe të familjarizohen me to, krijoni një stendë të madhe në murin e klasës dhe quajeni "Muri i fjalëve". Përdorini figurat e "Murit të fjalëve" bashkë me fjalët sa herë të jetë e mundur. Përfshijini nxënësit në krijimin dhe në mirëmbajtjen e tij. Në këtë fazë, ju mund t'i vini në dukje materialet kyçe dhe të tregoni shembuj të tyre. Sigurohuni që nxënësit të kuptojnë dallimin mes materialeve të ashpra dhe të lëmuara, të forta dhe të buta, me shkëlqim dhe pa shkëlqim. Demonstroni këto veti duke treguar shembuj materialeesh që i kanë ato dhe shtojni këto fjalë në "Murin e fjalëve".

Libri i nxënësit ka gjithashtu rubrikën *Fjalorth* ku nxënësit duhet të shkruajnë rregullisht përkufizimet ndërkohë që përparojnë me kapitullin.

Me qëllim që të familjarizohen sa më shpejtë me fjalët e reja, kërkojuni nxënësve t'i *dëgjojnë*, t'i *thonë*, t'i *lexojnë* dhe pastaj t'i *shkruajnë* fjalët.

Veprimtari më të zgjeruara

Ky mësim hyrës mund të zgjerohet më tej, duke u kërkuar nxënësve të bëjnë kërkime për materialin që përbën objekte të tjera të përditshme.

- 1 Jepuni nxënësve si detyrë të bëjnë kërkime për historinë e krijimit dhe të prodhimit të lodrave. Si kanë ndryshuar materialet me kohën?
- 2 Kërkojuni nxënësve të bëjnë një listë materialeesh të tjera që përdoren për të bërë lodra.

Materiale të ndryshme

Nxënësit përdorin shqisat për të zbuluar dhe për të folur për materiale të ndryshme.

Materiale të ndryshme

Ti përdor shqisat për të zbuluar materiale të ndryshme.

Ideja kryesore

Materialet janë të ndryshme edhe kur i shikojmë, edhe kur i prekim.

Për të zbuluar se si janë objektet, ne përdorim shqisat. Ne i shikojmë objektet. Ne i prekim ato.

☐ Shiko objektet më poshtë. Sa janë ato?

☐ Përfytyro sikur je në një dhomë të errët. Si do ta kuptojë se po prek mollën dhe jo lëmslin e leshit?

Kur i prek, disa objekte janë të forta, kurse disa të tjera janë të buta.

☐ Shiko fotografitë sërisht. Rretho përgjigjet e tua.

Cilat objekte janë të buta?
Cilat objekte janë të forta?
Cili objekt është i butë dhe i fortë?

☐ Zbulo: Cilat materiale mund të gesh?

1. Fute dorën brenda një çante me objekte.
2. Mos shiko brenda. Vetëm prek objektet.

☐ Çfarë mund të gesh?
Ti përdore shqisën e të prekurit.

Objektet përbëhen nga **materiale** të ndryshme. Kur i prek:

- disa materiale janë të forta;
- disa të tjera janë të buta;
- disa materiale janë të lëmuara;
- disa të tjera janë të ashpra.

☐ Rretho fjalën e saktë.

Kjo lodër është e butë e fortë

Toni shiko në faqen 34 për të kontrolluar se çfarë di.

Si të fillojmë

Nxënësit diskutojnë se si mund t'i identifikojnë objektet e forta e të buta, duke përdorur shqisën e të prekurit. Ata diskutojnë se si mund të dallojnë një mollë nga një varg objektesh të tjera dhe hetojnë për këtë, duke i identifikuar objektet që ndodhen brenda një çante me anë të shqisës së të prekurit. Nxënësit përsërisin njohuritë që kanë për vetitë e materialeve ndërkohë që plotësojnë detyrat në fund të mësimi.

Burime

Çanta, rrip për të mbyllur sytë, disa objekte të ashpra dhe disa të lëmuara.

Fjalë kyçe

material

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

krahasoj vështroj zgjedh

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të përdorin shqisat e tyre për të dalluar objekte;
- të zbulojnë materiale të ndryshme.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë për vetitë e materialeve të ndryshme.

Diskutoni që ne e zbulojmë përbërjen e

materialeve duke përdorur shqisat tona. U thoni nxënësve t'u tregojnë se çfarë mendojnë se janë shqisat. Përdorni tekstin dhe fotografitë e një syri dhe një dore në *librin e nxënësit* dhe bëni pyetje të tilla që ata t'u thonë se shikimi (të parit) dhe ndijimi (të prekurit) janë dy shqisa të rëndësishme që ndihmojnë për të njohur materialet.

Vështroni objektet më poshtë. Sa objekte shikoni?

Kërkojuni nxënësve të punojnë në grupe dhe të vështrojnë fotografitë e objekteve të ndryshme të përbëra nga materiale të forta.

Përgjigja: Shtatë objekte.

Sigurohuni që të gjithë nxënësit t'i përgjigjen saktë kësaj pyetjeje. Ata mund të përdorin fleta të vogla, të bardha, për t'ju treguar përgjigjet.

Vështroni fotografitë sërisht. Rrethoni përgjigjet tuaja.

Kërkojuni nxënësve t'i vështrojnë fotografitë sërisht dhe të mendojnë se si do u dukej secili prej objekteve po ta preknin. Para se t'u kërkonin nxënësve të qarkojnë përgjigjet e pyetjeve në librin e tyre, diskutoni me ta përgjigjet.

Cilat objekte janë të buta?

Përgjigjet: Leshi, tullumbacja.

Cilat objekte janë të forta?

Përgjigjet: Luga e drunjtë, molla, guri, qiriu.

Cili objekt është i butë dhe i fortë?

Përgjigja: Furça.

Përfytyroni se jeni në një dhomë të errët. Si do ta kuptonit se po prekni mollën dhe jo lëmslin e leshit?

Nxirrni si përfundim se ne mësojmë për objektet duke i parë dhe duke i prekur. Pyetini:

- A mund t'i shihni objektet në një dhomë të errët? Jo.
- Ç'shqisë tjetër mund të përdorni për të gjetur mollën? *Të prekurit/të ndijuarit.*

Nxirrni si përfundim se disa objekte janë të forta e disa janë të buta.

Përgjigje e mundshme: Duke përdorur shqisën e të prekurit.



Zbulohet: Cilat materiale mund të gjeni?

Qëllimi i kësaj veprimtarie është t'i lejojë nxënësit të identifikojnë materiale të ndryshme duke përdorur shqisën e të prekurit. Kjo do t'i ndihmojë ata të praktikojnë aftësitë e kërkimit shkencor që lidhen me identifikimin e materialeve bazuar në një veti të caktuar.

Do t'ju duhen: një çantë (një çantë prej pëlhure) që përmban objekte të vogla prej materialeve të ndryshme, si: prefëse lapsash, goma, lapsa, makina lodër, lodra të buta, monedha, gurë dhe sfungjerë.

Shpjegoni se objektet përbëhen prej materialeve të ndryshme. Disa janë të forta. Të tjera janë të buta. Disa materiale janë të lëmuara, ndërsa disa të tjera janë të ashpra.



Për të përmirësuar përdorimin e fjalëve të reja, tregoni shembuj të këtyre vetive ndërkohë që i thoni këto fjalë.

1 Fusni dorën brenda një çante me objekte.

- Organizoni klasën në grupe prej tre ose katër vetash dhe jepini një çantë secilit prej grupeve.
- Lidhni sytë njërit prej nxënësve. Nxënësit e tjerë do të udhëheqin duart e nxënësit për të prekur objektet në çantë.



Kini parasysh se disa nxënësve nuk u pëlqen errësira apo që t'u lidhin sytë. Këta nxënës mund të marrin pjesë thjesht duke mbyllur sytë.

2 Mos shikoni brenda. Vetëm prekni objektet.

- Shpjegoni se keni futur disa objekte në çantë. Nxënësit duhet të bëhen hetues. Kërkojuni t'ju thonë se sa objekte mund të gjejnë.
- Nxënësit duhet ta provojnë me radhë. Ata duhet të përpiqen derisa të kenë identifikuar të gjitha objektet që ndodhen në çantë.



Çfarë mund të gjeni?

U thoni nxënësve që t'i përdorin si ndihmë pyetjet e mëposhtme për të vendosur se ç'veti ka një objekt i dhënë:

- Është i fortë apo i butë?
- Është i lëmuar apo i ashprë?

Nxënësit duhet t'u thonë anëtarëve të grupit të tyre se çfarë mendojnë se është objekti dhe pastaj

ta nxjerrin nga çanta. Anëtarët e grupit vendosin nëse nxënësi kishte të drejtë.

Shpjegojini klasës se ata kanë përdorur një nga shqisat. Ata kanë përdorur të prekurit. Kjo shqisë mund t'i ndihmojë ata që të gjejnë se cilat materiale janë të forta apo të buta, dhe cilat materiale janë të lëmuara apo të ashpra.

Përgjigje e mundshme: qiri, gur, kaçavidë, tullumbace, lugë druri, penel, mollë, varëse rrobash etj.

Vlerësim formues



Rrethoni fjalën e saktë.

Shfrytëzoni pyetjet në fund të temës për të përforcuar dhe për të vlerësuar të kuptuarit e saj nga nxënësit.

Përgjigje: Lodra është e butë.

Përsëritje dhe reflektim

Përmbyllni temën duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë veprimtaritë e përsëritjes dhe të reflektimit në faqen 34 të *Librit të nxënësit*. (Shikoni edhe shënimet e mësuesit në faqen 36).

Mbështetje gjuhësore

Përdorni imazhet kur paraqisni fjalët e reja kyçe. Veprimtaritë e zbulimit në temat pasardhëse do të përforcojnë të kuptuarit e fjalëve kyçe. Referojuni "Murit të fjalëve" dhe imazheve të deritanishme. Shumica e fjalëve kyçe në këtë kapitull janë emra materialeve që do ti zbulojnë nxënësit. Një gabim që bëhet shpesh është rezultat i konfuzionit mes fjalëve "material" dhe "pëlhurë". Për këtë do të flitet me hollësi në temën e ardhshme. Si parapërgatitje shërben demonstrimi i fjalëve kyçe, si: dru, letër, qelq etj., që janë emra materialeve.

Veprimtari më të zgjeruara

Thuajuni nxënësve t'u kërkojnë anëtarëve të familjes të tyre të mbyllin sytë dhe të identifikojnë objektet në shtëpi. Objektet t'i përshkruajnë sipas ndijimeve që marrin nga prekja e tyre. Kjo do të shërbejë për përforcimin e fjalëve kyçe.

Vetitë e materialeve

Nxënësit identifikojnë karakteristikat e materialeve të ndryshme.

Vetitë e materialeve

Ti zbulon pamjen e materialeve dhe se çfarë ndien kur i prek ato.

Ideja kryesore

Materialet kanë veti.

Çfarë pamjeje kanë materialet?
Çfarë ndjesie marrim kur i prekim ato?
Çfarë bëjnë materialet kur veprojmë mbi to?

Shiko objektet dhe fjalët. Secili objekt ka një veti.

Bashko me vije secilën tullumbace me objektin përkatës.

a. i butë

b. i fortë

c. i ashpër

d. i lëmuar

e. me shkëlqim

f. pa shkëlqim

g. i tejdukshëm

h. e fortë

1. Zbulo: Si është objekti?

1. Gjej objekte brenda në klasë.

2. Ndaj objektet në grupe.

3. Si është secili objekt?

3. Regjistro çfarë gjete në fletoren e zbulimeve.

4. A ndodhet ndonjë objekt në më shumë se një grup?

5. Cili objekt është më i fortë?

6. Cili objekt ka më shumë shkëlqim?

7. Cili objekt është më i butë?

Fakt i çuditshëm

Diamanti është materiali më i fortë që gjendet në natyrë.



Plotëso me fjalët që mungojnë.

Disa materiale kanë më shumë se një _____.

Një material mund të jetë me _____ dhe _____.

Kutia e fjalëve

veti shkëlqim i fortë

Toni shiko në faqen 34 për të kontrolluar se çfarë di.

Si të fillojmë

Në këtë mësim, nxënësit përdorin shqisën e të prekurit dhe atë të të parit për të mësuar rreth materialeve të ndryshme. Nxënësit mësojnë për veti të tilla të materialeve si: i fortë, i butë, me shkëlqim dhe pa shkëlqim. Ata hetojnë disa objekte dhe identifikojnë vetitë e secilit. Nxënësit mendojnë rreth arsyes pse materialet me veti të veçanta përdoren për qëllime të ndryshme.

Burime

Disa objekte të vogla që shërbejnë për të treguar materiale të ndryshme dhe vetitë e tyre; një tabelë rezultatesh.

Fjalë kyçe

metal qelq

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

gjej zbuloj

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të kuptojnë se materialet kanë veti të ndryshme;
- të zbulojnë se ç'veti kanë disa objekte.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë të identifikojnë më shumë veti të materialeve të ndryshme.

Fillojeni mësimin me një lojë. Përgatitni një tabaka me rreth 12 objekte të buta e të forta dhe mbulojini ato me një cohë. Hiqeni mbulesën dhe lëroni nxënësit të vështrojnë objektet për 30 sekonda, pastaj vendoseni mbulesën sërish. Skuadrat bëjnë dy lista (një me të forta dhe tjetra me të buta). Skuadra me listën më të gjatë fiton.



Lidh me vije secilën tullumbace me objektin e saktë.

Shpjegoni se vetia përshkruan pamjen e materialit dhe ndjesinë që të jep. Thoni se materialet kanë veti të ndryshme. Kërkojuni nxënësve të shohin vetitë e shkruara në secilën tullumbace dhe ta lidhin atë me objektin e duhur.



Bëni kujdes të veçantë me fjalët "shikoj tejprertej". Fjala e duhur është "i tejdukshëm", por shikoj tejprertej është më e thjeshtë për këtë grupmoshë. Megjithatë provojeni nëse "i tejdukshëm" është një fjalë e njohur për ta. Tregoni me gisht xhamin e dritares ose objekte të tjera qelqi për ta ilustruar këtë praktikisht.

Përgjigjet:

- a) = (lodër e butë) e butë
- b) = (shkallë) e fortë
- c) = (sfungjer për pastrim) i ashpër
- d) = (gur) i lëmuar
- e) = (bizhuteri) me shkëlqim
- f) = (kuti kartoni) pa shkëlqim
- g) = (dritare) e tejdukshme
- h) = (tra mbajtës) i fortë

Lexoni bashkë me nxënësit tekstin në fillim të faqes 20 për të përsëritur se ç'është vetia.



Zbulo: Si është objekti?

Qëllimi i kësaj veprimtarie është t'i nxisë nxënësit të përdorin vetitë e materialeve për t'i grupuar. Ata do të praktikojnë aftësitë e hulumtimit shkencor të lidhura me vëzhgimin dhe grupimin.

Do t'ju duhen: prefëse lapsash, goma, lapsa, makina lodër, lodra të buta, monedha, gurë, sfungjerë enësh, qese plastike të tejdukshme dhe vizore plastike.

1 Gjeni objektet që ndodhen në klasë.

- Shpjegojuni nxënësve se ata do të jenë vëzhgues

dhe do të hetojnë disa materiale. Ata duhet të punojnë në grupe prej tre ose katër vetash.

2 Ndajini objektet në grupe.

Si është secili objekt?

Kërkojuni nxënësve t'i shohin objektet me kujdes. Bëni pyetje të tilla si:

- Është me shkëlqim apo pa shkëlqim?
- Kur e prek, duket i ashpër apo i lëmuar?
- Është i përkulshëm apo i papërkulshëm?

Përgjigje e mundshme: Guri është i fortë.

3 Regjistroji në fletoren e zbulimeve ato që zbulon.

- Vizatoni në dërrasë një tabelë si ajo më poshtë dhe tregojni klasës si ta plotësojë me shenjë pohuese ✓ ose me kryq ✗ (po dhe jo).
- Nxënësit duhet ta plotësojnë tabelën për secilin prej objekteve që hetojnë.

Objekti	I fortë	I butë	Me shkëlqim	Pa shkëlqim	I përkulshëm	I tejdukshëm
Vizore plastike	✓	✗	✓	✗	✓	✗

A ka objekte që ndodhen në më shumë se një grup?

Vini në dukje se materialet mund të kenë më shumë se një veti, p. sh.: materiali mund të jetë me shkëlqim dhe i butë.

Përgjigje e mundshme: Po.

Cili objekt është më i forti?

Cili objekt ka më shumë shkëlqim?

Cili objekt është më i buti?

Kërkojuni nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve në *Librin e nxënësit*.

A e dini se...

Referojuni faktit të çuditshëm për të theksuar se materialet, si diamanti, kanë veti të ndryshme.

Vlerësim formues

Plotësoni vendet boshe.

Përdorni këtë veprimtari për të përforcuar mësimin dhe për të matur se sa e kanë kuptuar nxënësit mësimin.

Përgjigje: Disa materiale kanë më shumë se një **(veti)**.

Një material mund të jetë me **(shkëlqim)** dhe **(i fortë)**.

Përsëritje dhe reflektim

Mbylleni temën duke u kërkuar nxënësve të përfundojnë veprimtarinë e përsëritjes dhe të reflektimit në faqen 34 të librit të nxënësit, të "Çfarë mësuam për materialet".

Mbështetje gjuhësore

Përdorni tullumbacet e fjalëve në faqen 20 për të ilustruar kuptimin e tyre. Vazhdoni t'i shtoni fjalë dhe figura "Murit të fjalëve". Referojuni rregullisht figurave mbështetëse për të përforcuar kuptimin dhe kontrolloni nëse nxënësit i kanë kuptuar konceptet. Përdorni fjalorthin për të nxitur nxënësit të gjejnë përkufizimet e fjalëve dhe lidhini këto me figurat.

Printoni emrat e vetive në fleta të veçanta A4. Vendosini përmbys në tavolinën tuaj. Ndajeni klasën në dy skuadra. Njëri prej nxënësve zgjedh një nga fjalët dhe përpiqet t'ia shpjegojë fjalën skuadrës së tij pa përdorur fjalën përkatëse. Nëse skuadra arrin ta gjejë fjalën, ata fitojnë një pikë. Pastaj e ka radhën skuadra tjetër. Vazhdoni derisa të mbarojnë të gjitha fletët me fjalë.

Veprimtari më të zgjeruara

1 Kërkojuni nxënësve të shohin tabelën e rezultateve të zbulimit. Pyetini:

- Ç'veti do të kishte materiali që do të zgjidhnit për një lodër bebeshe?

Përgjigje e mundshme: I butë, i përkulshëm, i papërshkueshëm nga uji.

- Ç'veti do të kishte materiali që do të zgjidhnit për të bërë shkallët e një pallati të ri?

Përgjigje e mundshme: I fortë.

Vetitë e materialeve

Nxënësit identifikojnë karakteristikat e materialeve të ndryshme.

Vetitë e materialeve

Ti zbulon çfarë bëjnë materialet kur veprojnë mbi to.

Ideja kryesore

Disa materiale nuk e lejojnë ujin të kalojë.

Materiali që nuk e lejon ujin të kalojë, quhet i papërshkueshëm nga uji.

Çfarë objekte të papërshkueshme nga uji ke në shtëpi?

Zbulo: Me cilin material mund ta mbështjellim pambukun për ta mbajtur të thatë sa më gjatë?

1. Mbështill pak pambuk me materiale të ndryshme. Materialet janë letër, karton, plastikë dhe pëlthurë.

2. Më pas, secilin material fute në ujë.

letër

karton

plastikë

pëlthurë

Burri nuk laget brenda në çadër.

Shëno në figurë materialin që parashikon se është më i papërshkueshëm nga uji.

Cili material e mban më gjatë të thatë pambukun?

Kopjo dhe plotëso tabelën në fletoren e zbulimeve.

A është i thatë pambuku?				
Koha	Letër	Karton	Qese plastike	Pëlthurë
5 minuta	×	✓	✓	×
10 minuta				
15 minuta				

Tabela tregon rezultatet që ke gjetur.

Çfarë zbulove? Plotëso me fjalë që mungojnë.

Unë përdora materialin të ndryshme për të mbështjellë

Unë veprova në mënyrë të _____ me secilin prej tyre.

Unë gjeta që _____ ishte materiali më _____ nga uji.

Kutia e fjalëve

i papërshkueshëm materiale njëjtë

pambukun qesja plastike

Si të fillojmë

Mësimi fillon me paraqitjen e vetisë së papërshkueshmërisë nga uji. Nxënësit, më pas, hetojnë materialet më të papërshkueshme nga uji. Fillimisht ata parashikojnë se çfarë do të ndodhë kur fusin materiale të ndryshme në ujë. Ata bëjnë vëzhgime çdo pesë minuta.

Burime

Lloje të ndryshme materialesh të papërshkueshme nga uji, pambuk, tasa të mëdhenj, qese plastike të tejdukshme, karton, letër, pëlthurë, orë, ngjithës.

Fjalë kyçe

letër plastikë

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

parashikoj zgjedh

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të flasin për vetitë e ndryshme të materialeve;
- të hetojnë se cilat materiale janë të papërshkueshme nga uji.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë se disa materiale tërhiqen.



Çfarë objekte të papërshkueshme nga uji keni në shtëpi?

Kërkojuni nxënësve të vështrojnë fotografinë dhe përshkrimin e saj. Diskutoni se si burri po mbrohet nga shiu. Kërkojuni të mendojnë për ndonjë material që është i përshtatshëm për të bërë një çadër. Pyetini edhe për materiale që nuk janë papërshtatshme.

Përgjigje e mundshme: Pardes, çadër, çizme llastiku, tas plastik etj.



Zbulo: Cili material është më i mirë për ta mbajtur pambukun të thatë?

Qëllimi i kësaj veprimtarie është që nxënësit të hetojnë materiale për të gjetur se cili prej tyre është më i papërshkueshëm nga uji. Kjo do t'i ndihmojë nxënësit të praktikojnë aftësitë e hulumtimit shkencor që kanë të bëjnë me kryerjen e një hetimi, me vëzhgimin e rezultateve dhe me zgjedhjen e materialit më të mirë.

Do t'ju duhet: pambuk, tas i madh me ujë, qese plastike e tejdukshme, karton, letër, pëlthurë, kronometër, ngjithës.

Shpjegoni se nxënësit do të hetojnë materiale të papërshkueshme nga uji.

- Mbështillni pak pambuk me materiale të ndryshme. Parashikoni se cili material do ta mbajë pambukun të thatë.
 - Organizojini nxënësit në dyshe. Shpjegojuni se ata duhet të mbështjellin pambukun me materiale të ndryshme: qese plastike, karton, letër dhe pëlthurë. Më pas, ata do ta fusin pambukun e mbështjellë në ujë për të provuar se cilët materiale janë të papërshkueshme nga uji. Demonstrojuni nxënësve si ta mbështjellin pambukun dhe si ta ngjisin mbështjellësen.
 - Jepini secilit grup materialet që do t'u duhen për veprimtarinë.
 - Vizatoni një tabelë në dërrasë që nxënësit të regjistrojnë rezultatet (shiko shembullin në *Librin e nxënësit* ose tabelën e plotësuar në faqen pasuese). Nxënësit duhet ta kopjojnë tabelën në fletoren e tyre të zbulimit dhe ta plotësojnë atë me rezultatet ndërkohë që janë duke kryer hetimin. Përndryshe fotokopjoni tabelën dhe jepuni nxënësve të gatshme.
- Pastaj, secilin pambuk të mbështjellë me materialin përkatës, futeni në ujë.

Udhëzoni nxënësit që të kenë kujdes kur përdorin ujë. U thoni të mos vrapojnë nëpër klasë se mund të rrëshqasin.

Shpjegoni se nxënësit duhet të thonë fillimisht se çfarë mendojnë se do të ndodhë. Kërkojuni ta diskutojnë me shokun ose shoqen e tyre se cili material mendojnë se do të jetë i papërshkueshëm nga uji. Shpjegojuni se kjo do të thotë të parashikosh.

Vër shenjën pohuese ✓ për materialin që ju parashikoni se është më i papërshkueshmi nga uji.

Kërkojuni nxënësve ta plotësojnë këtë veprimtari në *Librin e nxënësit* para se të vazhdojnë me veprimtarinë.

Përgjigje e mundshme: Materiali plastik.

Cili material e mban më gjatë pambukun të thatë?

Diskutojeni pyetjen me nxënësit. Kërkojuni grupeve dyshe të nxënësve të shohin pambukun pas 5 minutash, 10 minutash dhe 15 minutash. Tregojuni si të përdorin kronometrat. Përndryshe, ju mund të përdorni një kronometër për të gjithë klasën. Matja e kohës do t'u tregojë nxënësve se cili material e mban pambukun të thatë më gjatë.

Përgjigje e mundshme: Materiali plastik.

Kopjoni dhe plotësoni tabelën në fletoren e zbulimeve.

Kërkojuni nxënësve të plotësojnë tabelën e rezultateve në fletoren e tyre të zbulimit. Ata vënë shenjën pohuese nëse pambuku është i thatë ose vënë kryq nëse pambuku është i lagur, pas 5 minutash, 10 minutash dhe 15 minutash, për secilin material.

U thoni të punojnë në dyshe për të regjistruar rezultatet. Ndhimojini grupet ndërkohë që janë duke punuar. Nëse doni, përmbledhni rezultatet e gjithë klasës në dërrasën e zezë. Më pas nxënësit mund t'i kopjojnë rezultatet në fletoret e tyre të zbulimit.

Përgjigje:

A është i thatë pambuku?				
Koha	Letër	Karton	Qese plastike	Pëlhurë
5 minuta	✗	✓	✓	✗
10 minuta	✗	✓	✓	✗
15 minuta	✗	✗	✓	✗

Çfarë zbuluat? Plotësoni vendet boshe.

Në fund të veprimtarisë, kërkojuni nxënësve të plotësojnë fjalitë duke përdorur fjalët e kutisë së fjalëve. Kjo do t'i ndihmojë të përforcojnë çka mësuam gjatë hetimit.

Përgjigje: Ne përdorëm (materiale) të ndryshme për të mbështjellë (pambukun). Gjithçka tjetër e mbajtëm të (pandryshuar). Ne gjetëm se (qesja plastike) ishte materiali më i (papërshkueshëm) nga uji.

Mbështetje gjuhësore

Vazhdoni të lidhni fjalët me figurat duke përdorur "Murin e fjalëve" dhe shembuj objektesh të papërshkueshëm nga uji. Përveç kësaj, kërkojuni nxënësve të plotësojnë fjalorthin me fjalët kyçe dhe me përkufizimet përkatëse.

Luani lojëra të ndryshme për të lidhur fjalët me figurat në mënyrë që të përforconi atë që nxënësit kanë mësuar. Ju mund t'u jepni atyre fjalët (ose figurat) dhe të fshihni kartat me figura apo fjalët përkatëse nëpër dhomë. Nxënësit pastaj mund t'i kërkojnë që t'i lidhin me fjalën ose figurën që kanë në dorë.

Veprimtari më të zgjeruara

Nxënësit mund të bëjnë një kërkim për përdorimet e materialeve të papërshkueshme nga uji, p. sh. mushamatë e shiut, çantat dhe çadrat.

Vetitë e materialeve

Nxënësit identifikojnë karakteristikat e materialeve të ndryshme.

Vetitë e materialeve

Ti zbulon çfarë bëjnë materialet kur veprojnë mbi to.

Ideja kryesore

Disa materialet zgjaten kur i tërheqim.

☐ Shiko fotografinë. Fol rreth saj me shokun ose shokën e bankës.

Pse duhet që lidhësja e flokëve të zgjatet?

Prej çfarë materiali është lidhësja e flokëve?

☐ Zbuloni: Cilat materialet zgjaten kur i tërheqim?

☐ Cilat materialet në figurë zgjatet kur e tërheqim?



Vajza po përdor një lidhësje flokësh. Shiko sa zgjatet lidhësja.

- Mësuesja do të të japë disa objekte. Zbuloni se cilat prej tyre zgjatet kur i tërheq. Parashiko se cili do të zgjatet më shumë.
- Shkruaj rezultatet e tua në fletoren e zbulimeve.

☐ Cilat materialet u zgjat më shumë?

☐ Cilat materialet u zgjat më pak?

Tekstilet

Rrobotat e tua janë prej tekstili.

Tekstili është një lloj tjetër materiali.

☐ Shiko fotografinë. Shëno objektet prej tekstili.



☐ Si mendon?
Pse rrobotat bëhen prej tekstili dhe jo prej druri?

Si të fillojmë

Nxënësit marrin parasysh se materialet tërhiqen dhe zgjaten. Ata hetojnë një varg materialesh për të zbuluar cilët mund të tërhiqen e cilët jo. Në fund, ata njihen me fjalën “pëlhurë” si term i përdorur për të përshkruar materialet që përdorim për rroba dhe perde.

Burime

Shumëllojshmëri materialesh që tërhiqen dhe zgjaten ose që nuk tërhiqen, si: objekte metali, lugë, dru, qese plastike, lidhësje flokësh, lëmshe leshi, krehëra plastike, tasa prej qeramike etj.

Fjalë kyçe

pëlhurë tërhiqet zgjatet

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

parashikoj

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të kuptojnë që disa materialet zgjaten dhe disa të tjerë nuk zgjatet;
- të mësojnë se materialet si copat prej pambuku quhen pëlhurë.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë të identifikojnë dhe të emërtojnë disa materialet të zakonshme, duke përfshirë dhe metalet.



Vështroni fotografinë. Flisni për të me shokun e skuadrës.

Pse duhet që lidhësja e flokëve të tërhiqet e të zgjatet?

Prej çfarë materiali është lidhësja flokëve?

Kërkojuni nxënësve të shohin fotografinë e vajzës që po lidh flokët. Vini në dukje sa shumë tërhiqet e zgjatet lidhësja. Organizojini nxënësit në dyshe dhe kërkojuni të diskutojnë pse lidhësja e flokëve duhet të tërhiqet e të zgjatet. Ata duhet të shpjegojnë se duhet të zgjatet që të mund të mbështillet rreth flokëve të vajzës. Demonstroni këtë me një lidhësje flokësh ose me një copë materiali që tërhiqet dhe zgjatet, si p. sh. : lidhësje llastiku.

Pastaj, pyetini nxënësit: *Prej çfarë materiali mendoni se është lidhësja e flokëve?* Ata duhet të thonë se duhet të jetë material që tërhiqet dhe zgjatet, si p. sh.: llastik ose gomë.

Përgjigje të mundshme: Lidhësja e flokëve duhet të jetë material që tërhiqet që të mbështillet rreth flokëve.

Përbëhet prej materiali që tërhiqet dhe zgjatet, si p. sh. : llastik ose gomë.



Zbuloni: Cilat materialet mund të zgjatet?

Qëllimi i kësaj veprimtarie është që nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre parashikuese duke marrë me mend se cilat materialet mund të tërhiqen dhe më pas të testojnë parashikimet e tyre.

Do t’ju duhet: shumëllojshmëri materialesh që zgjaten dhe që nuk zgjaten, si: objekte metali, lugë, dru, qese plastike, lidhësje llastiku, lëmshe leshi, krehëra plastike, tasa qeramike etj.



Cili prej materialeve në figurë do të zgjatet kur ta tërheqim?

Kërkojuni nxënësve të shohin me kujdes figurat e objekteve mbi tavolinë. Lërin t’i prekin dhe të përpiqen t’i tërheqin disa prej materialeve.

Përgjigje të mundshme:

Nuk do të zgjatet: shufra e metalit, druri, krehëra plastik, tasi prej argjile.

Do të zgjatet: qesja plastike, lidhësja e llastikut, leshi.

1 Mësuesja do t’ju japë disa objekte. Zbuloni se

cilat objekte mund të zgjaten. Parashikoni se cili do të zgjatet më shumë.

- Nxënësit mund të punojnë në grupe treshe ose katërshe.
- Shpërndajuni nxënësve objektet që duhet të provojnë.

Si do ta provoni secilin material?

Nxënësit duhet të dinë se po të tërheqësh materialin nga cepat, kuptohet nëse materiali zgjatet (zgjerohet) apo jo. Ata duhet të nxjerrin si përfundim se disa materiale zgjaten ose zgjerohen kur i tërheqim.

Përgjigje e mundshme: Do ta tërheq materialin.

2 Shkruajini rezultatet në fletoren e zbulimeve.

- Kërkojuni nxënësve të shkruajnë rezultatet e tyre në fletoren e zbulimeve. Më poshtë jepet shembulli i një tabele rezultatesh.

Materiali	Sa shumë tërhiqet?
Lidhëse Ilastiku	Shumë
Tel metalik	Fare
Qese plastike	Pak

- Lidhëset e Ilastikut do të zgjaten më shumë se materialet e tjera dhe materialet e papërkulshme siç janë shufrat e metalit do të zgjaten më pak ose aspak. Ju mund ta vazhdoni më tej këtë veprimtari duke u kërkuar nxënësve të rendisin materialet nga ai që mund të zgjatet më pak gjer te ai që zgjatet më shumë.

Cili material u zgjat më shumë?

Përgjigje e mundshme: Lidhësja e Ilastikut.

Përgjigjet do të varen nga materialet që nxënësit kanë testuar/provuar.

Cili material u zgjat më pak?

Përgjigje të mundshme: Shufra e metalit, copa e drurit, krehri plastik, tasi prej argjile.

Përgjigjet do të varen nga materialet që nxënësit kanë provuar.



Vështroni fotografitë. Shënoni me shenjë pohuese ✓ objektet prej pëlhere.



Diskutoni këtë ide të gabuar: disa njerëz përdorin fjalën material për të përshkruar pëlhurën që përdorim për rroba. Këto janë lloje materiale, por është më e saktë të përdoret fjala 'pëlhurë'.

Për të vlerësuar të kuptuarit e këtij koncepti, kërkojuni nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve në *Librin e nxënësit*.

Përgjigje: a) Këmishë ✓, b) Perde ✓, c) Kanistër ✗, d) Peshqirë (✓), e) Mur ✗

Mbështetje gjuhësore

Nxënësit duhet të kuptojnë që fjala "tërheq" do të thotë: kap diçka në një skaj ose nga të dy skajet dhe e zgjas a e zgjeroj. Kur t'i njihni nxënësit me këtë term, tërhiqni një lidhëse Ilastiku ndërkohë që nxënësit thonë fjalën. Përsëriteni këtë veprim dy-tri herë gjatë mësimit. Kur të shpjegoni fjalën pëlhurë, tregojuni nxënësve shembuj rrobash. Vini në dukje se pëlhurat janë një lloj materiali.

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Demonstroni zgjatjen e materialeve në mënyrë me shkencore: ngjisni në një mbajtëse disa objekte prej materiale të ndryshme dhe me gjatësi të njëjtë, si p. sh.: sustë, lidhëse Ilastiku, tel dhe fije pambuku. Pastaj varni me një gur peshe në fund, p. sh., 20 g, në fundin e secilit objekt. Secili material do të zgjatet në gjatësi të ndryshme. Ju mund ta masni se sa është zgjatuar materiali me vizore.
- 2 Kërkojuni nxënësve të shohin pëlhura të ndryshme dhe të parashikojnë se cila do t'i mbante më ngrohtë.



Si mendon? Pyetja e kësaj rubrike është ndërtuar për t'i bërë nxënësit të mendojnë se pse materiale të veçanta përdoren për qëllime të ndryshme. Prisni një përgjigje që shpjegon se: *Druri është material i fortë. Ai nuk përkulet, kështu që rrobat nuk do të ishin të rehatshme.*

Vetitë e materialeve

Nxënësit identifikojnë karakteristikat e materialeve të ndryshme.

Vetitë e materialeve

Ti zbulon çfarë bëjnë materialet kur veprojnë mbi to.

Ideja kryesore

Metalet mund të marrin formë të ndryshme.

Ky byzylyk është prej metali.

Clat janë vetitë e byzylykut? Rretho fjalët e sakta.

i butë i fortë pa shkëlqim me shkëlqim

Si janë metalet?

Metalet zakonisht janë të forta dhe me shkëlqim. Metalet mund të marrin formë të ndryshme. Metali nxehtet derisa zbutet. Pastaj rrihet me çelëz për t'i dhënë formën e objektit që duam. Metalet mund edhe të zgjaten për t'u bërë tel.

Metali tingëllon kur goditet.

Pse tigani është prej metali?

Zbulo: Gjej objekte metalike.

- Shiko rreth e qark klasës.
- Gjej objekte prej metali.
- Regjistro objektet që gjeje në fletoren e zbulimeve.

Çfarë është vetia? Rretho fjalët që tregojnë veti të materialeve.

i fortë i butë letër metal dru i përkulshëm i papërkulshëm nga uji

Fakt i çuditshëm

Ekziston një metal që nuk është i fortë. Ai është lëng, njësoj si uji. Ai quhet merkur.

Tani shiko në faqen 34 për të kontrolluar se çfarë di.

Si të fillojmë

Metalet paraqiten si material shumë i rëndësishëm dhe nxënësit zbulojnë vetitë e tyre. Ata bëjnë një listë të përdorimeve të shumta të metaleve dhe i lidhin ato me vetitë përkatëse. Duke identifikuar gjithë objektet prej metali që ndodhen në klasë, nxënësit tregojnë se sa mirë i dallojnë metalet. Ata nxiten edhe të emërtojnë secilin metal dhe të tregojnë se në ç'mënyrë përdoret objekti metalik. Ata përfundojnë mësimin duke përsëritur vetitë e materialeve që mësuën.

Burime

Objekte metalike, si: tel, ibrik, zile e vogël, prefëse lapsash, lugë, gërshërë, varëse rrobash, kapëse letrash, gozhdë, vidha dhe vegla.

Fjalë kyçe

dru material metal pëlhurë

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

ndaj thuaj/trego

Vështirim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të zbulojnë vetitë dhe përdorimet e metaleve;
- të përsërisin vetitë e materialeve.



Cilat janë vetitë e byzylykut? Rrethoni fjalët e sakta.

Veprimtaria e fillimit është planifikuar që t'i bëjë nxënësit të mendojnë për vetitë e metaleve. Kërkojuni të vështrojnë fotografinë dhe bëjuni pyetjen e mëposhtme për secilën veti me radhë:

- A është byzylyku i butë/i fortë/pa shkëlqim/me shkëlqim?

Përgjigje: i fortë, me shkëlqim.

Si janë metalet?

Shpjegoni vetitë e metaleve. Metalet janë zakonisht të fortë dhe me shkëlqim. Ata e lejojnë përçimin e elektricitetit. Ata tingëllojnë kur ju i godisni. Shumica e tyre e përçojnë nxehtësinë. Metalet mund edhe të petëzohen apo të zgjaten e të bëhen tela.



Shembujt janë mënyra më e mirë për të ilustruar këto veti, p. sh.: një gotë metalike e fortë dhe me shkëlqim, tela elektrikë, zile të vogla që tingëllojnë, kaloriferë për të ngrohur klasën ose ibrik, varëse rrobash metalike etj.



Pse tigani është prej metali?

Bëni që nxënësit t'i përgjigjen kësaj pyetjeje. Pastaj flisni për objektet e tjera që ndodhen në fotografi. Për shembull, zilja është prej metali, sepse metalet tingëllojnë kur i godasim. Metali për varësen e rrobave është telëzuar dhe pastaj i është dhënë forma e duhur. Tasi metalik është rrahur për t'u petëzuar. Rikujtoni fjalën "veti". Pyesni:

- Cilat janë vetitë e këtyre objekteve metalike? Ata janë të fortë, me shkëlqim dhe zakonisht të papërkulshëm.

Përgjigje e mundshme: Tigani është metalik, sepse metali është i fortë dhe lejon nxehtësinë të kalojë nëpër të.



Zbulo: Gjej objekte metalike

Qëllimi i kësaj veprimtarie është gjetja dhe identifikimi i objekteve metalike. Kjo do t'i ndihmojë ata të praktikojnë aftësitë e hulumtimit shkencor që lidhen me vëzhgimin dhe grupimin.

Do t'ju duhen: objekte të vogla metalike, si: prefëse lapsash, lugë, gërrshërë, varëse metalike rrobash, kapëse letrash, gozhdë, vidha, zbukurime, vegla etj.

Para se të fillojë mësimi, shpërndani nëpër klasë objekte të ndryshme metalike në mënyrë që t'i gjejnë nxënësit.

1 Shiko rreth e rrotull klasës.

- Tregojuni nxënësve për hetimin dhe u thoni të ndahen në dyshe.
- Sigurohuni që në klasë të ketë shumëllojshmëri objektesh të përbëra prej metalesh të ndryshme.

2 Gjej objektet metalike.

- Kërkojuni nxënësve të shohin rreth e rrotull dhomës. U thoni të tregojnë me gisht dhe të identifikojnë çdo objekt metalik që shohin. Pastaj tregojuni se prej ç'lloj metali është objekti. Për shembull, shpjegoni se luga është prej çeliku.
- Kërkojuni nxënësve që objektet metalike që gjejnë t'i vendosin në një tavolinë në mes të klasës.



U thoni nxënësve se duhet të tregohen të kujdesshëm, sepse disa objekte mund të jenë të mprehta dhe të rënda.

3 Regjistroni objektet që gjetët në fletoren e zbulimit.

- Kopjoni në dërrasë tabelën e rezultateve si më poshtë. Nxënësit nuk janë mësuar të vizatojnë apo të plotësojnë tabela, prandaj përdorni diskutimin dhe demonstrimin për ta bërë plotësimin e tabelës si një veprimtari të përbashkët në nivel klase, që udhëhiqet nga ju.
- Nxitini nxënësit të kopjojnë dhe plotësojnë tabelën si grupe dyshe. Disave mund t'u duhet të kopjojnë nga dërrasa tabelën e plotësuar.

Emri i objektit	Emri i metalit	Për çfarë përdoret?

A e dini se...

Referojuni faktit të çuditshëm. Merkuri është metal. Është i pazakontë, sepse është i lëngët. Përdoret në termometrat mjekësorë, por dihet që merkuri është shumë helmues. Termometri me merkur është shumë i saktë dhe përdoret nëse është e sigurt që qelqi i tij nuk thyhet. Ju mund t'u tregoni nxënësve tuaj mjete të tjera për të matur temperaturën, si p.sh., me termometra prej kristali.

Vlerësim formues

Përdorni veprimtarinë në fund të mësimi në mënyrë që nxënësit të kontrollojnë se sa e kanë kuptuar temën. Këtë detyrë duhet ta bëjnë në mënyrë individuale.



Çfarë është vetia? Rrethoni fjalët që tregojnë veti të materialeve.

Përgjigje: I fortë, i butë, i përkulshëm, i papërkulshëm nga uji.

Përsëritje dhe reflektim

Në fund të mësimi, kërkojuni nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve "Çfarë mësuam për materialet" te rubrika "Përsëritje dhe reflektim" në faqen 34 të *Librit të nxënësit*.

Mbështetje gjuhësore

Shpjegoni që vetitë e materialit kanë të bëjnë me pamjen dhe me ndjesinë që merr kur i prek. Ndhimojini nxënësit ta kuptojnë këtë duke dhënë shembuj materialesh me veti të ndryshme. Kërkojuni të thonë, p.sh.: "Një nga vetitë e këtij materiali është butësia" ose "Një nga vetitë e këtij materiali është fortësia".

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Kërkojuni nxënësve të mendojnë për objekte metalike që ata kanë parë dhe kanë përdorur. Kërkojuni të përdorin fotografi për të bërë një ekspozitë në mur.
- 2 Kërkojuni nxënësve të përfytyrojnë se ç'do të ndodhte nëse nuk do kishte metale?

Metalet dhe jometalet

Nxënësit njohin dhe emërtojnë materiale të zakonshme.

Metalet dhe jometalet
Ti emërton disa materiale të zakonshme.

Ideja kryesore
Materialet mund të jenë metale ose jometale.

Nëse një material nuk është metal, ai quhet jometal. Disa jometale të zakonshme janë: plastika, druri, qelqi, argjila, goma, guri dhe tekstili.

28

argjilë

plastikë

guri

qelq

druri

tekstil

Zbulo: Është metal apo jometal?

Puno me një shok ose shoqe.

- Shikoni objektin që ju jep mësuesi. Është objekt prej metali apo jometali?
- Më pas, kërkoni objekte rreth e qark shkollës.
- Bëni një listë të objekteve që gjetët.

Tregoni rezultatet tuaja.

29

Si mendon?
Si e kupton nëse një objekt është prej plastike apo prej druri?

Si të fillojmë

Në fillim nxënësit përsëritin punën e bërë në mësimin paraardhës, më tej ata japin shembuj objektesh metalike dhe thonë se për çfarë i përdorin. Më pas mësimi vazhdon me jometale, që në këtë mësim paraqiten si çfarëdolloj materiali që nuk është metal. Nxënësit krahasojnë vetitë e jometaleve me ato të metaleve. Ata kryejnë një vërtetim në shkollë, gjatë të cilit bëjnë lidhjen mes materialit të marrë si mostër dhe materialeve të tjera të ngjashme që ndodhen në shkollë.

Burime

Mostra të vogla materialesh përfshirë kauçukun, metalin, qelqin (jo të mprehtë), drurin dhe pëlhurën.

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të zbulojnë se disa materiale janë metale dhe disa janë jometale;
- të grupojnë materialet në metale dhe jometale.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë se si disa materiale janë të përshtatshme për një përdorim të caktuar.

Kërkojuni nxënësve të vështrojnë fotografite e materialeve të ndryshme në *librin e nxënësit* dhe të lexojnë përshkrimet e tyre së bashku.



Shpjegojuni nxënësve se nëse materiali nuk është metal, ai është jometal. Disa jometale të zakonshme janë kauçuku, druri, qelqi, argjila, goma, guri dhe pëlhura. Bëjini nxënësit t'i përdorin këto fjalë duke u treguar objekte të përbëra prej këtyre materialeve. Shtojini fjalët në "Murin e fjalëve" të klasës.

Për të përmbledhur ato që nxënësit kanë mësuar gjatë kapitullit, pyetini:

- Nga i dallojmë metalet nga jometalet?
Shikojmë vetitë e materialit.

Tregojuni nxënësve tabelën e mëposhtme. Kjo tabelë ka një listë vetish të metaleve dhe jometaleve. Nxënësit do ta përdorin këtë informacion për të identifikuar metalet dhe jometale. Informacioni është thjeshtuar për nxënësit e vegjël, megjithatë, vetitë që gjenden në listë u përkasin shumicës së metaleve dhe jometaleve.

Metale	Jometale
Shumica janë të rëndë	Shumica janë të lehtë
Copat e holla janë të përkulshme	Copat e holla thyhen lehtësisht
Janë të fortë	Shumica janë të fortë
Mund telëzohen	Nuk mund të telëzohen
Mund të petëzohen nëse rrihen me çekan	Nëse rrihen me çekan thyhen
Lëshojnë tingull kur i godasim	Nuk lëshojnë tingull kur i godasim

Tabela duket e ndërlikuar, por nëse ju i ndihmoni nxënësit kur ta përdorin, atyre do t'iu duket e dobishme. Diskutoni secilin rresht me kujdes.



Zbulo: A është metal apo jometal?

Qëllimi i kësaj veprimtarie është që nxënësit të përdorin njohuritë që kanë për materialet dhe vetitë e tyre për të identifikuar disa materiale brenda shkollës. Kjo do t'i ndihmojë të praktikojnë aftësitë e vëzhgimit, të identifikimit dhe të grupimit.

Do t'ju duhen: mostra të vogla druri, kauçuk, qelq (jo i mprehtë), metal, pëlhurë.

Informojini nxënësit që ata do të vëzhgojnë materialet që gjenden në shkollë. Shpjegojuni se

kjo do të thotë se ata do të ecin nëpër shkollë që të gjejnë materialet. Mos harroni të njoftoni dhe mësuesit e tjerë.

1 Shikoni objektin që të jep mësuesi.

- Organizojini nxënësit në dyshe dhe jepini secilit nxënës mostrën e një materiali.
- Mostrat duhet të jenë prej materialesh të zakonshme, në mënyrë që nxënësit të gjejnë lehtësisht më shumë shembuj nëpër shkollë.

A është objekt prej metali apo jometali?

Bëjuni nxënësve pyetje të tilla si:

- Nëse materiali juaj është jometal, ç'lloj është ai: dru apo kauçuk?
- Cilat janë vetitë e tij? Është i fortë? Është i butë? Është i rëndë? etj.

2 Më pas kërkoni objekte rreth e qark shkollës.

U thoni nxënësve që ata duhet të gjejnë më shumë shembuj të këtij materiali rreth e rrotull shkollës.

3 Bëni një listë të objekteve që gjetët.

- Kërkojuni nxënësve të mbajnë shënime në fletoren e tyre të hetimit. Ata mund të shkruajnë emrin e secilit objekt dhe vendin se ku e kanë gjetur. Nëse doni, ata mund t'i vizatojnë objektet në vend që të shkruajnë emrat e tyre.
- Diskutoni tabelën me vetitë e metaleve dhe të jometaleve. Kërkojuni nxënësve t'u thonë se cilat përshkrime përkojnë me mostrën e objektit të tyre dhe të objekteve që kanë gjetur. Ndhmojini nxënësit që të ndërtojnë si klasë një tabelë të vetive të objekteve që gjetën.

Tregojuni rezultatet tuaja mësuesit dhe shokëve në klasë.

Në fund të vërtetimit kërkoni me radhë secilit grup tregojë për gjetjet e tij.

Mbështetje gjuhësore

Bashkë me figurat e jometaleve, përdorni dhe tabelën e vetive të metaleve dhe të jometaleve. Referojuni figurave dhe fjalëve në "Murin e fjalëve". Përdorni fjalorthin për përkufizimet.

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Pyetini nxënësit se cili është materiali më i përdorur në botë (betoni). Nëse ata nuk e dinë, kërkojuni të përpiqen ta gjejnë. Interneti dhe burime të tjera mund t'i ndihmojnë ata për të gjetur përgjigje. Ju mund të përgatisni burime të tjera dytësore për t'i ndihmuar nxënësit me këtë detyrë (p. sh., tabela të thjeshta dhe grafikë).
- 2 Kërkojuni nxënësve që në një periudhë të caktuar të ditës të bëjnë një listë për të gjitha materialet që shohin. Pyetini: *Cilin material patë më shumë? A ju çuditi kjo gjë? A ishte i njëjtë me materialin më të përdorur në botë?*



Si mendon? Kërkojuni nxënësve që ta diskutojnë pyetjen me shokun apo shoqen e tyre. Nxitini të përdorin vetitë e metaleve që kanë mësuar në këtë kapitull, për të krahasuar objektet plastike me ato prej druri. Prisni përgjigje që shpjegojnë se *druri ka ca si kokrriza dhe është më pak i lëmuar se materiali plastik.*

Metalet dhe jometalet

Nxënësit njohin dhe emërtojnë materialet e zakonshme.

Metalet dhe jometalet

Ti emërton disa materiale të zakonshme.

Ideja kryesore

Disa materiale i përdorim më shumë pasi janë më të rëndësishme.

☐ Kujto disa objekte që ke përdorur gjatë kësaj jave. Për çfarë i ke përdorur ato? Pse?

Modeli i urës në figurë është bërë me makarona fije gjata. Makaronat janë një ushqim që bëhet me miell.

Ne mund të emërtojmë disa materiale të zakonshme. Këto janë ato që përdorim më shumë.

Druri është shumë i zakonshëm.

☐ Cili nga këto objekte është zakonisht prej druri?

☐ Po objekti tjetër nga se bëhet zakonisht?

Si mendon? Pse nuk bëhen urat e vërteta me makarona fije gjata?

Metalet janë shumë të rëndësishme. Çfarë janë metalet? Disa metale të zakonshme janë: hekuri, çeliku, bakri, alumini, ari dhe argjendi.

monedha bakri tigan çeliku kënaçe alumini

vëthë prej ari byzylykë argjendi

Shiko fotografitë. Shkruaj dy gjëra që janë prej metali.

_____ dhe _____

Rretho përgjigjen e saktë.

Bakri është	jometal	metal.
Plastika është	jometal	metal.
Nëse tingëllon si zile kur goditet, materiali është	metal	jometal.

Toni shiko në faqen 35 për të kontrolluar se çfarë di.

Si të fillojmë

Nxënësit nxiten të mendojnë, se pse materiale të ndryshme përdoren për qëllime të ndryshme, në varësi të vetive që kanë. Pastaj ata shohin përdorimet e drurit dhe të materialeve të tjera.

Nxënësit e vlerësojnë metalin si material shumë të rëndësishëm. Ata bëjnë një listë të disa prej përdorimeve të shumta të metaleve dhe i lidhin këto përdorime me vetitë e tyre. Thëksoni se vetitë e metaleve (i fortë, me shkëlqim, i përkulshëm, që mund të telëzohet, që përçjell elektricitetin dhe nxehtësinë) i bëjnë shumë të përshtatshëm për disa përdorime. Tregojuni nxënësve shembuj të tillë si tela elektrike, zbukurime dhe vegla, për të ilustruar këto veti dhe përdorime. Nxënësit pastaj përsërisin ato që mësuhan duke iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me materialet dhe vetitë e tyre.

Burime

Makarona të gjata; gurë ose tulla; objekte të përbëra prej materialeve të ndryshme.

Fjalë kyçe

dru

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të përsërisin, pse disa materiale janë më të mira se disa të tjera për gjëra të caktuara
- të mësojnë disa nga përdorimet e metaleve.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë si të klasifikojnë objektet.



Mendoni për objektet metalike që keni përdorur këtë javë. Për çfarë i përdorët? Pse?

Kërkojuni nxënësve të diskutojnë pyetjet në grupe dyshe. Bëjini të mendojnë për disa shembuj, duke u bërë pyetjen:

- A mund t'i emërtoni metalet?

Përgjigje të mundshme: Luga – për të ngrënë, prefesja e lapsit – për të mprehur lapsin, varësja e rrobave – për të varur bluzën time, etj.

Pastaj vazhdoni të shpjegoni se ne mund t'i emërtojmë disa materiale të zakonshme. Këto janë ato materiale që ne përdorim më shpesh. Referojuni sërish figurave në faqen 28: statuja e gurit, tabela druri, poçe prej argjile, kuti plastike, copa pëlhure dhe xhami i dritares. Pyetini nxënësit për emra materialeve të tjerë të zakonshëm. Ata duhet të përdorin fjalët: metal, jometal, plastik, qelq, dru dhe qeramikë (argjilë). Kërkojuni nxënësve të propozojnë ndonjë material tjetër.



Cili prej këtyre objekteve është zakonisht prej druri?

Kërkojuni nxënësve të shohin dy fotografitë e objekteve prej druri. Bëni pyetjet e librit të nxënësve.

Pyesni Pse? pas çdo përgjigjeje të nxënësve, qoftë ajo e gabuar apo e saktë, për t'i nxitur të shpjegojnë se përse mendojnë se karrigia dhe telefoni celular janë zakonisht prej druri ose prej metali a kauçuku. Ata duhet të dinë se kjo lidhet me vetitë e tyre.

Përgjigje e mundshme: b) karrigia.



Diskutoni çdo veti të re që nxënësit përshkruajnë. Shtoni konceptet dhe idetë e reja në "Murin e fjalëve" të klasës.



Prej ç'lloj materiali është zakonisht objekti tjetër?

Bëni që nxënësit t'ju thonë se telefoni celular përbëhet zakonisht prej disa materialeve, p. sh., kauçuk dhe metal. Kërkojuni t'i shkruajnë përgjigjet në Librin e nxënësve.

Përgjigje e mundshme: Metal, kauçuk.



Vështroni figurat. Shkruani dy gjëra për të cilat i përdorim metalet.

Tregoni figurat e objekteve metalike dhe u rikujtojani nxënësve që metalet janë shumë të rëndësishme.

Rendisni një varg të vogël objektiv metalike në fillim të klasës. Përdorni vegla të tilla si çekiç dhe dalta, gozhdë dhe vidha, komplet thikash dhe zbukurime. Pyesni:

- Nga e dimë ne se këto objekte janë prej metali? Ata janë me shkëlqim dhe të fortë. Ata kanë marrë forma të ndryshme, pra janë përkulur, kështu që ka mundësi të jenë metale.
- A mund të bëhen prej qelqi këto objekte? Nëse disa nga objektet do të ishin prej qelqi, ata nuk do ta bënin mirë punën e tyre. Për shembull, një çekiç, daltë apo gozhdë prej qelqi do të thyhej. Disa objekte mund të bëhen dhe prej qelqi si p. sh., zbukurimet.

Shpjegoni se disa prej metaleve të zakonshëm janë hekuri, çeliku, bakri dhe alumini. Nxënësit mund të kenë dëgjuar edhe për arin dhe argjendin. Tregojuni se prej ç'lloj metalesh janë bërë objekte të ndryshme. Pastaj kërkojuni nxënësve t'i përgjigjen pyetjes.

Përgjigje të mundshme: Dy prej këtyre: për monedha, për të gatuar, për kënaqë, stoli (vëthë, byzylykë).

Vlerësim formues

Përdorni detyrën në fund të mësimin, për të vlerësuar të nxënët e nxënësve. Nxënësit duhet ta plotësojnë detyrën në mënyrë të pavarur për të matur të nxënët personal.



Rrethoni përgjigjen e saktë.

Përgjigje: Bakri është metal.

Materialet plastike janë jometale.

Nëse tingëllon si zile, materiali është metal.

Përsëritje dhe reflektim

Përfundojeni mësimin, duke u kërkuar nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve në faqen 35 të librit të nxënësit.

Mbështetje gjuhësore

Organizojini nxënësit në grupe prej gjashtë vetash. Jepini njërit prej anëtarëve të secilit grup një letër me një fjalë kyçe. Letra duhet të jetë e palosur që anëtarët e tjerë të grupit të mos e shohin. Kërkojini nxënësit që i dhatë letrën, ta lexojë fjalën kyçe pa zë dhe të mos lejojë askënd tjetër që ta shohë. Pastaj, po ky nxënës shkruan në një copë letër një fjalë që e përshkruan fjalën kyçe ose të kundërtën e saj dhe pasi e palos ia jep një nxënësi tjetër, i cili shkruan një fjalë të re që ka lidhje me fjalën që i dha anëtari i parë i grupit. Ata vazhdojnë kështu me të gjithë anëtarët e grupit. Anëtari i fundit lexon fjalët me zë të lartë.

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Kërkojuni skuadrave të nxënësve të ndërtojnë një urë me makarona të gjata ose pipëza dhe të provojnë se sa peshë mund të mbajë. Bëni një konkurs në klasë.
- 2 Kërkojuni nxënësve të bëjnë një kërkim për disa metale dhe për përdorimet e tyre. Jepini secilit grup një metal të ndryshëm që ata të mund të përgatisin një vitrinë të vogël me fotografi nga revistat, broshurat e dyqaneve ose nga interneti.

Si mendon? Kërkojuni nxënësve të shohin fotografinë e urës me makarona. Nxitini të mendojnë për vetitë e makaronave. Nëse është e mundur, lërin të shohin dhe të prekin disa prej tyre. Ata do të zbulojnë se makaronat thyhen shumë lehtë. Pastaj tregojuni ca gurë dhe pyetini se pse mendojnë se gurët dhe tullat janë materiale më të zakonshme për të ndërtuar ura. Lërin të shtypin dhe të përthyejnë makaronat e gjata dhe gurët dhe të krahasojnë dy materialet e ndryshme. Nxirni si përfundim se: Makaronat e gjata thyhen shumë lehtë.

Grupimi i objekteve

Nxënësit klasifikojnë objektet në grupe, bazuar në vetitë e materialeve prej nga përbëhen.

Grupimi i objekteve
Ti i ndan materialet në grupe.

Ideja kryesore
Ne mund t'i ndajmë materialet në grupe.

Fakt i çuditshëm
Goma nxirret nga pemë. Shumë objekte mund të bëhen me gomë.

Zbulo: Grupimi i materialeve
Ndaj materialet në grupe.
1. Vendosi secilin grup brenda një rrethi.

Si mendon?
Pse nuk është shkencor grupimi i objekteve sipas ngjyrës?

Shkruaj emrat e dy metaleve.
dhe _____
Shkruaj emrat e dy jometaleve.
dhe _____
Shiko këto objekte. Ato janë prej gome.

a. topa gome
b. çizme gome
c. rathë gome
d. doreza gome

Pse përdoret goma për të bërë këto objekte?
Goma mund të tërhiqet ose të kërcejë.
Ajo nuk përkrahë nga uji.

Plotëso etiketat.
Doreza është prej _____
Trupi është prej _____
Rrota është prej _____
Kutia e fjalëve
metali plastike gome

Toni shiko në faqen 35 për të kontrolluar se çfarë di.

Si të fillojmë

Në mënyrë që ata të reflektojnë për çfarë kanë mësuar, nxënësve fillimisht u kërkohet të japin shembuj metalesh dhe jometalesh. Nxënësit, pastaj, shohin objekte të ndryshme prej gome dhe shqyrtojnë vetitë e këtij materiali. Pastaj ata ndajnë materialet në grupe, në varësi të pamjes apo ndjesisë që të japin kur i prek. Ata shqyrtojnë pse zgjedhën këtë mënyrë të grupuarit të objekteve, p. sh., në bazë të ngjyrës, të formës, të fortësisë apo të shkëlqimit.

Burime

Rrathë të mëdhenj ose tabaka, shumëllojshmëri objektesh për të klasifikuar, p. sh., lugë druri, blloqe druri, zare, vizore plastike, gërrshërë, topa etj.

Fjalë kyçe

gomë

Vështirësi shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të identifikojnë materiale të ndryshme;
- të ndajnë materialet në grupe.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të përsërisin dhe do të reflektojnë për çfarë kanë mësuar në këtë kapitull.

A e dini se...

Referojuni faktit të çuditshëm dhe diskutoni informacionin e dhënë. Goma vjen në fakt nga limfa e pemës dhe quhet lateks/lëng qumështor. Ju mund t'u tregoni nxënësve prej nga prodhohet goma, duke përdorur fotografi nga libra të ndryshëm dhe nga interneti. Goma sintetike mund të prodhohet dhe nga vaji.

Për të përsëritur ato që kanë mësuar, kërkoni nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve të para në *Librin e nxënësit*.

Shkruani emrat e dy metaleve.

Përgjigje: Dy prej këtyre: hekur, çelik, bakër, ar, argjend ose alumin.

Shkruani emrat e dy jometaleve.

Përgjigje: Dy prej këtyre: kauçuk, dru, qelq, argjilë, gomë ose pëlthurë.



Pse përdoret goma për të bërë këto objekte?

Kërkoni nxënësve të shikojnë objektet prej gome në *Librin e nxënësit*. Nxitini të shikojnë pamjet dhe të diskutojnë për çfarë po shohin. Bëjuni pyetje të tilla, si:

- Cila fotografi tregon lidhëse llastiku? Fotografia c.
- Cila fotografi tregon dorashka gome? Fotografia d.

Shpjegoni se ka një arsye pse këto objekte janë prej gome.

Sigurohuni që nxënësit të kuptojnë se goma përdoret, sepse mund të tërhiqet e të zgjatet, të kërcejë dhe është e papërshkueshme nga uji.

Përgjigje e mundshme: Goma përdoret, sepse tërhiqet; mund të kërcejë; e papërshkueshme nga uji.



Zbulo: Grupimi i materialeve

Qëllimi i kësaj veprimtarie është që nxënësit të përdorin vetitë e materialeve për të grupuar objektet. Kjo do t'i ndihmojë të praktikojnë aftësitë e hulumtimit shkencor që janë të lidhura me vëzhgimin, identifikimin dhe grupimin.

Do t'ju duhen: rrathë të mëdhenj, tabaka ose kuti; disa objekte, si: prefëse lapsash, lugë, kapëse

letrash, gozhdë, vegla, lodra prej druri, stilolapsa, goma fshirëse, lidhëse llastiku, vizore plastike, guaska, pëlhurë etj.

Paralajmërojini nxënësit që të kenë kujdes pasi disa artikuj mund të jenë të mprehtë dhe të rëndë.



1 Vendosni secilin grup brenda një rrethi.

- Kërkojuni nxënësve të ndahen në grupe treshe ose katërshe.
- Kërkojuni atyre të shikojnë fotografite e rrathëve klasifikues në librin e nxënësve. Fotografite tregojnë se si një rreth është përdorur për të grupuar objekte plastike dhe një tjetër është përdorur për të grupuar objektet prej druri.
- Jepini secilit grup shumë objekte dhe shumë rrathë, tabaka ose kuti ku të grupojnë objektet e tyre. Kërkojuni nxënësve t'i shohin me kujdes objektet dhe të përdorin sa më shumë veti për t'i grupuar.
- Shpjegojuni se ata duhet t'i klasifikojnë objektet, duke i vënë në një grup ato që duken njëjloj kur i sheh dhe në një grup tjetër ato që ndijojnë njësoj kur i prek.



Shpjegojuni nxënësve se nëse gjërat duken njëjloj kur i sheh dhe kur i prek, themi që janë të ngjashme.

Kërkojuni nxënësve t'ju tregojnë se pse i vendosën objektet në grupe të ndryshme. Nxirrni si përfundim se ka shumë mënyra për të grupuar objektet. Disa nxënës mund të vendosin të kenë dy grupe: metale dhe jometale. Të tjerë mund t'i ndajnë objektet e tyre në "me shkëlqim" dhe "pa shkëlqim", ose në të fortë dhe të butë. Është po ashtu e saktë nëse nxënësit vendosin të kenë tre ose më shumë grupe, si: objekte plastike, metali, druri, pëlhure etj.



Shkruani disa përgjigje të mundshme në dërrasë që nxënësit të mund t'i kopjojnë në librin e tyre.



Plotësoni etiketimet

Shpjegoni se nxënësit duhet të përdorin fjalët: metal, plastikë, dhe gomë për të plotësuar etiketat.

Përgjigje: Kjo dorezë është prej plastike.

Kjo kornizë është prej metali.

Kjo rrotë makine është prej gome.

Përsëritje dhe reflektim

Përfundojeni mësimin duke u kërkuar nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve në faqen 35 të librit të nxënësit.

Mbështetje gjuhësore

Për të përfocuar fjalët kyçe, luani një lojë që ka të bëjë me përkufizimin dhe gërmëzimin e materialeve. Një nga nxënësit thotë një fjalë. Një nxënës tjetër e shkruan fjalën. Pastaj një i tretë shkruan përkufizimin e fjalës. Mund t'ju duhet t'u rikujtoni të gjitha fjalët kyçe të kësaj faze. Vazhdoni derisa të gjitha fjalët të jenë përkufizuar.

Veprimtari më të zgjeruara

Kërkojuni nxënësve të mendojnë për pyetjet e mëposhtme.

- 1** Pse nuk e përdorim dhe aq shumë gomën në ditët e sotme?
- 2** Ç'material përdorim në vend të gomës?

Shpjegoni se është e vështirë të gjesh gomë. Kjo e bën atë të shtrenjtë. Kauçuku e ka zëvendësuar gomën në shumë prodhime, sepse është më i lirë dhe më i lehtë për t'u përdorur.



Si menden? Përdorni këtë detyrë për të zgjeruar më tej mënyrat e grupimit të objekteve. Pyetini nxënësit:

- Ju mund t'i klasifikoni materialet, duke vendosur së bashku ato që kanë ngjyra të njëjta. Cila është mënyra më shkencore për të klasifikuar materialet? Klasifikimi i materialeve bëhet duke përdorur veti që janë më shkencore se ngjyra.

Nxitini nxënësit të kuptojnë se materialet mund të ngjyrosen, por kjo nuk i ndryshon vetitë e tyre kryesore. Për shembull, një lidhëse llastiku, sfungjer larës, sferë qelqi, tigan metalik apo pëlhurë mund të jenë të gjitha blu, por janë që të gjitha materiale shumë të ndryshme nga njëri-tjetri.

Vlerësim formues

Përdorni veprimtarinë në fund të mëimit për të përsëritur dhe për të matur të nxënësit e pavarur të nxënësve në secilin grup.

Çfarë mësuam për materialet

Çfarë mësuam për materialet

Materiale të ndryshme

Plotëso fjalinë me fjalët e duhura.

Lodrat, kur i prek, mund të jenë të _____ ose të _____.

Kurta e fjalëve të forta të buta

Unë i përshkruaj materialet duke i parë dhe duke i prekur.

Si duken materialet?

Disa gjëra duken _____ ose _____.

Kurta e fjalëve pa shkëlqim me shkëlqim

Unë i dalloj materialet duke i parë dhe duke i prekur.

Çfarë bëjnë materialet kur veprojmë mbi to?

Kur bie shi, unë vesh... Rretho figurën e saktë.

Unë e di pse përdorim materialet të ndryshme për gjëra të ndryshme.

Metale dhe jometale

Shiko këto materiale. Rretho të gjitha jometalet.

Unë e di se cilat materiale janë metale dhe cilat janë jometale.

Grupimi i objekteve

A mund t'i gruposh këto objekte? Lidh me vijë çdo objekt me fjalën e duhur.

gomë pëlthurë

Unë mund t'i grupoj objektet sipas materialeve që i përbëjnë ato.

Si të fillojmë

Qëllimi i këtij mësimi është të nxisë nxënësit të përsëritin ato që kanë mësuar në çdo mësim të kapitullit. Çdo mësim ka pyetje përforcimi për nxënësit. Këto pyetje shërbejnë për të vlerësuar njohuritë dhe të kuptuarit e mësimi.

Pas pyetjeve përforcuese, ka një detyrë përsëritjeje dhe reflektimi. Ju duhet të vlerësoni sa të sigurt ndihen nxënësit për secilin mësim. Në klasën e parë, nxënësit mund të ngjyrosin, të vizatojnë një fytyrë të buzëqeshur ose të vendosin një poster të vogël.

Përsëritje dhe reflektim

Materiale të ndryshme

Pyetini nxënësit:

- Cila është e kundërta e "i nxehtë"? I ftohtë.

Përdorni shembuj të të ftohtit dhe të të nxehtit për të përsëritur të kundërtat e tjera që përshkruajnë materialet: i fortë dhe i butë, i ashpër dhe i lëmuar.

Tregojuni nxënësve shembuj realë të objekteve që ndodhen në fotografi. Kërkojuni të përdorin shqisat e tyre (të të parit dhe të të prekurit) për t'i përshkruar.

Përgjigje: Lodrat mund të jenë **të forta** ose **të buta** kur i prek.

Unë mund t'i përshkruaj materialet duke i parë dhe duke i prekur.

Si janë materialet?



Plotësoni fjalinë me fjalët e duhura.

Përsërisni fjalët e përdorura për të përshkruar vetitë e materialeve që nxënësit mësuam gjatë veprimtarive në faqen 20 dhe shembujve të materialeve me veti të ndryshme. Nxitini nxënësit të krahasojnë materialet duke bërë pyetje të tilla si: Cili material është më i shkëlqyeshmi? Cili material është më i forti? etj.

Përgjigje: Disa gjëra duken me **shkëlqim**. Gjëra të tjera duken **pa shkëlqim**.

Shtojni materiale dhe etiketa tavolinës-vitrinë. Krijoni një vitrinë muri me titull "Vetitë", me etiketa, p. sh., "i fortë", "i butë", "me shkëlqim", "pa shkëlqim", "i papërkulshëm", "i përkulshëm" etj. Nxënësit mund të gjejnë ose të vizatojnë figura për të ilustruar secilën veti.

Çfarë bëjnë materialet kur veprojmë mbi to?



Kur bie shi unë vesh... Rretho figurën e duhur.

Kërkojuni nxënësve të rrethojnë figurën e duhur.

Metalet dhe jometalet



Shikoni këto materiale. Rrethoni gjithë jometalet.

Përgjigje: argjilë, letër, pëlthurë, kauçuk, dru.

Bëni që nxënësit të nxjerrin si përfundim që vetitë e materialeve i bëjnë ata të përshtatshëm për qëllime të caktuara. Kështu, një shtëpi e ndërtuar me tulla është shumë më e mirë se një shtëpi e ndërtuar me pipëza.

Krijoni një vitrinë muri me materiale të ndryshme dhe shembuj të përdorimit të tyre. Nxitini nxënësit të thonë se pse disa materiale përdoren për qëllime të caktuara, duke thënë vetitë e tyre. Për shembull, pyesni:

- Pse dritaret janë prej qelqi? Sepse qelqi është i tejdukshëm.
- Pse lidhëset e llastikut janë prej gome? Sepse goma tërhiqet dhe zgjatet.

Grupimi i objekteve



A mund t'i gruponi saktë këto objekte? Lidh me vizë çdo objekt me fjalën e duhur.

Kujtojuni nxënësve hetimin që bënë për grupimin e objekteve. Pyetini:

- Çfarë mund të përdorni për t'i grupuar këto objekte? Rrathë grupimi.

Tregoni me gisht figurat në këtë veprimtari dhe kërkojuni nxënësve të emërtojnë objektet e treguara. Pyetini se prej ç'lloj materiali janë objektet dhe ç'veti e bëjnë këtë material të përshtatshëm për funksionin që ka objekti.

Përgjigje: Goma: lidhëse llastiku, çizme llastiku/gome, topa llastiku, doreza gome.

Pëlhura: bluzë, perde, peshqirë.

Vlerësimi formues

Detyra e përsëritjes dhe e reflektimit në *Librin e nxënësit* është një pikë fillestare e shkëlqyer, kur ju duhet të diskutoni për përparimin e secilit nxënës në veçanti. Ky informacion mund të përdoret edhe për dëftesat në fund të tremujorit.

Është e dobishme të mbani shënime mbi ecurinë e nxënësve dhe sigurinë e të nxënësve të tyre, për të identifikuar ato pjesë që duhen përsëritur më vonë (shikoni një shembull në tabelën e mëposhtme).

Detyra për "Çfarë mësuam për materialet"	Shumë i sigurt	Jo shumë i sigurt	Jo i sigurt

Këto të dhëna mund të përdoren për të ndërtuar një program ndihmese për nxënësit që kanë nevojë. Të dhënat dhe analiza për çdo nxënës duhet të jenë në një formë të thjeshtë. Ju duhet vetëm një përshtypje e përgjithshme për vlerësimin e klasës dhe jo të dhëna personale të nxënësit, p. sh.: 50% e klasës nuk ishin të sigurt për...

3 Gjallesat dhe rritja e tyre

Në këtë kapitull, nxënësit:

- mësojnë që kafshët dhe bimët janë gjallesa;
- zbulojnë që ka gjallesa dhe jogjallesa;
- zbulojnë kafshë dhe bimë të ndryshme si dhe vendin ku jetojnë;
- mësojnë për nevojën e një diete të shëndetshme, që përfshin llojet e duhura të ushqimeve dhe ujit;
- mësojnë se njerëzit dhe kafshët e tjera kanë pasardhës, të cilët bëhen të rritur.

3. Gjallesat dhe rritja e tyre

Në këtë kapitull, ti:

- mëson se kafshët dhe bimët janë gjallesa;
- zbulon gjëra që nuk kanë qenë asnjëherë të gjalla;
- zbulon ndryshimet mes kafshëve dhe bimëve si dhe ku jetojnë ato;
- zbulon pse ne kemi nevojë për një dietë të shëndetshme;
- mëson se të vegjlit bëhen të rritur;
- mëson se të vegjlit quhen pasardhës.

bimë jogjallesa familje gjallesa Reja e fjalëve

Shiko me kujdes figurat e lulëdiellit.

A ndryshon pozicioni i Diellit në figurë? Nga është drejtuar lulja?



Fakt i çuditshëm

A e di se ne jemi shumë të ngjashëm me bimët? Edhe ne, edhe bimët jemi TË GJALLË!

Si të fillojmë

Ky kapitull i njeh nxënësit me idenë se bimët dhe kafshët janë gjallesa që rriten dhe ndryshojnë. Nxënësit bëhen të vetëdijshëm për ngjashmëritë dhe dallimet mes bimëve e gjallesave të tjera dhe kuptojnë se ka disa sende pa jetë që nuk kanë qenë kurrë të gjalla dhe që quhen jogjallesa.

Aftësi të kërkimit shkencor

Nxënësit përpiqen t'u përgjigjen pyetjeve, duke mbledhur të dhëna përmes vëzhgimit, duke marrë pjesë në diskutime dhe duke bërë parashikime për dukuri të ndryshme shkencore. Ata mësojnë si të propozojnë ide, si të ndjekin udhëzimet dhe si të regjistrojnë informacionin. Ata bëjnë krahasime dhe shohin nëse parashikimet e tyre përputhen me rezultatet. Nxënësit modelojnë dhe komunikojnë idetë e tyre në mënyrë që të zhvillojnë aftësitë e të menduarit shkencor.

Fjalë kyçe

bimë	fermë	ha	i gjallë
i vërtetë	kafshë	lëviz	pa jetë
pi	shtëpiake		ujë
ushqim			

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

përgjigjem

pyes

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të njohin çfarë do të mësojnë në këtë kapitull;
- të mendojnë për ngjashmëritë mes bimëve dhe njerëzve;
- të zbulojnë se bimët mund të lëvizin.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë më shumë për gjallesat dhe sendet pa jetë.

U thoni nxënësve të shohin fjalët dhe figurat në faqet hyrëse. Kërkojuni nxënësve të shohin fjalët kyçe dhe u thoni se ata do të mësojnë kuptimin e këtyre fjalëve. Tregojuni se ata do të mësojnë për gjallesat.

Kërkojuni nxënësve të shohin me kujdes fotografinë e lulëdiellit. Nxirrni si përfundim se lulëdielli është bimë. Nëse në klasë ka bimë të tjera, u thoni nxënësve se edhe ato janë bimë. Pamjet tregojnë se si lulëdielli lëviz duke iu drejtuar Diellit. Përdorini këtë pamje për t'i bërë nxënësit të mendojnë se bimët lëvizin. Lëvizja është një nga faktorët që përcakton nëse diçka është e gjallë apo jo. Referojuni faktit të çuditshëm.

A ndryshon pozicioni i Diellit në qiell?

Kërkojuni nxënësve të tregojnë me gisht Diellin. Pastaj pyetini nëse ata e vënë re se gjatë ditës, Dielli duket sikur lëviz nga njëra anë e qiellit në tjetrën.

Kërkojuni nxënësve të shohin me kujdes pozicionin e Diellit mbi lulediellit në pamjet në libër. Pastaj kërkojuni të tregojnë me gisht Diellin dhe duke e mbajtur gishtin mbi faqen e librit, të tregojnë lëvizjen tij.

Pyesni:

- Çfarë mendoni se po bën Dielli?
- A mund të përshkruani atë që shihni?

Përgjigje e mundshme: Dielli duket se po lëviz nga një anë e fotografisë/qiellit në anën tjetër të fotografisë/qiellit.

Shpjegoni se fotografia paraqet lëvizjen e dukshme të Diellit përmes qiellit gjatë ditës, ndërkohë që Toka rrotullohet rreth boshtit të saj.

Në ç'drejtim lëviz lulja?

Kërkojuni nxënësve ta shohin lulen sërish. Pyetini:

- Çfarë po i ndodh lules ndërkohë që Dielli lëviz?

Përgjigje e mundshme: Lulja lëviz në mënyrë që të jetë përballë Diellit.

Nxitini nxënësit të parashikojnë se çfarë i ndodh lulediellit kur Dielli perëndon.

Pyetini nxënësit:

- Çfarë mendoni se i ndodh lulediellit kur perëndon Dielli? Hamendësoni: ajo fle; petalet mbyllen; ajo rri aty ku është derisa të lindë Dielli; qëndron drejt; lëviz e shkon aty ku ishte në fillim ndërkohë që pret që Dielli të lindë.



Shpjegoni ç'kuptim ka fjala parashikoj. Përkufizojeni këtë fjalë ndërkohë që mendoni se "çfarë mund të ndodhë" gjatë hetimit.

Shpjegoni se natën luledielli kthehet në pozicion neutral, që do të thotë në mes, dhe kur Dielli lind sërish, ato sërish e ndjekin.

Shpjegoni se ne e dimë se një bimë është e gjallë, sepse ajo mund të lëvizë, megjithëse në shumë bimë lëvizja nuk është shumë e dukshme. Luledielli është shembull i mirë i një bime që lëviz.

- Kërkojuni nxënësve t'ju thonë një nga gjërat që mësuan në këtë mësim.
- Kujtojuni nxënësve gjërat kryesore që mësuan për gjallesat.
- U thoni nxënësve se në mësimin e ardhshëm ata do të mësojnë më shumë për gjallesat dhe sendet pa jetë ose jogjallesat.

Mbështetje gjuhësore

Filloni me fjalët kyçe. Krijoni në klasë një "Mur fjalësh" në mënyrë që nxënësit t'i shohin shpesh fjalët dhe të familjarizohen me to. Sa herë që të jetë e mundur, bashkë me fjalët, përdorni edhe figura. Përfshijini nxënësit në krijimin e "Murit të fjalëve".

Libri i nxënësit ka një fjalorth ku nxënësit mund të shtojnë vazhdimisht përkufizime. Përdorimi i vazhdueshëm i fjalorthit do të përmirësojë vetëbesimin e nxënësve në njohjen e fjalëve të reja dhe të kuptimit të tyre.

Kërkojuni nxënësve t'i dëgjojnë, t'i thonë dhe më pas t'i shkruajnë fjalët.

Kur të paraqisni koncepte shkencore, si p. sh., "ndaj me të tjerët", ilustroni ato me lojëra. Për shembull, kërkojuni nxënësve "të ndajnë me të tjerët" disa ëmbëlsira ose artikuj të tjerë në mënyrë që secili të ketë të njëjtën sasi. Përforcojeni këtë në mësimet e ardhshme, duke e përsëritur ushtrimin.

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Kërkojuni nxënësve të shohin fjalët kyçe dhe të identifikojnë fjalët e përdorura në mësim: bimë, e gjallë.
- 2 Kërkojuni nxënësve të shkruajnë përkufizimet e fjalëve në fjalorthin e tyre.

Gjallesë apo jogjallesë?

Nxënësit kuptojnë që kafshët dhe bimët janë gjallesa.
Nxënësit kuptojnë që ka gjallesa dhe sende pa jetë që quhen jogjallesat.

Gjallesë apo jogjallesë?

Ti mëson se kafshët dhe bimët janë gjallesa.
Ti zbulon se ka gjëra që nuk kanë qenë asnjëherë të gjalla.

Ideja kryesore

Në mund ta ndajmë botën në gjallesa dhe jogjallesat.

☐ Si e kuptojmë që një gjë është gjallesë ose që nuk ka qenë asnjëherë e gjallë?
Shiko figurat.
☐ Rretho gjërat që janë gjallesa.



☐ Pse mendon se kafshët dhe bimët janë të gjalla?
Gjallesat mund të marrin frymë, të rriten, të lëvizin dhe të ushqehen. Jogjallesat nuk mund të bëjnë asgjë nga këto.
☐ Cilat fjalë u përkasin gjallesave?
Rretho ato.

☐ Si mendon?
A është gjallesë një bimë e tharë?

☐ Plotëso fjalët me fjalët e duhura.
Bimët dhe kafshët janë gjallesa.
Gjallesat mund të rriten, mund të dhe të ushqehen.
Ndërtesat dhe nuk kanë qenë asnjëherë të gjalla.
Gjërat që nuk kanë qenë asnjëherë të gjalla nuk mund të të lëvizin ose të ushqehen.

Fjalë të gjallesave
kafshët lëvizin shkëmbinjtë rriten

Tani shiko në faqen 48 për të kontrolluar se çfarë di.

aftësia për të lëvizur, për t'u ushqyer dhe për t'u rritur.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë më shumë për mënyrat se si kafshë dhe bimë të ndryshme jetojnë në mjedise lokale.

Si t'i dallojmë gjallesat nga jogjallesat?

Diskutojeni këtë pyetje me nxënësit. Bëni pyetje dhe përdorni shembuj që të dilni në përfundimin se gjallesat mund të lëvizin, të hanë dhe të rriten. Mos u flisni ende për riprodhimin. Kjo çështje do të diskutohet më vonë.

Përgjigje e mundshme: Gjallesat mund të lëvizin, të hanë dhe të rriten. Jogjallesat nuk bëjnë asnjë nga këto gjëra.

Si të fillojmë

Në këtë temë nxënësit mësojnë si t'i dallojnë gjallesat nga jogjallesat. Duke u bazuar në temën paraardhëse, nxënësit kuptojnë se gjallesat kanë disa karakteristika të përbashkëta, p. sh., aftësinë për t'u rritur, për të lëvizur dhe për t'u ushqyer.

Burime

Bimë e prerë; bimë e gjallë; makinë lodër; pamje gjallesash dhe jogjallesash.

Fjalë kyçe

bimë	e gjallë	ha
lëviz	pa jetë	rritem

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

përgjigjem	pyes
------------	------

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të dinë se bimët dhe kafshët janë gjallesa;
- të bëjnë dallimin mes gjallesave dhe jogjallesave;
- të identifikojnë disa karakteristika të përbashkëta të të gjithë gjallesave, si p. sh.,

U thoni nxënësve të shohin me kujdes figurat në librin e tyre. Nisni një diskutim për dallimet mes gjallesave dhe jogjallesave. Pyesni për figurën e parë:

- Si mendoni, kali është i gjallë apo pa jetë? Pse mendoni se është i gjallë?

Përgjigje e mundshme: Ai mund të lëvizë, të hajë dhe të lindë të vegjël.

Shpjegoni se nëse diçka mund të lëvizë, të hajë dhe të rritet, është gjallesë. Kujtojuni nxënësve se si lëvizte luledielli. Pastaj pyesni për figurën e dytë:

- A mendoni se është e gjallë apo pa jetë? E gjallë.

Nxënësit mund të thonë që është pa jetë. Nëse kjo ndodh, përforconi idenë se nëse diçka mund të lëvizë dhe të rritet është gjallesë.

- Pse mendoni kështu?

Përgjigje e mundshme: Mund të rritet; mund të lëvizë.

Në vijim, kërkoni nxënësve të shikojnë fotografinë e gurit. Pyesni:

- Guri, a është i gjallë apo pa jetë? Është gjallesë apo jogjallesë? Pse?

Përgjigje e mundshme: Nuk mund të lëvizë; nuk ha; nuk mund të rritet.

Pyetini nxënësit nëse makina lodër në figurën e katërt është e gjallë apo jo e gjallë. Përgjigjet e tyre duhet të jenë të tilla si: mund të lëvizë. Shpjegoni

se një makinë mund të lëvizë, por duhet një shofer për ta ngarë. U thoni atyre se një makinë nuk mund të hajë apo të rritet.

Vazhdoni të bëni pyetje për dy figurat e fundit (pema dhe peshku).

Rrethoni gjallesat.

Para se të fillojnë, tregojuni nxënësve modelin e përgjigjes.

Përgjigje: Gjallesa: **kali**, bima, pema, peshku.
Jogjallesa: guri, makina lodër.

Shpërndani figura të gjallesave dhe të sendeve pa jetë. Kërkojuni nxënësve të punojnë në dyshe për të klasifikuar figurat në kategoritë e duhura.

 Ecni nëpër klasë që të siguroheni se nxënësit janë të sigurt për mënyrën se si duhet t'i klasifikojnë figurat.

Kjo veprimtari përforcon idenë se ka gjallesa dhe sende pa jetë. Ndërkohë që ecni nëpër klasë, pyetini nxënësit se përse e kanë vendosur një figurë të caktuar në atë kategori e jo në kategorinë tjetër.

Pse mendoni se kafshët dhe bimët janë të gjalla?

U thoni nxënësve se kemi folur për kafshët dhe bimët si gjallesa. Pastaj, kërkojuni t'ju thonë edhe njëherë të përbashkëtat e kafshëve dhe të bimëve që janë treguese se ato janë të gjalla.

Përgjigje e mundshme: Kafshët dhe bimët mund të hanë, të rriten dhe të lëvizin.

Cilat fjalë u përkasin gjallesave? Rrethojini ato.

Lista përfshin fjalë që lidhen edhe me gjallesat edhe me jogjallesat. Nxënësit qarkojnë fjalët që lidhen me gjallesat.

 Thojeni secilën prej fjalëve. Pyetini nxënësit nëse ajo fjalë mund të përdoret për gjallesat. Kërkojuni nxënësve t'ju thonë fjalën juve. Kontrolloni shqiptimin e fjalës.

Përgjigje: Të gjalla: **ec**, marr frymë, lëviz, tigër, rritem, ha.

Jo të gjalla: ujë, qelq, gur, dru, kauçuk, tavolinë, karrige.

Vlerësimi formues

Plotëso fjalitë me fjalët e duhura.

Kërkojuni nxënësve të plotësojnë fjalitë që përmbledhin pikat kyçe të mësimin.

 Shkruajeni modelin e përgjigjes në dërrasë/ tabelë për t'u treguar nxënësve se si bëhet. Shkruani secilën fjalë nga kutia e fjalëve dhe thojeni me zë të lartë. Kërkojuni nxënësve të thonë fjalët, kur ju i tregoni ato me gisht. Udhëhiqni nxënësit të përgjigjja e saktë, duke shkruar fjalinë në dërrasë ndërkohë që e thoni. Për shembull: *Bimët dhe...? janë gjallesa.* Veproni njëlojtë për secilën fjalë.

Kërkojuni nxënësve të kopjojnë në librin e tyre fjalët nga kutia e fjalëve.

Përgjigje: Bimët dhe **kafshët** janë gjallesa. Gjallesat mund të rriten, të **lëvizin** dhe të hanë. Ndërtesat dhe **gurët** nuk kanë qenë kurrë të gjalla. Jogjallesat nuk mund të **rriten**, të lëvizin apo të hanë.

Përsëritje dhe reflektim

Përfundojeni mësimin duke u kërkuar nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve në faqen 48 të librit.

Mbështetje gjuhësore

Përdorni karta me figura të gjallesave dhe jogjallesave. Thoni emrin e çdo figure dhe pyetini nxënësit nëse ajo është e gjallë apo jo. Kthejeni veprimtarinë në lojë skuadrash. Kjo mund të jetë një mundësi e mirë për të mësuar konceptin e ndarjes me të tjerët.

Veprimtari më të zgjeruara

1 Kërkojuni nxënësve të bëjnë një poster që tregon gjallesa dhe jogjallesa.

 **Si mendon?** Tregojuni nxënësve një bimë pa jetë në vazo dhe pyetini nëse ajo është e gjallë apo jo. Nxirrni si përfundim se, megjithëse bima nuk jeton më, ajo ka jetuar më parë. Kjo veprimtari ka si qëllim të zgjerojë më tej aftësitë e të menduarit dhe të të arsyetuarit të nxënësve.

Ku jetojnë kafshët dhe bimët?

Nxënësit zbulojnë si kafshët dhe bimët jetojnë në mjediset lokale (habitete të tyre).

Ku jetojnë kafshët dhe bimët?

Ti zbulon kafshët dhe bimët të ndryshme, si dhe vendin ku jetojnë ato.

Ideja kryesore

Kafshëve dhe bimëve u pëlqen të jetojnë në vende të ndryshme.

☐ Pse jetojnë në ndërtesa?
Shiko fotografitë e kafshëve dhe të bimëve që jetojnë në vende të ndryshme.

☐ a. Pse palma e palmet rritet këtu?
☐ b. Pse antilopat jetojnë këtu?
☐ c. Pse nuk ka bimë ose kafshë këtu?

Ku jetojnë secili prej tyre? Lidh kafshën ose bimën me shtëpinë e vet.

Plotëso vendet boshe me fjalët që mungojnë.

Kafshët dhe bimët kanë nevojë për një vend ku të jetojnë dhe të rriten.

Kafshët kanë nevojë për ushqim, ujë dhe një vend për të qelqur.

Bimët kanë nevojë për ujë që të rriten.

Disa kafshë dhe zogj e gjejnë vetë vendin ku flenë.

Rutina e fjalëve:
rriten fjetur ujë bëjnë

Toni shiko në faqen 48 për të kontrolluar se çfarë di.

Si të fillojmë

Ky mësim flet për vendet ku kafshët dhe bimët jetojnë dhe se cilat janë kushtet e favorshme për to. Ju mund të organizoni një shëtitje në mjedisin lokal ose në një rezervat natyror.

Burime

Një mjedis lokal; një fletë me një listë të gjërave që nxënësit duhet të kërkojnë; fotografi për të identifikuar bimët dhe kafshët.

Fjalë kyçe

pi ujë ushqim

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të njohin mjediset të ndryshme ku jetojnë bimët dhe kafshët;
- të dinë se bimëve dhe kafshëve iu duhet të gjejnë gjithçka brenda mjedisit të tyre;
- të kuptojnë pse bimët dhe kafshët jetojnë në një mjedis të caktuar.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë më shumë për dietat e shëndetshme.

Pse jetoni në një ndërtesë?

Nxënësit shikojnë fotografinë e një shtëpie. Pyetini ata se pse banojnë brenda një ndërtese dhe jo jashtë saj. Nxirrni si përfundim se shtëpitë na

strehojnë dhe mbrojnë nga moti.

- A i hani vaktet në shtëpi?
- A keni ujë të freskët për të pirë në shtëpi?
- A keni një vend për të fjetur?

Përdorni pyetjet që të nxirrni si përfundim se shtëpitë na japin gjërat bazë që na duhen për të mbijetuar: ushqim, ujë dhe strehë.

U thoni nxënësve që do të shikoni vende të ndryshme ku bimët dhe kafshët banojnë. Përdorni fotografitë në librin e nxënësve për të diskutuar pse bimët dhe kafshët jetojnë në të tilla vende dhe për të krahasuar mjediset të ndryshme.

Njihini nxënësit me fjalën “krahasoj” duke u kërkuar të përshkruajnë ngjashmëritë dhe dallimet mes mjediseve.

Më pas kërkojuni nxënësve të punojnë në dyshe. Kërkojuni nxënësve të shikojnë fotografitë në librat e tyre dhe pyesni:

a. Pse palmet rriten këtu?

Shpjegoni që bimët kanë nevojë të ndryshme nga kafshët. Si për shembull: bimët kanë nevojë për ujë; dhe duhet të jetë i përshtatshëm për llojin e bimës.

b. Pse antilopat jetojnë këtu?

Nxirrni si përfundim se të gjitha nevojat e antilopës plotësohen, si p. sh.: ushqimi, uji dhe streha. Mbërrini në përfundimin se edhe kafshët, edhe bimët mund të jetojnë në mjediset të përshtatshme me nevojat e tyre.

c. Pse nuk ka bimë apo kafshë këtu?

Kërkojuni nxënësve të shikojnë fotografinë e mjedisit të pabanueshëm dhe diskutoni pyetjen.

Përgjigje të mundshme:

a) Sepse ka ujë.

b) Sepse ka ushqim dhe ujë.

c) Sepse nuk ka as ushqim as ujë. Nuk ka as edhe një vend ku kafshët mund të strehohen.

Nëse vendosni të bëni një shëtitje për të parë një mjedis lokal, jepuni nxënësve një fletë me një listë të gjërave që nxënësit duhet të kërkojnë. Pikat kyçe për t'u shqyrtuar janë:

- 1 Ç'bimë dhe kafshë mund të gjeni në mjedisin që po shikoni?
- 2 Si e marrin ushqimin dhe ujin bimët dhe kafshët?
- 3 Ç'materiale gjenden në natyrë që kafshët mund t'i përdorin si strehë?



Nëse bëni ekskursion në një rezervat vendas, sigurohuni të keni lejen e prindërve dhe të keni marrë parasysh rreziqet në bazë të rregullores së shkollës.



Ku jeton secili prej tyre? Lidhni kafshën ose bimën me shtëpinë e vet.

Kjo është veprimtari përforcuese për t'u siguruar se nxënësit dinë të identifikojnë se ku jetojnë kafshët dhe bimët. Nxënësit vizatojnë vija që lidhin pamjet e kafshëve dhe bimëve me pamjen e vendit ku ato jetojnë.

Për secilën fotografi, bëni pyetjen:

- Ku jeton zogju/kaktusi/dhelpra/peshku/merimanga?

Përgjigje:

zogju – në çerdhen e zogut;

kaktusi – në shkretëtirë;

dhelpra – në strofkën e dhelpres;

peshku – në liqen;

merimanga – në rrjetën e merimangës.

Vlerësimi formues



Plotësoni vendet boshe me fjalët që mungojnë.

Kërkojuni nxënësve të plotësojnë vendet boshe me fjalë nga kutia e fjalëve.

Shkruani secilën fjalë të kutisë së fjalëve në dërrasë dhe thojeni me zë të lartë. Tregoni secilën fjalë me gisht dhe kërkojuni nxënësve ta thonë atë me zë të lartë. Udhëhiqni nxënësit të përgjigja e duhur, duke shkruar secilën fjalë në dërrasë ndërkohë që e thoni. Për shembull: *Kafshët dhe bimët kanë nevojë për një vend ku të jetojnë dhe...?*

Përgjigje: Kafshët dhe bimët kanë nevojë për një vend ku të jetojnë dhe të **rriten**.

Kafshët kanë nevojë për ushqim, ujë dhe për një vend për të **fjetur**.

Bimët kanë nevojë për **ujë** që të rriten.

Disa kafshë dhe zogj e **ndërtojnë** vetë vendin ku flenë.

Përsëritje dhe reflektim

Përfundojeni mësimin duke u kërkuar nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve në faqen 48 të librit të tyre.

Mbështetje gjuhësore

Sigurohuni që nxënësit të kuptojnë fjalët kyçe dhe idetë e diskutuara në mësim.

Bëni dy komplete kartash: një komplet me pamje dhe tjetrin me përkufizime. Kërkojuni nxënësve të lidhin pamjet me përkufizimet. Përforconi fjalët që nxënësve iu duken të vështira, duke i vënë në "Murin e fjalëve".

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Kërkojuni nxënësve të përgatisin një fletëpalosje me informacion për vendin që vizituan.
- 2 Kërkojuni nxënësve të vizatojnë kafshën që iu pëlqen më shumë në mjedisin e tyre më të favorshëm. Kujtojini që të përfshijnë në vizatim ushqimet dhe ujin e nevojshëm për kafshën që zgjedhën.

Të ngrënë dhe të pirët

Nxënësit njohin nevojën e një diete të shëndetshme që përfshin llojet e duhura të ushqimeve dhe të ujit.

Të ngrënë dhe të pirët

Ti zbulon pse kemi nevojë për një dietë të shëndetshme.

Ideja kryesore

Ushqimet dhe pijet e përshtatshme na mbajnë të shëndetshëm.

☐ Çfarë hëngrë mbrëmë për darkë?
☐ Shkruaj se çfarë hëngrë.

Vakti im:

Ushqimi që hamë çdo ditë quhet dietë. Ne duhet të hamë pesë lloje ushqimesh për të qenë të shëndetshëm. Shiko pjatën me ushqime. Ajo ka llojet e ushqimeve që nevojiten për një dietë të shëndetshme.

Fruta dhe perime Bukë dhe drithëra

Mish dhe peshk Yndyrna dhe sheqerna Qumësht dhe nënprodukte të qumështit

Dieta e shëndetshme ndihmon trupin që të rritet. Ne duhet të pimë shumë ujë që të jemi të shëndetshëm. Ne nuk duhet të hamë vetëm një apo dy lloje ushqimesh. Kjo mund të na bëjë jo të shëndetshëm.

☒ Shiko figurën e pjatës me ushqime. Bëj një model të një vakti të shëndetshëm.

☒ Zbulo: Cilat ushqime janë të shëndetshme? Vështro ushqime të ndryshme në një dyqan. A janë të mira për ty?

Pse kemi nevojë për një dietë të shëndetshme?

☒ Plotëso fjalët me fjalët e duhura.

Ne kemi nevojë të hamë sipas një diete të shëndetshme për t'u **LF**.

Ne kemi nevojë të pimë shumë _____ për të qenë të shëndetshëm.

☒ Rretho përgjigjet. Ato mund të jenë më shumë se një.

Një dietë e shëndetshme ka shumë _____.

Ajo ka **ca** _____.

Ajo ka **pak** _____.

Tani shiko në faqen 49 për të kontrolluar se çfarë di.

Si të fillojmë

Në këtë temë shpjegohet se si duhet të jetë një dietë e shëndetshme. Tema nuk jep shumë hollësira se pse shumë prej ushqimeve janë jo të shëndetshme, por tregon për ushqime që janë të mira apo të këqija për ne. Nxënësit mësojnë se pse na duhet një dietë e shëndetshme dhe se ç'ndodh nëse dieta nuk është e tillë.

Burime

Ambalazhe boshe ushqimesh të ndryshme, si ato të patateve, orizit etj.; plastelinë; fruta dhe perime të freskëta ose modele të tyre dhe figura të bimëve prej nga vijnë.

Fjalë kyçe

fermë

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të kuptojnë ç'është dietë e shëndetshme;
- të dinë disa nga përbërësit e një diete të shëndetshme;
- të dinë se na nevojitet një dietë e shëndetshme për të qenë të shëndetshëm;
- të kuptojnë se dieta jo e shëndetshme mund të sjellë probleme shëndetësore.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë më shumë për njerëzit dhe kafshët e tjera që lindin të vegjël e që rriten.



Çfarë hëngrët mbrëmë për darkë?

Gjatë veprimtarisë së parë diskutohet për vaktin tipik. Kërkojuni nxënësve të punojnë në dyshe dhe t'i thonë njëri-tjetrit se çfarë hëngrën darkën e shkuar.



Shkruani se ç'hëngrët mbrëmë në darkë.

Më pas, kërkojuni nxënësve të shkruajnë se çfarë hëngrën mbrëmjen e shkuar. Regjistroni të gjitha llojet e ushqimeve që nxënësit kanë ngrënë në një tabelë të vizatuar në dërrasë.

Kërkojuni nxënësve të shohin me kujdes pamjen e pjatës me ushqim. Shpjegojuni nxënësve që ajo tregon një dietë të shëndetshme. Pesë llojet kryesore të ushqimeve ndodhen në sasi të duhura:

- 1 bukë dhe drithëra, 33%;
- 2 fruta dhe perime, 33%;
- 3 qumësht dhe prodhime bulmeti, 15%;
- 4 mish dhe peshk ose prodhime të tjera me përmbajtje të lartë proteinash, 12%;
- 5 ushqime me yndyrna dhe sheqerna, 7%;

Shpjegojuni nxënësve që ne kemi nevojë më shumë për llojet 1 dhe 2 të ushqimeve sesa për llojet 3 dhe 4 dhe vetëm pak për llojin 5. Nxënësit duhet të nxjerrin si përfundim se ne duhet të hamë pesë llojet e ushqimeve në balancën e duhur. Flisni për çfarë do të ndodhte nëse nuk do të vepronim kështu.



Diskutoni kuptimin e fjalës baraspeshë dhe shtojeni në "Murin e fjalëve".

Kërkojuni nxënësve të emërtojnë një ushqim prej secilit prej pesë llojeve të ushqimeve që ata e hanë në shtëpi. Kjo do t'ju tregojë nëse ata i kuptojnë llojet e ndryshme të ushqimeve. Shpjegoni që neve na duhet një dietë e shëndetshme në mënyrë që trupi ynë të rritet dhe të riparojë vetveten.



Shpjegoni se dietë quhet ushqimi që ne hamë çdo ditë.



Shikoni figurën e pjatës me ushqim. Bëni një model të një vakti të shëndetshëm.

Kërkojuni nxënësve të punojnë në dyshe për të bërë një model të një vakti të shëndetshëm duke përdorur plastelinën. Kjo veprimtari kinestetike (lëvizore) i lejon nxënësit të krijojnë raportet e

ushqimeve të një vakti të shëndetshëm.

Pastaj bëjuni nxënësve këto pyetje:

- Si mendoni, ushqimi që hëngrët mbrëmjen e shkuar ishte i shëndetshëm apo jo?
- Si mund ta bëjmë dietën tonë më të shëndetshme?

Përgjigje të mundshme: Të hamë më shumë fruta dhe perime, të hamë më pak çokollatë.

- Nëse njerëzit nuk ushqehen në mënyrë të shëndetshme, çfarë mendoni se mund të ndodhë?

Përgjigje të mundshme: Ata mund të sëmuren, të shëndoshen, të dobësohen shumë.

- Pse është e rëndësishme të pimë?

Përgjigje të mundshme: Që të mos jemi të etur; na duhet ujë për të jetuar.

Shpjegoni se gjithë gjallesat kanë nevojë për ujë për të jetuar. Përfundoni që gjithë gjallesat kanë nevojë për ushqim dhe ujë për të qenë të shëndetshme.



Zbulo: Cilat ushqime janë të shëndetshme?

Qëllimi i këtij veprimtarie është që nxënësit të identifikojnë ushqimet e shëndetshme dhe jo të shëndetshme. Ata do të përdorin aftësitë e krahasimit, të vëzhgimit, të të ndarit me të tjerët dhe të bërjes së pyetjeve.

Do t'ju duhen: ambalazhe ushqimesh. Zgjidhni shumë lloje ushqimesh që janë të shëndetshme dhe jo të shëndetshme, p. sh.: ambalazhe orizi, patatesh, kënaçe pijesh të gazuara, mbështjellëse çokollatash, buke, frutash etj.

- 1 Ndërtoni një vitrinë me etiketat "E shëndetshme", "Jo e shëndetshme" dhe "Jo i sigurt".
- 2 Kërkojuni nxënësve të punojnë në dyshe për të parë ambalazhet e ushqimeve.
- 3 Pastaj, kërkojuni nxënësve të klasifikojnë paketimet e ushqimeve në tri kategori.
- 4 Nxitini nxënësit t'ju kërkojnë këshilla për ushqimet, për të cilat nuk ndihen të sigurt se në cilën kategori duhet t'i vendosin. Kur t'ju pyesin,

shpjegojuni nxënësve se te cila kategori duhet vendosur ambalazhi dhe pse.

Vlerësimi formues



Vendosni fjalët e duhura.

Kërkojuni nxënësve të plotësojnë fjalitë për një dietë të shëndetshme, duke përdorur kutinë e fjalëve.

Përgjigje: Ne duhet të hamë një dietë të shëndetshme për t'u rritur. Ne duhet të pimë shumë ujë për të qenë të shëndetshëm.



Rretho përgjigjet. Ato mund të jenë më shumë se një.

Kërkojuni nxënësve të rrethojnë figurat e duhura. Ata veprojnë si në përgjigjen model.

Përgjigje: Nxënësit duhet të qarkojnë figurat e ushqimeve në listën më poshtë:

Një dietë e shëndetshme ka shumë: **fruta, perime, bukë, oriz.**

Ka ca: **peshk, mish, qumësht.**

Ka pak: **yndyrna.**

Përsëritje dhe reflektim

Përfundojeni mësimin duke iu kërkuar nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve në faqen 49 të librit të nxënësit.

Mbështetje gjuhësore

Ndërtoni një vitrinë që tregon përbërësit e një diete të shëndetshme. Jepuni nxënësve etiketa që të familjarizohen me fjalët.

Veprimtari më të zgjeruara

Organizoni një vizitë në një fermë lokale që nxënësit të shohin vetë nga vjen ushqimi.



Sigurohuni të keni lejen e prindërve dhe të keni marrë parasysh rregulloren e shkollës.

Familjet

Nxënësit mësojnë se njerëzit dhe kafshët e tjera lindin të vegjël, të cilët rriten.

Familjet

Ti mëson se të vegjëlit bëhen të rritur. Ti mëson se të vegjëlit quhen pasardhës.

Ideja kryesore

Njerëzit kanë foshnja që bëhen të rritur.

44

So fëmijë jeni në familje?
Ne jemi _____ fëmijë.

A je ti më i vogël? A je më i madh? A je fëmija i mesëm?
A je fëmija i vetëm?
Unë jam _____

Rritja
Njerëzit kanë foshnja, të cilat në fillim janë të vogla dhe pastaj rriten. Ato bëhen fëmijë dhe pastaj të rritur.

45

Foshnjat kanë nevojë për shumë ndihmë që të rriten dhe të jenë të shëndetshme.

☐ Sipas teje, cilat janë dy gjëra për të cilat kanë nevojë foshnjat?

☐ A rriten të gjithë njerëzit me të njëjtën madhësi? Po apo jo?

☐ Zbuloi: A rriten të gjithë njerëzit me të njëjtën ritëm?

a. Sa i gjatë je?

b. Sa i gjatë është nxënësi më i gjatë i klasës?

c. Sa i gjatë është nxënësi më i shkurtër i klasës?

d. Cila është gjatësia e shumicës së nxënësve në klasë?

☐ Çfarë mësojmë nga matja e gjatësisë së çdo nxënësi në klasë?

Fëmijë dhe të rritur

Figurat e jetës së njeriut

Si të fillojmë

Kjo temë trajton ciklin jetësor të njeriut që nga fëmijëria deri në plakje dhe aftësinë e tij riprodhuese. Nuk jepen hollësira për riprodhimin, por përmendet fakti që njerëzit lindin të vegjël dhe kjo shpjegon vazhdimësinë e llojit njerëzor. Tema thekson që njerëzit kalojnë faza jetësore në mënyrë ciklike: nga të vegjëlit në bëmehi të rritur dhe të rriturit lindin të vegjël, të cilët pastaj rriten e kështu me radhë. Proceset riprodhimit nuk përmenden. Nxënësit bëjnë një hetim për të parë nëse ne rritemi me të njëjtin ritëm. Përgatisni që më parë një tabelë për ta plotësuar me gjatësinë e secilit nxënë.

Burime

Komplete figurash që tregojnë fazat e jetës së njeriut: bebe, fëmijë i vogël, fëmijë më i rritur, adoleshent, i ri, i rritur, i moshuar; një metër.

Fjalë kyçe

familje

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të mësojnë që njerëzit e fillojnë jetën si foshnja dhe rriten e bëhen të mëdhenj;
- të kuptojnë që disa njerëz lindin foshnja dhe se foshnjat rriten e bëhen të mëdhenj;

- të marrin pjesë në një hetim për të përcaktuar nëse njerëzit rriten të gjithë njëjloj.

Në mësimin e ardhshëm, nxënësit do të mësojnë më shumë për kafshët që lindin të vegjël e që bëhen kafshë të rritura.



Sa fëmijë ka në familjen tuaj?

A je ti fëmija më i vogël? A je më i madh? A je fëmija i mesit? A je fëmijë i vetëm?

Veprimtaria e fillimit ka si qëllim t'i bëjë nxënësit të mendojnë për familjen. Shkruajini pyetjet në dërrasë. Në fillim, bëjini nxënësit t'ju pyesin për familjen tuaj. Pastaj kërkojuni atyre të punojnë në dyshe dhe të pyesin njëri-tjetrin.

Kërkojuni nxënësve të shkruajnë përgjigjet në hapësirat e duhura në librat e tyre.



Për t'u siguruar që nxënësit i kuptojnë fjalët "më i vogli" dhe "më i madhi", shpjegoni që më i vogli është fëmija që ka lindur i fundit dhe më i madhi është fëmija që ka lindur i pari. Jepni një shembull, p. sh.: në një familje më dy fëmijë, një djalë 15 vjeç dhe një vajzë 5 vjeç, më i vogli është vajza 5 vjeçare dhe më i madhi është djali 15-vjeçar.

Përgjigje e mundshme: Ne jemi 2 fëmijë. Unë jam fëmija më i vogël.

Rritja

Kërkojuni nxënësve të lexojnë fjalitë për rritjen dhe të shikojnë pamjet e fazave të jetës së njeriut. Nga kjo veprimtaria, nxënësit duhet të nxjerrin si përfundim se jeta ka faza që nisin që nga lindja deri në moshën e vjetër dhe që në një kohë të caktuar njerëzit mund të lindin të vegjël, të cilët rriten e bëhen të mëdhenj.

Sigurohuni që nxënësit të mos krijojnë idenë e gabuar se njerëzit lindin të vegjël kur janë të moshuar.



A mund të thoni dy gjëra, të cilat foshnjat nuk i bëjnë dot vetë?

U thoni nxënësve se foshnjat kanë nevojë për shumë ndihmë që të rriten dhe të jenë të shëndetshëm. Pastaj bëni pyetjen që është në librin e nxënësit.

Përgjigje të mundshme: Të ushqehen, të ndërrojnë pelenat, të lëvizin rreth e rrotull.



A rriten të gjithë njerëzit me të njëjtën madhësi?

Nxënësit shikojnë pamjet e njerëzve me madhësi të ndryshme dhe shkruajnë përgjigjen.

Përgjigje: Jo.



Zbulohet: A rriten të gjithë njerëzit me të njëjtin ritëm?

Qëllimi i kësaj veprimtarie është që nxënësit të zbulojnë se njerëzit rriten me ritme të ndryshme. Nxënësit do të praktikojnë aftësitë e hulumtimit shkencor të lidhura me vëzhgimin, matjen dhe krahasimin.



Përforconi kuptimin e fjalës “krahasoj”. Shpjegoni se disa njerëz janë më të gjatë a më të shkurtër se disa të tjerë, por ne të gjithë rritemi. Kërkojuni dy nxënësve që të çohen e të rrinë kurriz më kurriz për të krahasuar gjatësitë e tyre. Kërkojuni nxënësve të tjerë të thonë se cili është më i shkurtër e cili më i gjatë. Tregojuni nxënësve se kur krahasojmë në shkencë, e bëjmë për të parë se çfarë është e ndryshme e çfarë është njëllor.

Do t’ju duhen: metra ose vizore, një tabelë e parapërgatitur (rekomandohet përmasa A3).

Kërkojuni nxënësve të rreshtohen përgjatë murit të klasës.

1 Matni gjatësinë e secilit nxënës dhe shkruajeni në tabelën që keni përgatitur më parë.

2 Thoni cili është më i gjatë e cili është më i shkurtri.

a) Sa i gjatë je?

b) Sa i gjatë është nxënësi më i gjatë i klasës tënde?

c) Sa i gjatë është nxënësi më i shkurtër i klasës tënde?

Përgjigje: Përgjigjet do të ndryshojnë në varësi të gjatësisë së nxënësve në klasën tuaj.



Çfarë mësojmë nga matja e gjatësisë së çdo nxënësi në klasë?

Pyetja e kësaj rubrike i nxit nxënësit të nxjerrin përfundime nga mbledhja e të dhënave. Nxënësit do të shohin se disa nxënës janë më të gjatë se disa të tjerë. Përdorni të dhënat që mbledhët për të diskutuar pyetjen dhe pastaj shkruajeni përgjigjen në dërrasë.

Përgjigje: Mësojmë se njerëzit nuk rriten me të njëjtin ritëm.

Familjet

Nxënësit mësojnë se njerëzit dhe kafshët e tjera lindin të vegjël, të cilët rriten e bëhen të mëdhenj.

Familjet

Ti mëson se të vegjëlit bëhen të rritur.
Ti mëson se të vegjëlit quhen pasardhës.

Ideja kryesore

Kafshët bëjnë të vegjël që quhen pasardhës. Pasardhësit rriten dhe bëhen kafshë të mëdha.

Vështro fotografinë e tigrove.

Çfarë po bën tigrin i rritur?

Sa pasardhës ka atje? Rretho përgjigjen.

1 2 3 4

Kafshët bëjnë të vegjël. Ata në i quajmë pasardhës.

Lidh kafshët me pasardhësit e tyre.

46

Vështro fotografitë e familjeve të këtyre kafshëve.

Cilat janë ndryshimet mes të rriturve dhe pasardhësve të tyre?

47

Rretho fjalën e saktë.

Njerëzit rriten/nuk rriten me të njëjtën madhësi në të njëjtën kohë.

Rretho figurën e saktë.

1. Njerëzit në fillim janë dhe më pas bëhen të rritur.

2. Unë jam në krahasim me të tjerët në klasën time.

Tani shiko në faqen 49 për të kontrolluar se çfarë di.

Si të fillojmë

Kjo temë bazohet në punën e bërë në temën paraardhëse dhe diskuton idenë se edhe kafshët e tjera kanë familje. Nxënësit mësojnë se kafshët kanë pasardhës, të cilët rriten. Ata njihen me idenë se pasardhësit e kafshëve kanë nevojë për prindërit, derisa të bëhen të aftë për t'u kujdesur për vete. Tema mund të bëhet brenda në klasë duke përdorur *librin e nxënësit*. Rekomandohet gjithashtu një vizitë në një rezervat apo fermë për të parë kafshët e sapolindura.

! Sigurohuni të keni lejen e prindërve dhe të keni vlerësuar rreziqet në bazë të rregullores së shkollës për çfarëdolloj udhëtimi jashtë shkolle.

Burime

Rezervat natyror ose një fermë me kafshë të sapolindura; vizore dhe lapsa.

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të dinë se kafshët kanë pasardhës që rriten;
- të dinë se pasardhësit kanë nevojë për ndihmë, derisa të bëhen të aftë për t'u kujdesur për veten;
- të lidhin pasardhësit e kafshëve me prindin përkatës.

Në mësimin pasardhës, nxënësit do të përsëritin dhe do të reflektojnë për ato që kanë mësuar në këtë kapitull.

Kërkojuni nxënësve të shohin në libër fotografinë e të vegjëlve të tigrin që po i lan nëna tigrin.

Çfarë po bën tigrin i rritur?

Sa tigrin të vegjël ndodhen në fotografi?

Qarko përgjigjen.

Kërkojuni nxënësve të shkruajnë përgjigjet e këtyre pyetjeve në librin e tyre.

Përgjigje: Po lan tigrin e vogël. 1, 2 qarkuar, 3, 4.

Pastaj bëni pyetje të tjera për të nisur një diskutim në klasë:

- Si mendoni, pse po vepron kështu tigrin i rritur?
Sepse tigrin e vegjël janë shumë të vegjël për t'u larë vetë.
- Më thoni një gjë tjetër që nëna tigrin duhet të bëjë për të vegjëlit e saj? Të gjuajë për ushqim; t'i ushqejë.

Lidhni kafshët me pasardhësit e tyre.

Shpjegoni se ne i quajmë pasardhës të vegjëlit e kafshëve. Diskutoni emrat e kafshëve të rritura dhe të të vegjëlve të tyre, p. sh. "kali" dhe "mëzi".

Kërkojuni nxënësve të shohin me kujdes figurat dhe të lidhin kafshët e rritura me pasardhësit e tyre me një vijë. Nxitini nxënësit të përdorin vizore për të vizatuar vija të drejta.

Përgjigje:

Ariu polar – arushi polar

Deveja – i vogli (këlyshi) i deveve

Rosa – rikat

Kali – mëzi

Cilat janë dallimet mes kafshës së rritur dhe pasardhësit?

Kjo veprimtari është për kafshët, të cilat ndryshojnë gjatë rritjes. Nxënësit gjejnë ndryshimet mes prindit dhe pasardhësit në një seri figurash. Kjo përforcon idenë se pasardhësi rritet, dhe për pasojë edhe tiparet e tjera mund të rriten. Flisni për këto dallime dhe shpjegoni pse këto tipare rriten dhe zhvillohen, p.sh., brirët e cjamin rriten që ai të mund të luftojë.

Përgjigje të mundshme:

Luani i rritur ka krifë.

Dhia e rritur ka brirë.

Shqiponja e rritur ka pendë në vend të pushit dhe një sqep të gjatë dhe të mprehtë.

Flutura duket krejt ndryshe: ka krahë me ngjyra të çelëta.

Vlerësimi formues

Lexoni pyetjet në fund të mësimin që të siguroheni se nxënësit e kuptojnë se ç'duhet të bëjnë. Disa nxënës mund t'u përgjigjen vetë këtyre pyetjeve; të tjerë mund të kenë nevojë për ndihmë.

**Rretho fjalën e saktë.**

Kërkojuni nxënësve të rrethojnë fjalën e duhur në fjali.

Përgjigje: Njerëzit **nuk** rriten në të njëjtën madhësi në të njëjtën kohë.

**Rretho figurën e saktë.**

Kërkojuni nxënësve të qarkojnë figurën e saktë në secilën prej fjalive.

Përgjigje:

1. Njerëzit e nisin jetën si (figura e një bebeje) dhe rriten.
2. Përgjigjja varet nga sa mirë e kanë kuptuar nxënësit konceptin e "krahasimit" dhe hetimin e këtij mësimi. Kontrolloni përgjigjet e tyre dhe mbështesni nxënësit që kanë nevojë për ndihmë.

Përsëritje dhe reflektim

Përfundojeni mësimin duke u kërkuar nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve në faqen 49 të librit të nxënësit.

Mbështetje gjuhësore

- 1 Gjatë kapitullit, nxënësit njihen me fjalë dhe koncepte të ndryshme. Në këtë mësim të fundit, sigurohuni që nxënësit të dinë mirë fjalët e reja e të përdorin fjalorthin. Sigurohuni që nxënësit të kenë përkufizimet e duhura për fjalët që kanë përdorur gjatë kapitullit. Përkufizimet e propozuara për gjithë fjalët kyçe përfshihen në fjalorthin në fund të librit të mësuesit.
- 2 Përdorni karta me figura dhe karta përkatëse me fjalë për të krahasuar dhe klasifikuar gjallesat dhe jogjallesat. Kërkojuni nxënësve të emërtojnë objektet për të vlerësuar njohuritë e tyre.

Veprimtari më të zgjeruara

Kërkojuni nxënësve të bëjnë një poster të kafshës që atyre iu pëlqen më shumë bashkë me të vegjlit e saj. Kërkojuni të etiketojnë çfarëdo tipari që është i ndryshëm te kafsha e rritur dhe te i vogli i saj.

Çfarë mësuam për gjallesat dhe rritjen e tyre

Çfarë mësuam për gjallesat dhe rritjen e tyre

Gjallesë apo jogjallesë?

Cila nga këto gjëra është gjallesë dhe cila është jogjallesë?
Shkruaj fjalët në kolonën e duhur.

Unë mund të emërtoj disa gjëra që janë të gjalla dhe disa që nuk kanë qenë asnjëherë të gjalla.

Ku jetojnë kafshët dhe bimët?

Ku jetojnë ato?
Lidh me vijë secilin bimë ose kafshë me vendin ku jeton.

Unë e di se bimët dhe kafshët mund jetojnë në vende të ndryshme.

Të ngrënë dhe të pirë

Cilat nga këto ushqime duhet t'i kemi në sasi më të madhe në dietën tonë? Rretho figurat e sakta.

Unë mund të emërtoj disa ushqime që e bëjnë dietën të shëndetshme.

Familjet

Lidh me vijë figurën me numrin përkatës.

Unë e di se njerëzit në fillim janë foshnja dhe pastaj rriten. Ata bëhen të rritur.

Si të fillojmë

Qëllimi është nxitja e nxënësve të përsërisin ato që kanë mësuar në çdo mësim të kapitullit. Çdo temë ka disa pyetje përforcuese, të cilave nxënësit duhet t'u përgjigjen. Këto pyetje kontrollojnë njohuritë e nxënësve për këtë mësim.

Pas pyetjeve përforcuese, ndodhet një fjali përmbledhëse, të cilës nxënësit duhet t'i përgjigjen. Lexoni fjalinë dhe t'i ndihmoni nxënësit të plotësojnë qarkun. Në fazën 1, ata mund ta ngjyrosin, të vizatojnë një fytyrë të buzëqeshur apo të ngjisin një poster.

Është e rëndësishme që ata të tregojnë për pjesët ku nuk ndihen të sigurt. Ky informacion është shumë i rëndësishëm për mësuesin për të hartuar një plan ndihmës në fund të kapitullit për vlerësimin përmbledhës.

Përsëritje dhe reflektim

Gjallesë apo jogjallesë?

Cila nga këto gjëra është gjallesë dhe cila jo?

Shkruani fjalët në kolonën e duhur.

Nëse është e nevojshme, përdorni dërrasën e zezë për t'u treguar nxënësve si ta bëjnë detyrën. Vizatoni një tabelë dhe jepuni nxënësve shembuj gjallesash dhe jogjallesash, p.sh., lepuri dhe lepuri lodër (tregojuni figura të këtyre artikujve). Pyetini:

- Lepuri, a është i gjallë apo jo i gjallë? *I gjallë.*
- Si e kuptoni që është i gjallë? *Mund të lëvizë, të hajë dhe të rritet.*
- Lepuri lodër, është i gjallë apo jo i gjallë? *Jo i gjallë.*
- Si e kuptoni që nuk është i gjallë? *Nuk mund të lëvizë, të hajë apo të rritet.*

Pastaj bëjuni nxënësve të njëjtat pyetje për artikujt

në librin e nxënësit dhe kërkojuni t'i shkruajnë përgjigjet në tabelë.

Ju mund t'u jepni nxënësve edhe gjëra të tjera më të vështira për t'u klasifikuar, si p. sh., një tufë me lule të këputura. Nxënësit duhet të përgjigjen se lulet dikur kanë qenë të gjalla.

Përgjigje:

Gjallesë	Jogjallesë
delja	guri

Ku jetojnë kafshët dhe bimët?



Ku jetojnë ato?

Vizatoni një vijë që lidh secilën bimë apo kafshë me vendin ku jeton.

Diskutoni mjediset e treguara në figura. Për shembull, pyesni:

- Cila bimë apo kafshë jeton në shkretëtirë? *Kaktusi.*
- Ç'kafshë apo bimë të tjera jetojnë në shkretëtirë?

Përgjigje e mundshme: *Hardhuca, gjarpri, akrepi etj.*

Ju mund t'u tregoni nxënësve figura të tjera kafshësh dhe bimësh që jetojnë në vendin tonë dhe t'i pyesni se në ç'lloj mjedisesh jetojnë ato. Pastaj pyetini se përse secila prej bimëve apo kafshëve pëlqen të jetojë në atë lloj mjedisi.

Përgjigje:

*shkretëtirë – kaktusi;
pyll – shimpanzeja;
arktik – ari polar;
det – ylli i detit.*

Të ngrënë dhe të pirë



Cilat nga këto ushqime duhet t'i kemi në sasi më të madhe në dietën tonë? Rrethoni figurat e sakta.

Diskutoni me nxënësit secilin prej ushqimeve të treguara me figura dhe pyetini:

- Sa (oriz) duhet të hamë? Shumë, ca apo pak?

Bini dakord si klasë për përgjigjet para se t'u

kërkoni nxënësve të qarkojnë në libër ushqimet që na duhen në sasi të madhe.

Mbështeteni këtë veprimtari me pamjen e një pjate të madhe me ushqim të shëndetshëm të paraqitur në një poster ose të marrë nga interneti.

Përgjigje: Nxënësit duhet të qarkojnë këto ushqime: orizin, frutat, perimet.

Familjet



Rendit saktë katër numrat për secilën fazë të jetës. Lidh me vijë figurën me numrin përkatës.

Bëjuni nxënësve pyetjet e mëposhtme para fillimit të veprimtarisë.

- A ka ndonjëri foshnje në shtëpi?
- A ka fëmijë të tjerë në familjen tuaj?
- Cilët janë të rriturit e familjes suaj?

Përgjigje të mundshme: Nëna, babai, halla, xhaxhai etj.

- A keni gjysh apo gjyshe në familjen tuaj?

Pastaj kërkoni nxënësve të plotësojnë veprimtarinë duke numëruar fazat jetësore në rendin e duhur, duke filluar me “foshnjë”.

Përgjigje: foshnje/i sapolindur, fëmijë, i rritur, i moshuar.

Përmbledheni përsëritjen duke iu rikthyer temës së gjallesave. Bëni pyetje të tilla në mënyrë që nxënësit të thonë se të gjitha bimët dhe kafshët mund të lëvizin, të jetojnë dhe të rriten dhe të lindin të vegjël.

Vlerësimi përmbljedhës

Detyra e përsëritjes dhe e reflektimit në libër është një pikë fillestare e shkëlqyer për rastet kur ju duhet të diskutoni për përparimin e secilit nxënës në veçanti. Ky informacion mund të përdoret edhe për evidencat në fund të tremujorit.

Mund të jetë e dobishme të mbani shënime mbi nivelin e sigurisë që nxënësit ndjejnë për njohuritë e marra në mënyrë që të identifikoni ato pjesë që duhet të përsëriten më vonë (shikoni një shembull në tabelën e mëposhtme).

Detyra për “Çfarë mësuam për gjallesat dhe rritjen e tyre”	Shumë i sigurt	Jo shumë i sigurt	Jo i sigurt

Këto të dhëna mund të përdoren për të ndërtuar një program ndihmës për nxënësit që kanë nevojë. Të dhënat dhe analiza për çdo nxënës duhet të jenë në një formë të thjeshtë. Ju duhet vetëm një përshtypje e përgjithshme për vlerësimin e klasës dhe jo të dhëna personale të nxënësit, si p. sh.: 50% e klasës nuk ishin të sigurt për...

4 Shtytja dhe tërheqja

Në këtë kapitull, nxënësit:

- zbulojnë, diskutojnë dhe përshkruajnë lëvizje të objekteve që i njohin;
- mësojnë mbi shtytjen dhe tërheqjen;
- mësojnë se ka një shkak pse objektet përshpejtojnë, ngadalësojnë ose ndërrojnë drejtim.

4. Shtytja dhe tërheqja

Në këtë kapitull, ti:

- zbulon shtytjet dhe tërheqjet;
- zbulon se çfarë i shpejton, i ngadalëson ose i ndryshon drejtimin gjërave.

50

Fakt i çuditshëm

Një patinator mund të bëjë 48 kilometra për një orë. Ai lëviz po aq shpejt, sa edhe një makinë!

Reja e fjalëve
kthej ngadalë
ndaloj shpejt
gjej lëkund

- Pse rrokulliset topi tatëpjetë kodrës?
- Si do të ndalojë topi?
- Si lëviz shilarësi?

Shtytjet dhe tërheqjet

51

Si të fillojmë

Ky kapitull mbi të gjitha përqendrohet te shtytjet dhe tërheqjet dhe se si ato ndikojnë në lëvizjen e objekteve, në përshpejtimin, ngadalësimin dhe ndryshimin e drejtimit të tyre. Kapitulli i nxit nxënësit të kujtojnë ato që dinë për shtytjet dhe tërheqjet. Fotot ngacmojnë të menduarit e nxënësve mbi to. Ai përfshin një fakt të çuditshëm dhe pyetje diskutimi, për t'i lidhur nxënësit me temën përkatëse.

Aftësi të nevojshme shkencore

Nxënësve u jepet mundësia të parashikojnë se si shtytjet dhe tërheqjet ndikojnë mbi lëvizjen e një objekti. Ata mësojnë se si të sugjerojnë ide, si të ndjekin udhëzimet dhe të regjistrojnë informacionin, si të krahasojnë të dhëna mbi shtytjet dhe tërheqjet. Ata formësojnë idetë e tyre, i komunikojnë, i ndajnë dhe i shpjegojnë, duke zhvilluar kështu aftësitë e të menduarit shkencor.

Fjalë kyçe

kthim ndalon ngadalë shilarës shpejt

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

fol për shkruaj trego zbulo vëzhgo

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të diskutojnë se çfarë i lëviz objektet
- të mendojnë se si ndalojnë objektet.

Në temën që vijon, nxënësit do të mësojnë rreth lëvizjes së objekteve të njohura dhe si ta përshkruajnë atë.

Pyetjet në faqet hyrëse synojnë t'i nxisin nxënësit të flasin për lëvizjen e objekteve. Ata mund të mos e kuptojnë lëvizjen, por mund të japin disa shembuj. Pyetjet paraqesin disa lloje të ndryshme lëvizjesh. Nxënësit diskutojnë mbi shtytjen e tërheqjen, identifikojnë si lëvizin objektet. Tipat kyçe të lëvizjes janë vërtitja, lëkundja, rrëshqitja, kërcimi, hedhja dhe rrokullisja.



Pse rrokulliset topi tatëpjetë kodrës?

Kërkojuni nxënësve ta diskutojnë pyetjen me atë që kanë pranë. Në këtë rast, po u kërkon nxënësve të fillojnë të mendojnë pse topi lëviz. Më tej, nxënësit do ta përdorin topin për ta hetuar lëvizjen në lidhje me veten.

Përgjigje e mundshme: Dikush e ka shtyrë topin nga maja e kodrës.

Si do të ndalojë topi?

Kërkojuni nxënësve të diskutojnë mbi pyetjen me shokun. Pastaj kërkojini çdo grupi ta ndajë idenë e vet me pjesën tjetër të klasës. Shpjegoni se nëse një objekt po lëviz, diçka mund ta ndryshojë lëvizjen e tij. Nxënësit do të mësojnë për ligjet e lëvizjes dhe forcat e kundërta në klasat e tjera, por kjo është një mundësi për t'ua prezantuar konceptin.

Përgjigje e mundshme: Diçka do ta ndalë. Për ta ndaluar topin, duhet ta shtysh në drejtimin e kundërt.

Si lëviz shilarësi?

Kërkojuni nxënësve të shikojnë foton e shilarësit në *Librin e nxënësit* dhe të diskutojnë me atë që kanë pranë si lëviz shilarësi.

Shilarësi lëviz para e pastaj pas. Shpjegojuni që gruaja e shtyn shilarësin para.

Vëriini nxënësit të mendojnë për çastin kur hipin në një shilarës. Bëjuni pyetjen:

- Kur hipni fillimisht në shilarës, a ka ndonjë lëvizje? Jo.

Nxitini që të zbulojnë se shilarësi është në prehje (nuk lëviz), derisa e shtyni atë. Shpjegojuni që gruaja e shtyn shilarësin para. Edhe vajza përdor këmbët, që ta largojë ajrin nga vetja.

Përgjigje e mundshme: Pas dhe para.

A e dini se...

Referojuni faktit të çuditshëm. Nxënësve mund t'u tregoni një video me patinatorë akulli në garë, marrë nga interneti. Mund t'u tregoni edhe kthimin dhe rrotullimin, me videon e një patinatori që rrotullohet në vend. Tregojuni nxënësve që patinatorët mund të vërtiten me shpejtësi mbi 308 rrotullime në minutë.

Mbështetje gjuhësore

Përdor Renë e fjalëve në faqet hyrëse, për të diskutuar mbi kuptimet e fjalëve kyçe për këtë kapitull: filloni me fjalët që i kanë hasur në faqet hyrëse. Nxënësit mund të fillojnë me një "Mur fjalësh" (shiko faqen 7). Ata mund të shtojnë pamje të lëvizjeve, shoqëruar me fjali të thjeshta. Mund të shtojnë pamje të shtytjes së një topi dhe shtytjes së një shilarësi nën titullin "Shtytj". Më vonë gjatë kapitullit, mund të shtojnë shembuj për të ilustruar "Tërheq". Nxitini të përfundojnë fjalorin me fjalët e tyre si dhe të përcaktojnë termat kyçe në *Librin e nxënësit*, ndërsa shtjellojnë kapitullin.

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Nëse nxënësit kanë mundësi të shkojnë në një park lojërash, kërkojuni të luajnë me lodrat e të piketojnë sa herë shtynë diçka për ta bërë të lëvizë. Për shembull, ata mund të shtynë një shilarës, një rrotullame që të vërtitet etj.
- 2 Kërkojuni nxënësve të mbajnë shënime, sa herë që shtynë ose tërheqin diçka gjatë një ore në një ditë shkollore. Ata mund të bëjnë thjesht shenja nën secilin titull: "Shtytj" dhe "Tërheq". Tregojuni nxënësve se si të bëjnë një tabelë për shenjat.

Si lëvizin gjërat

Nxënësit zbulojnë, flasin rreth dhe përshkruajnë lëvizjen e objekteve të njohura.

Si lëvizin gjërat

Ti zbulon shtytjet dhe tërheqjet.

Ideja kryesore

Shtytjet dhe tërheqjet lëvizin gjërat.

☐ Çfarë është lëvizja?
Ne nuk mund t'i shohim shtytjet dhe tërheqjet. Por ato i lëvizin gjërat.

☐ Zbulo: Si mund ta lëvizësh topin?
☐ Kur do të fillojë topi të lëvizë?
☐ Tani tërheq topin nga vetja. Çfarë i ndodh topit?

Ti duhet ta shtytsh topin që ai të lëvizë përpara.
Shtytja i vë gjërat në lëvizje.
Edhe tërheqja i vë gjërat në lëvizje.
Si mund ta provosh këtë?
☐ Zbulo: Gjëj vende në shkollë ku gjërat janë duke lëvizur.
Parashiko se ku mund të jenë këto vende në shkollë.
1. Gjeji këto vende.
2. Regjistro çfarë shikon në një tabelë si kjo më poshtë. A i kishë parashikuar saktë vendet?

Gjërat që po lëvizin	Përshkruaj lëvizjen
Topi.	Topi rrokulliset në palestër.



Disa nga makinat në fotografi janë duke lëvizur.
Disa të tjera kanë ndaluar.
Shtytjet dhe tërheqjet mund t'i lëvizin gjërat.
Shtytjet dhe tërheqjet mund t'i ndalojnë gjërat.

☐ A shikon ndonjë flamur që po valëvitet?
Pse lëvizin flamujt?
Në çfarë drejtimi lëvizin?
Flamujt nuk po shkojnë gjëkund.
Ata qëndrojnë në shtizë dhe valëviten nga era.

Si mendon?
Pse disa gjëra lëvizin, kurse disa të tjera jo?

Shtytja dhe tërheqja

Si të fillojmë

Kjo temë heton dhe zbulon se si lëvizin objekte të njohura. Shtytjet dhe tërheqjet paraqiten si shkaqe të lëvizjes së objekteve. Nxënësit analizojnë mbi objektet në lëvizje. Ata përshkruajnë se si lëvizin objektet qark shkollës. Automjetet në lëvizje përdoren për të treguar se si objektet lëvizin më shpejt, ngadalësojnë, ndalen dhe ndërrojnë drejtim. Për të shmangur idenë e gabuar se lëvizja është thjesht udhëtimi nga një vend në tjetrin, nxënësit shikojnë se si një flamur lëviz nga era.

Burime

Topa të vegjël, p.sh. topa tenisi, dërrasë për të mbërthyer letrat, tabelë rezultatesh, flamur ose banderolë jashtë klasës.

Fjalë kyçe

lëviz ndalon ngadalë shpejt

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

fol për shkruaj zbuloj

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të zbulojnë si lëvizin objektet
- të përshkruajnë mënyrën se si lëvizin objekte të njohura.

Gjithashtu, nxënësit do të mësojnë rreth mënyrës se si mund të lëvizim trupin tonë.

Çfarë është lëvizja?

Kërkojuni nxënësve të diskutojnë në grupe të vogla se çfarë mendojnë se është lëvizja. Shpjegojuni se shtytjet dhe tërheqjet janë të padukshme, por ne mund të shohim pasojat e tyre. Shtytjet dhe tërheqjet lëvizin objektet.

Përgjigje e mundshme: Lëvizje është të shkosh nga një vend në një tjetër.

Zbulo: Si mund ta lëvizësh një top?

Synimi i kësaj veprimtarie është t'i nxisë nxënësit të mendojnë për faktin se si shtytjet dhe tërheqjet i lëvizin objektet. Kjo i ndihmon të praktikojnë aftësitë e vëzhgimit dhe të diskutimit se si veprojnë shtytjet dhe tërheqjet mbi një top.

Do t'ju duhen: top tenisi ose top i ngjashëm me të.

- Ndajini nxënësit në grupe dyshe.
- Jepini secilit grup një top dhe kërkojuni secilit prej tyre që të zbulojë ndikimin e shtytjes dhe të tërheqjes.
- Pyetini se si do ta lëvizin topin mbi tavolinën e tyre.

Si do ta bësh topin të lëvizë?

Kërkojuni nxënësve të diskutojnë me shokun.

Përgjigje e mundshme: Duhet ta shtyjmë topin që të lëvizë para. Shtytja i lëviz objektet.



Pasi nxënësit të jenë përpjekur ta shtyjnë topin, shpjegojuni gjithë klasës se shtytja është ajo që i lëviz objektet.



Tani tërhiqeni topin nga vetja. Çfarë i ndodh topit?

Kërkojuni atyre që të përpiqen ta tërheqin topin nga vetja dhe pastaj të diskutojnë me partnerin:

- Çfarë i ndodh topit?



Shpjegojuni gjithë klasës se edhe tërheqja i lëviz objektet.

Përgjigje e mundshme: Topi lëviz drejt meje. Nëse e tërheq qetë, topi rrotullohet drejt meje ngadalë.

Tregojuni nxënësve se rreth nesh shtytjet dhe tërheqjet veprojnë gjatë gjithë kohës, duke i bërë objektet të lëvizin. Thojuni se në zbulimin e radhës do të mësojnë më shumë rreth kësaj.



Zbulo: Gjej vende në shkollë ku ka objekte që lëvizin.

Synimi i kësaj veprimtarie është që nxënësit të provojnë shtytjet dhe tërheqjet që na rrethojnë. Kjo do t'i ndihmojë ata të praktikojnë aftësi të vëzhgimit, zbulimin e shtytjeve dhe të tërheqjeve dhe mbajtjen shënim se ku i gjejnë.

Do t'ju duhen: tabelë rezultatesh, stilolapsa.

- Sigurohuni ta keni informuar personelin në të gjitha zonat e shkollës që do t'i vizitoni për vëzhgimin. Bëni një inspektim paraprak për të gjetur vendet më të mira për të vërejtur lëvizjen. Ndajini nxënësit në grupe me nga tre ose katër veta.
 - Sigurohuni që të gjithë nxënësit të kenë nga një kopje të tabelës në *Librin e nxënësit*, para se të fillojnë inspektimin.
- 1 Gjeni vende ku objektet janë duke lëvizur.
 - Udhëzoni nxënësit të regjistrojnë gjithçka që shohin të lëvizë.
 - 2 Hidhni atë që shihni në një tabelë si kjo më poshtë. A i kishit parashikuar saktë vendet?

Objekt që lëviz	Përkrahur lëvizjen
Topi	Topi rrotullohet në oborr

- Vizatoni në dërrasë tabelën shembull që tregohet këtu. Diskutoni mbi të, që të siguroheni se nxënësit e dinë se çfarë do të kërkojnë.
- Ndihmoni nxënësit që ta plotësojnë tabelën në dërrasë me rezultatet e tyre.



Çfarë mendoni se ndodh me shtytjen kur makina ngadalëson?

Përpiquni të gjeni një vend të sigurt për klasën, ku të vëzhgoni makinat që lëvizin. Në klasat e tjera, nxënësit do të mësojnë për forcat e rezistencës. Për të shmangur idetë e gabuara, shpjegojuni se shtytja mund të mbetet e njëjtë. Makina mund të ngadalësojë, për shkak të rezistencës. Shpjegoni se diçka tjetër mund të fillojë të veprojë mbi makinën dhe shtytja mund të mos jetë aq e madhe sa të kundërveprojë.

Nëse situata e këshilluar më lart nuk është e mundur, përdorni foton në *Librin e nxënësit* ose

video me trafik në lëvizje. Kërkojuni nxënësve të diskutojnë se si do ta përshkruanin lëvizjen e automjeteve.

- A lëvizin të gjitha makinat me të njëjtën shpejtësi? *Jo. Disa makina lëvizin shpejt. Disa makina kanë ndaluar. Të tjera makina lëvizin ngadalë në radhën e trafikut.*

Nxitini nxënësit të flasin mbi shkakun e ngadalësimit të makinave.

Përgjigje e mundshme: Shtytja është më e vogël.



Shihni ndonjë flamur të valëvitet?

Çfarë i lëviz flamujt?

Në ç'drejtim lëvizin?

Kërkojuni nxënësve të shohin fotografinë e të diskutojnë pyetjen. Nxitini të përgjigjen se flamujt lëvizin prej erës. Flamujt lëvizin në drejtim të erës. Nëse ajo është e fuqishme, flamujt lëvizin sa para-pas bashkë me të.

Përgjigje e mundshme: Flamujt lëvizin prej erës. Flamujt lëvizin fillimisht në një drejtim dhe pastaj në të kundërtin.

Mbështetje gjuhësore

Fjalët kyçe për këtë temë janë: lëvizje, lëviz, duke lëvizur. Tregojuni këto fjalë në kontekst, për të përforcuar kuptimin e tyre.

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Nxënësit mund të bëjnë vetë një vëzhgim të shtytjeve dhe të tërheqjeve gjatë rrugës për në shtëpi.



Si mendon? Kjo është një mundësi për të treguar se lëvizja jo gjithmonë e çon diçka nga një vend në tjetrin. Nxitini nxënësit të përgjigjen se shtiza e flamurit qëndron saktësisht në të njëjtin vend, por flamuri lëviz.

Përdoreni pyetjen për t'i ndihmuar nxënësit të vlerësojnë se jo gjithçka duhet të ndërrojë vend. Prisni një përgjigje që shpjegon se: disa objekte janë shumë të mëdha për t'u lëvizur nga era apo nga shtytja jonë. Makinat dhe automjetet janë bërë që të lëvizin. Godinat janë bërë që të qëndrojnë aty ku ndodhen. Shpjegoni se si lëvizin objektet.

Si lëvizin gjërat

Nxënësit zbulojnë, diskutojnë dhe përshkruajnë lëvizjen e objekteve të njohura.

Si lëvizin gjërat

Ti zbulon shtytjet dhe tërheqjet.

Ideja kryesore

Ti mund ta lëvizësh trupin.

Zbulo: Çfarë ndodh kur i lëkund krahët?

Përpiqu edhe të ecsh, edhe të lëkundësh krahët në të njëjtën kohë.

☐ A mund t'i lëkundësh krahët më shpejt?

☐ A mund t'i lëkundësh krahët shumë ngadalë?

☐ Parashiko çfarë do të ndodhë me shpejtësinë e ecjes, nëse ngadalëson lëkundjen e krahëve?

☐ Çfarë i lëviz krahët përpara?

☐ Çfarë i lëviz krahët pas?

54 Çdo gjë që bëjmë, e bëjmë me anë të shtytjeve dhe të tërheqjeve.

☐ A e gjea dot se çfarë i bën lapsit kur e ngre nga dyshemeja?

Zbulo: Lojëra me shtytje ose me tërheqje.

1. Mendo të gjitha lëvizjet e ndryshme që ke bërë në këtë kapitull.

2. Zgjidh disa lojëra që të pëlqejnë t'i luash.

3. Sigurohu që ke zgjedhur lojëra me shtytje ose tërheqje.

Zbulo: Shiko figurën e fëmijëve që po luajnë. Çfarë po bën secili prej tyre? Shkruaj në etiketë fjalën e saktë.

a. _____ d. _____

b. _____ c. _____

Kutia e fjalëve: tërheq shtytj

Tani shiko në faqen 64 për të kontrolluar se çfarë di.

Si të fillojmë

Kjo temë heton lëvizjet e trupit. Gjatë gjithë zhvillimit të saj duhet të merren parasysh ndjesitë e nxënësve. Këtë temë mund ta shpjegoni së bashku me edukimin fizik. Nxënësit marrin parasysh lëvizjet që përfshihen në ecje dhe në veprimtari të tjera. Për ta përfunduar zbulimin e lëvizjeve trupore mund të bëni një mini-olimpiadë.

Burime

Shesh i lirë, pajisje sportive, si p.sh. topa, thasë me kokrriza, litar kërcimi, rathë, stola ose tra ekuilibri.

Aftësi të nevojshme shkencore

Nxënësit hetojnë mënyrat e shumta se si ne mund ta lëvizim trupin dhe identifikojnë cilat forca mundësojnë ecjen tonë.

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

Parashikoj

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- zbulojnë mënyrat se si lëviz trupi
- përdorin lëvizjet për të planifikuar dhe për të marrë pjesë në mini-olimpiadën.

Në temën që vijon, nxënësit do të përdorin shtytjet dhe tërheqjet për të vënë në lëvizje një makinë lodër.



Në sa mënyra të ndryshme mund ta lëvizësh trupin?

Kërkojuni nxënësve të diskutojnë mbi pyetjen. Shpjegojuni që ne mund t'i lëvizim trupat tanë në shumë mënyra. Pyesni nxënësit:

- Kur ecni, si lëvizin këmbët tuaja?
Përgjigje e mundshme: Para dhe pas.

Përgjigje e mundshme: Vrapojnë, ecin, kërcenjë, hidhen, kthehen, vërtiten.



Zbulo: Çfarë ndodh kur lëkundni krahët?

Synimi i kësaj veprimtarie është që nxënësit të zbulojnë se si trupi i përdor shtytjet dhe tërheqjet për të lëvizur. Ajo do t'i ndihmojë nxënësit të praktikojnë aftësitë e kërkimit shkencor, duke parashikuar rezultatin e lëkundjes së krahëve.

- Pyetini nxënësit se çfarë ndodh kur i lëkundni krahët.



Shpjegojuni se lëkundje do të thotë të lëvizësh para dhe pas diçka, që në këtë rast është krahët e tyre. Demonstruojuni duke lëvizur krahët tuaj.

- Hapni një vend në klasë ose dilni jashtë. Kërkojuni nxënësve të ecin në një rreth, duke lëkundur krahët.



A mund t'i lëkundni krahët më shpejt?

Thojuni nxënësve t'i lëkundni krahët më shpejt. Disa nxënës natyrisht që do të fillojnë të përshpejtojnë.

Përgjigje: Po.



A mund t'i lëkundni krahët shumë ngadalë?

Thojuni nxënësve t'i lëkundni krahët më ngadalë.

Përgjigje: Po.



Kombinoni komandat "më shpejt" dhe "më ngadalë", duke u siguruar që të gjithë nxënësit të kenë hapësirën e duhur për ta bërë këtë, për të përforcuar fjalën e thënë dhe, natyrisht, edhe argëtimin.

Çfarë ndodh me shpejtësinë e ecjes kur krahët tuaj ngadalësojnë?

Zakonisht, kur ne i lëkundim krahët ngadalë, edhe ecim më ngadalë. Zhvilloni një diskutim në grup, që nxënësit të ndajnë zbulimet e tyre për këtë lloj lëvizjeje.

Përgjigje e mundshme: Kur krahët e mi lëkunden më ngadalë, edhe ecja ime ngadalësohet.

Kërkojuni nxënësve që t'i shkruajnë përgjigjet e dy pyetjeve në vijim në *Librin e nxënësit*.

Çfarë i lëviz krahët tuaja para?

Përgjigje: Shtytja.

Çfarë i lëviz krahët tuaja pas?

Përgjigje: Tërheqja.

A e gjeni dot se çfarë i bëni lapsit për ta ngritur?

Hidhni në dërrasë përgjigjet e nxënësve për këtë pyetje, duke bërë shenja nën kolonën "Shtytje" ose "Tërheqje". Pastaj thuajuni që ta provojnë, duke ngritur një laps nga tavolina para tyre. A ishin të sakta hamendësimet e tyre?

Përgjigje: Tërheqja.

Zbulohet: Lojëra me shtytje dhe tërheqje.

Synimi i kësaj veprimtarie është t'i vërë nxënësit të përdorin të gjitha tipat e shtytjeve dhe të tërheqjeve që kanë vërejtur deri tani në këtë kapitull. Nxënësit do të parashikojnë se cilat shtytje dhe tërheqje përdoren në veprimtari të ndryshme.

Do t'ju duhen: një sërë pajisjesh sportive.

Thojuni nxënësve: *Do të planifikoni një olimpiadë "shtytjesh dhe tërheqjesh".*

- Mendoni për të gjitha lëvizjet e ndryshme që keni bërë në këtë kapitull.
 - Kërkojuni nxënësve të mendojnë edhe lëvizje të tjera veç atyre që janë diskutuar.
 - Shkruajini lëvizjet e sugjeruara nga nxënësit në dërrasë dhe kërkojuni që t'i etiketojnë sipas nevojës për një lëvizje shtytëse ose tërheqëse. Për shembull, hedhja e një topi është shtytje.

2 Zgjidhni disa lojëra që u pëlqejnë t'i luajnë.

- Ndajeni klasën në skuadra dhe kërkojuni të shohin se cila skuadër ka më shumë ide.
- ### 3 Sigurohuni që të keni si lojëra me shtytje, ashtu edhe me tërheqje.
- Nxitini të përgjigjen se cilat lojëra janë me tërheqje: për shembull, tërheqja e litarit është lojë me tërheqje.
 - Nxënësit i hedhin idetë e tyre në një tabelë si ajo më poshtë.

Loja	Parashikohet Shtytje	Parashikohet Tërheqje
Futboll	✓	

- Ndihmohuni nxënësit që t'i organizojnë këto lojëra në një kohë të përshtatshme për të provuar hamendësimet (parashikimet).

Vlerësim formues

Shiko fotografinë e fëmijëve që luajnë. Etiketo saktë secilin person me atë që bën.

Kërkojuni nxënësve ta bëjnë këtë veprimtari në grupe dyshe për të nxitur diskutimin.

Përgjigjet: a) (tërheqje litari) tërheqje, b) (hedhja e një topi basketbolli) shtytje, c) (shkelmimi i një topi futbollit) shtytje, d) (tërheqja e një harku lodër) tërheqje.

Shqyrto dhe reflekto

Përfundojeni temën duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë "Çfarë mësuam" në faqen 64 të Librit të Nxënësit. (Shiko edhe shënimet e mësimdhënies në faqen 66).

Mbështetje gjuhësore

Në këtë temë janë përdorur shumica e fjalëve kyçe. Lejojuni nxënësve të përdorin fjalorin për të shkruar përkufizimet e disa prej fjalëve. Kjo është një temë aktive, ndaj nxënësit mund t'i shohin shtytjet dhe tërheqjet në veprim. Etiketimi i veprimtarive si "shtytje" ose "tërheqje" e përforcojnë më tej kuptimin e tyre.

Veprimtari më të zgjeruara

- Kërkojuni nxënësve të shikojnë sporte të tjera në shkollë ose në televizor. Kërkojuni të identifikojnë shtytjet dhe tërheqjet që shohin.

Më shpejt ose më ngadalë

Nxënësit dallojnë që shtytjet dhe tërheqjet ndryshojnë lëvizjen e objekteve.

Më shpejt ose më ngadalë

Ti zbulon se shtytjet dhe tërheqjet i shpejtojnë ose i ngadalësojnë gjërat.

Ideja kryesore

Shtytjet dhe tërheqjet mund të ndalojnë lëvizjen e gjërave.

Disa makina lëvizin shumë më shpejt se të tjerat.

Disa makina lëvizin shumë më ngadalë se të tjerat.

☐ Si duhet të jenë shtytjet dhe tërheqjet që makinat të lëvizin më shpejt?

Shiko makinën lodër.

☐ Zbulo: Si mund ta lëvizësh makinën lodër?

1. Puno me një shok ose me një shoqe.

2. Lëvizni makinën lodër.

☐ Si do ta lëvizësh makinën lodër drejt vetes?

☐ Si do ta lëvizësh makinën lodër për ta larguar nga vetja?

☐ A duhet ta shtytësh apo ta tërheqësh që të lëvizë?

3. Lëviz makinën lodër më shpejt.

☐ Si veproje?

☐ Si mund ta lëvizësh makinën lodër më ngadalë?

☐ Si mund ta ndalosh makinën lodër?

☐ Zbulo: Si mund ta ndalosh një makinë lodër në lëvizje?

1. Puno me një shok. Gjenero si mund ta ndaloni një makinë lodër në lëvizje.

2. Shtytjeni me radhë makinën lodër.

☐ Mos e shtytini shumë fort se mund të lëndoni një qetir.

3. Personi tjetër duhet ta ndalojë makinën lodër.

☐ Si e ndaloat makinën lodër?

Si mendon?
Si lëviz roska lodër?

Si të fillojmë

Në këtë temë, nxënësi fillon të njohë që shtytjet dhe tërheqjet i lëvizin objektet më shpejt ose më ngadalë. Tema përqendrohet në lëvizjen e makinave lodër dhe të lojërave të tjera lëvizëse. Nxënësit zbulojnë se si lëvizin lodrat duke i shtytur dhe tërhequr ato më shumë ose më pak. Ata zbulojnë edhe se si ta ngadalësojnë një lodër, pasi është vënë në lëvizje.

Burime

Një gamë lodrash lëvizëse, përfshirë edhe makina lodër.

Fjalë kyçe

kthehet

Vështirësi i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të përdorin shtytjet dhe tërheqjet për të lëvizur një makinë lodër.

Në temën që vijon, nxënësit do t'i përdorin dijet e tyre mbi lëvizjen për të skicuar, ndërtuar dhe testuar një lodër lëvizëse.

Çfarë ndodh me shtytjet dhe tërheqjet që i bëjnë makinat të lëvizin më shpejt?

Kërkojuni nxënësve të mendojnë se si mund ta

lëvizin një lodër më shpejt. Nxitni idenë se që të lëvizin më shpejt, ato duhen shtyrë më fort.



Zbulo: Si ta lëvizësh makinën lodër?

Synimi i kësaj veprimtarie është t'i nxisë nxënësit të zbulojnë se si shtytjet dhe tërheqjet veprojnë mbi një makinë lodër. Nxënësit do të zhvillojnë aftësitë e vëzhgimit se si lëviz makina lodër kur e shtytjnë.

Do t'ju duhen: sipërfaqe e lëmuar (p.sh. tavolinat), makina lodër.

1 Puno me një shok ose shoqe.

- Caktoni rregullat para se të ndani makinat lodër.



Nxënësit nuk duhet t'i shtytjnë makinat shumë fort, sepse mund të lëndojnë njëri-tjetrin.

2 Lëvizeni makinën lodër.

- Jepini një makinë lodër secilit grup.
- Kërkojuni nxënësve të mendojnë se çfarë po bëjnë për të lëvizur makinën lodër: po e shtytjnë apo po e tërheqin? Nxënësit me radhë lëvizin makinën dhe e vërejnë duke lëvizur.
- Diskutoni pyetjet në *Librin e nxënësit*, para se nxënësit të shkruajnë përgjigjet e tyre.



Si do ta lëvizni makinën lodër drejt vetes?

Përgjigje: Duke e tërhequr makinën.



Si do ta lëvizni makinën lodër për ta larguar nga vetja?

Përgjigje: Duke e shtyrë makinën.



Duhet ta shtyni apo ta tërhiqni makinën lodër që ta lëvizni?

Hetimi tregon se si shtytja, ashtu tërheqja si përfundim kanë lëvizjen. Nxitini nxënësit t'ju japin këtë përgjigje.

Përgjigje: Mund ta shtyni ose ta tërhiqni. Kjo varet nga drejtimi në të cilin doni të ecë makina.

3 Lëvizeni makinën lodër më shpejt.

- Kërkojuni nxënësve të përpiqen ta lëvizin makinën më shpejt.
- Pastaj thojuni nxënësve që të shkruajnë se si e lëvizën atë në *Librin e nxënësit*.

 Si e bëtë?

Përgjigje: E shtymë ose e tërhoqëm më fort.

 Si mund ta lëvizni makinën më ngadalë?

Kërkojuni nxënësve të mendojnë se si mund ta lëvizin makinën më ngadalë.

Përgjigje e mundshme: E shtyj ose e tërheq më pak (jo aq fort) ose e ndaloj lëvizjen.



Ndaloni orën e mësimi për të bërë një raport dhe vazhdoni me shpjegimin e tekstit në *Librin e nxënësit*. Thojuni nxënësve (ose bëni pyetje nxitëse për të marrë përgjigjen prej tyre): *Për ta lëvizur makinën lodër (ose ndonjë objekt tjetër) ne duhet ta shtyjme ose ta tërheqim. Për ta bërë makinën të ecë më shpejt, ne duhet ta shtyjme ose ta tërheqim më fort. Kur e bëmë makinën të lëvizte më shpejt, na u desh ta shtynim më fort. Për ta bërë makinën të lëvizte më ngadalë, nuk e shtymë edhe aq fort.*

 Si mund ta ndalni makinën lodër?

Kërkojuni nxënësve të kujtojnë se si e lëvizën makinën më shpejt. Nxitini të përgjigjen që, për të ndaluar makinën, duhet të ndodhë e kundërta. Shtytja ose tërheqja që e lëviz makinën duhet të zvogëlohet, madje edhe të ndalet. Kërkojuni të mendojnë se si mund të arrihet kjo. Në këtë fazë nuk duhet të diskutoni për forcat e rezistencës, si fërkimi.

Përgjigje e mundshme: Duhet të ndalim shtytjen.

**Zbulohet: Si mund ta ndalësh një makinë lodër që po lëviz?**

Nxënësit tani do të zbulojnë si ndalen shtytja dhe tërheqja që e lëvizin makinën lodër. Ata mund ta bëjnë këtë duke e ndaluar makinën lodër me një dorë ose me një tjetër objekt, p.sh. me një tjetër makinë lodër.

Do t'ju duhen: sipërfaqe e lëmuar (p.sh. tavolinat), makina lodër.

1 Puno me një shok/shoqe.

- Thojuni nxënësve se do të zbulojnë se si të ndalin shtytjen në një makinë lodër.

2 Bëjeni me radhë shtytjen e makinës lodër.

- Kërkojuni një nxënësi ta shtyjë makinën.

**Sigurojuni që nxënësit të jenë të vetëdijshëm për rrezikun e mundshëm nëse e shtynë një makinë shumë fort.****3 Personi tjetër duhet ta ndalë makinën lodër.**

- Shpjegojuni se personi tjetër duhet ta ndalë makinën lodër me dorë ose me një objekt tjetër.
- Nxënësit e shtynë dhe e ndalin me radhë makinën lodër.

**Si e ndalët lëvizjen e makinës lodër?**

Nxënësit duhet të jenë në gjendje ta ndalin shtytjen, duke bllokuar lëvizjen ose duke mos e shtyrë edhe aq fort.

Përgjigje e mundshme: Vura dorën (ose vura një tjetër lodër) para makinës lodër që lëvizte dhe ajo u ndal.

Mbështetje gjuhësore

Në këtë temë përdoret termi “parashikoj”. Kërkojuni nxënësve të shtojnë një përkufizim për “parashikoj” në fjalorin dhe në “Murin e fjalëve”.

Shpjegojuni me gjuhën e thjeshtë të nxënësve se “parashikoj” tregon një bazë të dhënash, të cilat ne mund t'i provojmë.

Veprimtari më të zgjeruara

1 Nxënësit mund të vënë në zbatim dijet e tyre nga vëzhgimet mbi të tjera lodra lëvizëse. Kërkojuni nxënësve të diskutojnë me njëri-tjetrin se si mund ta vënë në lëvizje secilën lodër. Pyetini:

- Si mund ta lëvizni lodrën më shpejt ose më ngadalë?
- Si mund ta ndalni lëvizjen e lodrës?

2 Pyesni: Si ngadalësojnë makinat e vërteta? Çfarë përdorin? Ndryshon shtytja apo tërheqja?

Si mendon? Pyetja e kësaj rubrike i ndihmon nxënësit të vlerësojnë se shtytjet dhe tërheqjet duhet të zbatohen nga një burim dhe se kjo ka pasoja mbi objektin. Prisni përgjigje që shpjegojnë se: *Tërheqja e litarit e lëviz rosakun përpara. Tërheqja buron nga personi që tërheq litarin.*

Më shpejt ose më ngadalë

Nxënësit dallojnë që shtytjet dhe tërheqjet ndryshojnë lëvizjen e objekteve.

Më shpejt ose më ngadalë

Ti zbulon se shtytjet dhe tërheqjet i shpejtojnë ose i ngadalësojnë gjërat.

Ideja kryesore

Ne mund të bëjmë lodra që lëvizin.

☐ Si mund të lëvizin lodrat?
☐ Zbullo: Si të bëjmë një lodër që lëviz.

- Puna bashkë me shokët e shoqet në grup.
- Bëni një lodër që lëviz, prej kartoni ose druri.
- Mendoni si ta bëni lodrën të lëvizë. Për këtë ju duhen nota.

Bëni një makinë lodër me tullumbace

- Fiksini tullumbacen te makina lodër që keni bërë.
- Futni një pipëz në grykën e tullumbaces.
- Mbani fundin e pipëzës me gishtat.
- Fryjeni me kujdes tullumbacen.
- Kur ta lëshoni, oji që del nga tullumbaja, e shtyn makinën lodër të ecë përpara.

☐ A mund t'i bëni rrotat të lëvizin?
☐ Çfarë e lëviz makinën lodër?

Bëni një lodër që kërcen

Ju duhet një sustë.

- Bëni fytyrën ose trupin e një kafshë dhe bashkoni me sustën.
- Tërhiqeni sustën dhe më pas lëreni të lirë.

☐ Çfarë e lëviz lodrën që kërcen?

Disa nga lodrat që lëvizin kanë një çelës për kurdise.

☐ Çfarë i bën ti çelësit kur e kthen?

Rretho çfarë bën për të lëvizur objektet.

- Për të hedhur një top, duhet ta tërheq/shyty.
- Për të marrë një libër nga tavolina, duhet ta tërheq/shyty.
- Për të hapur derën nga vetja, duhet ta shtyj/tërheq.

Tani shiko në faqen 64 për të kontrolluar se çfarë di.

Si të fillojmë

Në këtë temë, nxënësit skicojnë dhe bëjnë një lodër që lëviz. Në *Librin e nxënësit* ka dy shembuj: makina me tullumbace funksionon shumë mirë.

Burime

Karton, përfshirë edhe kuti kartoni të valëzuar, dru i punueshëm, shirit ngjytës, ngjytës i lëngshëm, një gamë sendesh për të bërë rrotat, si p.sh.: kapakë shishesh plastike, kunja lidhës, shkopinj shishqebapi, llastiqe gome, tullumbace, susta.

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

trego

Aftësi të nevojshme shkencore

Në këtë temë, nxënësit praktikojnë mënyrat e parashikimeve për ta bërë një lodër të lëvizë dhe përdorin aftësitë e të menduarit për të vendosur se cilën lodër do të bëjnë.

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të përdorin njohuritë mbi lëvizjen, për të skicuar, për të ndërtuar dhe për të provuar një lodër lëvizëse;
- të punojnë në skuadër për të marrë vendime rreth lodrës.

Në temën tjetër, nxënësit do të mësojnë se ka një arsye pse objektet lëvizin më shpejt, ngadalësojnë ose ndërrojnë drejtim.

Si mund të lëvizin lodrat?

Përdorni pyetjen fillestare për të radhitur ato që nxënësit tashmë kanë mësuar. Kërkojuni të diskutojnë në grupe të vogla:

- A mund t'i kujtoni mënyrat e ndryshme që lëviznin lodrat?

Nëse është e nevojshme, kujtojuni që disa lodra nuk është e nevojshme të shtyhen ose të tërhiqen.

Përgjigje e mundshme: Me shtytje, me tërheqje, me kurdise, me susta..

Zbullo: Si të bëjmë një lodër që lëviz.

Synimi i kësaj veprimtarie është që nxënësit të bëjnë një lodër lëvizëse, e cila të tregojë shtytjen dhe tërheqjen. Kjo do t'i ndihmojë nxënësit të praktikojnë aftësinë e krahasimit.

Do t'ju duhen: materiale pune me dorë ose hedhurina (shiko listën e burimeve).

Tregojuni nxënësve pamjen e makinës lodër në *Librin e nxënësit*, për të nxitur mendimet e tyre.

Thojuni se nuk kanë pse të bëjnë detyrimisht një makinë-mund të jetë çfarëdolloj lodre e lëvizshme.

1 Punoni në grupe të vogla.

- Shpjegojuni nxënësve se do të skicojnë dhe do të bëjnë një lodër që lëviz.
- Organizojini nxënësit në grupe me nga tre ose katër veta, që të mund të ndihmojnë njëri-tjetrin me disa nga detyrat e vështira. Caktajini secilit nxënës një rol, si p.sh.: mbledhës i materialeve, skicues, ngjytës etj.

2 Bëni një lodër lëvizëse me karton ose dru.

- Nxënësit mund të bëjnë më shumë se një lodër, nëse kanë kohë. Çështja është që të mendojnë mbi ato aspekte të lodrës, që i mundësojnë asaj lëvizjen.
- Nxitini të punojnë së bashku, që të mendojnë se si të skicojnë një lodër lëvizëse, si p.sh. duke përdorur rrotat.
- Mund të përdorni karton të valëzuar për trupin, duke i futur shkopinj të shishqebapit nëpër kanalet e kartonit dhe pastaj në to të vini rrotat.
- Ngjisni kapakët e shisheve plastike në anët e shkopinjve. Përdorni ngjytës ose plastelinë për t'i ngjitur tapat pas shkopinjve.

Bëni një makinë lodër me tullumbace

Makina lodër me tullumbace funksionon shumë mirë dhe bëhet shumë lehtë.

- Fusni një pipëz në qafën e tullumbaces.
- Shtrengojeni pas grykës së tullumbaces me një llastik gome.
- Lidhni spangon rreth llastikut prej gome dhe lidhni pastaj rrotull bazës së makinës.
- Lidhni spangon fort nën makinë.
- Përdorni pipëzën për të fryrë tullumbacen.
- Shtypeni majën e pipëzës me majat e gishtave. Kjo nuk do të lejojë që ajri të shpëtojë para se makina të jetë në një vend të sigurt për të lëvizur.
- Vëreni makinën në një vend të sigurt dhe lëshojeni.
- Mund të organizoni një garë "Formula 1".

A mund t'i bëni rrotat të lëvizin?

Tregojuni nxënësve se si të sigurohen që rrotat janë të lirshme për të lëvizur dhe jo të bllokuara. Tregojuni si t'i vërtisin rrotat, që të kontrollojnë lëvizjen.

Çfarë e lëviz makinën lodër?

Diskutoni me nxënësit disa metoda të ndryshme të lëvizjes së makinës lodër dhe se si funksionon secila metodë. Disa nga metodat e ndryshme janë:

- Përdorimi i një çelësi për të kurdisur makinën lodër
- Përdorimi i një llastiku gome për të grumbulluar energjinë
- Tërheqja e makinës lodër me një spango

Kërkojuni nxënësve që ta vendosin makinën lodër në një sipërfaqe të lëmuar e të sheshtë. Kërkojuni të mos e prekin makinën dhe të vërejnë sjelljen e saj. Disa mund të piketojnë përdorimin e tërheqjes për ta bërë makinën të lëvizë po aq mirë sa edhe shtytja.

Bëni një lodër që kërcen

Nxënësit mund ta bëjnë këtë si një alternativë tjetër të makinës lodër. Jepuni nxënësve materiale të vizatojnë dhe të bëjnë një kafshë qesharake.

- Bashkujini pjesët e trupit me llastik gome, që të bëjë sa më shumë lëvizje.
- Sytë që kërcen janë gjithashtu efikase dhe shumë argëtuese. Zbukurojeni trupin sipas dëshirës.
- Lidhni trupin e kafshës pas sustës, duke përdorur shirit ngjites dhe/ose ngjites të lëngshëm.
- Tërhiqni sustën që ta lëvizni lodrën.



Çfarë e lëviz lodrën kërcyese?

Përgjigjja: Shtytja ose tërheqja.



Çfarë i bëni çelësit kur e rrotulloni?

Thojuni nxënësve të shikojnë fotografinë e lodrës me kurdisje në *Librin e nxënësit*. Bëjuni pyetjen dhe nxitini ta thonë vetë përgjigjen, para se t'u kërkonin ta shkruajnë.

Përgjigjja: E shtyjme.

Vlerësim formues



Rrethoni çfarë i lëviz objektet.

Përdorni detyrën e fundit të temës, për të matur të nxënët e nxënësve nga dy temat e fundit.

Përgjigje:

- 1 Për të hedhur një qese me fasule, ju duhet ta shtyni atë.
- 2 Për ta ngritur një libër, duhet ta tërhiqni atë.
- 3 Hapja e derës nga vetja kërkon ta tërheqësh atë.

Shqyrto dhe reflekto

Përmbylleni temën duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë "Çfarë mësuam" në faqen 64 të Librit të Nxënësit. (Shiko edhe shënimet në faqen 66).

Mbështetje gjuhësore

Përdorimi i fjalëve kyçe "shpejt", "më shpejt" dhe "më i shpejti" vjen duke u rritur në këtë kapitull. Tregojini konceptet, duke përdorur makina lodra dhe thoni se *Makina A është më e shpejtë se Makina B. Por Makina C është më e shpejtë se Makina A, prandaj Makina C është më e shpejta.*

Veprimtari më të zgjeruara

Lejojini nxënësit të ndërtojnë një shilarës lodër. Ata mund të përdorin pipëza dhe spango për të bërë shilarësin. Kërkojuni nxënësve të diskutojnë mbi pyetjen:

- Si do ta bëni shilarësin që të fillojë të lëvizë? *Duke e shtyrë atë.*

Vëzhgo gjërat në lëvizje

Nxënësit dallojnë që, ka një shkak pse objektet përshpejtojnë, ngadalësojnë ose ndërrojnë drejtim.

Vëzhgo gjërat në lëvizje

Ti dalloj çfarë i përshpejton, i ngadalëson ose ua ndërrojnë drejtimin gjërave në lëvizje.


Ideja kryesore

Era i lëviz gjërat.

Vështro fotografinë.

☐ Nga po lëviz rëra?
Pse është duke lëvizur në këtë mënyrë?
Era e fryn rërën nga dora.

Era
Era lëviz gjethet e pemëve.



Era lëviz anijen me vela. Era lëviz mullinjët me erë.

1. Zbulohet: Ndërtimi i një helike prej letre.

2. Puna me një shok ose me një shoqe. Ndhmoni njëri-tjetrin.

3. Mbivendosni skajet e secilit cep në vrimën në mes të kartonit. Ndhmoni njëri-tjetrin për ta bërë këtë.

4. Mbështilni pjesën e fundit të kapësës së letrave rreth e qark shkopit.

5. Vendosni letër ngjitëse mbi fundin e kapësës së letrave. Fryjini helikës.

Platëso fjalitë për të përshkruar si lëviz helika.

Kur i fryj fort, helika lëviz **me shpejtësi**.

Kur i fryj lehtë, helika lëviz **ngadalë**.

Helika _____ duke u rrotulluar, por nuk lëviz nga një _____ në një tjetër.

Katja e fjalëve: **me shpejtësi** - **vend** - **ngadalë**

Si të fillojmë

Në këtë temë, nxënësit hetojnë mënyrën se si lëvizin objektet dhe çfarë e shkakton lëvizjen. Tema fillon me vëzhgimin e rërës që derdhet dhe që e merr era. Nxënësit bëjnë një helikë letre dhe zbulojnë se si mund ta ndryshojnë mënyrën se si lëviz ajo duke i fryrë.

Burime

Karton i hollë, kapëse letrash, kunja druri, ngjitës lëng, letra ngjitëse, shirit ngjitës.

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të zbulojnë se si era i bën objektet të lëvizin
- të bëjnë një rrotë ere dhe ta testojnë atë.

Në temën që vijon, nxënësit do të mësojnë më shumë rreth fakti se si uji dhe era i bëjnë objektet të lëvizin.



Në cilin drejtim po lëviz rëra? Pse po lëviz në këtë drejtim?

Kërkojuni nxënësve të shikojnë foton e rërës që e merr era. Kërkojuni të diskutojnë me personin që kanë pranë se si po lëviz rëra dhe ta përshkruajnë. Nxitini të përgjigjen se është era ajo që e largon rërën nga dora.

Nxitini të përgjigjen se nëse era ndalon të fryjë, rëra do të lëvizë ndryshe. Pyetini nxënësit:

- Si mendoni se do të lëvizë rëra, nëse nuk ka erë? Rëra do të bjerë drejt mbi dyshe.

Përgjigje e mundshme: Era po fryn nga e majta. Era po e fryn rërën.

Ndiqui veprimtarinë fillestare duke pyetur nxënësit:

- Çfarë ndodh me gjethet e pemëve kur fryn erë? Era i lëviz gjethet.

Tregojuni nxënësve fotografinë e një varke me vela dhe mullirin e erës në *Librin e nxënësit*. Mund t'u tregoni edhe video të këtyre objekteve nga interneti. Nxitini nxënësit të përgjigjen se është era ajo që lëviz varkën me vela dhe mullirin e erës.



Zbulohet: Ndërtimi i një helikë letre

Synimi i kësaj veprimtarie është që nxënësit të zbulojnë se era i lëviz objektet. Kjo do t'i ndihmojë nxënësit të praktikojnë aftësitë e diskutimit se si ta bëjnë helikën e letrës të lëvizë dhe pastaj ta testojnë.

Do t'ju duhen: copa letre të përgatitura (shiko udhëzimet më poshtë), letra ngjitëse, kapëse letrash, kunja druri, ngjitës lëng ose shirit ngjitës.

Duhet të përgatisni një copë letër për secilin grup si më poshtë:

- Palos një copë katrore kartoni në gjysmë, sipas diagonales (nëse e filloni me një letër A4, kur ta palosni sipas diagonales, do t'ju mbetet një copë. Prijeni atë për ta bërë katrore.)
- Paloseni sërish në dysh sipas diagonales.
- Hapeni kartonin. Tani të katër diagonalet kanë lënë gjurmë. Nga secili skaj prisni përgjatë secilës diagonale, gjer në mes të rrugës mes cepit e qendrës.
- Bëni një vrimë në mes të kartonit dhe në secilin skaj të katrorit, që nxënësit ta kenë më kollaj të fusin kapësen e letrave mes tyre.

Tregojuni pamjen e helikës prej letre gjatë detyrës, pasi nxënësve do t'u duket më i lehtë ndërtimi, nëse shohin modelin e përfunduar.

- Punoni me një shok/shoqe dhe ndihmoni njëri-tjetrin.
 - Organizojini nxënësit në grupe dyshe. Duhet ta ndihmojnë njëri-tjetrin, që secili të bëjë nga një helikë letre.



Kërkojuni nxënësve t'ju shikojnë dhe t'ju imitojnë ndërsa bëni një model helike, hap pas hapi. Sigurohuni që ta shoqëroni çdo hap me fjalë, duke i thënë udhëzimet me zë të lartë dhe kërkojuni nxënësve që t'i përsërisin. Për shembull thoni: *Çfarë thashë, Arbër? Ku e vendosim secilin cep?*

- 2 Merrni secilin skaj të kartonit dhe mbivendoseni mbi vrimën e mesit. Ndhmoni njëri-tjetrin për ta bërë këtë.
 - Nxënësit palosin të gjithë cepat drejt qendrës së kartonit dhe i mbajnë që të mos lëvizin ndërsa vazhdojnë punën. Njëri mund ta mbajë dhe tjetri ta palosë.
 - Pastaj kërkojuni të vënë një ngjitës letër mbi të katër cepat, që t'i mbajnë të katra flatrat në vend.
- 3 Fiksojini të gjithë cepat me kapësen e letrës.
 - Një nxënës mund të marrë një kapëse letrash dhe ta shtyjë në mes të ngjitësit, derisa të dalë në anën tjetër të helikës.
- 4 Kapini anët e kapëses së letrave pas shkopit.
- 5 Vini pak ngjitës mbi fundet.
 - Nxënësit kapin me ngjitëse fundet e kapëses së letrave.
 - Tani nxënësit mund t'u fryjnë helikave të tyre prej letre.

Kërkojuni nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve në *Librin e nxënësit*.



Plotësoni fjalitë për të përshkruar se si lëviz helika.

Lejojini nxënësit të hetojnë se si sasia e ajrit që ata fryjnë mbi helikën prej letre, ndikon në lëvizjen e saj. Kërkojuni të gjithëve që t'i fryjnë lehtë, pastaj më fort dhe në fund aq fort sa munden. Diskutojini zbulimet e tyre në grup, duke i nxitur ata të krahasojnë se çfarë ndodh dhe të bëjnë lidhjen mes fryrjes më të qetë dhe helikës që lëviz më ngadalë.

Fjala e fundit vihet për të forcuar idenë se lëvizja jo gjithmonë përfshin zhvendosjen nga njëri vend në tjetrin. Pyetini nxënësit:

- A lëvizi helika në një tjetër vend, kur i frytë? *Jo.*
- A mund ta përshkruani se si lëviz rrota e erës? *Rrotullohet rreth e rreth.*

Përgjigje:

Kur i fryj fort, helika lëviz më shpejt.

Kur i fryj lehtë, helika lëviz më ngadalë.

Helika lëviz duke u rrotulluar, por nuk lëviz në një vend në një tjetër.

Mbështetje gjuhësore

Përdorni rrëfimin hap pas hapi se si bëhet helika, për të përforcuar fjalët kyçe dhe për të nxitur përsëritjen. Kërkojuni nxënësve të shtojnë imazhe të objekteve që lëvizin nga era në "Murin e fjalëve" të klasës. Ata mund të shkruajnë fjalë ose fjali të thjeshta, për të përshkruar lëvizjen e secilit objekt, si p.sh: *Era e shtyn helikën të rrotullohet. Era e shtyn varkën me vela përmes detit etj.*

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Helika mund të bëhen në çdo formë e masë. Nëse keni kohë dhe burime në dispozicion, klasa mund të ndërtojë një helikë të madhe.
- 2 Kërkojuni nxënësve të krahasojnë dy helikat:
 - Si lëviz helika madhe? *Era i lëviz fletët e helikës së madhe.*
 - A është lëvizja e helikës së madhe e ndryshme nga ajo e helikës së vogël? *Jo, është e njëjtë.*
 - A është më e vështirë për ta lëvizur? *Helika e madhe është shumë më e vështirë për t'u lëvizur. Era duhet të jetë shumë më e fortë për ta lëvizur atë.*

Vëzhgo gjërat në lëvizje

Nxënësit dallojnë që, ka një shkak pse objektet përshpejtojnë, ngadalësojnë ose ndërrojnë drejtim.

Vëzhgo gjërat në lëvizje

Ti dallosh se çfarë i përshpejton, i ngadalëson ose ua ndërrojnë drejtimin gjërave në lëvizje.

Ideja kryesore

Uji dhe era lëvizin gjërat.

Uji

Djali po derdh ujë mbi lodrën me rrotë ujë.

☐ A mund të përshkruash se si e lëviz uji rrotën?

☐ Çfarë ndodh nëse djali ndalon derdhjen e ujit?

☐ Gjej se çfarë do të ndodhë nëse djali derdh shumë ujë.

Uji që bie e lëviz rrotën e ujit.
Uji e shtyn rrotën e ujit.

Zbuloj: Si lëvizin fluskat në erë?

Përdor lëng fluskash dhe një shkop për t'i fryrë ato. Parashiko çfarë do të ndodhë me fluskat.

☐ Çfarë i lëviz fluskat? Pse ndryshojnë drejtimin ato?

☐ Kur lëvizin më shpejt? Kur ngadalësojnë?

Era u ndryshon shpejtësinë dhe drejtimin fluskave.

Rendit dy gjëra që ti i përdor për të lëvizur objektet.

Çfarë e lëviz helikën?

Çfarë e lëviz rrotën e ujit?

Toni shkoi në faqen 65 për të kontrolluar se çfarë di.

Shtypja dhe lëvizja

Si të fillojmë

Në këtë temë nxënësit hetojnë mënyrën se si lëvizin objektet dhe çfarë e shkakton lëvizjen. Nxënësit nxiten të përshkruajnë mënyrën se si uji lëviz rrotën lodër.

Burime

Pajisje për lojëra me ujë dhe rërë, lëng fluskash dhe shkop për fluska.

Aftësi të nevojshme shkencore

Kjo temë heton se si uji dhe era lëvizin objektet të lëvizin. Nxënësit diskutojnë si dhe pse fluskat ndryshojnë drejtim dhe shpejtësi.

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

parashikoj

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të zbulojnë se si uji dhe era i lëvizin objektet;
- të vëzhgojnë se si lëvizin fluskat në erë.

Në temën që vijon, nxënësit do të shqyrtojnë dhe do të reflektojnë mbi atë që kanë mësuar në këtë temë.

A mund ta përshkruani se si e lëviz uji rrotën?

Shpjegojuni nxënësve se mund t'i lëvizin objektet me anë ujit. Kërkojuni të shikojnë djalin në fotografi, që derdh ujë në rrotën e ujit. Kërkojuni të diskutojnë dhe pastaj të përshkruajnë se si e lëviz uji rrotën.

Përgjigje e mundshme: Uji i lëviz rrotat. Uji lëviz rrotën e parë, pastaj bie tek rrota e pasme dhe e vë edhe atë rrotë në lëvizje.



Çfarë ndodh nëse djali ndalon derdhjen e ujit?

Kërkojuni nxënësve t'i përgjigjen pyetjes në *Librin e nxënësit*, për të matur se sa e kanë kuptuar.



Mund ta mbështesni këtë veprimtari, duke i nxitur nxënësit të përgjigjen dhe duke shkruar një fjali model në dërrasë, që ata ta kopjojnë në *Librin e nxënësit*.

Përgjigje: Rrota e ndal lëvizjen.



Parashikoni se çfarë ndodh nëse djali derdh shumë ujë.

Përdoreni këtë diskutim për të zgjeruar të nxënësit e nxënësve.

Përgjigje e mundshme: Rrota lëviz më shpejt.

Nxitini nxënësit të përgjigjen se uji i shtyn rrotat që të rrotullohen. Kërkojuni nxënësve të diskutojnë se çfarë i bën rrotat të lëvizin më shpejt ose më ngadalë. Pyetini si mund ta bëjmë rrotën të ndalë lëvizjen.

Nxitini nxënësit që të përgjigjen se një rrotë e vërtetë hidraulike punon po me të njëjtin parim. Kërkojuni të mendojnë se për çfarë mund të përdoret. Rrotat hidraulike mund ta transmetojnë energjinë e ujit që lëviz, duke i bërë makineritë të funksionojnë ose të prodhojnë energji elektrike.



Vëzhgo: Si lëvizin fluskat në erë?

Synimi i kësaj veprimtarie është që nxënësit të mund të zbulojnë se si lëvizin fluskat në erë dhe cilën forcë përdor era (shtytjen). Nxënësit do të praktikojnë aftësitë e arsytimit deduktiv përmes diskutimit se si era u ndryshon drejtimin fluskave.

Do t'ju duhen: lëng fluskash, shkop për fluska.

- Jepini secilit nxënës lëng fluskash dhe shkop për fluska për t'u fryrë e për të krijuar fluska.



Thojuni nxënësve se lëngu nuk është i rrezikshëm, por duhet ta shmangin kontaktin me sytë, sepse mund t'u djegin.

- Nxirrini nxënësit jashtë që të zbulojnë se si lëvizin fluskat në erë.

Kërkojuni nxënësve të diskutojnë për pyetjet në *Librin e nxënësit*, ndërsa vëzhgojnë se si lëvizin fluskat.



Çfarë i lëviz fluskat kështu?

Përgjigje: Era.

Pse ndërrojnë drejtim fluskat?

Përgjigje: Sepse era i çon në drejtime të ndryshme.

Kur lëvizin më shpejt?

Përgjigje: Lëvizin më shpejt kur era fryn më fort.

Kur ngadalësojnë?

Përgjigje: Ngadalësojnë kur era fryn më pak.

Nëse nxënësit nuk e kanë kuptuar ende vetë, shpjegoni se është era ajo që i bën fluskat të ndryshojnë shpejtësi e drejtim.

Vlerësim formues

Përdoreni këtë veprimtari për të matur se sa mirë e kanë kuptuar nxënësit temën.



Renditni dy mjetet që keni përdorur për t'i lëvizur objektet.

Përgjigje: Ujë, erë.

Çfarë e lëvizi helikën prej letre?

Pyetini nxënësit se si e bënë helikën të lëvizë. Nxitini të përgjigjen se iu desh t'i frynin helikës që të fillonte të lëvizte.

Përgjigje: Era ose fryrja.

Çfarë e lëvizi rrotën e ujit?

Nxitini të përgjigjen rreth idesë se uji e lëviz rrotën. Kërkojuni nxënësve të kujtojnë se si i lëvizën lodrat. Duhet të kujtojnë se iu desh t'i shtynin ose t'i tërhiqnin lodrat. Pyetini se kush e bën shtytjen apo tërheqjen te rrota e ujit.

Përgjigje: Uji e shtyn atë.

Shqyrto dhe reflekto

Përmbylleni temën duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë "Çfarë mësuam" në faqen 65 të Librit të Nxënësit. (Shiko edhe shënimet e mësimdhënies në faqen 67).

Mbështetje gjuhësore

Kërkojuni nxënësve të plotësojnë në fjalorin e tyre "për t'u shkruar vetë" përkufizimet për fjalët kyçe të përdorura në këtë temë. Ju mund t'i ndihmoni ose duke i shkruar përkufizimet në dërrasë, që ata t'i kopjojnë, ose duke diskutuar për fjalët dhe ata ta thonë vetë përkufizimin që do të përdorin. Vazhdoni t'i referoheni "Murit të fjalëve" ose Resë së fjalëve dhe shfrytëzoni çdo rast që t'u riktheheni gjatë mësimdhënies.

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Tregoni se si të mund bëni fluskën më të madhe të mundshme, duke përdorur një tel për të bërë një shkop gjigant për fluska.
- 2 Lejojini nxënësit të zbulojnë me pajisjet e rërës se si rëra është një tjetër objekt që mund ta përdorim për të krijuar lëvizje. Rrotat me rërë janë të shkëlqyera për këtë veprimtari. Ato funksionojnë njësoj si rrotat me ujë dhe funksionojnë mbi të njëjtat parime.

Çfarë mësuam mbi shtytjen dhe tërheqjen

Çfarë mësuam për shtytjen dhe tërheqjen

Si lëvizin gjërat

Në lëvizim trupat tanë me anë të shtytjeve dhe të tërheqjeve.

Këto janë disa mënyra si mund ta lëvizësh trupin. A mund t'i përputhësh figurat me fjalët?

duke ecur

duke u rrotulluar

duke kërcyer

duke lëkundur krahët

Unë e di që shtytjet dhe tërheqjet lëvizin gjërat.

Më shpejt ose më ngadalë

Si mund t'i lëvizësh këto lodra? Përdor kutinë e fjalëve.

Unë mund ta _____ makinën lodër.

Unë mund ta _____ rosakun lodër.

Unë mund ta _____ robotin lodër.

Unë mund të _____ tullumbacen për ta lëvizur makinën lodër.

Kutia e fjalëve

era

uji

Unë e di se kur diçka lëviz, atëherë atë ose e kanë shtyrë, ose e kanë tërhequr.

Kutia e fjalëve

shtyj

tërheq

fryj

kurdís

Shtytjet dhe tërheqjet

65

Si të fillojmë

Qëllimi i këtij seksioni është që të nxit nxënësit të shqyrtojnë të nxënit e tyre pas çdo teme në kapitull. Çdo temë ka disa pyetje përforcuese që t'i përgjigjen nxënësit. Këto vlerësojnë njohuritë e nxënësve dhe të kuptuarin e tyre mbi temën.

Pas çdo serie pyetjesh përforcuese, ka një model "çfarë mësuam" që nxënësit duhet t'i përgjigjen. Duhet të kaloni përmes modelit dhe t'i ndihmoni nxënësit të plotësojnë rrethin e vetëshqyrtimit, për të parë se sa të sigurt janë mbi secilën temë. Nxënësit mund të ngjyrosin, të vizatojnë një fytyrë të thjeshtë me shprehje emocionale ose të vënë një letër ngjyrtë mbi të.

Është e rëndësishme që të merret informacion ku nuk ndihen të sigurt. Ky informacion është thelbësor për mësuesin, që të mund të përftojë korrigjimet e nevojshme në fund të kapitullit.

Përsëritje dhe reflektim

Zbulo si lëvizin objektet

Nxënësit e vegjël janë mësuar me shtytjet dhe tërheqjet në lojëra ose dhe rastësisht

Pyetini nxënësit se çfarë ndiejnë kur shtytjnë ose përplasen me diçka. Proveni t'u prezantoni parakonceptin e forcës nëpërmjet shtytjeve dhe tërheqjeve. Në klasat e tjera do të mësojnë se "forca" ka një kuptim të veçantë në fizikë. Lidhni së bashku idenë e "shtytjes dhe tërheqjes" me "lëvizjen".



Ja disa nga mënyrat se si mund të lëvizni trupin tuaj. A mund t'i lidhni fotografitë me fjalët?

Kërkojuni nxënësve të kujtojnë disa nga mënyrat se si e lëvizën trupin e tyre në këtë temë. Nëse

nuk i kujtojnë dot fjalët, kërkojuni t'jua tregojnë lëvizjet, pastaj shkruani fjalën për çdo lëvizje në dërrasë. Thojeni fjalën me zë të lartë dhe kërkojuni nxënësve ta përsërisin.

Sigurohuni që nxënësit të përfshijnë të gjitha lëvizjet që duhen për këtë veprimtari (kërcimi, ecja, lëkundja).

Mund ta zgjeroni veprimtarinë duke i pyetur nxënësit nëse përdorin shtytjen apo tërheqjen për secilën lëvizje. Për shembull:

- Si kërceni? Përdorni shtytje apo tërheqje? *Përgjigje e mundshme: E tërheq trupin lart.*
- Si ecni? Përdorni shtytje apo tërheqje? *Përgjigje e mundshme: E shtyj këmbën para, pastaj e tërheq.*
- Si i lëkundni krahët? Përdorni shtytje apo tërheqje? *Përgjigje e mundshme: E shtyj krahun para dhe pastaj e tërheq pas.*
- Si vërtitesh në vend? Përdorni shtytje apo tërheqje? *Përgjigje e mundshme: E shtyj trupin rreth vetes.*

Përgjigje: Duke kërcyer, duke ecur, duke u rrotulluar, duke u lëkundur.

T'i lëvizësh objektet më shpejt ose më ngadalë



Si mund t'i lëvizni këto lodra?

Kërkojuni nxënësve të shikojnë fotografitë dhe përfundoni fjalitë se si mund të lëvizë secila lodër. Dy të parat janë lodra të thjeshta "shtytjeje" ose "tërheqjeje".

Për dy lodrat e fundit kërkojuni nxënësve t'ju thonë se nga vjen shtytja, e cila i bën të lëvizin lodrat me tullumbace dhe ato me kurdísje. Nxënësit i kanë hasur të gjitha këto lodra gjatë mësimi të kësaj teme, ndaj me pak nxitje duhet të jenë në gjendje të përgjigjen.

Bëjuani të qartë se shtytjet dhe tërheqjet i lëvizin objektet në forma të ndryshme. Kjo do t'i paraprijë temës së radhës, ku nxënësit do të studiojnë fuqinë e ujit e të erës.

Përgjigje: Unë mund ta shtyj ose ta tërheq makinën lodër.

Unë mund ta tërheq rosakun lodër.

Unë mund ta kurdís robotin lodër.

Unë mund ta fryj tullumbacen për ta lëvizur makinën lodër.

Rretho fjalën e saktë.

Vazhdoni temën “e shtytjeve, të tërheqjeve dhe të lëvizjes”, duke u kërkuar nxënësve të kujtojnë se si i lëvizëm makinat lodër më shpejt e më ngadalë. Përforconi idenë e një shtytjeje ose të një tërheqjeje më të madhe dhe të një shtytjeje ose të një tërheqjeje më të vogël, duke i bërë objektet të lëvizin më shpejt ose më ngadalë.

Përgjigje: Nëse i shtyn më fort, gjërat lëvizin më shpejt.

Vëzhgo gjërat që lëvizin

Kush po i lëviz gjërat në këto fotografi? Shkruani fjalën e saktë nën secilën fotografi.

Kërkojuni nxënësve të kujtojnë se çfarë i lëvizte objektet që kanë studiuar në këtë temë. Për shembull, pyesni:

- A ju kujtohet se çfarë e lëvizte varkën me vela?
Era.

Përdorini pyetjet për t’i nxitur të përgjigjen se mund ta përdorim erën dhe ujin për të lëvizur objektet.

Nxënësit mund të jenë të interesuar të mësojnë se era dhe uji ishin burimet e para të energjisë, para zbulimit të energjisë elektrike dhe naftës.

Pastaj kërkojuni nxënësve të shikojnë fotografitë dhe të shkruajnë përgjigjet e tyre në *Librin e nxënësit*.

Përgjigje: Era, uji, uji, era.

Përforcojeni veprimtarinë duke i pyetur nxënësit nëse mund ta shohin fuqinë e ujit në det ose në një lumë.

A mund ta shohin fuqinë e ajrit tek era? Diskutoni dhe theksoni se ata e shohin ose e ndjejnë rezultatin, por era është e padukshme.

Vlerësim përmbledhës

Modeli “Çfarë mësuam” në *Librin e nxënësit* është një pikënisje e shkëlqyer, kur diskutohet për përparimin individual të secilit nxënë. Ky informacion mund të përdoret edhe për të krijuar raporte për secilin nxënë në përfundim të tremujorit.

Ai mund të jetë i nevojshëm edhe për të mbajtur një raport të përgjithshëm për nivelin e sigurisë së mbarë klasës, për të identifikuar zonat që më vonë mund të duan një rishikim (shiko një tabelë me shembuj më poshtë).

Detyra për “Çfarë mësuam për shtytjet dhe tërheqjet”	Shumë të sigurt	Jo edhe aq të sigurt	Të pasigurt

Ky raport më pas mund të përdoret për krijuar një program përplotësues, për t’i ndihmuar nxënësit të përmirësohen. Bëjini sa më thjeshtë regjistrimet dhe analizat e vetëvlerësimit të nxënësve. Kërkohet vetëm një përshtypje e përgjithshme e vetëvlerësimit të klasës, jo të dhëna individuale të nxënësve, p.sh. *50% e klasës nuk ishin të sigurt për...*

5 Tingujt

Në këtë kapitull, nxënësit:

- identifikojnë burimet e shumta të tingullit.
- shquajnë se si tingulli fillon dhe dobësohet, ndërsa largohet nga burimi.
- mësojnë se ne dëgjojmë, kur tingulli na hyn në vesh.

5. Tingujt

Në këtë kapitull, ti:

- emërton disa burime tingujsh;
- zbulon çfarë ndodh me tingujt, kur ne lëvizim;
- kupton se tingujt i dëgjojmë me veshë.



dëgjo
tingull zë
i fortë i butë
emërtoj vesh

- ☐ Sa tinguj mund të bësh?
- ☐ Pse kafshët lëshojnë tinguj?
Çfarë mendojnë se po thotë majmuni?
Kë po thërret ai?

Fakt i çuditshëm
Disa kafshë, si sfungjeri i detit, nuk lëshojnë tinguj për të komunikuar.

Si të fillojmë

Kjo është tema e parë që flet për tingullin. Nxënësit me probleme të dëgjimit do të duan mbështetje të veçantë. *Tingulli* do të zbulohet më tej në klasat më të larta. Kjo temë fillon me nxënësit, të cilët mendojnë rreth tingujve të shumtë që mund të bëjnë dhe pastaj vazhdon me shqyrtimin e tingujve që bëjnë kafshët e tjera dhe pse i bëjnë.

Tema vijuese shqyrtton më në detaje idenë se kafshët komunikojnë. Nxënësit zbulojnë se si flasim dhe këndojmë, duke përdorur vetëm zërin tonë.

Nxënësit pastaj mendojnë për tërësinë e gjerë të tingujve. Pasi diskutojnë për tingujt e përditshëm, atyre u prezantohet muzika si një tingull që ne e bëjmë thjesht, sepse na pëlqen.

Nxënësit gjithashtu zbulojnë se si tingulli ndryshon me lëvizjen. Ata hetojnë se si këmbët e kafshëve grabitqare janë krijuar që t'i minimizojnë tingujt që bëjnë kur iu afrohen vjedhurazi presë. Fakti që tingulli udhëton në distanca të largëta, diskutohet më pas.

Më në fund, nxënësit zbulojnë mënyrën se si dëgjojmë tingujt. Ata mësojnë se si tingulli përcillet nga një burim drejt veshëve tanë.

Aftësitë e kërkimit shkencor

Nxënësit hetojnë tingujt e ndryshëm që bëjnë kafshët. Ata zbulojnë se si përdoren tingujt dhe matin sa të lartë janë tingujt të ndryshëm rreth tyre. Nxënësit hamendësojnë ose parashikojnë

se cilat kafshë bëjnë më shumë zhurmë kur ecin, pastaj përdorin idetë e tyre për të krijuar këmbët e përkryera për kafshët grabitqare dhe prenë. Nxënësit gjithashtu komunikojnë se si tingujt përdoren në sigurinë rrugore dhe se si përdoren sirenat për të na paralajmëruar për rreziqe.

Burime

Foto sfungjerësh deti.

Fjalë kyçe

dëgjo i dobët i fortë zë

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

hartoj

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të flasin për tingujt që mund të nxjerrin;
- të hamendësojnë pse kafshët bëjnë tinguj.

Në temën që vijon, nxënësit do të mësojnë rreth burimeve të ndryshme të tingullit.

Sa tinguj mund të bëni?

Kërkojuni nxënësve të ndahen në dyshe dhe të mendojnë për llojet e tingujve që janë në gjendje të bëjnë, si p.sh. të flasin, të këndojnë etj.

Vini në dukje që tingujt mund të bëhen me çfarëdolloj pjese të trupit.

Vëri në tregojnë me radhë, për të parë se sa mundësi kanë gjetur. Grupet duhet t'i ndajnë me të gjithë klasën përgjigjet e tyre. Theksoni se do të diskutoni vetëm tingujt e dëgjueshëm. Nxënësit mund të fishkëllojnë ose të gumëzhijnë.

Përgjigje e mundshme: Fishkëllima, e folura, e kënduara, përplasja e duarve, përplasja e këmbëve etj.

Pse lëshojnë tinguj kafshët?

Drejtojini nxënësit tek imazhi i majmunit që ulërin. Kërkojuni të diskutojnë me shokun a shoqen që kanë pranë pse bëjnë tinguj kafshët.

Vini në dukje që ne jemi kafshë, ndaj nëse nuk janë të sigurt për majmunin, kërkojuni të mendohen pse ne bëjmë zhurma.

Përgjigje e mundshme: Për të komunikuar ose për të folur me njëri-tjetrin, sikundër edhe ne.

Çfarë mendoni se po thotë majmuni?

Nxitini përmes diskutimit të thonë se çfarë mund të jetë duke thënë majmuni. Ai duket i frikësuar ose i zemëruar, ndaj mund të jetë duke mbrojtur veten ose duke lajmëruar rrezik.

Përgjigje e mundshme: Largohu! Ndhmë!

Kë po thërret?

Nxënësit duhet të dallojnë se atë mund ta kuptojë vetëm një tjetër majmun, ndaj me gjasë ai po thërret një majmun tjetër. Ka mjaft përgjigje alternative për këtë; çështja në këtë fazë është që të jenë të vetëdijshëm se kafshët komunikojnë me njëra-tjetrën duke përdorur tinguj.

Përgjigje e mundshme: Majmunë të tjerë.

Fakt i çuditshëm

Referojuni faktit të çuditshëm. Nxënësit mund të mos e kuptojnë që sfungjeri i detit është një kafshë e gjallë. Pasi t'jua keni shpjeguar këtë, informojini se ai nuk lëshon tinguj për të komunikuar. Për ta zgjeruar të nxënët, mund t'u kërkonit nxënësve të mendojnë rreth faktit pse sfungjeri nuk nxjerr asnjë tingull. Për t'i mbështetur në këtë ide, bëni një kërkim se ku jetojnë sfungjerët në natyrë. Sfungjerët e detit janë gjallesa që ushqehen me ato që filtrojnë nga uji, që do të thotë se konsumojnë grimca organike dhe mikroorganizma që gjenden rreth tyre në det.

Mbështetje gjuhësore

Përdorni Renë e fjalëve në fillim të kapitullit për të diskutuar kuptimet e fjalëve kyçe. Nxënësit mund të fillojnë një "Mur fjalësh" për kapitullin (shiko faqen 7). Ndërsa shtjellojnë kapitullin, nxitini të plotësojnë fjalorin për t'u shkruar vetë në *Librin e nxënësit*, duke i lejuar të përcaktojnë termat kyçe me fjalët e tyre. Termi kyç "tingulli" përshkruhet dhe diskutohet gjerësisht në temat në vijim.

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Kërkojuni nxënësve të vizatojnë një sfungjer në mjedisin e tij. Për këtë do të duhet që t'u jepni fotografi të sfungjerëve në mjedisin e tyre.
- 2 Nëse ka një kopsht zoologjik ose një fermë kafshësh në zonën tuaj, organizoni një vizitë. Kjo është një mundësi e mirë për nxënësit që të vëzhgojnë kafshët dhe zhurmat e tyre.



Mos harroni t'u kërkonit leje prindërve dhe të ndiqni të gjitha procedurat e sigurisë që zbatohen kur i nxirrni fëmijët në udhëtime jashtëshkollore.

Të flasësh dhe të dëgjosh

Nxënësit identifikojnë burimet e shumta të tingullit.

Të flasësh dhe të dëgjosh

Ti emërtën disa burime tingujsh.

Ideja kryesore

Kafshët flasin me njëra-tjetrën.

☐ Sa tinguj mund të bësh me zërin tënd?
Ne jemi kafshë dhe shumica e kafshëve bëjnë tinguj.
☐ Shkruaj emrin e një kafshë që nuk lëshon tinguj për të komunikuar.

Shumica e kafshëve lëshojnë tinguj për të komunikuar me njëra-tjetrën.
☐ Pse flasim?
Flasim me njëri-tjetrin për të shkëmbyer ide.



Disa kafshë bëjnë zhurmë për të paralajmëruar se ka rrezik.



Disa kafshë bëjnë zhurmë për të trembur kafshët e tjera që mund t'i sulmojnë.

Njerëzit dhe disa kafshë mund të këndojnë.
☐ Pse këndojmë?
Zogjtë këndojnë për të komunikuar me njëri-tjetrin.
Njerëzit këndojnë për arsye të ndryshme.



Tinguj

Si të fillojmë

Kjo temë zbulon më tej idenë se kafshët dhe njerëzit komunikojnë. Nxënësit zbulojnë se si mund të flasim e të këndojmë, duke përdorur vetëm zërat tanë. Ata zbulojnë gjithashtu edhe tinguj të tjerë që mund t'i bëjmë me trupin tonë, si fishkëllima ose përplasja e duarve. Në fund nxënësit marrin pjesë në një lojë me pyetje-përgjigje për kafshët-tingujt. Qëllimi i gjithë këtyre veprimtarive është nxitja e nxënësve që të kuptojnë më shumë rreth burimeve të ndryshme të tingullit. Nxënësit zbulojnë më shumë rreth faktit pse kafshët lëshojnë tinguj (p.sh. për të komunikuar lumturinë, trishtimin, një burim ushqimi ose rrezikun). Nxënësit mund të reflektojnë se sa të ngjashme janë qëllimet e tingujve mes specieve të ndryshme, përfshirë edhe tonën.

Burime

Regjistrime të njerëzve që këndojnë dhe flasin; regjistrime të zhurmave të kafshëve; tinguj të përditshëm për t'u dalluar në lojën me pyetje-përgjigje mbi tingujt; veglat muzikore.

Fjalë kyçe

tingulli zëri

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të zbulojnë se si mund ta përdorin trupin për të

bërë tinguj të ndryshëm;

- të zbulojnë se si kafshët e tjera bëjnë tinguj dhe supozojnë pse i bëjnë këta tinguj.

Në temën që vijon, nxënësit do të mësojnë rreth mënyrës se si njerëzit e përdorin trupin e tyre për të bërë tinguj, të tillë si përplasja e duarve ose fishkëllima.



Sa tinguj mund të bëni thjesht me zërin tuaj?

Kërkojuni nxënësve të flasin për pyetjen në *Librin e nxënësit*. Nxitini nxënësit të ndahen në çifte dhe me radhë të nxjerrin tinguj me zërat e tyre. Diskutoni për tingujt që bën çdo çift dhe regjistroni në një tabelë në dërrasë.



Kjo është një mundësi e mirë për t'u kujtuar nxënësve se çfarë kanë mësuar në kapitujt e shkrimit e këndimit, p.sh. se secila shkronjë e alfabetit ka tingullin e saj ose se tingujt kombinojnë kur kombinohen shkronjat. Ftojini nxënësit të thonë se si tingëllojnë tingujt e buta e të forta, që mund t'i kujtojnë nga kapitulli i shkrimit e këndimit, p.sh. tingujt e butë "oo" dhe "ee".

Përgjigje e mundshme: Të kënduarit, të folurit, murmuritja, e qeshura, psherëtima, fishkëllima, kërcitja e gjuhës pas qiellzës.



Përmendni një kafshë që nuk lëshon tinguj për të komunikuar.

Kjo ka si qëllim t'u kujtojë nxënësve se çfarë kanë mësuar në temën hyrëse. Kërkojuni nxënësve ta shkruajnë përgjigjen në *Librin e nxënësit*.

Theksoni se shumica e kafshëve lëshojnë tinguj për të komunikuar. Gjithsesi, disa kafshë, si krimbat ose sfungjerët e detit, nuk komunikojnë kështu.

Përgjigje: Sfungjeri.



Pse flasim?

Kërkojuni nxënësve të diskutojnë pse flasim me njëri-tjetrin. Nxitini të përgjigjen se ne flasim për të ndarë idetë dhe për të ndihmuar me njëri-

tjetrin. Luajuni nxënësve regjistrime të njerëzve që këndojnë dhe flasin, qeshin dhe qajnë. Kërkojuni nxënësve:

- Ç'tinguj bëjnë familjarët tuaj me zërat e tyre?

Flisni për rastet kur nxënësit kalojnë kohë duke folur me familjen e tyre, p.sh. vaktet e drekës. Njerëzit janë të aftë të punojnë së bashku si skuadër, sepse ne flasim dhe kjo na bën të jemi shumë të suksesshëm.

Përgjigje e mundshme: Të komunikojnë me njëri-tjetrin.

Flisni për faktin se si disa kafshë bëjnë zhurma që të paralajmërojnë të tjerat nga rreziqet ose të frikësojnë kafshë të tjera, që mund t'i lëndojnë. Në këtë pikë luajuni regjistrimet dhe videot me zërat e kafshëve. Kërkojuni nxënësve të identifikojnë secilën kafshë dhe/ose të thonë se çfarë mendojnë se po komunikon kafsha.

Pse këndojmë?

Shpjegoni se njerëzit dhe kafshët e tjera mund edhe të këndojnë. Kërkojuni nxënësve të diskutojnë pse këndojmë. Fol rreth faktit se njerëzve u pëlqen të këndojnë ose të bëjnë "zhurma" muzikore me zërat e tyre. Theksoni që disa prej kafshëve, p.sh. zogjtë, këndojnë për të përçuar informacionin te shpendët e tjerë. Ata e përdorin të kënduarit ashtu si ne përdorim të folurën, pra si formë komunikimi. Si qenie njerëzore, ne këndojmë kur jemi të lumtur, të trishtuar ose kur dëgjojmë këngën tonë të preferuar. Kjo nuk është forma jonë kryesore e komunikimit, por është një mënyrë shumë e fuqishme e shprehjes së emocioneve.

Ndajeni klasën në dy grupe. Thojuni se do të zbulojnë se si të kënduarit dhe mbajtja e ritmit me trokitjen e duarve ndikon në "mesazhin" e këngës. Kërkojuni grupit të parë të nxënësve të këndojnë një këngë të zgjedhur prej jush (mundësisht një që ta dinë, njohin të gjithë nxënësit). Kërkojuni grupit të dytë të duartrokasë jo me ritmin e këngës. Ndërsa grupi i parë këndon, grupi tjetër përshpejton ritmin e këngës, duke përplasur duart

shpejt e më shpejt. Këngëtarët duhet të përpiqen t'i shkojnë pas ritmit. Në fund pyetini nxënësit se si i bëri të ndiheshin të kënduarit shpejt:

- Të kënduarit më shpejt i bëri të ndihen më të lumtur apo më të trishtuar? Rritja e tempit normalisht ka efekt për t'i bërë njerëzit më të lumtur.

Përgjigje e mundshme: Për kënaqësi.

Mbështetje gjuhësore

Filloni me Renë e fjalëve në faqen 66 të Librit të Nxënësit dhe krijoni një "Mur fjalësh" në klasë, që nxënësi t'i shohë fjalët kyçe shpesh dhe të familjarizohet me to. Aty ku mundeni, përdorni foto krah fjalëve të "Muri i fjalëve". Përfshini nxënësit në krijimin dhe në mbajtjen e tij.

Theksoni fjalët kyçe për bërjen e tingujve nëpërmjet zërit dhe tregoni shembuj të tyre. Kontrolloni që nxënësit të kuptojnë dallimin mes tyre, si p.sh.: e folura, e qeshura, e kënduara, trokitja e duarve dhe fishkëllima. Përshtatni tingujt e ndryshëm kur thoni fjalët.

Për të përforcuar familjaritetin me fjalët e reja, kërkojuni nxënësve të dëgjojnë, të thonë, të lexojnë dhe pastaj të shkruajnë fjalët.

Kërkojuni nxënësve të regjistrojnë përkufizimet për fjalët kyçe "tingull" dhe "zë".

Nxënësit mund të përdorin një regjistruer zëri për të bërë një kolonë zanore me njerëz dhe kafshë që këndojnë, flasin dhe bëjnë tinguj të tjerë me zërat e tyre.

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Nxënësit mund të bëjnë një vëzhgim mbi kafshët që i dëgjojnë të lëshojnë tinguj, si p.sh. në një park të zonës.
- 2 Kërkojuni nxënësve të bëjnë një vizatim të familjes së tyre që bisedojnë së bashku, me nga një flluskë dialogu ku janë fjalët e secilit person.

Të flasësh dhe të dëgjosh

Nxënësit identifikojnë burimet e shumta të tingullit.

Të flasësh dhe të dëgjosh

Ti emërtim disa burime tingujsh.

Ideja kryesore

Ne e përdorim trupin tonë për të bërë tinguj.

Ne bëjmë tinguj të ndryshëm me trupin tonë.

Çfarë po bën burri?

Si mendon, pse fshikëllejnë njerëzit?

Disa sportistë fshikëllejnë për të tërhequr vëmendjen e lojtarëve të tjerë.

Disa njerëz fshikëllejnë për argëtim.

Ata shprehin muzikën me fshikëllime.

Zbulo: Çfarë tingujsh mund të bësh?

1. Bëj shumë tinguj të ndryshëm me trupin tënd.
2. Përpiku të fshikëlle. Boshko buzët dhe pastaj fry lehtë.
3. Përplosi duart me njëra-tjetrën.

Përplosi fort dhe lehtë për të bërë tinguj të ndryshëm.

Çfarë ndodh kur i përplas duart fort?

Çfarë ndodh kur i përplas lehtë?

Përplasa e fortë nxjerr tingull të fortë.

Përplasa e lehtë nxjerr tingull të butë.

4. Dëgjo ritmin e përplasjes së duarve të mësuës.

A mund ta imitosh atë?

Ku mund ta përdorësh tingullin e përplasjes së duarve?

Gjeni se çfarë tingujsh lëshojnë këto kafshë.

Shkruaj tingujt poshtë secilës kafshë.

a. b. c. d.

Tingulli

Si të fillojmë

Në këtë temë nxënësit zbulojnë idenë se ne përdorim trupat tanë për të bërë tinguj. Ata diskutojnë mbi mënyra të tjera se si mund të komunikohet, përfshirë fshikëllima dhe përplasje të duarve. Ata mësojnë se tingujt nuk i bëjmë me zërat, por me trupat tanë. Më në fund, nxënësit marrin pjesë në një lojë pyetje-përgjigje me tingujt kafshësh.

Burime

Video e një publiku që duartroket në një shfaqje; lojë edukative me pyetje-përgjigje për tingujt kafshësh nga interneti (ose bëjeni vetë); regjistrime të tingujve të kafshëve; skeda didaktike me fotografi kafshësh dhe fjalë për tingujt që ata bëjnë.

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

shkruaj / vizato

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të zbulojnë se si mund ta përdorin trupin e tyre për të bërë tinguj të ndryshëm;
- të zbulojnë se si bëjnë tingujt kafshësh të tjera.

Në temën që vijon, nxënësit do të mësojnë rreth tingujve të ndryshëm, duke bërë një shëtitje për të dëgjuar (shëtitje dëgjimi).



Çfarë po bën burri?

Kërkojuni nxënësve të shikojnë fotografinë në

Librin e nxënësit. Vini në dukje se mund të bëjmë shumë tinguj me trupat tanë dhe fshikëllima është një ndër ta. Pastaj ata duhet t'i përgjigjen pyetjes në *Librin e nxënësit.*

Përgjigje: Po fshikëllen.



Si mendoni, pse fshikëllejnë njerëzit?

Bëni pyetje që t'i nxitni të përgjigjen se gruaja në fotografi është një sportiste. Shpjegoni se disa sportistë fshikëllejnë për t'iu tërhequr vëmendjen lojtarëve të tjerë. Njerëz të tjerë fshikëllejnë sepse është argëtuese.

Përgjigje e mundshme: për argëtim, për të tërhequr vëmendjen.



Zbulo: Çfarë tingujsh mund të bësh?

Synimi i kësaj veprimtarie është që nxënësit të zbulojnë tingujt e shumtë që qeniet njerëzore mund të nxjerrin përveç të folurit. Nxënësit do të praktikojnë aftësitë e të dëgjuarit të një sere tingujsh dhe do të flasin se si janë bërë tingujt.

1 Bëni tinguj të shumtë e të ndryshëm me trupin tuaj.

- Kërkojuni nxënësve të bëjnë tinguj me trupin e tyre sa më shumë që të munden. Thëksoni se do të diskutohen vetëm tingujt që dëgjohen.



Kërkojuni nxënësve të ndajnë emrat e tingujve që bëjnë. Nëse nuk i dinë emrat, kërkon t'ju demonstrojnë tingujt dhe pastaj thojnë emrin për secilin tingull dhe shkruajeni në dërrasë. Krijoni një listë klase me të gjithë tingujt, që nxënësit bëjnë me trupat e tyre.

2 Përpikuni të fshikëlleni. Mblidhni buzët bashkë dhe pastaj përpikuni të fryni lehtë. A mund të fshikëlleni një melodi?

- Shtroni pyetjen: *A mund të fshikëlleni?* Tregojuni nxënësve se si të fshikëllejnë. Kërkojuni të eksperimentojnë me fryrjen e ajrit më fort ose më lehtë, për të bërë tinguj të ndryshëm.
- Mbani parasysh se fshikëllima mund të jetë një detyrë e vështirë për t'u mësuar. Kërkojuni nxënësve ta provojnë vazhdimisht dhe se më shumë se sa fort duhet të fryjnë lehtë.

3 Përplasni duart.

- Tregojuni nxënësve pamjen në *Librin e nxënësit.* Nxitini të përgjigjen se ky person po troket duart së bashku (po duartroket) dhe se ky

është një tjetër tingull që ne mund ta bëjmë duke përdorur trupat tanë. Kërkojuni nxënësve të përplasnin duart.

- Në vijim kërkojuni nxënësve t'i përplasnin duart lehtë, pastaj edhe më fort. Diskutoni se çfarë i ndodh tingullit që ata bëjnë. Nxitini të përgjigjen vetë se përplasja e duarve më fort e bën zhurmën më të fortë. Çfarë ndodh kur i përplasni më fort?

Çfarë ndodh kur përplas duart fort?

Përgjigje e mundshme: Bëj një tingull të fortë.

Çfarë ndodh kur i përplas lehtë?

Përgjigje e mundshme: Bëj një tingull të butë.

- 4 Dëgjoni ritmin e përplasjes së duarve të mësuesit. A mund ta imitoni?
- Mbani një ritëm me duartrokitje dhe kërkojuni nxënësve ta kopjojnë.
 - Provoni disa ritme të ndryshme.
 - Kërkojuni nxënësve t'u përgjigjen pyetjeve vijuese në *Librin e nxënësit*.

Kur mund ta përdorësh tingullin e përplasjes së duarve?

Kërkojuni nxënësve të diskutojnë se kur mund ta përdorin përplasjen e duarve. Tregoju një video me njerëz që duartrokasën pas një shfaqjeje, në një sallë teatri ose koncerti.

Përgjigje e mundshme: Për të duartrokitur në fund të një koncerti ose kur diçka të bën të lumtur.

Gjeni se çfarë tingujsh lëshojnë këto kafshë.

Organizoni një lojë pyetje-përgjigje me tinguj kafshësh. Regjistroni tinguj nga televizori a radio ose përdorni një nga lojërat me pyetje-përgjigje që gjeni në internet. Kërkojuni nxënësve të dëgjojnë me kujdes tingujt e kafshëve dhe të përpiqen të hamendësojnë se ç'lloj kafshe është.

Kërkojuni nxënësve t'i regjistrojnë pyetjet në një tabelë si ajo më poshtë. Plotësojeni ju përgjigjen e parë për t'iu dhënë nxënësve një shembull.

Tingulli nr.	Kafsha
1	miu

2	macja
3	majmuni



Mund të nxirrni një listë me pamje kafshësh, për të ndihmuar në njohjen e kafshëve dhe gjuhën.

Pastaj kërkojuni nxënësve të thonë emrin e kafshës në pamjet e *Librit të Nxënësit* dhe të hamendësojnë se ç'tinguj bëjnë.

Përgjigjes: Jepni përgjigje si për veprimtarinë me shkrim që vjen pas.



Shkruajini tingujt këtu.

Kërkojuni nxënësve të shkruajnë tingujt e kafshëve në pamjet në *Librin e nxënësit*.



Sigurojuni mbështetje gjuhësore për emrat e tingujve të kafshëve: luani secilin tingull, pastaj thoni emrin e tingullit; shkruajeni në dërrasë dhe kërkojuni nxënësve ta përsëritin fjalën.

Përgjigje: a) Lehtë, b) Mjaullimë, c) Cijatje, d) Pëllitje.

Mbështetje gjuhësore

Shtoni fotografi të kafshëve në "Murin e fjalëve" për to. Nxënësit mund të shtojnë etiketa me emrin e secilës kafshë dhe me tingullin që ajo bën.

Luani një lojë me përkime, duke përdorur skadat didaktike me vizatime kafshësh në një rënë anë dhe me emrat e tyre në anën tjetër.

Përdoreni këtë mundësi për të përforcuar termin kyç të kërkimit shkencor "emërto". Bëni pyetje si: Ç'emër ka kjo kafshë? A mund ta emërtoni tingullin që bën?

Veprimtari më të zgjeruara

Për një veprimtari tjetër jepuni nxënësve këto udhëzime: A mund të dëgjoni tinguj pas vetes? Punoni me një shok ose shoqe. Qëndroni pa lëvizur me sy të mbyllur. Shoku ose shoqja juaj duhet të qëndrojë në pozicione të ndryshme rreth jush dhe të duartrokasë. A është tingulli i përplasjes së duarve i ngjashëm nga të gjitha pozicionet?

Të flasësh dhe të dëgjosh

Nxënësit identifikojnë burimet e shumta të tingullit.

Të flasësh dhe të dëgjosh

Ti emërtan disa burime tingujsh.

Ideja kryesore

Disa kafshë dëgjojnë më shumë tinguj se njerëzit.

Ne i dëgjojmë dhe i dallojmë shumë mirë tingujt.

☐ Renditni të gjithë tingujt që mund të dëgjosh tani.

Unë mund të dëgjoj _____

Ne mund ta matim sa i lartë është tingulli me anë të një mjeti të veçantë. Ai quhet nivel-matës i tingullit.

Si mendon?
Imagino sa shumë tinguj ka në gjithë botën.

Fakt i çuditshëm
Njerëzit mund të dëgjojnë vetëm disa tinguj. Fluturata e natës mund të dëgjojë shumë më tepër tinguj se ne.

Zbulo: Mat tingujt në shkollë.

1. Bëj një shëtitje dëgjimi rreth e qark shkollës. Parashiko se ku do ta zbulosh tingullin më të fortë.
2. Rëndor një nivel-matës të tingullit për të matur tingujt. Shkruaj rezultatet në një tabelë.

☐ A dëgjuan shokët e shoqet e tua ndonjë gjë që ti nuk dëgjoje?

☐ Sa tinguj dëgjoje ti?

Herë pas here ne bëjmë një tingull vetëm se na pëlqen.
Muzika i bën njerëzit të lumtur.
Atyre u pëlqen ta dëgjojnë atë.

☐ Sa instrumente muzikore njih?

☐ Çfarë tingujsh mund të bësh me trupin tënd?
Shkruaj katër prej tyre.

Tani shiko në faqen 80 për të kontrolluar se çfarë di.

Si të fillojmë

Në këtë temë, nxënësit zbulojnë larminë e pafundme të tingujve. Ata bëjnë një shëtitje për të dëgjuar dhe për të identifikuar tingujt e njohur. Ata do të zbulojnë se ka tinguj të ndryshëm dhe se sa prej tyre mund të pikasin. Pas zbulimit të tingujve të përditshëm, nxënësit diskutojnë sërish për muzikën, si një tingull që e bëjnë vetëm sepse na pëlqen. Tema mbyllet me një lojë pyetje-përgjigje për tinguj të ndryshëm nga jeta e përditshme.

Burime

Dërrasë për të mbërthyer letrat, stilolapsa dhe lapsa, pajisje regjistrimi, matës të nivelit të tingullit, një gamë instrumentesh muzikore; lojë pyetje-përgjigje për dëgjimin e tingujve të ndryshëm.

Fjalë kyçe

dëgjo

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

parashikoj

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të vlerësojnë se sa shumë tinguj të ndryshëm ka;
- të identifikojnë tingujt e përditshëm.

Në temën që vijon, nxënësit do të mësojnë se si tingujt sa më shumë largohen nga burimi, aq më shumë dobësohen.



Renditni të gjithë tingujt që mund të dëgjoni tani.

Shpjegoni se qeniet njerëzore janë shumë të afta të dëgjojnë dhe t'i vënë veshin një tingulli. Jemi kaq të mësuar me dëgjimin, sa mund të dallojmë me lehtësi tinguj të ndryshëm. Kërkojuni nxënësve t'ua vënë veshin të gjithë tingujve të ndryshëm që mund të dëgjojnë veç në klasë.



Mbështeteni veprimtarinë duke mbledhur përgjigjet e nxënësve në tabelë, që ata t'i kopjojnë në *Librin e nxënësit*.

Përgjigje e mundshme: Mund të dëgjoj kollitje, të folura, fëshfëritje letrash etj.

Fakt i çuditshëm

Referojuni faktit të çuditshëm. Paçka se dëgjimi ynë është i mrekullueshëm, disa kafshë, përfshirë edhe insekte, kanë dëgjim akoma më të mirë. Fluturat e natës mund të dëgjojnë një shtrirje (frekuencë) shumë më të gjerë tingujsh se sa njerëzit; ne mund të dëgjojmë vetëm tinguj që hyjnë në shtrirjen (frekuencën) e të folurit tonë. Pyesni nxënësit se pse mendojnë se ndodh kjo. Nxitini të përgjigjen se është e rëndësishme që të dëgjojmë atë çfarë po na thonë njerëzit e tjerë, pasi ne shpesh punojmë në grup.

Tregojuni nxënësve matësin e nivelit të tingujve, duke përdorur foton në *Librin e nxënësit* dhe nëse do të mundeni edhe një matës të vërtetë. Tregojuni si ta përdorin.



Zbulo: Matni tingujt në shkollë

Synimi i kësaj veprimtarie është zbulimi i tingujve të ndryshëm dhe matja e tyre. Kjo do t'i ndihmojë nxënësit të praktikojnë aftësitë shkencore të matjes dhe të regjistrimit të tingujve. Do t'ju duhen: Dërrasë për të mbërthyer letrat, pajisje regjistruese, si p.sh.: një regjistruer zëri, një matës i nivelit të tingujve.

1 Bëni një shëtitje dëgjimi rreth shkollës. Parashikoni se ku do të zbuloni tingullin më të lartë.

- Organizoni nxënësit që të bëjnë një shëtitje nëpër shkollë, me një pajisje regjistruese. Ata duhet të regjistrojnë tinguj të njohur që i dëgjojnë.



Sigurohuni të keni leje nga çdo njeri që regjistroni. Mund të duhet leja e prindërve për regjistrimin e zërave të nxënësve.

2 Përdorni një matës të nivelit të tingujve për të matur tingujt. Shkruajini rezultatet në një tabelë.

- Në këtë fazë, me gjasë do t'ju duhet të plotësoni tabelën si veprimtari klase dhe pastaj të tregoni rezultatet.

Vendi	Tingulli	Niveli i tingullit (dB)
1 Palestra	topi, përplasje, të folura, bilbili	85 dB



A dëgjoi njeri ndonjë gjë që ju nuk e dëgjuat?

Pas shëtitjes së dëgjimit, kërkojuni nxënësve të diskutojnë se sa tinguj dëgjuan. Kërkojuni të krahasojnë me të tjerët në grup larminë e tingujve që dëgjuan individualisht. Për këtë mund të punojnë në çifte ose në grupe të vogla. Nëse kanë dëgjuar me kujdes, mund të kenë dëgjuar insekte të gumëzhijnë, ndonjë sirenë ose telefon që bie diku larg.



Sa tingujt dëgjuat?

Nxisni garën mes nxënësve përmes diskutimit. Shkruani përgjigjet e tyre në dërrasë. Pasi të kenë rënë dakord për përgjigjet, kërkojuni t'i shkruajnë në *Librin e nxënësit*.



Sa instrumente muzikore njihni?

Paraqiteni sërish muzikën si tingull duke treguar disa vegla muzikore. Vërinë nxënësit t'u bien. Nxitini të përgjigjen se ka shumë instrumente të ndryshme, që nxjerrin tinguj të ndryshëm, si daullet. Sa më fort i godisni ato, aq më i lartë është tingulli.

Përgjigje e mundshme: Daulle, piano, kitarë, marakas (vegla të vogla perkusioni të Amerikës së Jugut që bëhen me kunguj të vegjël mbushur me guriçka ose fara, me bisht, që luhen duke u tundur etj.)

Thojuni nxënësve se do të bëjnë një lojë pyetje-përgjigje duke dëgjuar me kujdes, por këtë herë do të jenë të ndryshëm dhe jo vetëm kafshë. Kërkojuni të dëgjojnë tingujt në grupe të vogla për të parë se sa njohin. Çdo grup do të renditë tingujt. Ka shumë lojëra pyetje-përgjigje mbi tingujt në Internet ose

mund ta bëni vetë. Pyetini:

- Sa tinguj dëgjuat në lojën me pyetje-përgjigje?

Vlerësim formues

Përdorni detyrën e fundit të temës për të matur të kuptuarit dhe të nxënësve të kësaj teme. Jepuni nxënësve mundësinë ta plotësojnë detyrën në mënyrë të pavarur, për të matur të nxënës individual deri tani.

Çfarë tingujsh mund të bëni me trupin tuaj?

Shkruani katër tinguj.

Përgjigje e mundshme: Fishkëllimë, të kënduarit, të folurit, duartrokitje.

Shqyrto dhe reflekto

Përmbylleni temën duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë "Çfarë mësuam për tingujt" në faqen 80 të Librit të Nxënësit. (Shiko edhe shënimet e mësimdhënies në faqen 82).

Mbështetje gjuhësore

Vazhdoni të përdorni fjalorin në *Librin e nxënësit* dhe në "Murin e fjalëve" të klasës. Aty ku mundeni tregoni fjalë e fotografi. Bëni lojëra përkimi me fotografi dhe fjalë kyçe.

Veprimtari më të zgjeruara

3 Kërkojuni nxënësve të dëgjojnë tingujt e ndryshëm në shtëpi dhe shiko se sa mund të emërtojnë. Kërkojuni t'i regjistrojnë tingujt në një tabelë si kjo më poshtë.

Tingulli nr.	Tingulli
1	Zilja
2	



Si mendon? Pyetja e kësaj rubrike është hartuar për të zgjeruar të menduarin e nxënësve rreth larmisë së tingujve në botë. Prisni një përgjigje që shpjegon se: *ka një numër të pafundmë tingujsh.*

Tingujt dhe lëvizja

Nxënësit dallojnë se ndërsa tingulli largohet nga burimi, ai fillon dhe dobësohet.

Tingujt dhe lëvizja

Ti zbulon çfarë ndodh me tingujt, kur ne lëvizim.

Ideja kryesore

Tingujt ndryshojnë kur ne afrohem ose largohemi prej tyre.

Dëgjio mësuken, ndërkohë që largohet nga ti.

☐ Çfarë ndodh me tingullin, kur mësuja largohet nga ti?



A të kujtohet shëtitja e dëgjimit?
Duhej të dëgjohet me shumë kujdes. Që të kapje disa tinguj.



Kur ne largohemi nga vendi ku bëhet tingulli, ai dëgohet më i dobët.

Këtë mund ta zbulosh, duke luajtur një lojë.

Zbulo: Çfarë ndodh me tingujt kur largohemi prej tyre?



Parashiko se çfarë do të ndodhë me një tingull nëse largohesh nga ai.

1. Dini jasthë, në një vend të hapur.
2. Formoni një rreth me Dëgjuesin në qendër. Qëndroni sa më larg tij.
3. Ecnë në majë të gishtave drejt Dëgjuesit.

Dëgjuesi dëgjon me shumë kujdes.

Nëse dëgjon ndonjë tingull, ai duhet të kthehet menjëherë aty nga i vjen tingulli.

Nëse të shikon që je duke lëvizur, ti del jasthë lojës.

Kush e prek i pari Dëgjuesin, fiton lojën.

☐ Mat sa larg je kur të dëgjon Dëgjuesi.

☐ A lëvizte ndonjëri nga ju me më pak zhurmë se të tjerët? Pse?



Si të fillojmë

Në këtë temë, nxënësit zbulojnë mënyrën se si tingujt ndryshojnë me lëvizjen. Nxënësit luajnë një lojë dëgjimi, që tregon se teksa burimi i tingullit afrohet tingulli është më i lartë dhe teksa largohet ai dobësohet. Nxënësit matin distancën ku mund ta dëgjojnë tingullin, duke matur se sa larg janë kur dëgjojnë nxënësit e tjerë që lëvizin.

Burime

Letër, lapsa, stilolapsa, metër shirit ose metër shkop, tabakë letre ose kartoni.

Fjalë kyçe

i lartë

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

Parashikoj

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të zbulojnë se si tingulli bëhet më i dobët, ndërsa i largohet burimit;
- të krahasojnë se si kafshë të ndryshme mund të lëvizin pa u ndier.

Në temën që vijon, nxënësit do të mësojnë se si dëgjojmë kur tingulli hyn në vesh.



Çfarë ndodh me tingullin kur mësuesi largohet?

Rregullojini nxënësit në një kënd të qetë ose të rinë ulur nëpër tavolina. Kërkojini të mbyllin sytë dhe të dëgjojnë me kujdes. Mbathni këpucë që bëjnë zhurmë ose flituni nxënësve. Mund t'u lexoni një histori. Filloni duke qëndruar përballë tyre. Pastaj kthejuni kurrizin dhe largohuni ngadalë. Kërkojuni nxënësve të diskutojnë mbi çështjen.

Mund t'ju duhet ta përsërisni demonstrimin më shumë se një herë para se nxënësit të kuptojnë se çfarë po ndodh.

Përgjigje e mundshme: Tingulli bëhet më i dobët.



Për të përforsuar familjarizimin me fjalët e reja si "më i dobët", kërkojuni nxënësve të dëgjojnë, të thonë, të lexojnë dhe pastaj të shkruajnë fjalët.

Kërkojuni nxënësve të thonë, nëse u kujtohet, shëtitjen e dëgjimit nga tema e fundit. Kujtojuni se për të dëgjuar disa tinguj, atyre iu desh të dëgjonin me shumë kujdes. Vazhdoni duke shpjeguar se ndërsa largoheni nga vendi ku prodhohet tingulli, ai bëhet më i dobët dhe është më e vështirë ta dëgjosh. Theksoni se disa prej tingujve që dëgjojnë janë më të lartë dhe më të fortë se të tjerët.



Zbulo: Çfarë ndodh me tingujt kur ne largohemi prej tyre?

Synimi i kësaj veprimtarie është që nxënësit të zbulojnë se sa më shumë largohemi nga burimi, aq më tepër tingulli dobësohet dhe sa më shumë afrohem aq më i lartë është ai. Nxënësit do të praktikojnë aftësitë e të dëgjuarit dhe të të regjistruarit të zbulimeve të tyre.

Do t'ju duhet: një hapësirë e madhe e hapur.

Ne mund t'i hetojmë tingujt, duke luajtur një lojë dëgjimi. Përdorni një hapësirë sa më të madhe që të jetë e mundur. Informojini përdoruesit e tjerë mbi faktin se do ta përdorni hapësirën për një detyrë të dëgjuarit, ndaj kërkojuni të rrinë sa më qetë të jetë e mundur gjatë kësaj kohe. Kjo do të sigurojë se tingujt nuk do të ndoten ose që nxënësit nuk do të shpërqendrohen nga zhurma të tjera.

**Sigurohuni që zona të mos ketë trafik ose rreziqe të tjera.**

- 1 Dilni në hapësirë të hapur.
 - Zgjidhni një person të qëndrojnë me sytë e mbyllur. Ai është Dëgjuesi.
- 2 Krijoni një rreth rrotull Dëgjuesit. Qëndroni larg tij sa të jetë e mundur.
- 3 Ecni në majë të gishtave drejt Dëgjuesit.
 - Dëgjuesi duhet të dëgjojë me shumë kujdes, me sytë mbyllur ose të lidhur (mbani parasysh se nxënësve nuk u pëlqen t'u lidhin sytë. Nuk do të ketë problem nëse nuk ua lidhni, për sa kohë nuk përgjojnë fshehurazi). Nëse dëgjojnë një tingull, duhet të vërtiten në vend dhe të tregojnë se nga erdhi tingulli, duke i çelur sytë. Nëse shohin një nxënës duke lëvizur, atëherë ai nxënës digjet.
 - I pari që ia del të prekë personin në qendër, fiton lojën dhe bëhet Dëgjuesi i radhës. Loja fillon sërish.
 - Në fund të lojës, krahasoni se si kafshët gjurmojnë pre të tyre.

**Matni sa larg jeni kur Dëgjuesi ju dëgjon.**

Tregojuni nxënësve si të përdorin një metër shirit për të matur distancën midis Dëgjuesit dhe personit që u dëgjua. Regjistrojini rezultatet në një tabelë për gjithë klasën. Në fund të lojës shikoni rezultatet dhe vëreni se cili ishte tingulli më i largët që pikasi Dëgjuesi dhe cili ishte më i afërti.

**A lëviznin disa nga ju me më pak zhurmë se të tjerët? Pse?**

Pasi të keni luajtur lojën, diskutoni me nxënësit se si në fillim nuk u dogjën shumë prej tyre. Kjo ndodh sepse sa më larg të jesh, aq më i dobët është tingulli. Pastaj, sa më shumë i afrohen Dëgjuesit, aq më shumë veta digjen, sidomos nëse disa nxënës kanë këpucë më të rënda se të tjerët.

Kërkojuni nxënësve ta diskutojnë çështjen në *Librin e nxënësit*. Kërkojuni të kontrollojnë nëse këpucët e disa njerëzve bëjnë më shumë zhurmë se të tjerëve, duke parë këpucët e njëri-tjetrit. Kërkoni vullnetarë për të ecur përgjatë dhomës, ndërsa të tjerët dëgjojnë për të krahasuar zhurmat e bëra nga këpucët e tyre. Nxitini të përgjigjen se disa

këpucë bëjnë shumë zhurmë.

Përgjigje e mundshme: Disa këpucë bëjnë shumë zhurmë dhe disa këpucë më pak.

Mbështetje gjuhësore

Fjala "e butë" përdoret shpesh për të përshkruar tingullin. Kjo mund t'i ngatërrojë nxënësit, pasi mund ta lidhin këtë fjalë me materiale, për shembull me lodrat. Tingujt të lartë e të butë mund të luhen për të treguar të lartën e të butën. Përndryshe mund të përdorni zërin tuaj për ta bërë këtë. Nxënësit mund të përdorin një tabelë nga ato që fshihen ose një tabak letër, ku shkruhet "i fortë" në njërin anë dhe "i butë" në anën tjetër. Kur bëhet një tingull ata mund të zgjedhin "i fortë" ose "i butë" në tabelën ose në letrën e tyre.

Veprimtari më të zgjeruara

Luaj lojë dëgjimi duke përdorur lloje të ndryshme tingujsh, p.sh. zile ose përplasje duarsh, për të krahasuar distancat në të cilat dëgjohet tingulli.

Tingujt dhe lëvizja

Nxënësit dallojnë se ndërsa tingulli largohet nga burimi, ai fillon dhe zbehet.

Tingujt dhe lëvizja

Ti zbulon çfarë ndodh me tingujt kur ne lëvizim.

Ideja kryesore

Kafshët mund të afrohen pa zhurmë.

☐ Përfytyro sikur je në një pyll. Ti duhet t'i afroshes, po u ndier, një kafshë. Çfarë këpucësh duhet të veshësh?

Kafshët e egra kanë putra të buta. Kafshët që gjuajnë kanë putra shumë të buta! Kjo bën që ato t'u afrohen pa zhurmë kafshëve të tjera. Ato përdoren t'i afrohen sa më shumë një kafshë tjetër, para se ajo t'i dëgjojë. Tani si vepruat ju në lojën tuaj.



Hiena po i afrohet pa zhurmë presë së vet.

A dëgjoje sirenën e ndonjë makine urgjence kur bërë shëtitjen e dëgjimit?

☐ Cilat makina urgjence njih ti? A mund t'i emërosh ato?

☐ Si mendon? Si vjen tingulli nga makina e urgjencës deri te ne?

☐ Pse këto makina kanë nevojë për sirena?

Sirenat lajmërojnë njerëzit se mund të ketë rrezik. Gjithashtu, ato lajmërojnë njerëzit se ndihma është duke ardhur. Kur ka shumë trafik shoferët e tjerë dëgjojnë sirenën dhe hapin rrugën.

☐ Shkruaj dy arsye pse makinat e urgjencës kanë sirena.

Pse kafshët që gjuajnë i kanë putrat e buta?

Tani shiko në faqen 84 për të kontrolluar se çfarë di.



Tingujt

77

Si të fillojmë

Nxënësit zbulojnë mënyrën se si tingujt përdoren për të na paralajmëruar nga rreziku. Ata flasin për dallimet që kanë këmbët e një kafshe grabitqare dhe këmbët e presë dhe se si putrat e një kafshe grabitqare ndihmojnë në pakësimin e zhurmave që ajo bën kur gjuan. Nxënësit zbulojnë mënyrën se si njerëzit përdorin tingujt për të lajmëruar se po afrohet një makinë që ka një urgjencë.

Burime

Letra, lapsa, stilolapsa, fotografi makinash të urgjencës, video kafshësh grabitqare në natyrë.

Fjalë kyçe

e heshtur

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të zbulojnë putrat e kafshëve grabitqare dhe të presë;
- të skicojnë këmbën ideale për një kafshë grabitqare;
- të diskutojnë mbi automjetet që kanë sirena;
- të zbulojnë përdorimin e sirenavë të automjeteve.

Në temën që vijon, nxënësit do të krahasojnë tingujt kur dëgjojnë me njërin vesh e me të dy veshët dhe do të diskutojnë për sigurinë rrugore.

Përfytyroni sikur jeni në natyrë. Doni t'i afroheni vjedhurazi një kafshe. Ç'loj këpucësh vishni?

Bëni një krahasim mes këpucëve të ndryshme, mes këpucëve që veshin njerëzit dhe putrave të kafshëve. Kjo lidh temën e tingujve të kafshëve që kanë mësuar nxënësit më herët, me faktin se tingujt ndryshojnë me largimin nga burimi. Disa kafshë janë shumë të zonjat në ndjekje dhe disa nuk janë. Kjo lidhet pjesërisht me faktin se sa zhurmë bëjnë kur lëvizin, gjë që lidhet me madhësinë trupore dhe formën e putrës.

Kërkojuni nxënësve të diskutojnë më tej për pyetjen në *Librin e nxënësit*.

Përgjigje e mundshme: Papatçe.

Kërkojuni nxënësve të shikojnë foton me putrën e leopardit dhe të hienës që ndjek antilopën (lloji impala) në *Librin e nxënësit*. Nxitini të përgjigjen se kafshët e egra nuk mbajnë këpucë, pastaj shpjegojuni se kafshët që gjuajnë kanë këmbë që nuk bëjnë zhurmë. Theksoni se ç'formë ka putra apo këmba.

Shpjegoni se disa kafshë gjuetare (grabitqare) zakonisht kanë putra në këmbët e tyre, që të mund t'u afrohen vjedhurazi kafshëve të tjera. Theksojeni këtë duke u treguar imazhet e këmbëve të kafshëve. Shpjegoni se disa kafshë kanë thundra. Përdorni foto të thundrave për të treguar kuptimin e fjalës. Theksoni se kafshët me thundra zakonisht janë pre.



Shpjegoni se një kafshë grabitqare është një kafshë që gjurmon dhe ushqehet me kafshë të tjera. Ajo përpiket t'i afrohet sa më shumë që të mundet presë para se ajo ta dëgjojë, ashtu siç bëjnë nxënësit në lojë.

Shpjegoni se preja është e kundërta e kafshës grabitqare. Ato janë kafshë që gjurmohen si ushqim zakonisht nga kafshë më të mëdha ose më të fuqishme.

Kërkojuni nxënësve të diskutojnë:

Cilat janë ndryshimet mes putrave dhe thundrave?
Putrat janë të përkulshme, të buta dhe përshtaten

me sipërfaqen, pra nuk bëjnë zhurmë. Thundrat janë të forta dhe mund të vrapojnë shpejt, si mbi terren të fortë shkëmbor, ashtu edhe mbi sipërfaqe me bar, por ato nxjerrin më shumë tinguj.



Ç'automjete urgjence njihni? A mund t'i emërtoni?

Filloni duke u kërkuar nxënësve të renditin në *Librin e nxënësit* të gjitha automjetet e urgjencës që njohin.

Shpjegoni se sirenat lajmërojnë njerëzit se mund të ketë rrezik. Ato gjithashtu i njoftojnë njerëzit se po vijnë shërbimet e urgjencës. Në rrugët e zëna, shoferët e tjerë dëgjojnë sirenën dhe hapin rrugën.

Përgjigje e mundshme: Zjarrfikëse, makinë policie, ambulancë, automjet i ndihmës mjekësore.



Pse u duhen sirenat këtyre automjeteve?

Kërkojuni nxënësve të diskutojnë për pyetjen. Shpjegojuni se njerëzit nuk e kanë gjithmonë mendjen tek automjetet e urgjencës, prandaj jo gjithmonë mund ta pikasin kur vjen një prej tyre.

Kërkojuni nxënësve të diskutojnë arsye të tjera pse automjetet e urgjencës kanë sirena, si p.sh. për t'u treguar njerëzve se po vjen ndihmë ose për të paralajmëruar shoferë të tjerë a kalimtarë se duhet të largohen nga rruga.

Përgjigje e mundshme: Njerëzit gjithmonë mund ta dëgjojnë një automjet urgjence duke ardhur, edhe nëse nuk e shohin dot.

Vlerësim formues

Përdorni detyrën e fundit të temës, për të matur të nxënësit e nxënësve në këtë temë. Lejojini nxënësit të plotësojnë në mënyrë të pavarur *Librin e nxënësit*, për të matur të nxënësit individual.



Shkruani dy arsye pse automjetet e urgjencës kanë sirena.

Lexojeni me zë të lartë pyetjen për gjithë klasën. Kërkojuni nxënësve që në fillim ta diskutojnë me personin pranë tyre pyetjen. Pastaj kërkojuni ta shkruajnë përgjigjen në *Librin e nxënësit*.

Përgjigje e mundshme: Për të informuar njerëzit mbi rrezikun. Për të lajmëruar të tjerët në rrugë se po afrohet një automjet urgjence.

Pse kanë këmbë me putra kafshët gjuetare?

Bëni pyetje që u kujtojnë nxënësve të nxënësve të mëparshëm. Kërkoni që t'i kthehen dhe të shikojnë edhe një herë fotografinë e këmbëve në *Librin e nxënësit* dhe cilindo foto tjetër që mund të keni përdorur gjatë shpjegimit të mëparshëm. Jepuni nxënësve mundësinë ta diskutojnë pyetjen para se të shkruajnë përgjigjen në *Librin e nxënësit*.

Përgjigje: Që të mund të afrohen vjedhurazi te kafshët e tjera.

Çfarë kemi mësuar

Përmbylleni temën duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë "Çfarë kemi mësuar për tingujt" në faqen 81 të Librit të Nxënësit. (Shiko edhe shënimet e mësimdhënies në faqen 82).

Mbështetje gjuhësore

Shtoni foto të automjeteve të urgjencës në "Murin e fjalëve", me emrat nën to. Te fjalori për t'u shkruar vetë, sigurohuni që nxënësit të kenë shtuar përkufizimet për fjalët kyçe.

Veprimtari më të zgjeruara

1 Kërkojuni nxënësve të skicojnë këmbën e përkryer për një kafshë grabitqare dhe për një pre. Nëse keni kohë, ata mund ta bëjnë putrën me materiale të ndryshme, për të zbuluar nëse materialet sjellin ndryshim në tingujt që bëjnë këmbët. (Këtë mund ta lidhni me karakteristikat e materialeve që keni studiuar në kapitullin 2, Materialet). Ata mund të përpiqen të skicojnë një këmbë që mund të jetë e përshtatshme si për një kafshë grabitqare, ashtu edhe për një pre.



Si mendon? Përdoreni këtë detyrë për të zgjeruar të nxënësit mbi mënyrën se si udhëton tingulli. Prisni një përgjigje që shpjegon se: *tingulli udhëton në valë nga sirena drejt veshit tonë, prandaj e dëgjojmë sirenën.*

Krahasimi i tingujve



Nxënësit kuptojnë se ne dëgjojmë kur tingulli hyn në veshin tonë.

Përgjigje e mundshme: Ne përdorim veshët.

Krahasimi i tingujve
Ti kupton se tingulli i dëgjojmë me veshë.

Ideja kryesore
Ne i përdorim veshët për të dëgjuar tingujt.

☐ Si i dëgjojmë gjërat?
Cilën pjesë të trupit përdorim për të dëgjuar gjërat?
Tingulli vjen nga vendi ku është prodhuar deri në veshët tonë.
Ne dëgjojmë kur tingulli hyn në veshin tonë.
Ne kemi dy veshë që na ndihmojnë të dëgjojmë tingujt rreth nesh.



Fakt i çuditshëm
Vetëm insekti Mantis ka një vesh të vetëm.

☐ Zbulohet: A mund të dëgjosh vetëm me një vesh?
1. Ulu, qëndro në qetësi dhe mbyll sytë.
2. Mbuloni njërin vesh me dorë. Dëgjo.
3. Tani hiqe dorën nga veshi. Dëgjo përsëri.
☐ A mund të dëgjosh të njëjtën tinguj?
4. Mbuloni veshin tjetër dhe dëgjo.
☐ A janë dy veshë më mirë se një?
☐ A të ndihmojnë sytë të dëgjosh?
Sytë dhe veshët bashkëpunojnë për sigurinë tonë.
Përfytyro sikur je duke kaluar një rrugë plot me makina.
☐ Bëj një poster për sigurinë në rrugë.
Tregoj njëzetë si t'i përdorin sytë dhe veshët kur kalojnë rrugën.

☐ Si dëgjojmë ne? Rretho përgjigjet e tua.
Tingulli kalon nëpërmjet syve tanë. ☐ E vërtetë ☐ E pavërtetë
Me dy veshë dëgjojmë më mirë se me një. ☐ E vërtetë ☐ E pavërtetë
Sytë dhe veshët na ndihmojnë ta kalojmë rrugën të sigurt. ☐ E vërtetë ☐ E pavërtetë

Tani shiko në faqen 81 për të kontrolluar se çfarë di.

Shpjegoni se tingulli udhëton nga vendi ku prodhohet drejt veshëve tanë. Theksoni se ne dëgjojmë kur tingulli hyn brenda veshit tonë. Është veshi ai që na e mundëson dëgjimin. Ne kemi dy veshë që të mund të dëgjojmë tinguj rreth e rrotull vetes.

Fakt i çuditshëm

Referojuni faktit të çuditshëm. Diskutoni se si do të dëgjonim po të kishim vetëm një vesh, si insekti Mantis ose Murgesha (kandërr fluturuese që e ndryshon ngjyrën sipas mjedisit, me trup shumë të gjatë, me kokën trekëndëshe e shumë të lëvizshme, me sy të dalë, me dy palë krahë të hollë, me të cilët, duke i fërkuar, bën zhurmë).



Zbulohet: A mund të dëgjoni vetëm me një vesh?

Synimi i kësaj veprimtarie është t'u lejojë nxënësve të zbulojnë se si tingujt dëgjojnë ndryshe kur përdorin vetëm një vesh. Është e mundur të dëgjosh vetëm me një vesh, ashtu siç ndodh me insektin Mantis, por është më mirë t'i përdorësh të dy veshët.

Do t'ju duhet: një vend i qetë për t'u ulur.

1 Uluni, qëndroni në qetësi dhe mbyllni sytë.

- Organizojini nxënësit që të ulen në një vend të qetë, ku mund të jenë të sigurt po të rrinë me sy mbyllur për një copë herë.

2 Mbuloni njërin vesh me dorë. Dëgjo.

- Sigurohuni që të ketë tinguj për t'u dëgjuar nga nxënësit, p.sh. radio ose televizor ndezur diku në distancë. Mund ta caktoni vendin e dëgjimit pranë palestrës së fizikuturës, aty ku zhvillohet një orë muzike etj.
- Pyetini nxënësit se çfarë dëgjojnë. Bëni si klasë një listë me të gjithë tingujt. Pyetini nëse mund t'i dëgjojnë tingujt qartë në këtë pikë.

3 Tani hiqeni dorën nga veshi. Dëgjo sërish.

- Kërkojuni nxënësve t'i mbajnë sytë mbyllur dhe të dëgjojnë sërish.
- Pyetini nxënësit se si janë tingujt tani. Pyetini nëse kanë ndonjë ndryshim.



A mund të dëgjoni të njëjtën tinguj?

Kërkojuni nxënësve të hapin sytë dhe të diskutojnë si grup nëse mund të dëgjojnë me njërin vesh të gjithë tingujt që i dëgjonin me të dy.

Si të fillojmë

Në temën e fundit nxënësit zbulojnë mënyrën se si dëgjojmë tingujt. Ata mësojnë se tingulli udhëton nga një burim drejt veshit tonë. Në vijim ata bëjnë një hetim të vogël, për të zbuluar nëse dy veshë janë më mirë se një. Pastaj vazhdojnë të zbulojnë se si i përdorim sytë dhe veshët për të qenë të sigurt kur kalojmë rrugën dhe bëjnë poster për sigurinë rrugore.

Burime

Regjistrime muzike ose tingujsh specifike, materiale për poster, letra, shkumës me ngjyra, kufje të mëdha.

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të krahasojnë tingujt e dëgjuar me një vesh, pastaj me dy veshë;
- të diskutojnë sigurinë rrugore.

Në temën që vijon, nxënësit do të shqyrtojnë dhe do të mendojnë mbi atë që kanë mësuar në këtë kapitull.



Si i dëgjojmë gjërat? Cilën pjesë të trupit përdorim për t'i dëgjuar ato?

Kërkojuni nxënësve të diskutojnë në grupe prej tre ose katër vetash pyetjen:

- Si i dëgjon tingujt?
- Cila pjesë e trupit na mundëson të dëgjojmë gjërat?

Përgjigje e mundshme: Po, por mund të dëgjoj më qartë me dy veshë.

4 Mbulo veshin tjetër dhe dëgjo.

- Tani nxënësit mbulojnë veshin tjetër dhe dëgjojnë sërish. Kontrolloni me ta për të parë nëse rezultati është i njëjtë si në fillim.

A janë dy veshë më mirë se një?

Kërkojuni nxënësve të përdorin vrojtimitet e tyre për të diskutuar pyetjen.

Përgjigje e mundshme: Dëgjimi është shumë më i mirë me dy veshë. Ata mund të dëgjojnë më shumë përqark.

A ju ndihmojnë sytë të dëgjoni?

Kërkojuni nxënësve të hapin sytë dhe të dëgjojnë, për të parë nëse dëgjojnë më mirë me sy hapur. Ata duhet të përsërisin hapat 1-3 të veprimtarisë me sytë e hapur.

Vëri nxënësit ta diskutojnë pyetjen në çifte. Shpjegoni se sytë dhe veshët tanë bashkëpunojnë për të na ruajtur.

Përgjigje e mundshme: Po, sepse arrij ta shoh atë që dëgjoj, ndërsa vazhdoj ta dëgjoj.

Nxënësit tani marrin parasysh se si e përdorim ne dëgjimin për të qenë të sigurt. Ata e kanë zbuluar në temën e shqisave në kapitullin 1, *Vetja ime*. Kërkojuni nxënësve të mendojnë për kalimin e një rruge të zënë.

Kërkojuni klasës të aktrojë se si kalohet rruga. Jepuni role nxënësve, si p.sh.: kalimtarë, makina, autobusë, semaforë. Kërkojuni "trafikut" të bëjë zhurmat e përshtatshme dhe të ecin shpejt përgjatë "rrugës". Pyetini këmbësorët se çfarë duhet të bëjnë për ta kapërcyer rrugën pa u lënduar (p.sh. "të shikojë, të dëgjojë..."). Nxitini të përgjigjen se duhet të përdorin sytë për të parë trafikun dhe veshët për ta dëgjuar atë.

Kujtojuni nxënësve tingujt që dëgjuan në shëtitjen e dëgjimit. Disa tinguj (p.sh. sirenat) mund të kenë qenë larg, por dëgjoheshin qartë. Pyesni:

- Sa rëndësi duhet t'i jepni një tingulli larg?
Përgjigje e mundshme: Varet se sa shpejt tingulli bëhet më i lartë.



Bëni një poster sigurie rrugore. Thojuni njerëzve të përdorin sytë dhe veshët kur kalojnë rrugën.

Nxënësit mund të punojnë individualisht ose me grupe të vogla për posterat e tyre të sigurisë. Jepuni nxënësve plot materiale krijuese që të realizojnë postera.

Vlerësim formues

Kërkojuni nxënësve të plotësojnë detyrën e përfundimit të temës, për të matur të nxënët e tyre në këtë temë. Ata duhet ta plotësojnë këtë individualisht për të treguar sa e kanë kuptuar.



Si dëgjojmë? Rrethoni përgjigjet.

Kërkojuni nxënësve të rrethojnë përgjigjet e sakta për çdo pohim: e vërtetë ose false.

Përgjigje:

Tingulli kalon nëpërmjet syve tanë.	Fals
Me dy veshë dëgjojmë më mirë se me një.	E vërtetë
Përdorimi i syve dhe i veshëve na ndihmon ta kalojmë të sigurt rrugën.	E vërtetë

Shqyrto dhe reflekto

Përmbylleni temën duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë "Çfarë kemi mësuar për tingujt" në faqen 81 të Librit të Nxënësit. (Shikoni edhe shënimet e mësimdhënies në faqen 82).

Mbështetje gjuhësore

Kërkojuni nxënësve të plotësojnë fjalorin dhe "Murin e fjalëve". Të gjitha fjalët kyçe tani janë përdorur gjerësisht përgjatë kapitullit.

Veprimtari më të zgjeruara

Thojuni nxënësve se disa njerëz nuk arrijnë të dëgjojnë aq mirë sa të tjerët. Pyetini: *si mund t'i ndihmoni për të kaluar një rrugë të ngarkuar? Mendoni se ku duhet ta kalojnë dhe se çfarë duhet të kenë kujdes.*

Çfarë mësuam për tingujt

? Çfarë mësuam për tingujt

Të gjithë fëmijët duhet të kenë një ditë të paktën një orë të lirë për të bërë detyrat e tyre të mësuara.

Të flasësh dhe të dëgjosh

☑️ Koshfët lëshojnë tinguj për shumë arsye. Këtu tregohen disa prej tyre. A mund të plotësosh vendet boshe?





Të
për rezekun

Të
koshfët e tjera

Të
me njëjt-tjetrin

Tingujt dhe lëvizja

☑️ Ambulanca kanë sirena. Sirena e cilës ambulancë dëgjohet fort dhe e cilës dobet?




a.

b.

Kutia e fjalëve

komunikojnë trembën paralajmërojnë

☑️ Njerëzit dhe kafshët bëjnë tinguj. Kush tjetër bën tinguj? Shkruaj dy prej tyre.

Unë e di se ka shumë gjëra **që** bëjnë tinguj.

Krahasimi i tingujve

☑️ Cilat janë dy shqisat që përdorim më shumë kur kalojmë rugën? Shëno shqisat e sakta.



a. të na hutantur



b. të shijuarit



c. të dëgjuarit



d. të prekurit



e. të parit

Unë e di se në përdorim veshët për të dëgjuar tinguj.

Si të fillojmë

Qëllimi i këtij seksioni është që të nxisë nxënësit të shqyrtojnë të nxënëit e tyre pas çdo teme në kapitull. Çdo temë ka disa pyetje përforcuese që t'i përgjigjen nxënësit. Këto do të vlerësojnë njohuritë e nxënësve dhe të kuptuarin e tyre mbi temën.

Pas çdo serie pyetjesh përforcuese, ka një model “Shqyrto dhe reflekto” që nxënësit duhet t’i përgjigjen. Duhet të kaloni përmes modelit dhe t’i ndihmoni nxënësit të plotësojnë rrethin e vetë-shqyrtimit, për të parë se sa të sigurt janë mbi secilën temë. Në klasën e parë, nxënësit mund ta ngjyrosin, të vizatojnë një fytyrë të thjeshtë me shprehje emocionale ose të vënë një letër ngjyterë mbi të.

Është e rëndësishme që të merret informacion ku nuk ndihen të sigurt. Ky informacion është jetik për mësuesin, që të mund të përftojë korrigjimet e nevojshme në fund të kapitullit.

Përsëritje dhe reflektim

Të folurit dhe të dëgjuarit



Kafshët lëshojnë tinguj për shumë arsye. Ja disa prej tyre. Mund t'i plotësoni hapësirat boshe?

Kërkojuni nxënësve t'ju kujtojnë pse bëjnë tinguj kafshët dhe njerëzit. Nxënësit mund të përmendin: Përcjelljen e informacionit, paralajmërimin ndaj rrezikut, frikësimin e kafshëve të tjera. Ata mund të përmendin edhe të folurën: shpengojuni në terma të thjeshtë se e folura është një nivel i lartë komunikimi, që kufizohet te njerëzit. Aftësia për të folur na ndihmon të jemi kafshët më suksesshme mbi Tokë.

Kur nxënësit janë të sigurt për arsyet pse kafshët
lëshojnë tinguj, u kërkoni të plotësojnë hapësirat e
lëna bosh në *Librin e nxënësit*.

Përgjigje:

- 1 Për të **paralajmëruar** nga rreziku.
- 2 Për të **trembur** kafshët e tjera.
- 3 Për të **kommunikuar** me njëra-tjetrën.



Njerëzit dhe kafshët bëjnë tinguj. Cilët janë gjërat e tjera që bëjnë tinguj? Shkruani dy prej tyre.

Diskutoni dhe krahasoni tingujt e kafshëve me ato të prodhuar nga objekte të bëra nga njerëzit, si instrumentet muzikore, telefonat, televizorët, makineritë, sirenat etj.



Mund ta mbështesni këtë veprimtari, duke shkruar një listë me përgjigje të mundshme në dërrasë prej nga nxënësit mund të zgjedhin.

Përgjigje e mundshme: instrumente muzikore, sirena, telefona, kambana, sinjalizues etj.

Tingujt dhe lëvizja



Ambulancat kanë sirena. Sirena e cilës ambulancë dëgjohet më fort dhe e cilës më dobët?

Pyetini nxënësit se çfarë ndryshimi ka ta dëgjosh mësuesin kur je i ulur në fillim me kur je i ulur në fund të klasës. Thoni një fjali me zë të ulët dhe kërkojini nxënësit në fillim ta përsëritë çfarë thatë. Pastaj thoni një tjetër fjali me po të njëjtin volum dhe kërkojini një nxënësi në fund nëse mund ta përsërisë.

Theksoni se distanca nga veshi te burimi i tingullit ndikon mbi faktin se sa i fortë ose i dobët na duket tingulli. Burimi i tingullit mund të largohet nga nxënësi ose nxënësi mund të largohet nga tingulli. Përfundimi është i njëjti: tingulli bëhet më pak i dëgjueshëm, ndërsa largohet nga veshët.

Përqijqjes: a) / dobët, b) / fortë.

Krahasimi i tingujve



Cila nga shqisat është më e rëndësishme kur kalojmë rrugën? Shënjo shqisat e sakta.

Kërkojuni nxënësve të punojnë në çifte. Një nxënës duhet të mbulojë veshët me duar dhe tjetri duhet të pëshpëritë mbi to. Pyeteni:

- A e dëgjua se çfarë ju tha shoku? Jo.

Përforcojeni konceptin e tingullit që udhëton drejt veshëve tanë. Derisa ai hyn dhe regjistrohet në trurin tonë, ne nuk dëgjojmë asgjë.

Diskutoni me nxënësit shqisën e pabesueshme të të dëgjuarit që kemi. Për shembull, ne mund të dëgjojmë mijëra nota të ndryshme muzikore, tinguj të ndërlikur gjuhësorë etj. Luani shpejt muzikë dhe gjuhë të ndërlikuara, për të treguar se sa e pabesueshme është shqisa jonë e të dëgjuarit.

Përdorni skenarin e kalimit të rrugës, për të treguar se si veshët tanë kapin tingullin dhe drejtimin. Bëjuni pyetje që t'i nxitni të përgjigjen se pasja e një veshi në secilën anë të kokës na ndihmon të identifikojmë se nga vjen tingulli. Pastaj janë sytë tanë ata që lokalizojnë se çfarë e prodhon tingullin. Të dyja shqisat bashkëpunojnë ngushtë që të na mbrojnë nga rreziku.

Përgjigje: Nxënësit duhet të shënjojnë dëgjimin dhe shikimin.

Vlerësim përmbledhës

Modeli "Çfarë kemi mësuar..." në *Librin e nxënësit* janë një pikënisje e shkëlqyer, kur diskutohet për përparimin individual të secilit nxënës. Ky informacion mund të përdoret edhe për të krijuar raporte për secilin nxënës në përfundim të tremujorit.

Mund të jetë i nevojshëm edhe për të mbajtur një raport të përgjithshëm për nivelin e sigurisë së mbarë klasës, për të identifikuar zonat që më vonë mund të duan një rishikim (shiko një tabelë me shembuj më poshtë).

Detyra për "Çfarë mësuam për tingujt"	Shumë të sigurt	Jo edhe aq të sigurt	Të pasigurt

Ky raport më pas mund të përdoret për krijuar një program përplotësues, për t'i ndihmuar nxënësit të përmirësohen. Bëjini sa më thjeshta regjistrimet dhe analizat e vetëvlerësimit të nxënësve. Kërkohet vetëm një përshtypje e përgjithshme e vetëvlerësimit të klasës, jo të dhëna individuale të nxënësve, p.sh. 50% e klasës nuk ishin të sigurt për...

6 Rritja e bimëve

Në këtë kapitull, nxënësit:

- emërtojnë pjesët kryesore të një bime, duke vëzhguar bimë të vërteta dhe modele;
- zbulojnë se si farat mbijnë dhe shndërrohen në bimë që lulëzojnë;
- mësojnë se bimët duan dritë edhe ujë që të rriten.

6. Rritja e bimëve

Në këtë kapitull, ti:

- mëson si të emërtosh pjesët kryesore të një bime;
- zbulon se si farat mbijnë dhe bëhen bimë me lule;
- zbulon se bimët kanë nevojë për dritë dhe ujë që të rriten.

82



Rritja e bimëve

83

Si të fillojmë

Ky kapitull i njeh nxënësit me idenë se bimët janë gjallesa. Nxënësit do të rrisin filiza luledielli, majdanoz nga farat e majdanozit dhe do të vëzhgojnë bimë të vyshkura përballë bimëve të shëndetshme.

Këto veprimtari shpërndahen në tema të ndryshme, por ju mund t'i filloni kur ta shihni të volitshme. Ne ju nxitim që të punoni me temat në këtë kapitull sipas radhës që ju përshtatet më mirë me planifikimin mësimor tremujor.

Nxënësit mësojnë se bimët rriten dhe ndërsa rriten, edhe ndryshojnë. Ata bëhen të vetëdijshëm mbi ngjashmëritë dhe dallimet mes bimëve. Brenda kapitullit ka mundësi që të lidhen njohuritë e tyre mbi rritjen e bimëve me të kuptuarit shkencor. Prezantohen dhe demonstrohen ide se si t'i trajtojmë bimët gjatë rritjes dhe nxënësve u jepet mundësia që të rrisin luledielli, të cilat mund t'i marrin në shtëpi, për t'i rritur plotësisht.

Për ta dhënë këtë kapitull me sa më shumë rezultat, sugjerohet që të kontrolloni listën e burimeve për secilën temë, që të mund të bëni planifikim të hershëm, pasi shumica e veprimtarive kërkojnë parapërgatitje. Kapitulli lidhet me të ushqyerin e shëndetshëm dhe krijon bazat për të nxënësit në vitet pasuese.

Aftësi të nevojshme shkencore

Nxënësve u jepet mundësia t'u përgjigjen pyetjeve, duke mbledhur të dhëna përmes vëzhgimit. Ata do të kontribuojnë në diskutime dhe do të bëjnë hamendësime (parashikime) mbi dukurinë shkencore. Nxënësit do të mësojnë si të sugjerojnë ide, të ndjekin udhëzime dhe të regjistrojnë informacionin. Për më tepër, nxënësit do të krahasojnë të dhënat dhe do të shohin nëse parashikimet e tyre përkojnë me rezultatet. Nxënësit do t'i modelojnë dhe do t'i komunikojnë idetë e tyre, që të mund të ndajnë, të shpjegojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e të menduarit shkencor.

Fjalë kyçe

dritë farë gjethe kërcell lule rrënjë

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

testim (provë) me një ndryshore

Burime

Përzgjedhje frutash dhe perimesh të freskëta; fotografi frutash dhe perimesh.

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të njohin çfarë do të mësojnë në këtë kapitull;
- të dallojnë se shumë bimë na sigurojnë ushqim;
- të identifikojnë dhe të emërtojnë frutat dhe perimet e zakonshme.

Në mësimin që vijon, nxënësit do të mësojnë më shumë për emrat e pjesëve të një bime.

Faqet hyrëse janë modeluar që të entuziazmojnë dhe të përfshijnë nxënësit në përmbajtjen e kapitullit dhe për të nxitur të menduarin mbi bimët që rriten. Këto faqe mund të përdoren si një veprimtari e zgjeruar fillestare.

Thojuni nxënësve të shikojnë fotot dhe fjalët në faqet hyrëse. Kërkojuni të shikojnë Renë e fjalëve dhe tregojuni që do t'i mësojnë kuptimet e këtyre fjalëve, ndërsa studiojnë këtë kapitull. Shpjegoni rrugës objektivat, duke treguar gjithashtu se gjatë kapitullit ata do të mësojnë rreth bimëve që rriten. Thojuni nxënësve se shumë bimë i rrisim që të na sigurojnë ushqim.

Thuaj emrin e një perimeje. Thuaj emrin e një frute.

Kërkojuni nxënësve t'i shikojnë me kujdes fotografitë në faqet hyrëse dhe të thonë emrin e një frute ose perimeje.

Nga përgjigjet e dhëna prej nxënësve, përpiloni në dërrasë një listë frutash dhe perimesh. Përforconi idenë se të gjitha këto fruta dhe perime janë bimë.

Nëse nxënësit nuk i njohin emrat e frutave dhe të perimeve të përditshme, përdorni fotografitë në faqet hyrëse ose shembuj frutash dhe perimesh të freskëta. Tregoni me radhë secilën frutë ose perime, duke u thënë nxënësve emrin e tyre. Mund të zgjidhni edhe të bëni një vizatim të thjeshtë në dërrasë.

Pastaj kërkojuni nxënësve të emërtojnë secilën frutë ose perime, si veprimtari përforcuere. Një tjetër mundësi përforcuere është përdorimi i skedave didaktike me fotografi të frutave e të perimeve dhe kërkojuni nxënësve t'i emërtojnë ato.

Mbështetje gjuhësore

Një pikënisje me vlerë është Reja e fjalëve. Mund të diskutoni dhe të përcaktoni disa prej fjalëve që nuk janë të njohura për nxënësit. Mund të krijoni edhe një "Mur fjalësh" për kapitullin që nxënësit t'i shohin fjalët shpesh dhe të familjarizohen me to. *Libri i Nxënësit* ka një fjalor për t'u shkruar vetë, ku nxënësit rregullisht shtojnë përkufizime, ndërsa përparojnë në kapitull. Është me vlerë të fillojë të zhvillohet fjalori që nga tema e parë.


Për të përforcuar familjarizimin me fjalët e reja, kërkojuni nxënësve *t'i dëgjojnë, t'i thonë, t'i lexojnë* dhe *t'i shkruajnë* fjalët.

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Kërkojuni nxënësve të shikojnë fjalët në Renë e fjalëve dhe të identifikojnë ato që kanë përdorur në këtë temë.
- 2 Kërkojuni nxënësve të shkruajnë një përkufizim për disa nga këto fjalë në fjalorin e tyre. Fjalët kyçe për këtë kapitull janë: bimë, gjethe, kërcell, rrënjë, lule, farë, rrit, dritë, ujë.

Pjesët e një bime

Nxënësit emërtojnë pjesët kryesore të një bime, duke iu referuar bimëve të vërteta ose modeleve.



Si të fillojmë

Kjo temë merret me emërtimin e pjesëve kryesore të një bime: kërcelli, gjethet, lulja dhe rrënjët. Tema ngrihet mbi temën hyrëse, duke u dhënë nxënësve mundësinë të mendojnë se cilat pjesë të bimëve hanë kur hanë fruta e perime. Kjo temë u jep mundësinë të bëjnë lidhje me ushqyerjen e shëndetshme, kur diskutojnë bimët si ushqim.

Burime

Topa të vegjël, p.sh. topa tenisi; dërrasë për të mbërthyer letrat; tabelë rezultatesh; flamur ose banderolë jashtë. Lapsa me ngjyra - të verdhë, të gjelbër dhe kafe; materiale për të bërë modele ose postera të bimëve; bimë të çelura në një vazo (shkriftojeni dheun, që të mund t'u tregoni rrënjët nxënësve).

Fjalë kyçe

gjethja kërcelli lulja rrënja

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të emërtojnë pjesët kryesore të një bime;
- të ngjyrosin një vizatim duke treguar pjesët kryesore të bimës;
- të dallojnë se hamë shumë bimë;
- të dallojnë se cilat pjesë të bimës hamë, kur hamë një bimë të caktuar;

- të kuptojnë se ka disa bimë që nuk duhet t'i hamë kurrë, sepse na sëmurin (na helmojnë);

Në temën që vijon, nxënësit do të mësojnë më shumë rreth rritjes së bimëve.

Ngjyrosni bimën.

Kërkojuni nxënësve të shohin skicën e një bime. Vizatimin mund ta kopjoni edhe në dërrasë.

Kërkojuni nxënësve të mblidhen në qendër të klasës dhe pastaj tregojuni një bimë të vërtetë të lulëzuar në një vazo. Tregojuni rrënjët, kërcellin, gjethet dhe lulen e bimës.

Kërkojini një nxënësi të tregojë kërcellin në skicë, një tjetër të tregojë gjethen, një tjetër lulen dhe një tjetër rrënjët.

Thojuni nxënësve të ngjyrosin vizatimin e bimës duke përdorur ngjyrat e sugjeruara në *Librin e Nxënësit*.

Lidhni fjalët me figurat.

Thojuni nxënësve se ne mund të hamë pjesë të bimëve. Pastaj kërkojuni atyre të shikojnë figurat në *Librin e Nxënësit*.

Bëjuni pyetjet:

- Kur hamë sallatë, cilën pjesë të bimës mendoni se hamë? *Gjethet*.
- Kur hamë karota, cilën pjesë të bimës mendoni se hamë? *Rrënjët*.
- Kur hamë selino, cilën pjesë të bimës mendoni se hamë? *Kërcellin*.
- Ne e përdorim shafëranin për t'i dhënë aromë gatimit. Cilën pjesë të bimës mendoni se hamë? *Pjesë të lules*.

Pastaj kërkojuni nxënësve t'i kthehen Librit të Nxënësit dhe të heqin vija, duke lidhur fjalët me figurat, për të përfunduar fjalitë.

Përgjigje: Kur hamë sallatë, ne po hamë *gjethet*.

Kur hamë karota, ne po hamë *rrënjët*.

Kur hamë selino, ne po hamë *kërcellin*.

Kur hamë shafëran, ne po hamë *pjesë të lules*.

Nxitini të përgjigjen mbi lidhjen që ka mes të ngrënit shumë fruta e perime dhe ushqimit të shëndetshëm. Deklaroni se frutat dhe perimet na bëjnë mirë dhe duhet të hamë mundësisht pesë

racione fruta dhe perime në ditë. Folu mbi faktin se ç'do të thotë një dietë e shëndetshme.

Shpjego me fjalë të thjeshta se frutat krijohen kur lulja e ndal lulëzimin.

 **Disa bimë mund të na sëmurin (helmojnë) keq. Ato nuk duhen ngrënë.**

 **Shpjegojuni nxënësve se ka disa bimë që nuk duhet t'i hamë kurrë, sepse do të na sëmurnin (helmonin). Këtu mund të përmendni sipas dëshirës disa bimë me kokrra helmuese, si paralajmërim për nxënësit që të mos hanë bimë që nuk i njohin.**

Shpjegojuni nxënësve se duhet të hanë vetëm bimë që i njohin ose që ua japin për të ngrënë. Nuk duhet të mbledhin kurrë e të hanë kokrra ose lule që nuk i njohin.

Vlerësim formues

 **E vërtetë apo e pavërtetë? Rrethoju përgjigjet.**

Vlerësimi formues për këtë temë është një veprimtari e thjeshtë, e vërtetë/e pavërtetë.

 Për të mbështetur zhvillimin gjuhësor mund të zgjidhni të lexoni me zë të lartë vlerësimet. Kërkoni që të ngrenë dorën nxënësit që mendojnë se vlerësimi është i vërtetë, pastaj kërkoni që të ngrenë dorën ata që mendojnë se është i pavërtetë.

Kërkojuni nxënësve të rrethojnë përgjigjen e saktë në *Librin e Nxënësit*.

Përgjigje:

- | | |
|-----------------------------------|--------------------|
| 1 Disa bimë hahen. | E vërtetë |
| 2 Të gjitha bimët kanë rrënjë. | E vërtetë |
| 3 Kur hamë karota, po hamë lulen. | E pavërtetë |

Shqyrto dhe reflekto

Përmbylleni temën duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë "Çfarë kemi mësuar..." në faqen 98 *Librin e Nxënësit*. (Shiko edhe shënimet e mësimdhënies në faqen 100).

Mbështetje gjuhësore

Sugjerimet për mbështetjen gjuhësore janë futur brenda hapave të mësimdhënies. Për të ndihmuar më tej zhvillimin gjuhësor, sipas dëshirës, mund të krijoni dhe një seri skedash didaktike për emrat e pjesëve kryesore të disa prej frutave dhe të perimeve.

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Mund t'u kërkonit nxënësve të bëjnë modele ose postera që tregojnë një bimë dhe pjesët kryesore të saj.
- 2 Ju mund t'u kërkonit nxënësve të flasin për frutat dhe perimet që hanë dhe gjithashtu t'i pyesni se nga cila pjesë e bimës mendojnë se vjen pjesa që hahet.

Rritja e bimëve

Nxënësit zbulojnë se si farat mbijnë dhe shndërrohen në një bimë të lulëzuar.

Rritja e bimëve

Ti zbulon se si farat mbijnë dhe bëhen bimë me lule.

Ideja kryesore

Ne i ndihmojmë farat që të rriten.

Vështro këto figura.

25 cm

4 m

Filiza e lulëdiellit.

Një lulëdiell e mitur plotësisht.

☐ Çfarë vë re te këto dy bimë?

☒ Sa e lartë është bima më e vogël?

☒ Sa e lartë është bima më e madhe?

Bimët në figura janë lulëdiell.
Lulëdiellit bëhen shumë të larta. Ato rriten prej farave, të cilat duken si në figurë.

Zbulo: Si të rritësh një lulëdiell.

1. Merr një vazo. Vendosi ca guralecë në fund të vazos.
2. Mbush vazën me përzierje dhe me pleh.
3. Mbili dy fara lulëdielli. Hidhi pak ujë.
4. Kontrolllo vazën çdo ditë.

Mbas 3-8 ditësh do të shikosh diçka që po rritet.

☒ Mbas sa ditësh dalën filizat?

☐ Si do të kujdesesh për filizat?

Si të fillojmë

Kjo temë merret me rritjen e bimëve dhe kërkon pak përgatitje paraprake. Sigurohuni të keni burimet e nevojshme, për ta shpjeguar temën me sa më shumë rezultat. Ajo u jep mundësinë nxënësve të rrisin bimët e tyre. Nëse është e mundur përdorni fara lulëdielli trupshkurtër, pasi lulëdiellit e mëdha mund të zmadhohen shumë. Tema i shtyn nxënësit të kujdesen për bimët që po rrisin dhe të zhvillojnë një ndjenjë përkujdesjeje për gjallesat. Nxënësit mësojnë se farat bëhen bimë që rriten dhe kanë mundësinë të matin lartësinë e bimëve.

Burime

Fara lulëdielli; vazo lulesh; guriçka ose zhavorr për kullim; përzierje dheu me pleh; ujë; spatul; mundësi për të larë duart, materiale krijuese.

Përgatisni paraprakisht disa filiza, për të zëvendësuar ndonjë që nuk arrin të rritet.

Fjalë kyçe

dritë farë

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të matin lartësinë e bimëve të lulëdiellit që tregohen në *Librin e Nxënësit*;

- të mbjellin fara lulëdielli;
- të ndjekin udhëzimet kur kryejnë hetime;
- të ndajnë burimet me nxënës të tjerë;
- të njohin se bimët rriten kur mbjellim fara.

Në vijim, nxënësit do të mësojnë më shumë mbi rritjen e bimëve.



Çfarë vini re te këto dy bimë?

Kërkojuni nxënësve të shikojnë dy pamjet e lulëdiellit në *Librin e Nxënësit*. Filloni një diskutim mbi ndryshimet mes dy bimëve. Shpjegoni se janë i njëjti lloj bime: një lulëdiell, por njëra është më e lartë se tjetra.

Pyetini nxënësit:

- Sipas tyre pse njëra bimë është më e lartë se tjetra?

Përgjigje e mundshme: Njëra është rritur më shumë se tjetra. Njëra është bimë e rritur, tjetra është filiz (bimë "foshnjë").

Udhëzojini nxënësit të shikojnë vizoren dhe shiritin matës pranë dy bimëve. Bëj pyetjet për matjet.



Sa e lartë është bima më e vogël?

Përgjigja: 25 centimetra.

Sa e lartë është bima më e madhe (më e lartë)?

Përgjigja: 4 metra.

Kërkoni nga nxënësit të shikojnë fotot e farave të lulëdiellit në libër, pastaj tregojuni farat e vërteta. Shpjegojuni se lulëdiellit që shohin në *Librin e Nxënësit* janë rritur nga fara të ngjashme me ato që po u tregoni.



Zbulo: Si të rrisim lulëdielli?

Synimi i kësaj veprimtarie është që nxënësit të marrin njohuri vetë mbi bimët që rriten nga farat. Ata duhet të mësojnë edhe se duhet të kujdesemi që farat të rriten.

Do t'ju duhen: fara lulëdielli, vazo lulesh, guriçka, përzierje dheu me pleh, ujë.

Pyetini nxënësit:

- Çfarë mendoni se do të ndodhë kur të mbillni këto fara? *Do të mbijnë (e do të shndërrohen në bimë).*

Tregojuni se si t'i mbjellin farat e lulediellit. Ndërsa ua tregoni, shpjegojuni çdo hap.

1 Merrni një vazo. Vini guriçka në fund të vazos.

- Shpjegojuni se po vini guriçka në fund të vazos, që bima të mos ketë shumë ujë. Vini në dukje se bimëve u duhet vetëm sasia e duhur e ujit: as shumë e as pak.

2 Mbusheni vazon me përzierje dheu me pleh.

- Thojuni nxënësve të lënë rreth 2.5 centimetra mes nivelit të dheut dhe buzëve të vazos së bimës.

3 Mbillni dy fara luledielli. Hidhni pak ujë.

- Sigurohuni që nxënësit t'i shtyjnë farat në një thellësi rreth 2.5 centimetra (gjatësia e gishtit të madh të dorës së një nxënësit).
- Tregojuni si t'i hedhin përzierjes së dheut me pleh sasinë e duhur të ujit.
- Udhëzoni nxënësit t'i vënë vazot me lule në një vend të përshtatshëm për rritjen e farave. Përpikuni të shmangni dritën e drejtpërdrejtë të diellit, nëse mundeni.



Sigurohuni që nxënësit të lajnë duart pasi të kenë mbjellë farat.

4 Kontrolloni vazon çdo ditë.

- Kujtojeni nxënësve se duhet të kontrollojnë vazon përditë, që të sigurohen se përzierja e dheut me pleh është ende e njomësht. Thojuni atyre se pas 3-8 ditësh duhet të shohin diçka të rritet.
- Është e këshillueshme që të keni përgatitur disa filiza, në mënyrë që nëse farat e nxënësve nuk arrijnë të rriten, të mund t'ju jepni një mundësi tjetër për vëzhgim.



Pas sa ditësh dolën filizat?

Krijoni lehtësira që nxënësit të mund t'i kontrollojnë filizat çdo ditë dhe të mbajnë shënim atë që shohin. Për shembull, nxënësit mund të vënë një etiketë me emrin e tyre në vazon e vet, duke lënë vend ku të shënojnë ditën kur kanë kontrolluar bimën. Ju mund t'i numëroni shenjat kur të shfaqet filizi dhe të shkruani përgjigjen e pyetjes në *Librin e nxënësit*.



Si do të kujdeseni për filizat?

Diskutojeni pyetjen dhe nxitini të përgjigjen.

Lëvdoini nxënësit për punën dhe tregojuni se çfarë duhet të bëjnë paskëtaj.

Kur bimët të kenë mbirë, kërkojuni nxënësve t'a heqin dhe ta hedhin filizin më të vogël.

Shpjegojuni se duhet të rrisni vetëm më të fortat.

Nxitini të përgjigjen se duhet ta largojnë filizin më të vogël, që t'i japin hapësirë filizit tjetër të rritet.

Mbështetje gjuhësore

Në këtë temë janë përdorur shumica e fjalëve kyçe. Lejojuni nxënësve të përdorin fjalorin për të shkruar përkufizimet e disa prej fjalëve. Kjo është një temë aktive, ndaj nxënësit do të mund t'i shohin forcat në veprim. Etiketimi i veprimtarive si "shtytje" ose "tërheqje" do ta përforcojë më tej kuptimin e këtyre forcave.

Sigurohuni që nxënësit ta kuptojnë idenë e më të madhes (më të lartës) dhe më të voglës, duke i kërkuar një nxënësi që vullnetarisht të rrijë krah jush, duke u shpjeguar që ju jeni më i madh (më i lartë) dhe nxënësi është më i vogël dhe arsyeja pse ndodh kështu është ngaqë ju keni pasur më shumë kohë të rriteni. Kjo lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me konceptin e më të madhit (më të lartit) dhe më të voglit në veprimtarinë hyrëse.

Mbështetje gjuhësore zhvillohet më tej, duke treguar objekte dhe duke i emërtuar ato ndërsa i përdorni, si p.sh.: *po përdor një spatul (duke treguar spatulën), për të vendosur përzierjen e dheut (tregoni përzierjen e dheut me plehun) në vazon e bimës (tregoni vazon e bimës).*

Veprimtari më të zgjeruara

- 1** Kërkojuni nxënësve t'i regjistrojnë parashikimet e tyre, duke vizatuar një pamje para dhe pas hetimit tuaj.
- 2** Siguroni skica të pamjes së lulediellit, që t'i ngjyrosin nxënësit.

Rritja e bimëve

Nxënësit zbulojnë se si farat mbijnë dhe shndërrohen në një bimë të lulëzuar.

Rritja e bimëve

Ti zbulon se si mbijnë farat dhe bëhen bimë me lule.

Ideja kryesore

Ne nuk mund ta shohim rritjen e bimëve.

Shiko figurat.

Çfarë mendon se do të ndodhë nëse i mbjellim këto fara?

Emërto dy fara që mund të hahen.

Ne nuk mund ta shohim rritjen e bimëve, pasi ajo ndodh ngadalë. Ne e kuptojmë që bimët rriten, kur matim lartësinë e tyre.

Përdor figurën e vizores. Mat lartësitë e bimëve.

Sa e lartë është bima më e madhe?

Sa e lartë është bima në mes?

Sa e lartë është bima më e vogël?

10 cm

Ngjyros bimët.

Si të fillojmë

Kjo temë është një teori dhe zbatim i kapitullit të aftësive dhe kërkon pak ose aspak planifikim paraprak. Qëllimi kryesor i temës është të zbulojë se si farat mbijnë dhe rriten në bimë që lulëzojnë. Nxënësit mësojnë se nuk mund ta shohim rritjen ndërsa ndodh, ndaj na duhet të mbështetemi në vërtetim pamor dhe matje, për të përfutur informacion mbi rritjen e bimëve. Aftësitë që zhvillohen janë parashikimi (hamendësimi), matja, vërtetimi pamor dhe diskutimi (fol/thuaj). Nxënësit kanë mundësinë të krahasojnë lartësitë e bimëve, ndërsa rriten ose ndryshojnë përgjatë ciklit të jetës; kjo arrihet duke përdorur ilustrimet në *Librin e nxënësit*.

Burime

Vizore ose metër shirit për të matur lartësinë; lapsa me ngjyra (të kuqe dhe të gjelbër për të ngjyrosur bimët e domateve; mundësisht edhe ngjyra të tjera për veprimtaritë e zgjeruara).

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të dallojnë që bimët rriten;
- të kuptojnë që ne nuk i shohim dot bimët ndërsa rriten;
- të matin dhe të krahasojnë lartësinë e bimëve në faza të ndryshme të jetës;
- të matin lartësitë e bimëve të ndryshme;

- të ndajnë informacionet me nxënës të tjerë.

Në temën që vijon, nxënësit do të mësojnë më shumë rreth faktit se bimëve u duhet dritë që të rriten.



Çfarë mendoni se do të ndodhë, nëse i mbjellim këto fara?

Kërkojuni nxënësve të shikojnë fotot e farave në *Librin e nxënësit*. Filloni një diskutim mbi atë që nxënësit mendojnë se do të ndodhë nëse farat mbillen. Pyetini nxënësit nëse ata vetë ose dikush që njohin ka rritur ndonjëherë fara dhe kërkojuni t'ju thonë se çfarë ndodhi. Udhëzojini t'i shkruajnë përgjigjet në *Librin e nxënësit*.

Përgjigje e mundshme: Do të mbijnë.



Emërtoni dy fara që mund të hahen.

Kërkojuni nxënësve nëse njohin ndonjë prej farave të treguara në figurë. Pastaj bëjuni pyetjen:

- E dinin emrin e ndonjë prej farave të ngrënëshme në figurë?



Shkruani emrat e farave në dërrasë dhe kërkojuni nxënësve të vizatojnë pamjet e farave e të kopjojnë emrat e tyre pranë vizatimeve dhe t'ia shtojnë "Murit të fjalëve" të klasës.

Përgjigje e mundshme: Arrë kokos, kikirikë, bizele etj.

Shpjegojuni nxënësve se nuk mund t'i shohim bimët duke u rritur, pasi ato rriten ngadalë, ndaj e vetmja mënyrë për të kuptuar se rriten, është t'i matin ato. Kërkojuni nxënësve të kontrollojnë lulëdiellit e tyre për të parë nëse kanë ndonjë shenjë rritjeje (shikoni temën paraprake). Tashmë, farat e lulëdiellit të nxënësve duhet të kenë mbirë dhe nxënësit duhet të shohin shenjat e para të sythave që po zhvillohen. Nxitini nxënësit të flasin për zbulimet e tyre.



Përdorni skicën e vizores. Matni lartësitë e bimëve.

Kjo është një veprimtari matëse që përdor skicat në *Librin e nxënësit*. Kërkojuni nxënësve të shikojnë vizatimet e bimëve të domates. Tregoni skicën e vizores në krah të bimëve dhe pastaj pyetini.

Sa e lartë është bima më e vogël?**Përgjigjja: 10 centimetra.****Sa e lartë është bima më e madhe?****Përgjigjja: 50 centimetra.****Sa e lartë është bima në mes?****Përgjigjja: 25 centimetra.**

Do të duhet t'u shpjegoni se skica nuk tregon masa të vërteta, pasi libri nuk është aq i madh sa të tregojë 50 centimetra. Shpjegojuni se përmasat reale janë zvogëluar që ato të mund të zënë vend në faqe.

**Ngjyrosni bimët.**

Kërkojuni nxënësve të ngjyrosin skicat e bimëve në *Librin e nxënësit*. Nxitini fëmijët të përdorin të kuqen për domatet dhe të gjelbrën për kërcejtë, që të krijojnë një ilustrim sa më të saktë të një bime domateje.

Mbështetje gjuhësore

Binduni që nxënësit ndihen të sigurt me gjuhën që përdorin në këtë temë. Për shembull, mund të përdorni skeda didaktike për fjalët që nuk i njohin ose mund t'i shtoni ato në "Murin e fjalëve" të klasës, në mënyrë që nxënësit t'i shohin fotot rregullisht dhe të jenë në gjendje t'i përdorin në bisedë.

Mund të krijoni edhe dy palë skeda: një me fjalë dhe një me ilustrime. Kërkojuni nxënësve që të lidhin secilën fjalë me pamjen përkatëse, p.sh.: imazhin e një vizoreje në një skedë dhe fjalën "vizore" në një tjetër.

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Kërkojuni nxënësve të kontrollojnë fjalorin "për t'u shkruar" dhe të shtojnë përkufizimet që nuk i kanë deri tani. Mund t'i udhëzoni drejt përkufizimeve të sakta duke përdorur skedat përkuese, ashtu siç përshkruhet në seksionin e Mbështetjes gjuhësore.
- 2 Nxënësit mund të krijojnë një poster ku të tregojnë se si bimët rriten nga fara. Ata mund të përdorin shembullin e një bime domateje, për të vizatuar një farë dhe pastaj lartësi të ndryshme të bimës ndërsa rritet.

Nëse dëshironi, mund t'i nxisni nxënësit të zgjedhin një bimë tjetër, që e njohin më mirë, p.sh.: disa nxënës mund të zgjedhin të vizatojnë një lulëdielli, duke filluar me vizatimin e farave, pastaj të filizit, pastaj një bimë të rritur pjesërisht dhe më në fund një vizatim të një lulëdielli me lartësinë e saj të plotë, me një lule.

Rritja e bimëve

Nxënësit zbulojnë se si farat mbijnë, rriten dhe shndërrohen në një bimë të lulëzuar.

Rritja e bimëve

Ti zbulon se si mbijnë farat dhe bëhen bimë me lule.

Ideja kryesore

Në shkencë, ne i matim dhe i regjistrojmë gjërat.

Plotëso me fjalët që mungojnë. Përdor kutinë e fjalëve.

Ne nuk mund ta shohim f r i t i j e n e bimëve.

Bimët rriten shumë _____.

Ne e dimë që bimët rriten, sepse mund t'i _____.

Kutia e fjalëve

rritjen matim ngadalë

Matja e bimëve

Mat me centimetra lartësinë e katër bimëve. Regjistro matjet e tua në tabelë.

Lartësia	30 cm	25 cm	20 cm	15 cm	10 cm	5 cm	0 cm
	1	2	3	4			

Shkencëtarët nuk bëjnë vetëm matje dhe regjistrim të gjërave. Rretho fjalët shkencore.

vazo emërtoja
krahasoj pica
makinë kafe

Si mendon?
Cila mund të jetë bima më e lartë në botë?

Si të fillojmë

Qëllimi kryesor në këtë temë është që nxënësit të praktikojnë matjen e bimës me saktësi, duke përdorur vrojtimin dhe matjet për të siguruar informacion mbi rritjen e bimës. Tema jep mundësi të rëndësishme për të zhvilluar aftësitë matëse dhe do të përforcohet edhe më shumë nëse nxënësit do të mund të përdorin një ambient të hapur, si p.sh. oborrin e shkollës ose ndonjë kopsht të zonës, për të matur lartësinë e bimëve të ndryshme.

Burime

Nëse është e mundur: hyrja në oborrin e shkollës ose në ndonjë kopsht të zonës dhe mundësia për t'u marrë me bimët që rriten aty; etiketa ku janë shkruar numrat 1, 2, 3 dhe 4; një bllok shënimesh për të mbledhur të dhëna nga nxënësit; vizore ose metra shirit; lapsa me ngjyra; materiale pune me dorë.

Nëse nuk ka ndonjë mjedis të hapur të përshtatshëm, përdorni një larmi bimësh në vazo me lartësi të ndryshme, që të mund t'i matin nxënësit.

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të ndajnë informacionin me nxënës të tjerë;
- të krijojnë një grafik (diagram) me shtylla.

Në temën tjetër nxënësit do të mësojnë më shumë rreth faktit se si bimët përdoren si baza e një diete të shëndetshme.



Plotësoni fjalët që mungojnë. Përdorni kutinë e fjalëve.

Kërkojuni nxënësve të plotësojnë fjalën që mungon, duke përdorur fillimisht kutinë e fjalëve. Udhëzojuni drejt përgjigjeve të sakta, duke thënë çdo fjalë dhe duke i pyetur për fjalën që mungon. Përpikuni të mos ua jepni përgjigjet. Nxitini nxënësit të shikojnë kutinë e fjalëve për të gjetur fjalët që mungojnë.

Përgjigje:

Ne nuk i shohim dot bimët duke u **rritur**.

Bimët rriten shumë **ngadalë**.

E dimë që rriten, sepse mund t'i **matim**.



Matja e bimëve

Matni katër bimë me centimetra. Regjistrojini matjet tuaja në grafikun (diagramin) me shtylla.

Nëse keni mundësi të përdorni një ambient të hapur ku rriten bimë, nxirrni nxënësit jashtë. Kur të dilni, tregojuni se si matet një bimë e vërtetë. Do t'ju duhet ta përsërisni demonstrimin gjatë gjithë veprimtarisë, për t'u treguar nxënësve se çfarë bëni.

- Zgjidhni bimë relativisht të vogla (më pak se 30 centimetra, që matjet të zënë vend në grafikun me shtylla).
- Duhet të keni një bllok shënimesh për të mbledhur të dhënat që ju japin nxënësit. Kërkojuni atyre të punojnë në çifte, për të matur katër bimë të ndryshme.
- Ndihmohuni t'i etiketojnë bimët 1, 2, 3 dhe 4, duke përdorur etiketat që keni përgatitur.
- Jepini secilit çift nxënësish nga një vizore ose metër shirit. Kërkojuni t'ju thonë përmasat, ndërsa i nxjerrin, që të mund t'i mbani shkurtimisht shënim në bllok.


Si alternativë, nëse nuk keni mundësi të shkoni në ambiente të hapura të përshtatshme, siguroni katër bimë të ndryshme në vazo, që nxënësit të mund t'i matin. Ndiqni hapat e mësipërm, njësoj si për aktivitetin në natyrë.

Kur të keni shënuar vargun e matjeve, mund t'i organizoni në dërrasë dhe t'u tregoni nxënësve se si t'i përdorin të dhënat, për të krijuar një grafik (diagram) të thjeshtë me shtylla mbi lartësitë e bimëve. Mund të përdorni vizatime të thjeshta bimësh në vend të shtyllave.

Teorikisht duhet të keni të njëjtin numër lartësish për bimët e përdorura, si p.sh.: në total vetëm 4 masa. Praktikisht me gjasë do të ketë mospërputhje, pasi nxënësit që kryejnë matjet nuk mund të jenë edhe aq të saktë në këtë moshë. Shpjegojuni se do të përdorni masën që i ka dalë shumicës së nxënësve, për secilën bimë. Duhet t'i siguron nxënësit se edhe nëse nuk kanë matur masën e saktë, ata nuk kanë gabuar. Kjo ndodh, sepse toka ose përzjerja e dheut me plehun nuk ishte e rrafshët.

Pastaj kërkojuni nxënësve të përdorin letren e milimetruar në bllokun e shënimeve të hetimit, për të kopjuar grafikun (diagramin) me shtylla në dërrasë dhe për të ngjyrosur më pas secilën nga shtyllat në grafik. Nxënësit më të shkathët mund të përdorin matjet e tyre, nëse ato janë mjaftueshëm të sakta.

Përgjigje: Shembull i plotësimit të një grafiku (diagrami) me shtylla:



Shkencëtarët bëjnë më shumë se matja dhe regjistrimi i gjërave. Rrethoni fjalët shkencore.

Diskutoni thënien e mësipërme me nxënësit para se ata të rrethojnë fjalët shkencore. Kujtoni kapitullin "Si të bëhesh shkencëtar" (faqet 2-5) me ta dhe diskutoni se çfarë është studimi shkencor.

Përgjigje: parashikoj, emërtoj, krahasoj.

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Kërkojuni nxënësve të bëjnë modele të bimëve për një ekspozitë klase. Ata mund të përdorin materiale për t'u hedhur, si kartonë, por edhe materiale punëdoreje, si letër të hollë me ngjyra, ngjites dhe bojë.



Si mendon? Përgjigja është sekvoja gjigante në Kaliforni. Është 116 metra e lartë. Gjithsesi, pyetja e kësaj rubrike duhet të nxitë shumë përgjigje, por jo me domosdoshmëri të saktën. Qëllimi i saj është të zhvillojë të kuptuarit se ka shumë bimë përtej atyre që njohin nxënësit dhe se bimët kanë shumë masa dhe forma.



Vizato bimën tënde. Mund të ketë çfarëdolloj mase, forme ose ngjyre.

Nxitini nxënësit të jenë vërtet krijues me këtë detyrë. Lavdërojin të gjitha vizatimet që krijojnë në *Librin e nxënësit*.

Rritja e bimëve

Nxënësit zbulojnë se si farat mbijnë, rriten dhe shndërrohen në një bimë të lulëzuar.

Rritja e bimëve

Ti zbulon se si mbijnë farat dhe bëhen bimë me lule.

Ideja kryesore

Ne duhet të hamë fruta dhe perime për të qenë të shëndetshëm.

Përdor fletoren tënde të zbulimeve. Vizato frutën që të pëlqen më shumë. A e gjen dot se cila frutë i pëlqen më shumë shokut ose shoqes tënde?

Vizato perimen që të pëlqen më shumë. A e gjen dot se cila perimë i pëlqen më shumë shokut ose shoqes tënde?

Pse i rritim bimët? Disa bimë i rritim, sepse na japin ushqim që hamë. Njerëzit dhe kafshët hanë ushqim që merret nga bimët. Disa bimë i rritim pasi duken të bukura dhe kanë aromë të këndshme.

Rretho arsyet pse rrisim bimë.

Të luajmë me to Kanë erë të mirë Për të shëtitur

Janë të mira për t'u ngrënë Duken bukur Për t'i bërë dhuratë

Ngjyros bimët që mund të hahen.

Petunia Bimë e karotës Pema e bredhit Bimë e misrit

Bimë e luleshytrës

Pema e mollës

Plotëso fjalitë. Përdor kutinë e fjalëve.

Ne rritim shumë bimë për _____

Ne kemi nevojë të hamë fruta dhe _____ për të qenë të _____

Ne nuk e shikojmë rritjen e bimëve, por mund të _____ sa shumë janë rritur ato.

Kutia e fjalëve: ushqim - perime - shëndetshëm - matim

Tani shiko në faqen 99 për të kontrolluar se çfarë di.

Si të fillojmë

Kjo temë mëson se shumë bimë i rrisim për të siguruar ushqim. Kjo lidhet me idenë e të ngrënit të shëndetshëm. Është tema e fundit e kapitullit të rritjes së bimëve dhe nuk kërkohet planifikim paraprak. Mund ta përdorni këtë kapitull për të kontrolluar të gjitha veprimtaritë e kryera deri tani dhe për të përfunduar çdo rezultat të marrë. Për ta përmbyllur temën, ju mund t'u jepni leje nxënësve t'i marrin luledielli të tyre në shtëpi, që të vazhdojnë të kujdesen për to. Zakonisht kjo mirëpritet nga nxënësit e kësaj moshe.

Burime

Materiale krijuese.

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të kuptojnë se bimët na japin ushqim;
- të identifikojnë arsyet pse ne rrisim bimë.

Në temën që vijon, nxënësit do të mësojnë se çfarë u duhet bimëve që të rriten.

94

Vizatoni frutën që ju pëlqen më shumë. A mund ta gjeni se cilën frutë pëlqen më shumë shoqja jote?

Vizatoni perimen që ju pëlqen më shumë. A mund ta gjeni se cilën perime pëlqen më shumë shoqja jote?

Thojuni nxënësve se ne duhet të hamë shumë fruta dhe perime për të qenë të shëndetshëm. Kërkojuni

të shikojnë foton e frutave dhe të perimeve. Pastaj kërkojuni të ndahen në çifte dhe të vizatojnë të preferuarat e tyre në bllokun e shënimeve të zbulimeve. Thojuni të pyesin shokun e tyre:

- A mund ta gjesh se cila është?
Përgjigje të mundshme: mollë, karotë.

Shkruani përgjigjet e çdo çifti në dërrasë.



Përsërisni emrat e perimeve dhe të frutave për të përforcuar dijet mbi emrat e tyre.

Kërkoni që nxënësit të shkruajnë emrin e frutave dhe të perimeve të preferuara të shokut në hapësirat e Librit të Nxënësit.



Pse i rrisim bimët?

Kërkojuni nxënësve të shikojnë fotot e grurit dhe të bukës në *Librin e nxënësit*. Nxitini të përgjigjen se buka bëhet nga mielli, i cili bëhet nga bluarja e grurit në mulli. Nxitini të përgjigjen mbi lidhjen mes bimëve dhe ushqimit. Pyetini nxënësit sa ushqime që vijnë nga bimët mund të gjejnë.

Në vijim kërkoni prej nxënësve të shikojnë figurat e luleve në *Librin e nxënësit*. Pyetini nëse u pëlqejnë lulet ose jo. Diskutoni me ta përvojën e nuhatjes së luleve. Mund të sillni lule në klasë, që nxënësit t'i nuhasin. Pyetini se cilat lule, aroma dhe ngjyra u pëlqejnë më shumë. Nxitini të përgjigjen se disa bimë i rrisim, sepse duken bukur dhe vijnë erë të mirë. Bisedoni rreth faktit që disa njerëzve u pëlqen të kenë bimë të lulëzuara në shtëpi e kopshte dhe se ndonjëherë është e këndshme të japësh lule si dhuratë.



Rretho arsyet pse rrisim bimë.

Kërkojuni nxënësve të shikojnë në *Librin e nxënësit* pohimet rreth arsyeve pse rrisim bimë. Lexojini një nga një dhe pas secilit prej tyre pyesni: I rrisim bimët për këtë arsye? Kërkojuni nxënësve të përgjigjen duke ngritur duart. Nëse arsyeja është e saktë, kërkojuni nxënësve ta rrethojnë atë në *Librin e nxënësit*. Nxënësit nuk duhet të rrethojnë arsye të pasakta. Shembuj pyetjesh:

- A mund të hahen disa bimë? *Po – rrethoje arsyen.*
- A i rrisim bimët për të luajtur me to? *Jo – nuk ka nevojë për rreth.*
- A duken bukur disa bimë? *Po – rrethoje arsyen.*
- A rrisim bimët që të dalim shëtitje me to? *Jo – nuk ka nevojë për rreth.*

- A vijnë erë të mirë disa bimë? Po - rrethoje arsyen.
- A mund t'i japim bimët si dhurata? Po - rrethoje arsyen.



Flisni për fjalën “dhuratë”. Shpjegoni se kjo fjalë është njësoj me “peshqesh”. Pyetini nxënësit se kur japin ose marrin dhurata. Shtoni fjalët “dhurata” dhe “peshqesh” në “Murin e fjalëve”, shoqëruara nga vizatimet e dhuratave ose peshqesheve të vizatuara nga nxënësit.

Përgjigje:

Janë të mira për t'u ngrënë.

Duken bukur.

Kanë erë të mirë.

Për t'i dhuruar.



Ngjyrosni bimët që mund të hamë.

Kërkojuni nxënësve të shikojnë figurat e bimëve në *Librin e nxënësit*. Aty ka tri bimë të ngrënshme dhe tri bimë të pangrënshme. Kërkojuni nxënësve të emërtojnë secilën prej tyre. Emrat e bimëve gjenden në *Librin e nxënësit*.



Nxitini nxënësit t'i lexojnë emrat nga libri, për të mbështetur zhvillimin e tyre gjuhësor. Jepuni modelin e saktë si shkruhet fjala, që ata ta kopjojnë.

Kërkojuni nxënësve të ngjyrosin vizatimet e bimëve që hahen dhe të lënë pa ngjyrosur ato që nuk hahen.

Përgjigje: Nxënësit duhet të ngjyrosin vizatimet në vijim: pemën e mollës, bimën e karotës, bimën e misrit.

Vlerësim formues



Plotësoni fjalitë. Përdorni kutinë e fjalëve.

Ndihmohuni nxënësit të plotësojnë veprimtarinë e vlerësimit formues, duke shkruar fjalitë në dërrasë. Pastaj lexojini me zë të lartë, duke u dhënë nxënësve mundësinë që të përdorin fjalët në kutinë e fjalëve, për të sugjeruar fjalën (fjalët) që mungojnë. Kërkojuni nxënësve t'i shkruajnë përgjigjet në *Librin e nxënësit*.

Përgjigje:

Ne mund t'i rrisim bimët si **ushqim**.

Ne kemi nevojë të hamë fruta dhe **perime** për të qenë të **shëndetshëm**.

Ne nuk mund t'i shohim bimët duke u rritur, por mund të **matim** sa janë rritur.

Përsëritje dhe reflektim

Përmbylleni temën duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë “Çfarë mësuam...” në faqen 99 të Librit të Nxënësit. (Shikoni edhe shënimet e mësimdhënies në faqen 100.)

Mbështetje gjuhësore

Kërkojuni nxënësve të shtojnë në “Murin e fjalëve” pamje të bimëve të rritura për arsye të ndryshme. Ata mund t'i organizojnë këto pamje nën kolona si: bimë për ushqim, bimë që duken bukur, bimë që vijnë erë të mirë etj. Mund të vënë dhe emrat e bimëve.

Veprimtari më të zgjeruara

Sigurohuni që nxënësit ta kenë kompletuar fjalorin për këtë temë.

Për çfarë kanë nevojë bimët që të rriten

Nxënësit mësojnë se bimët kanë nevojë për dritë dhe ujë që të rriten.

Për çfarë kanë nevojë bimët që të rriten

Ti zbulon se bimët kanë nevojë për dritë dhe ujë që të rriten.

Ideja kryesore

Bimët nuk rriten mirë në errësirë.

Vështro fotografinë.

☐ Çfarë dalloni?

☒ Zbulo: A kanë nevojë për dritë bimët që të rriten?

Do të zbulosh nëse bimët kanë nevojë për dritë që të rriten. Të duhen dy lëvozhga vezësh për të rritur farat e majdanozit.

1. Dekoro lëvozhgat e vezëve.
2. Vendos pambuk në fund të lëvozhgave.
3. Hidh pak ujë mbi pambuk dhe vendos aty farat.

Parashiko se çili fidan do të rritet më mirë.

☐ Si mund ta bësh të besueshëm zbulimin tënd?

Si mendon?
A mund të hahen bimët që rriten në errësirë?

Si të fillojmë

Kjo temë prezanton kushtet e nevojshme për rritjen e bimëve dhe përqendrohet mbi faktin se si drita është e nevojshme për rritjen e tyre. Tema tjetër tregon se si uji është i nevojshëm për rritjen e bimëve. Kontrolloni listën e burimeve për detajet e pajisjeve që do t'ju duhen në këto dy tema.

Burime

Fara groshile, lëvozhga veze të boshatisura, mbajtëse vezësh kartoni për 6 vezë (njërën etiketojeni "dritë" dhe tjetrën "errësirë"); pambuk, ujë; materiale krijuese për të zbukuruar lëvozhgat e vezëve; lapsa me ngjyra.

Fjalë kyçe të kërkimit shkencor

parashikoj

testim (provë) me një ndryshore

Vështrim i shpejtë mbi temën

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të mësojnë se bimëve u duhet dritë që të rriten;
- të mbjellin dhe të rrisin farat e majdanozit, për të provuar se bimëve u duhet dritë që të rriten;
- të kuptojnë idenë e një testimi me ndryshore.

Në temën që vijon, nxënësit do të mësojnë më shumë rreth faktit se bimëve u duhet ujë që të rriten.



Çfarë mund të dalloni?

Kërkojuni nxënësve të shikojnë foton në *Librin e nxënësit*. Aty tregohen bimë që janë rritur në errësirë. Filloni një diskutim mbi atë që mund të shohin nxënësit. Bëni pyetjet:

- Mendoni që bimët duken të shëndetshme? Pse? Jo, sepse gjethet e tyre janë të verdha.

Përgjigje e mundshme: Gjethet të verdha.



Zbulo: A kanë nevojë për dritë bimët që të rriten?

Synimi i kësaj veprimtarie është t'i ndihmojë nxënësit të zbulojnë se bimëve u duhet dritë që të rriten. Farat e majdanozit përdoren, sepse rriten shpejt dhe kanë rezultate të dukshme.

Do t'ju duhen: fara majdanozi, lëvozhga vezësh për t'i zbukuruar, mbajtëse vezësh kartoni.

1 Zbukuroni lëvozhgat.

- Shpjegojuni nxënësve se do të vëzhgojnë nëse bimëve u duhet dritë për t'u rritur. Pastaj jepuni nga një lëvozhgë veze secilit (ose në çifte) dhe kërkonin që t'i zbukurojnë e t'u vënë emrin sipër.
- Nëse punojnë në çifte, një lëvozhgë veze mund të përdoret për t'i rritur farat në dritë dhe tjetra për t'i rritur në errësirë.
- Nëse punojnë individualisht, secili nxënës duhet të ketë dy lëvozhga veze. Thojuni nxënësve se duhet të tregojnë shumë kujdes me lëvozhgat e vezëve, pasi ato thyhen lehtë.

2 Vini pak pambuk përfund çdo lëvozhgë.

- Demonstrojuni se si vihet pak pambuk në lëvozhgën e vezës.

3 Shtoni pak ujë dhe vëriini farat sipër.

Demonstroni hedhjen e sasisë së vogël të ujit dhe pastaj vendosjen e farave mbi pambuk. Përsëriteni këtë për një lëvozhgë të dytë. Vëzhgojini nxënësit ndërsa veprojnë si ju.



Si mund ta bëni testimin (provën) të besueshëm?

Ndërsa po demonstroi, njihini nxënësit me idenë e një testimi me ndryshore, duke bërë pyetjen:

- Si mund të sigurohem se është një testim i besueshëm?

Jepuni nxënësve të dhëna duke treguar farat, pambukun dhe ujin. Përpikuni t'i nxitni të përgjigjen se duhet të kontrollohen ndryshoret, p.sh. duke mbajtur sasinë e ujit, numrin e farave

dhe sasinë e pambukut të njëjtë për çdo lëvozhgë veze. Ju mund t'u tregoni nxënësve dy mbajtëse vezësh me fara të mbjella majdanozi, një me më shumë fara se tjetra dhe pastaj t'i pyesni nëse ky testim do të ishte i besueshëm. Pastaj pyetini:

- Pse mendoni se ju duhet të përdorni dy lëvozhga veze? *Për të krahasuar se si rriten bimët.*

Ideja që qëndron pas pyetjes është që t'i nxitni të përgjigjen se na duhet ta kontrollojmë hetimin mbi një ndryshore. Udhëhiqini nxënësit drejt përgjigjes, duke përforcuar se po hetojnë nëse bimëve u duhet dritë që të rriten.



Ngjyrosni këto skica, për të treguar se çfarë mendoni se do të ndodhë.

Thojuni nxënësve të shikojnë skicat në *Librin e nxënësit* dhe kërkojuni të parashikojnë rezultatet e zbulimit të tyre. Pyetini nxënësit se çfarë mendojnë se do t'u ndodhë farave ndërsa rriten, duke pyetur:

- Çfarë ngjyre mendoni se do të kenë gjethet e bimëve të rritura në dritë? Të gjelbër.
- Çfarë ngjyre mendoni se do të kenë gjethet e bimëve të rritura në errësirë? Të verdhë.

Nxënësve u jepet skica e bimëve që duhet të ngjyrosin për të treguar parashikimet e tyre.



Shpjegojuni se një testim me ndryshore do të thotë se po përdorim më shumë se një kampion kur testojmë, p.sh.: dy lëvozhga veze. Vazhdoni duke shpjeguar se mund të ndryshojmë vetëm një gjë (dritë dhe errësirë) dhe ta ruajmë gjithçka tjetër të njëjtë (çdo lëvozhgë veze ka të njëjtat gjëra brenda: pambuk, ujë dhe fara).

Përgjigje e mundshme: Përdorim të njëjtat gjëra për secilën lëvozhgë veze.

Kur farat janë mbjellë, vendosini lëvozhgat e vezëve në mbajtëse vezësh. Sigurohuni të keni dy të tilla për secilin nxënës ose çift dhe që njëra lëvozhgë të vendoset në mbajtësen e emërtuar "dritë", ndërsa tjetra të vendoset në atë të emërtuar "errësirë".

Kujtojuni nxënësve se po hetojnë nëse bimëve u duhet dritë që të rriten. Pyetini:

- Çfarë mendoni se duhet të bëjmë tani me farat? *Do ta vëmë njërën mbajtëse vezësh diku në errësirë. Do ta vëmë mbajtësen tjetër diku që ka dritë.*

Njërën vëreni në një vend të ndriçuar dhe tjetrën në një vend të errët.

Kontrollojini farat që rriten çdo ditë dhe hidhuni sa ujë u nevojitet. Duhet t'i shihni të rriten brenda 3-5 ditësh.

Mbështetje gjuhësore

Përdorni veprimtaritë e diskutimit për të folur mbi atë që nxënësit kanë bërë gjatë kësaj teme dhe çfarë kanë mësuar. Nxitini nxënësit të përdorin disa nga fjalët me të cilat po familjarizohen: për shembull, "testim me ndryshore" dhe "krahaso".

Veprimtari më të zgjeruara

- 1 Kërkojuni nxënësve të vizatojnë një skicë të bimëve të tyre të lulëdiellit, të rezultateve para dhe pas, në raport me kohën e tanishme. Nxitini që të lënë vend në faqe për të shtuar më vonë, ndërsa lulëdielli rritet.



Si mendon? Kjo pyetje është menduar për të zgjeruar të menduarit dhe për të sfiduar nxënësit. Prisni përgjigje si: *Po, por ato mund të mos jenë aq të shijshme sa bimët e rritura në dritë. /Jo, sepse nuk do të ishin të shijshme. /Nuk jam i/e sigurt.*

Pranoni secilën nga këto përgjigje dhe shpjegoni se bimët që rriten në errësirë nuk do të na helmojnë (sëmurin), por mund të mos kenë aq shumë shije sa bimët e rritura në dritë.

Për çfarë kanë nevojë bimët që të rriten

Nxënësit mësojnë se bimët kanë nevojë për dritë dhe ujë që të rriten.

Për çfarë kanë nevojë bimët që të rriten

Ti zbulon se bimët kanë nevojë për dritë dhe ujë që të rriten.

Ideja kryesore

Nëse një bimë nuk merr mjaftueshëm ujë, ajo do të vishket dhe do të vdesë.

Shiko figurën.

☐ **Fal për atë që** shikon në këto figura.

A ke ngrënë ndonjëherë karote që nuk është e freskët?

Nëse po, do ta keq vënë re se kur e kafshon ajo është e butë dhe nuk kërcet në gojë. Kjo, sepse karota e freskët ka shumë ujë. Po ujë karota **vyshket**.

Kaktusi ka nevojë për shumë pak ujë.

Zbulo: A kanë nevojë bimët për ujë që të rriten?

1. Merr një bimë që ka nevojë për ujë.
2. Hidhi pak ujë asaj çdo ditë.
3. Shiko se çfarë ndodh.

☐ Vizatoje bimën, në fillim dhe në fund të zbulimit.

Në fillim Në fund

Plotëso me fjalët që mungojnë. Përdor kutinë e fjalëve.

Bimët kanë nevojë për dritë dhe ujë që të rriten.

Po nuk pati dritë gjethet e bimës _____.

Po nuk pati ujë gjethet e bimës _____.

Kurta e fjalëve: **ujë, vyshken, zverden**

Tani shiko në faqen 99 për të kontrolluar se çfarë di.

Si të fillojmë

Në këtë temë nxënësit hetojnë nëse bimëve u nevojitet ujë që të rriten. Tema kërkon planifikim paraprak. Do t'ju duhet të siguroni bimë që nuk janë ujitur dhe që po fishken. Barbarozat dhe petuniat janë shumë mirë, pasi ato e marrin veten shumë shpejt, pas riparimit të nivelit të lagështirës. Do t'ju duhen edhe disa shkopinje selinoje, të freskët e të fishkur.

Burime

Bimë të fishkura, kova të vogla plastike për të ujitur; tri enë me përzierje dheu me pleh: një me tepri uji, një shumë e thatë dhe një e njomë sa duhet, për qëllime krahasimi; shkopinje selinoje, të freskët për t'u ngrënë dhe të fishkur për krahasim – nuk duhet të hahen; materiale krijuese, mundësi për të larë duart.

Përsëritje dhe reflektim

Mësimdhënia e kësaj teme synon që nxënësit:

- të mësojnë se bimëve u duhet ujë që të rriten;
- të mësojnë se nëse bimët nuk ujiten, ato do të vishken dhe do të thahen;
- t'i krahasojnë bimët para dhe pasi janë ujitur;
- të plotësojnë grumbullimin e të dhënave nga hetimet e tjera;
- të konsolidojnë kuptimin e fjalëve kyçe të kapitullit.

Në temën që vijon, nxënësit do të shqyrtojnë dhe mendojnë mbi atë që kanë mësuar në këtë kapitull.



Flisni për atë që shihni në fotografi.

Kërkojuni nxënësve të shikojnë fotot e bimëve që janë ujitur dhe të bimëve që janë vyshkur. Filloni një diskutim rreth asaj që shohin nxënësit. Prisni përgjigje përshkruese. Nxitini nxënësit të krahasojnë të dyja bimët.



Paraqitni fjalën “vyshk” për të përshkruar atë që u ndodh bimëve që nuk janë ujitur. Shpjegoni se gjethet dhe kërcelli zbuten shumë dhe mund të fillojnë të thahen, nëse nuk u hedhim ujë.

Përgjigje e mundshme: Një bimë që po thahet dhe një bimë e shëndetshme.

Tregojuni nxënësve shkopinjtë e freskët të selinos dhe kërkojuni t'i kafshojnë. Nxitini të përgjigjen që selinoja është e fortë dhe kërcet në gojë. Pastaj tregojuni nxënësve selinon e vyshkur dhe tregojuni se si mund ta përthyeri selinon e vyshkur, por këtë nuk mund ta bëni me shkopinjtë e selinos së freskët. Selinoja e vyshkur nuk duhet ngrënë.

Kërkojuni nxënësve t'ju thonë, pse sipas tyre selinoja u përkul. Nxitini të përgjigjen se nuk është ujitur.

Nëse nuk arrini të gjeni selino, përdorni një tjetër perime kërce, si marulet.



Zbulo: A kanë nevojë për ujë bimët që të rriten?

Synimi i kësaj veprimtarie është që nxënësit të krahasojnë se çfarë i ndodh një bimë të vyshkur para dhe pasi e ujitim dhe të dallojnë se bimëve u duhet ujë që të rriten.

Do t'ju duhen: bimë të vyshkura, ujitëse.

Fillojeni veprimtarinë duke pyetur:

- Si mund ta zbulojmë nëse bimës i duhet ujë për t'u rritur? *Duke mos i hedhur ujë një bime/ duke ujitur një bimë të vyshkur dhe duke parë se çfarë ndodh.*

1 Merrni një bimë që ka nevojë për ujë.

- Jepini një çifti nxënësish një bimë të vyshkur.
- Kërkojini secilit çift të bëjë një etiketë me emrat e tyre, që ta vendosin në krah të bimës së vet.



Vizatojeni bimën tuaj në fillim dhe në fund të kësaj veprimtarie.

Kërkojuni nxënësve të vizatojnë dhe të ngjyrosin bimët e tyre në kutinë “Fillimi” në *Librin e nxënësit*.

Nxitini nxënësit të vizatojnë gjethet e fishkura.

2 Hidhni bimës çdo ditë pak ujë.

- Tregojuni nxënësve tri enët me përzierje dheu me pleh, që i keni përgatitur për të treguar sasinë e nevojshme të ujit.
- Shpjegoni se përzierja e dheut me pleh nuk duhet të jetë as shumë e lagësht dhe as shumë e thatë. Merrni pak nga përzierja e thatë e dheut me pleh dhe shkërmoqeni në dorë, duke e lënë të derdhet sërish në enë. Merrni pak nga përzierja e njomë e dheut me pleh dhe tregojuni ndryshimin.
- Pastaj merrni ca nga përzierja shumë e lagur e dheut me pleh dhe shtrydhjeni, për të treguar se si rrjedh uji prej saj.
- Lejojini nxënësit të prekin përzierjen e dheut me pleh, për të kontrolluar se si duhet të jetë.



Sigurohuni që nxënësit t'i lajnë duart pasi kanë prekur përzierjen e dheut me pleh.

- Tregojuni se si të ujitin një bimë, derisa përzierja e dheut me pleh të njomet. Bëjeni këtë gradualisht, duke e kontrolluar përzierjen e dheut me pleh, ndërsa shtoni ujë.
 - Jepini secilit çift nxënësish një kovë të vogël plastike për ujitje dhe thojuni të ujitin bimët e tyre çdo ditë për një javë.
- ## 3 Shikoni se çfarë ndodh.
- Thojuni nxënësve t'i vënë bimët e tyre me etiketa në një vend me dritë, si p.sh. parvazi i një dritareje.

Në fund të javës, kërkojuni nxënësve të vizatojnë bimën e tyre në kutinë "Fundit" në *Librin e nxënësit*. Pyetini:

Çfarë kanë ndryshe bimët tani? *Gjethet janë më të gjelbra dhe bima ka filluar të rritet sërish.*

Kërkojuni nxënësve të kontrollojnë të gjitha vëzhgimet, për të parë nëse kanë rezultate të reja dhe të punojnë me to për të përmbushur ndonjë informacion që u mungon, pastaj t'i shtojnë në seksionet përkatëse të Librit të Nxënësit.

Për shembull, farat e majdanozit duhet të jenë rritur dhe nxënësit mund të shohin nëse vëzhgimet përkujtojnë me parashikimet e tyre. Luledielli duhet të ketë filluar të bëhet një bimë e vogël. Bima e vyshkur duhet të ketë treguar shenja rigjallërimi. Sigurohuni që të gjithë nxënësit të përfshihen në veprimtari domethënëse të të nxënës.

Vlerësim formues



Plotësoni hapësirat boshe. Përdorni kutinë e fjalëve.

Kërkojuni nxënësve të plotësojnë fjalën që mungon në fjali. Shkruajini fjalitë në dërrasë dhe thoni, për shembull: Bimëve *u duhet dritë dhe...? që të rriten*. Nxitini nxënësit të shikojnë kutinë e fjalëve për fjalën e duhur.

Përgjigje:

Bimët kanë nevojë për dritë dhe **ujë** që të rriten.

Po nuk pati dritë gjethet e bimës **zverdhen**.

Po nuk pati ujë gjethet e bimës **vyshken**.

Përsëritje dhe reflektim

Përmbylleni temën duke u kërkuar nxënësve të plotësojnë "Çfarë mësuam për rritjen e bimëve" në faqen 99 të Librit të Nxënësit. (Shiko edhe shënimet e mësimdhënies në faqen 101).

Mbështetje gjuhësore

Provoni se sa mirë i kanë mësuar nxënësit fjalët dhe idetë e mbuluara nga ky kapitull, duke bërë pyetje-rrufe. Për shembull:

- Ç'emër ka pajisja që përdorim për të matur gjërat? *Vizore*.
- Ku mund t'i gjejmë rrënjët? *Në pjesën e poshtme të bimëve*.

Veprimtari më të zgjeruara

Kërkojuni nxënësve t'u hedhin një sy fjalorëve të tyre dhe të shtojnë ndonjë përkufizim që u mungon, në lidhje me fjalët kyçe të këtij kapitulli.

Çfarë mësuam për rritjen e bimëve

Çfarë mësuam për rritjen e bimëve

Pjesët e bimës

Rretho fjalët për katër pjesët e një bime. Pastaj lidhi ato me vijë me pjesën e saktë të bimës.

dora

lulja

gjetheja

kërceji

rrënjët

qelq

zëri

familja

Unë i di emrat e katër pjesëve të një bime.

Rritja e bimëve

Rrit disa luledielli. Lidh fjalitë me figurat.

1. Merr një vazo. Vendosi disa guralecë në fund të saj.

2. Mbush vazën me dheur e pleh. Ujto.

3. Mblidh dy fara luledielli.

4. Ujit filizot.

Unë e di se farat mbijnë dhe bëhen bimë e pemë.

Për çfarë kanë nevojë bimët që të rriten

Shiko figurat e bimëve dhe lexo fjalitë. Rretho fjalët e sakta.

a Kjo bimë ka/nuk ka pasur ujë sa duhet.

b Kjo bimë ka/nuk ka ujë të mjaftueshëm.

c Kjo bimë është rritur në dritë/errësirë.

Unë e di se bimët kanë nevojë për dritë dhe ujë që të rriten mirë.

e rrethuara, për pjesën e saktë të bimës në figurë.

Përgjigje: Lulja, gjethja, kërcelli, rrënjët.

Nxënësit duhet të kenë bërë vija për të lidhur secilën nga këto fjalë me pjesën përkatëse të bimës.



Përmendni një gjethë që mund ta hani.

Përmendni një rrënjë që mund ta hani.

Nxënësit tani i zbatojnë njohuritë mbi pjesët e bimëve, për të dhënë shembuj mbi pjesët e ngrënshme të bimës. Kërkojuni nxënësve të sugjerojnë disa përgjigje të mundshme dhe shkruajini në dërrasë, që ata të zgjedhin.

Mund edhe t'u kërkonti të japin shembuj lulesh dhe kërcesh të ngrënshëm. Sillini shembuj të vërtetë ose foto të gjethëve, të kërcjeve, të rrënjëve, të luleve e të frutave të ngrënshme.



Kujtojuni nxënësve se jo të gjitha bimët janë të ngrënshme!

Përgjigje e mundshme: Gjethja: marule, spinaq.

Rrënja: karotë, patate etj.

Si të fillojmë

Qëllimi i këtij seksioni është që të nxisë nxënësit të shqyrtojnë të nxënët e tyre pas çdo teme në kapitull. Çdo temë ka disa pyetje përforcuese që t'i përgjigjen nxënësit. Këto do të vlerësojnë njohuritë e nxënësve dhe të kuptuarin e tyre mbi temën.

Pas çdo serie pyetjesh përforcuese, ka një model "çfarë mësuam..." të cilit nxënësit duhet t'i përgjigjen. Duhet të kaloni përmes modelit dhe t'i ndihmoni nxënësit të plotësojnë rrethin e vetëshqyrtimit, për të parë se sa të sigurt janë mbi secilin temë. Nxënësit mund të ngjyrosin një fytyrë të lumtur ose të trishtuar për të treguar nivelin e tyre të sigurisë.

Është e rëndësishme që të marrin informacion ku nuk ndihen të sigurt. Ky informacion është thelbësor për mësuesin, për të bërë korrigjimet e nevojshme në fund të vlerësimit përmbledhës të kapitullit.

Përsëritje dhe reflektim

Pjesët e një bime



Rrethoni fjalët për katër pjesët e një bime. Pastaj lidhni ato me vijë me pjesën e saktë të bimës.

Kjo veprimtari teston aftësinë e nxënësve për të dalluar fjalët kyçe për pjesët e një bime. Lexoni me zë të lartë secilën fjalë me radhë dhe pyesni, për shembull:

- Lulja. A është lulja pjesë e një bime? Po.
- Dora. A është dora pjesë e një bime? Jo.

Mund t'u jepni laps që thekson fjalët, që ata ta theksojnë dhe ta rrethojnë fjalën e duhur. Në vijim kërkojuni nxënësve të përdorin një vizore dhe një laps për të hequr vija, të cilat lidhin secilën nga katër fjalët

Rritja e bimëve



Rrisni disa luledielli. Lidhni fjalitë me figurat.

Kërkojuni nxënësve të rikujtojnë se si i rritën lulediellit nga farat. Mund t'i keni gati para klasës pajisjet e nevojshme për të mbjellë një bimë dhe t'u kërkonti nxënësve t'ju udhëzojnë mbi atë që duhet të bëni. Për shembull:

- Cila është gjëja e parë që bëjmë kur mbjellim fara? Vëmë guriçka në fund të vazos.

Nxitini nxënësit nëse është e nevojshme, duke i pyetur p.sh.:

- Çfarë vëmë në fillim, përzierjen e dheut me pleh apo guriçkat? Guriçkat.

Bëni pyetje të mëtejshme dhe ndiqni udhëzimet e nxënësve për të përfunduar mbjelljen e farave, pastaj kërkojuni nxënësve ta plotësojnë veprimtarinë përkatëse në *Librin e nxënësit*.

Tregojuni nxënësve shembuj farash të ngrënshme (p.sh. thjerrëzat, arrat e kokosit, bizelet). Prisni disa fruta dhe tregojuni farat brenda. Pyetini se cila bimë rritet nga secila farë. Nxitini nxënësit të tregohen kureshtarë se si fara kaq të vogla mund të krijojnë bimë të mëdha, madje edhe pemë gjigante.

Përgjigje: 1 c, 2 d, 3 b, 4 a.

Pyetini nxënësit nëse e dinë përgjigjen e kësaj pyetjeje:

- Cilat janë ato dy fara, mbi të cilat mbështetet për ushqim gjysma e popullsisë së botës? Farat e grurit (sepse me miellin bëhet buka) dhe orizi.

Nxënësit mund të sugjerojnë një larmi ushqimesh. Nëse nuk sugjerojnë miell/bukë ose oriz, tregojuni ju përgjigjen. Tregojuni se që të dyja janë fara barishtesh. Këto fara jo vetëm që rriten e shndërrohen në bimë, por sigurojnë bazën ushqimore për gjysmën e botës.

Siguroni shembuj të farave të grurit e miell dhe kokrra orizi për t'ua treguar nxënësve, si edhe pamje të bimëve.

Për çfarë kanë nevojë bimët që të rriten



Shikoni pamjet e bimëve dhe lexoni fjalitë. Rrethoni fjalët e sakta.

Krahasimi i pasojave kur u japim bimëve ujë e dritë dhe kur ua heqim atë që u duhet, do të përforcojë konceptet kyçe për nxënësit.

Pyetini:

- Çfarë do të ndodhë nëse bimët nuk marrin as ujë e as dritë? *Ato vyshken, zverdhen dhe në fund thahen.*

Tërhiquni vëmendjen se si shkencëtarë, ne nuk e vrasim qëllimisht diçka; ne i rigjallërojmë bimët, para se të jetë shumë vonë.

Theksoni nevojën e përkujdesjes për bimët në shkollë ose në shtëpi dhe kujtojeni nxënësve se si ta bëni këtë. *Duke i ujitur bimët dhe duke i vendosur diku me shumë dritë, p.sh. në parvazin e një dritareje.*

Përgjigje:

- Kjo bimë nuk ka pasur ujë sa duhet.*
- Kjo bimë ka ujë të mjaftueshëm.*
- Kjo bimë është rritur në dritë.*

Vlerësim përmbledhës

Modeli “çfarë mësuam” në *Librin e nxënësit* është një pikënisje e shkëlqyer, kur diskutohet për përparimin individual të secilit nxënës. Ky informacion mund të përdoret edhe për të krijuar raporte për secilin prej tyre në përfundim të semestrit.

Mund të jetë i nevojshëm edhe për të mbajtur një raport të përgjithshëm për nivelin e sigurisë së mbarë klasës, për të identifikuar zonat që më vonë mund të duan një rishikim (shiko një tabelë me shembuj më poshtë).

Detyra për “Çfarë mësuam për rritjen e bimëve”	Shumë të sigurt	Jo edhe aq të sigurt	Të pasigurt

Ky raport më pas mund të përdoret për krijuar një program përplotësues, për t'i ndihmuar nxënësit të përmirësohen. Bëjini sa më thjeshta regjistrimet dhe analizat e vetëvlerësimit të nxënësve. Kërkohet vetëm një përshtypje e përgjithshme e vetëvlerësimit të klasës dhe jo të dhëna individuale të nxënësve, p.sh.: 50% e klasës nuk ishin të sigurt për...

1 Fjalorth

bimë	gjallesë që e krijon ushqimin e saj duke përdorur dritën e diellit. Pemët, bari dhe shkurret janë lloje bimësh.
(të) dëgjuarit	një nga shqisat tona. Kur diçka lëshon tingull, ne e dëgjojmë me veshët tanë.
farë	prej sajë mbin një bimë e re.
gjethe	prej saj bimët krijojnë ushqim.
kërcell	kërcelli është pjesa e fortë e një bime, që mban gjethet.
krahasoj	kërkoj ngjashmëritë dhe ndryshimet. Për shembull, kur krahasojmë flokët, mund t'i krahasojmë si të shkurtër e të gjatë.
kthim	i ndryshoj drejtim diçkaje që po lëviz. Kthej një çelës ose dorezën e një dere.
(i) lartë (tingull)	një tingull i lartë është e kundërta e një tingulli të butë ose të heshtur, të ulët. Koncertet me muzikë të drejtpërdrejtë, sirenat dhe alarmet kundër zjarrit, kanë tinguj shumë të lartë.
lëkundje	lëvizje sa para, pas. Mund të lëkundni krahët ose të luani me një shilarës.
lule	pjesë e një bime, që krijon farat.
ndalje	e kundërta e nisjes. Për shembull, kur niseni, vraponi dhe ndaloni. Kur ndaleni, nuk po vraponi më.
e ngadaltë	i duhet kohë e gjatë të lëvizë. Një breshkë është shumë e ngadaltë.
rrënjë	mbajnë bimët si spirancë pas tokës. Bimët përthithin ujin përmes rrënjëve. Ne i hamë rrënjët e disa bimëve.
rritje	gjallesat rriten dhe zmadhohen. Pemët rriten dhe lartësohen gjatë gjithë jetës së tyre.
parashikoj	nuk e di përgjigjen, por mendoj një që mund të jetë e saktë.

shikoj	përdor sytë, që të dalloj, zbuloj diçka.
(i) shpejtë	lëviz me shumë shpejtësi. Makinat e <i>Formula 1</i> mund të lëvizin shumë shpejt.
testim me ndryshore	test që mund ta përsëritim. Që testimi me ndryshore të jetë i besueshëm, ne ndryshojmë vetëm një gjë, çdo herë.
tingull	krijohet nga lëkundjet. Ju e dëgjoni tingullin me veshë. Kur i bini një dauilleje, lëkura e saj lëkundet dhe krijon një tingull.
(i) ulët	(tingull) e kundërta e "i lartë". Duhet t'i vëmë veshin që të dëgjojmë tingujt e ulët.
ushqim	kafshëve u nevojitet ushqim për energji dhe që t'i ndihmojë të rriten. Bimët e krijojnë vetë ushqimin e tyre nga uji, ajri dhe drita e diellit.
zë	tingulli që bëjmë kur flasim ose këndojmë.
mbaj vesh	mbaj vesh kur përqendrohem dhe përpiqem me ngulm të dëgjoj një tingull. Kur mësuesi flet përpiqemi sa mundemi të mbajmë vesh.